



Shkodër / 2016

Titulli origjinal: *Hak Dostlarmın*
ÖRNEK AHLÂKINDAN - 2

Përktheu: Ilir Hoxha
Redaktor: Zija Vukaj
Kryeredaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama



PROGRESI sh.p.k. _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 67 60 78484
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

NGA MORALI SHEMBULLOR

I TË DASHURVE TË ALLAHUT

-2-

Osman Nuri TOPBASH

PARAFJALA

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili na nxori neve, robërit e Tij, nga “asgjëja” dhe “mosekzistenca” në botën e ekzistencës edhe pse nuk paguam asgjë për këtë, që na krijoi si njerëz midis gjithë krijesave të tjera, që na bëri popullin e Muhamedit ﷺ, midis të gjithë njerëzimit dhe që na nderoi me mirësitë e besimit dhe Kuranit!

Salatet dhe selamet e pafundme qofshin mbin Muhamedin ﷺ, i cili u dërgua si një mëshirë hyjnore për të gjitha botët, që e donte shumë popullin e tij dhe që ishte i butë e i mëshirshëm ndaj tyre. Po ashtu, përshëndetjet qofshin edhe mbi familjen dhe shokët e tij të bekuar!..

Falënderuar qoftë Allahu i Madhëruar, i Cili e bëri të mundur realizmin e librit të dytë me titull **“NGA MORALI SHEMBULLOR I TË DASHURVE TË ALLAHUT”**. Njësoj si në librin e parë, edhe në librin e dytë që keni në duar, jemi përpjekur të shprehim disa nga parimet morale të Islamit nën dritën e Kuranit dhe Sunetit dhe me shembuj nga jeta e profetëve, sahabëve të nderuar, të parëve tanë të mirë dhe të dashurve të Allahut.



Padyshim se këto shkrime modeste, janë veç një hap modest që është hedhur në rrugën përshkrimit të modelit të “njeriut të përkryer”, ku mishërohet personaliteti Islam. Nëse do të mund të flasim mbi temat e shkrimeve që zënë vend në libër, shkurtimisht mund të themi:

Ne, jemi dërguar në këtë botë sprovash për të njohur Allahun e Madhëruar dhe për të qenë robër të Tij. Ndërsa udhëzuesi kryesor që do të na kapë përdore dhe do të na tregojë rrugën në këtë çështje, është Profeti ﷺ. Ai, është një model konkret që na qartëson konceptin e devotshmërisë me të cilën na ka urdhëruar Zoti ynë dhe një personalitet shembullor e i pashoq. Nisur nga kjo, rruga e cila të çon në dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, kalon nga “Bindja me dashuri ndaj Profetit ﷺ”. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”.

(Al-i Imran, 31)

Nga kjo, kuptojmë se Allahu i Madhëruar, dashurinë ndaj Tij, e ka lidhur me bindjen me dashuri dhe me gjithë shpirt ndaj Profetit ﷺ. Kjo, sepse ai nuk flet prej mendjes dhe dëshirës së vet. Çdo gjendje dhe vepër e tij, do të thotë shpjegim dhe qartësim i shpalljes hyjnore. Morali dhe jeta e tij shpirtërore, janë pasqyrimi në jetën reale i të vërtetave Kuranore që kanë zbritur në zemrën e tij të pastër.

Si populli i Muhamedit ﷺ, edhe ne jemi të detyruar të bëhemi **“ZOTËRUES TË KURANIT”**, me qëllim që të jemi në gjendje të ndjekim rrugën e tij të ndritur dhe të përfitojmë prej moralit të tij. Siç shprehet edhe nëna jonë Aisheja ؓ;

«Morali i tij, është Kurani.»¹ Prandaj, për të zbukuruar botën tonë të brendshme me ndjenjat e tij shpirtërore, më parë kemi nevojë të edukohemi shpirtërisht me frymëzimin e Kuranit Fisnik.

Profeti ﷺ, sahabët e tij, i edukoi në këtë mënyrë edhe kur ishte në kushtet më të vështira. Gjithashtu, me këtë edukim e ka këshilluar edhe popullin e tij që do të vijë deri në ditën e kijametit. Kjo, sepse vetëm në atmosferën e Kuranit njeriu mund ta gjejë vetveten mënyrën më të drejtë dhe vetëm me të mund t'i kapërcejë vështirësitë materiale dhe shpirtërore. Kurani Fisnik, i garanton njeriut njohjen e vetvetes, duke e vënë atë para një pasqyre hyjnore me qëllim që të shohë pamjen e tij të vërtetë. Kurani Fisnik, nuk është fjala e një njeriu; ai është një letër udhëzimi dhe një udhërrëfyes i lumturisë së përhershme që na ka dërguar Zoti ynë i Madhëruar, i Cili na ka krijuar dhe i njeh më së miri të gjitha cilësitë tona.

Një besimtar i cili hyn me zemër të pastër në atmosferën shpirtërore të Kuranit Fisnik dhe arrin të meditojë ashtu siç duhet mbi të fshehtat dhe urtësitë e tij, para së gjithash, kupton dobësinë e vet dhe të qenit një **“HIÇ”** përballë fuqisë dhe madhështisë së pakufishme të Zotit tonë. Kjo vetëdije dhe ky kuptim, nuk lë tek ai asnjë forcë që të luftojë për ekzistencë apo të pretendojë për ego. Përkundrazi, ndjenja e dobësisë dhe hiçit, e shndërron atë në një qiri që shkrihet. Ai, jo vetëm që e di se përveç adhurimit dhe lutjeve asgjë tjetër nuk ka vlerë², por e kupton mirë edhe faktin, se sado vepra të mira që të bëjë, ato janë veçse një “hiç” për të garantuar

1. Muslim, Musafirin, 139.

2. Shih. Furkan, 77.

shpëtimin e përjetshëm dhe se për këtë, ka nevojë gjithmonë për mëshirën dhe faljen e Zotit të tij.

Vetëm kështu mund të realizohet devotshmëria e vërtetë. Përparimi në devotshmëri ndaj Allahut, fillon pas arritjes së një pjekurie të tillë shpirtërore, pra pasi të arrihet gjendja e “hiçit”. Edhe të dashurit e Allahut, majat e larta shpirtërore, i kanë arritur vetëm pasi kanë zotëruar pjekurinë e duhur shpirtërore.

Kushti më i rëndësishëm për të arritur kuptimin e vërtetë të devotshmërisë ndaj Allahut, është vetëdija se në çdo çast gjendemi nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, se Allahu na sheh në çdo moment dhe se është gjithmonë bashkë me ne. Pra, ta mbajmë zemrën të gjallë dhe vigjilente me vetëdijen e **“TË QENIT BASHKË ME ALLAHUN”** dhe të bëjmë kujdes në fjalët dhe veprimet tona.

Allahu i Madhëruar, na bën të ditur se Ai ndodhet pranë nesh më afër se damari i qafës sonë. E rëndësishme, është që të mos jemi të shkujdesur ndaj këtij fakti, por edhe ne të jemi bashkë me Allahun. Kjo, sepse në zemrën e cila nuk merret me të Vërtetën (Allahun), zë vend e kota. Një zemër e cila është me Allahun, nuk dëmtohet nga angazhimi me punë e kësaj bote. Ndërsa, prej adhurime që bëhen me një zemër që preokupimi për këtë botë e ka lënë të shkujdesur ndaj Allahut, nuk mund të shpresohet asnjë e mirë.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që vetëdijen e të qenit bashkë me Allahun, ta ngulitim përgjithmonë në zemrat tona. Dhe mënyra e mirë për ta bërë këtë, është vazhdimi në **“PËRMENDJEN E ALLAHUT”** me entuziazëm, dashuri dhe përkushtim. Njeriu, i cili asnjëherë nuk mund të shpëtojë prej

sëmundjes së harresës dhe shkujdesjes, ka nevojë ta përmendë shumë Allahun dhe të jetë me Të në çdo kohë dhe vend.

Një zemër e mbushur me dashurinë e besimit, nuk gjen rehati pa e përmendur Allahun. Për të, përmendja e Allahut është një nevojë po aq e domosdoshme sa ç'është edhe ushqimi dhe ajri, madje atë e shijon edhe më shumë. Atë nuk mund ta pengojë asnjë angazhim dhe asnjë bukuri e kësaj bote nga përmendja e Allahut.

Mirëpo, për të arritur të vërtetën e përmendjes së Allahut, duhet që ta ndjesh me shpirt Atë dhe duke jetuar me vetëdijen se çdo gjë është prej Tij, të ruash trupin prej harameve dhe gjërave të dyshimta.

Një tjetër prej metodave më të rëndësishme për eliminimin e shkujdesjes dhe zgjimit të zemrave, është edhe **"MEDITIMI"**. Kushtëzimet materialiste dhe egoiste, shkaktojnë plogështi të zemrës, pra dobësi mendimi dhe verbim ndjenjash. Për këtë arsye, zemrat e lodhura dhe të plogështa, duhen kuruar dhe gjallëruar me meditimin rreth të fshehtave dhe urtësive hyjnore. Kjo, sepse meditimi, është metoda më e mirë që njeriu të kuptojë dhe të korrigjojë gabimet dhe kryeneçësitë në të cilat shpesh herë bie në mënyrë të pavetëdijshme. Meditimi është një çelës i besimit.

Një meditim i pranuar i cili realizohet në një atmosferë shpirtërore, është si një shkollë e edukimit shpirtëror. Prandaj, si besimtar duhet të bëhemi nxënës shembullorë të kësaj shkolle dhe të mundohemi ta zbatojmë urdhrin hyjnor; **"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)!"**³ Në gjithësi, çdo genie dhe çdo ndodhi, është një libër urtësie i cili duhet të

3. Alak, 1.

lexohet dhe të kuptohet mirë. Ndërsa arsimimi i vërtetë, është që urtësitë hyjnore të cilat fshihen në çdo gjë **“TI SHOHËSH ME SYRIN E URTËSISË PËR TË MARRË MËSIM”**.

Njeriu që arrin ta realizojë këtë lexim, para së gjithash, kupton se ai është i dobët të perceptojë ashtu siç duhet urtësitë dhe të fshehtat e pafundme të Zotit të tij. Ai e kupton se të gjitha gjallesat mbi tokë, jetojnë në një mënyrë të mrekullueshme brenda ligjeve jashtëzakonisht delikate, të cilat e bëjnë të mundur jetën në të. Dhe asnjë mendje, logjikë, botëkuptim apo ndërgjegje e cila e kupton këtë, nuk tregohet kryeneçe, mosmirënjohëse dhe e paturpshme ndaj Allahu të Madhëruar që është Krijuesi dhe Drejtuesi i botëve. Përkundrazi, shpirtin e tij e kaplon një ndjenjë e papërshtatshme **“FALËNDERIMI”** ndaj Zotit të tij, sepse kudo që sheh me syrin e urtësisë, vëren gjithmonë imazhe të mirësive të ndryshme hyjnore. Dhe në fakt, falënderim, do të thotë të njohësh pronarin e vërtetë të mirësive.

Të dashurit e Allahut, duke qenë të vetëdijshëm se sado që të falënderojnë për mirësitë e panumërta të Allahut, asnjëherë nuk është e mjaftueshme, gjithmonë janë përpjekur t'i shtojnë sa më shumë falënderimet. Gjithashtu, falënderim; do të thotë që robi të jetë i devotshëm ndaj Zotit të tij që i ka falur mirësi të panumërta, si në fjalë ashtu edhe në vepra. Pra, të **“JETOJË ME PASIONIN E ADHURIMIT”**.

Myslimanizmi, nuk është një ceremoni që bëhet vetëm në kohë të caktuara, por një devocion që zgjat gjithë jetën. Përrjedhojë, asnjëherë nuk duhet të kaplohem nga dembelizmi në çështjen e adhurimeve dhe kurrë nuk duhet t'i braktisim qëllimet tona të pastra. Përkundrazi, duke u mbështetur në

urdhrin hyjnor; “Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”⁴, duhet të bëjmë një jetë të mbushur me pasionin e adhurimit. Kjo, sepse pranimi i adhurimeve, është në përpjesëtim të drejtë me vazhdimësinë e tyre.

Nga ana tjetër, synimi i fesë, është kultivimi i një njeriu të mirë, i cili e ka pastruar botën e tij të brendshme nga të gjitha gjërat negative dhe e ka zbukuruar atë me moral të bukur, pra i një “njeriu të përkryer”. Dhe rruga për arritjen e këtij synimi, është **“PAJISJA ME MORALIN ISLAM”**, në përfundim të një edukimi shpirtëror. Nëse besimtari lidhet me gjithë kuptimin e fjalës pas Kuranit, i cili shpall urdhrat hyjnorë, kapërcen pengesat e egos dhe bëhet një pasqyrë e moralit kuranor. Një pasqyrë e tillë, që kush e sheh, vëren jo gjendjen e një njeriu të mposhtur nga egoja e vet, por imazhin e bukurisë së moralit islam.

Po ashtu, edhe synimi i edukimi shpirtëror të Tasavufit, pra i pastrimit dhe rafinimit të zemrës, është përgatitja e botës së brendshme të njeriut ndaj shfaqjeve hyjnore, duke e pastruar atë nga dëshirat e egos dhe veset e ulëta.

Miqësia dhe dashuria buron prej bashkimit. Prandaj dhe mënyra më e bukur për ta bërë shpirtin shtrat ku rrjedhin bukuritë hyjnore, është bashkimi, në sajë të të cilit fitohet edhe miqësia dhe dashuria e Allahut. Nisur nga kjo, në çdo fjalë dhe vepër të besimtarit që e do Allahun dhe dëshiron miqësinë me Të, duhet të gjenden gjurmët e cilësive të Tij të bukura.

Siç dihet, Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. S’ka asgjë të bukur dhe të vlefshme që të mos

4. Hixhr, 99.

ndodhet në thesaret e Tij të pashtershme. Për këtë arsye, dhurata më e pranueshme që mund t'i ofrojmë Zotit tonë si besimtarë, është një pasqyrë shpirtërore e pastruar nga ndotjet e botës materialiste, e shndritshme, e kthjellët dhe ku reflektohen bukuritë e moralit. Pra, një zemër të pastër, në të cilën Allahu i Madhëruar sheh bukuritë e cilësive të Veta dhe kënaqet me të.

Nisur nga kjo, edhe ne si besimtarë, duhet të **“JETOJMË MORALIN ISLAM”**, duke u bërë dëshmuesit e Allahut mbi tokë. Gjithashtu, me sjelljet tona, duhet të tregojmë delikatesën, butësinë dhe fytyrën e qeshur të Islamit. Sa herë që të na jepet mundësia, të tregojmë se jemi robër të Mëshiruesit dhe populli i Profetit të mëshirës, duke i bërë zemrat tona vend mëshire për të gjitha krijesat. Kjo, sepse **“TA BËSH ZEMRËN VEND MËSHIRE”**, është mënyra më e bukur për të arritur dashurinë dhe miqësinë e Allahut, i Cili është Mëshirues e Mëshirëbërës.

Të dashurit e Allahut, janë personalitete të larta që kanë vuajtur për vuajtjet e të tjerëve, janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve dhe që zotërojnë një zemër të butë dhe të ndjeshme. Ata janë njerëz fatlumë, të cilët e kanë kuptuar se shpëtimi i tyre, varet nga përpjekjet edhe për shpëtimin e të tjerëve. Për këtë arsye, **“MËSHIRA NDAJ KRIJESAVE PËR HIR TË KRIJESIT”**, është bërë shenja e tyre dalluese dhe natyra e tyre. Ashtu siç është e pamundur për diellin të mos ngrohë, ashtu është e pamundur edhe për besimtarët e devotshëm të tregohen të pandjeshëm ndaj hidhërimit dhe vuajtjeve të krijesave, të mos ndjejnë dhembshuri e mëshirë ndaj tyre. Kjo, sepse bota e tyre e zemrës, e cila është e mbushur me dashurinë ndaj Allahut, është thelluar në vuaj-



tjet e të përvuajturve, është pjekur duke qëndruar përreth të hidhëruarve, është lartësuar me qetësinë e ndërgjegjes për shkak të ndihmës ndaj nevojtarëve dhe ka arritur pasurinë e vërtetë në sajë të lumturisë së dhënies së pasurisë atyre që kanë më tepër nevojë.

Për t'i mësuar këto dhe virtyte të tjera në mënyrën më të bukur, kërkohet bashkimi i zemrave me besimtarët e devotshëm. Kjo, sepse njeriu është një krijesë që ndikohet lehtë dhe patjetër që ndikohet edhe nga gjendjet e personave me të cilët qëndron -pozitive apo negative qofshin-. Ashtu si njerëzit që shëtisin në një kopsht me trëndafila dhe marrin prej aromës së tyre, ashtu edhe zemra e njerëzve që qëndrojnë së bashku me të devotshmit, marrin frymëzim shpirtëror prej tyre.

Nisur nga kjo, një nga mënyrat më frymëzuese për arritjen e moralit të bukur, me të cilin është i kënaqur Zoti ynë, është qëndrimi brenda rrethit të ndikimit të robërve të devotshëm e besnikë, duke përfituar prej entuziazmit të tyre shpirtëror. Kur ky përfitim arrin **“HORIZONTIN E BEGATISË NË QËNDRIMIN ME NJERËZIT E MIRË”**, fiton cilësi dhe ndikim më të madh. Qëndrimi me njerëzit e devotshëm, bëhet shkak i përkujtimit të Allahut dhe i përforcimit të besimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjërat që të kujtojnë njerëzit e devotshëm, forcojnë lidhjen shpirtërore me ta, duke u bërë shkak i mëshirës hyjnore. Për këtë arsye, kërkimi i begatisë në qëndrimin me njerëzit e devotshëm, është një edukim dashurie që siguron pjekjen shpirtërore.

Nga ana tjetër, dashuria e vërtetë, kërkon të përfitohet nga çdo mundësi dhe të provohet çdo mënyrë për t'u takuar me atë ndaj të cilin ndihet dashuri. Nisur nga kjo edhe një

i dashuruar me Allahun, që e ka zemrën të mbushur me dashurinë e besimit, përdor çdo **“MËNYRË QË TË AFRON TEK KËNAQËSIA E ALLAHUT”**. Pra, kapet fort dhe me dashur pas tyre. Kjo, sepse këtë e ka urdhëruar vetë Zoti ynë, duke urdhëruar:

“O besimtarë! Kini frikë Allahun, kërkon mënyrën që t’i afroheni Atij dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!” (Maide, 35)

Rrugët që të çojnë tek Allahu, -sipas shprehjes së famshme- janë aq shumë, sa edhe frymët e krijesave. E rëndësishme, është të zotërosh një pjekuri shpirtërore, në sajë të së cilës do t’i perceptosh këto rrugë që të takojnë me Allahun dhe të përfitosh prej tyre në mënyrën më të bukur.

Një nga faktet që duhet ta përkujtojmë vazhdimisht, është, se të gjithë jemi nxënësit e shkollës së kësaj bote, e cila është vendi i sprovës hyjnore. Arsimimi ynë në devotshmëri, do të marrë fund me certifikatën e vdekjes, pas së cilës do të varrosemi në gjirin e tokës së bashku me punët tona. Jeta e kësaj bote të përkohshme, është vetëm një “kohë” e cila na është vënë në dispozicion për ta shpëtuar ardhmërinë tonë të përjetshme nga një fatkeqësi e kobshme, duke e kthyer në një lumturi të pafundme.

Nisur nga kjo, një besimtari i mençur, nuk sillet si vendas në këtë botë, nuk e harron kurrë vdekjen dhe jeton duke u përgatitur me devotshmëri për botën tjetër. Dhe mënyra më e mirë për ta mbajtur gjallë këtë vetëdije, është të marrësh pjesë në përcjelljet e xhenazeve dhe të vizitosh varrezat sa më shpesh. Edhe Profeti ﷺ, shpesh i pyeste shokët e tij:

“A ndokush që ka përcjellë xhenaze sot?”⁵ dhe u thoshte: “Kujtojeni shpesh atë (vdekjen) që i pret si me thikë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote!”⁶.

Po ashtu, edhe sahabët fisnikë dhe robërit e mirë të Allahut, e kishin bërë parim të jetës së tyre përgatitjen për vdekjen dhe përkujtimin e shpeshtë të saj duke vizituar varret. Për rrjedhojë, **“PËRGATITJA PËR BOTËN TJETËR DHE VIZITA E VARREVE”**, zë një vend të paneglizhueshëm në botën shpirtërore të një besimtari të vërtetë. Kjo, sepse varrezat janë si pasqyra që i tregojnë çdo njeriu të ardhmen e tij. Nëse njeriu arrin të shohë shpesh në këtë pasqyrë dhe për të marrë mësim, do të shpëtojë prej humbjes së jetës pas kënaqësive të egos. Pra, vizita e varreve, është mënyra më e bukur në përgatitjen për botën tjetër. Një jetë e cila nuk është ndriçuar me meditimin e vdekjes, nuk ndryshon aspak nga një natë e errët katastrofe. Dielli i lumturisë së përjetshme, lind vetëm në horizontet e atyre që jetojnë të përkushtuar ndaj fjalës hyjnore dhe dinë të vdesin me një ndërgjegje të pastër.

Të dashur lexues!

Shkurtimisht, këto janë temat që kemi trajtuar në librin që keni në duar. Padyshim, se ka ende shumë fjalë për të thënë në lidhje me këto tema. Mirëpo, e rëndësishme është të meditojmë siç duhet mbi këto të vërteta dhe duke e peshuar veten tonë me robërit e mirë të Allahut, të përpiqemi t'i reflektojmë me aq sa të mundemi bukuritë e tyre në sjelljet dhe veprat tona.

5. Muslim, Fedailu's-Sahabe, 12.

6. Tirmidhi, Zuhd, 4; Nesai, Xhenaiz, 3.

**Allahu i Madhëruar, na bëftë prej atyre që marrin
mësim prej çdo gjëje me të cilën përballen. Po ashtu, na
e bëftë të mundur të marrim urtësitë e duhura për botën
tonë shpirtërore dhe të veprojmë në përputhje me to!**

Amin!..

Osman Nuri Topbash

Dhjetor 2010

Uskudar





Ndjekja e Profetit ﷺ me dashuri dhe bindje

Ai, gjithmonë ka shpërndarë dashuri për popullin e tij, është bërë ortak në vuajtjet e të përvuajturve dhe është gjendur pranë të hidhëruarve dhe të varfërve. Në këtë mënyrë, me ndihmën e Allahut, ai arriti të edukonte një shoqëri sahabësh që e donin më shumë se pasuria dhe jeta e tyre, pra më shumë se çdo gjë.

Profeti ﷺ, arriti të ndryshonte një periudhë të egër injorance, duke e kthyer atë në një epokë lumturie. Në të njëjtën mënyrë, edhe sot, ajo që do t'i sjellë paqe dhe do ta shpëtojë njerëzimin, është fryma e tij mëshiruese.

NDJEKJA E PROFETIT ﷺ, ME DASHURI DHE BINDJE

Që feja të jetohet me dashuri, emocion, paqe dhe hijeshi, është e domosdoshme që Kurani dhe Suneti të zënë vend në çdo pjesë të saj. Dhe mënyra më e mirë për të arritur një përsosmëri të tillë shpirtërore, është mbushja e zemrës me “**dashuri**”, sepse dashuria sjell me vete edhe bindjen edhe sakrificën. Gjithashtu, edhe lidhja shpirtërore midis zemrave, mund të ndërtohet vetëm në sajë të dashurisë.

Njëri prej sahabëve të nderuar, **Enes bin Malik** ؓ, tregon:

Një njeri erdhi te **Profeti** ﷺ dhe e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Kur është dita e Kijametit?”

Profeti ﷺ, e pyet duke i thënë:

“Çfarë ke përgatitur për ditën e Kijametit?”

Njeriu përgjigjet:

“Dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij...”

Pas këtyre fjalëve, Profeti ﷺ, thotë:

“Atëherë, ti do të jesh me atë që do”.

Në vazhdim të këtij transmetimi, Enesi ؓ, thotë:



“Përveç hyrjes në islam, asgjë tjetër nuk na kishte gëzuar më shumë se fjala e të Dërguarit të Allahut: “Atëherë, ti do të jesh me atë që do”. Prandaj dhe unë e dua Allahun, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Omerin. Megjithëse nuk kam bërë aq sa kanë bërë ata, shpresoj që të jem së bashku me ta.” (Muslim, Birr, 163)

Profetin ﷺ, mund ta njohim aq sa dashuri ndjejmë për të dhe aq sa mund t’i afrohem atij, sepse, dashuria midis dy të dashuruarve, përjetohet aq sa është edhe forca e dashurisë. Pra, edhe hadithi “Njeriu është me atë që do”. (Buhari, Edeb, 96), shpreh këtë bashkim zemrash. I dashuruari, i ngjan të dashurit dhe merr pjesë prej karakterit të tij, vetëm në masën e dashurisë që ndjen për të. Përfitimi shpirtëror më i mirë që duhet të marrim prej të Dërguarit të Allahut ﷺ, është bashkimi i botës sonë të brendshme me ndjenjat e tij shpirtërore.

ME SYRIN E ZEMRËS SË EBU BEKRIT ﷺ

Kur dashuria arrin nivelet më të larta, atëherë del në pah edhe miqësia e vërtetë. Dhe në mes të gjithë njerëzve, ai që ka arritur nivelin më të lartë të miqësisë me Profetin ﷺ, padyshim që është **Ebu Bekri** ﷺ. Për shkak se përjetimi i dashurisë së Ebu Bekrit ﷺ, për Profetin ﷺ, ishte në nivelin më të lartë, ai sakrifikoi pasurinë, shpirtin dhe çdo gjë tjetër për të. Sakrificat që bënte me gjithë shpirt për Profetin ﷺ, ishin kthyer në lumturinë më të madhe të jetës së tij. Dhe si rezultat i horizontit të gjerë të dashurisë që ndjente për të, ka thënë:

“Nga kjo botë, më janë bërë të dashura vetëm tri gjëra:

- Shikimi i fytyrës së Profetit ﷺ,
- Martesa e vajzës sime me të,

- Shpenzimi i pasurisë në rrugën e tij.”

Shpenzimi pa kufi i çdo gjëje për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e ngriti ëmbëlsinë e besimit të Ebu Bekrit ﷺ, në nivelet më të larta. Ebu Bekri ﷺ, ishte aq i lidhur me Profetin ﷺ, saqë edhe pas vdekjes, ai e mbante të gjallë në zemrën e tij. Madje, tek Ebu Bekri ﷺ, ishte e mundur të ndjeje edhe frymën e Profetit ﷺ. Këtë gjendje të Ebu Bekrit ﷺ, na e tregon **Ebu Hurejre** ﷺ:

“Një ditë, Ebu Bekri ﷺ, doli në minber dhe tha:

«- Siç e dini, vitin e kaluar i Dërguari i Allahut ﷺ, qëndronte midis jush, ashtu siç po qëndroj edhe unë...» Pas këtyre fjalëve, nga sytë e tij rrodhën lot. I përsëriti këto fjalë, por lemza i zuri fytyrën. Kur e përsëriti për herë të tretë, nuk e mbajti dot veten dhe filloi të qante.” (Shih. Tirmidhi, Deauat, 105)

Edhe zemrat e ndritura, që e njihnin dashurinë e madhe të këtij sahabiu për Profetin ﷺ, në çdo rast mundoheshin të përfitonin prej tij. Me kujtimet e Profetit ﷺ, mundoheshin sadopak të shuanin mallin që kishin për të.

Një prej sahabëve të nderuar, **Bera bin Adhib** ﷺ, na tregon kështu për dëshirën e madhe të babait të tij për të dëgjuar ndonjë prej kujtimeve të Profetit ﷺ:

“Ebu Bekri ﷺ, bleu një samar prej babait tim dhe m'u lut ta çoja deri në shtëpinë e tij. Por babai kundërshtoi, duke thënë:

«- Jo! Kjo nuk është e mundur, nëse nuk më tregon se si bëtë hixhret me të Dërguarin e Allahut nga Meka në Medine, ndërkohë që po ju ndiqnin mushrikët.»

Pas kësaj Ebu Bekri ﷺ, tregoi udhëtimin e hixhretit. (Shih. Buhari, Ashabu'n-Nebi, 2.; Ahmed, I, 2.)

Sa bukur e pasqyrojnë dashurinë për Profetin ﷺ, këto fjalë të Ebu Bekrit ؓ:

“Dashuria për Profetin ﷺ, është më e vlefshme se jeta askete dhe lufta në rrugë të Allahut.” (Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161)

NJË DASHURI MË E SHENJTË SE JETA...

Dashuria e sahabëve për Profetin ﷺ, kishte arritur në nivele aq të larta, saqë edhe sakrifikimin e jetës së tyre e konsideronin si një borxh ndaj tij. Disa nga shembujt më të mahnitshëm që e vërtetojnë këtë, janë përjetuar në luftën e Uhudit, në momentet kur ushtria islame u përça për pak çaste. Një grup prej mushrikëve, që përfituan prej rrëmujës dhe përçarjes, sulmuan me egërsi duke synuar të vrasin të Dërguarin e Allahut ﷺ. Një pjesë prej sahabëve, të përbërë prej Muhaxhirëve dhe Ensarëve, e rrethuan Profetin ﷺ, me qëllim që ta mbronin. Ata u betuan se, po të ishte nevoja, do të jepnin edhe jetën për të. Pastaj i dhanë besën Profetit ﷺ, duke thënë:

“Fytyra ime, mburojë mbi fytyrën tënde. Trupi im u sakrifikoftë për trupin tënd! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë me ty! Nuk do të ndahemi asnjëherë prej teje.” Pastaj luftuan me gjithë fuqinë që kishin. (Ibën Sa’d, II, 46.; Uakidi, I, 240.)

Ebu Talha ؓ, ishte një harkëtar që e tërhiqte fort harkun. Gjatë luftës së Uhudit, për shkak të entuziazmit që i jepte besimi, në dorën e tij u thyen dy-tre harqe. Ndërsa i Dërguari i Allahut, këdo që kalonte pranë tij me torbën e shigjetave në sup, e urdhëronte:

“Zbraze torbën e shigjetave pranë Ebu Talhasë!” Profeti ﷺ, qëndronte mbas Ebu Talhasë dhe, sa herë që ngrinte kokën

për të parë mushrikët, Ebu Talha, thoshte:

“Të qofshin falë nëna dhe babai im, o Resulullah! Mos e ngri kokën! Kam frikë se mos të godet ndonjë prej shigjetave të mushrikëve. Gjoksi im le të jetë mburojë për gjoksin tënd. Ajo që do të prekë ty, le të më prekë mua!” (Buhari, Megazi, 18.)

Edhe **Sa’d bin Ebi Uakkas** ﷺ, qëndronte pranë Profetit ﷺ dhe pa pushim gjuante me shigjeta mbi armikun. Ndërsa Profeti ﷺ, për shkak të sakrificës së tij thoshte:

“Qëll o Sa’d! Të qofshin falë babai dhe nëna ime!” Këto fjalë i dëgjoi edhe **Aliu** ﷺ, i cili u shpreh kështu:

“Unë nuk e kam dëgjuar kurrë Profetin ﷺ, që përveç Sa’dit t’i thotë dikujt tjetër: “Të qofshin falë babai dhe nëna ime!” (Tirmidhi, Edeb 61, Menakib 26.; Ahmed, I, 92.)

Në fund të luftës së Uhudit, Profeti ﷺ, u bë merak për gjendjen e **Sa’d bin Rebisë** ﷺ, njërit prej sahabëve, të cilin e donte shumë. Prandaj, urdhëroi një prej sahabëve që të shkonte e ta kërkonte në fushëbetejë. Sahabiu kërkonte shumë, por nuk mundi ta gjejë Sa’din. Kur ishte duke u kthyer, me një shpresë të fundit thërret:

“O Sa’d! Më ka dërguar Profeti. Ai më urdhëroi që ta njoftoja nëse je gjallë apo ke rënë shëhid!”

Në atë moment, Sa’di që po përjetonte çastet e fundit dhe nuk kishte fuqi për të përgjigjej, kur dëgjoi se Profeti ishte bërë merak për të, mbledhi veten dhe tha:

“Tashmë unë jam midis të vdekurve!” Sahabiu që po e kërkonte shkoi menjëherë pranë Sa’dit dhe e gjeti atë me trup të shpuar e të prerë prej goditjeve të shpatave. Sa’di, duke pëshpëritur fjalët e fundit, tha:

“Për Allahun! Edhe sikur t’ju ketë ngelur fuqi vetëm sa për

të lëvizur sytë, nëse nuk e mbroni Resulullahun prej armiqve, por e lini t'i ndodhë ndonjë e keqe, nuk do të keni asnjë të drejtë të justifikoheni përpara Allahut!” (Muuatta, Xhihad, 41.; Hakim, III, 221/4906.; Ibën Hisham, III, 47)

Sulmet që i janë bërë sulltanit të profetëve, të dashurit tonë ﷺ, kur ishte ende gjallë, në mënyra dhe kamuflazhe të ndryshme, shpeshherë po vihen re edhe në ditët tona. Sahabët e mbrojtën Profetin ﷺ, me jetët e tyre. Prandaj edhe ne në ditët e sotme duhet t'i dalim për zot trashëgimisë së bekuar të Profetit ﷺ. Kjo është detyra jonë si umeti i Muhamedit ﷺ.

Të mos harrojmë se profetët nuk lanë trashëgimi materiale. Trashëgimia e vërtetë që i ka ngelur umetit prej Profetit ﷺ, është karakteri, personaliteti dhe devotshmëria e tij. Ndërsa dy amanetet e tij më të mëdha, janë Kurani Kerim dhe Suneti i tij. Mbrojtja e kësaj trashëgimie dhe e këtyre amaneteve, është e mundur vetëm duke u edukuar me moralin e tij, duke jetuar një jetë të devotshme dhe duke e përfaqësuar atë, Profetin ﷺ, në çdo vend dhe kohë ashtu siç e meriton. Nuk duhet të harrojmë se edhe kjo është një provë për besimin dhe devotshmërinë tonë.

Shpirti i bekuar i Profetit tonë të dashur ﷺ, është djegur e përvëlur për dertet e umetit të tij. Gjatë gjithë jetës, Ai është përpjekur dhe ka punuar për shpëtimin e njerëzimit. Ka shpërndarë dashuri dhe është bërë ortak në vuajtjet e popullit të tij. Gjithmonë është gjendur pranë të hidhëruarve dhe të varfërve. Në këtë mënyrë, me ndihmën e Allahut, ai arriti të edukonte një shoqëri sahabësh që e donin më shumë se shpirtin e tyre.

Mesazhi që na vjen prej Profetit ﷺ, është: **“Njeriu, të cilit**

i kemi zgjidhur hallet dhe shoqëria ku kemi shpërndarë dashuri, është e jona”.

Ja pra, sahabët që u edukuan në një atmosferë të tillë dashurie, e kishin kënaqësi të jepnin edhe shpirtin e tyre për Profetin ﷺ, duke thënë: “Të qofshin falë nëna dhe babai im, o Resulullah!”. Njërin prej shembujve të panumërt të këtij fakti, e shohim edhe në ngjarjen e Rexhit:

Profeti ﷺ, e kishte zakon të dërgonte mësues në fiset përreth, me qëllim që t’u mësonin islamin. Dy nga fiset që kishin kërkuar mësues, ishin edhe fiset Adal dhe Kare. Për këtë arsye, një grup prej dhjetë vetave doli në udhë për të shkuar tek këto fise. Mirëpo, gjatë udhëtimit, grupi ra në pusi dhe tetë prej mësuesve ranë shehidë, ndërsa dy të tjerë u kapën rob. Dy mësuesit që ranë rob, ishin **Zejdi** dhe **Hubejbi** (r.anhuma.). Që të dy iu dorëzuan mushrikëve të Mekes, të cilët më pas i vranë. Por para se ta vrisnin, mushrikët i thanë Hubejbit ﷺ:

“A do të dëshiroje që tani në vendin tënd të ishte Profeti dhe ti të shpëtoje?”

Hubejbi ﷺ, me keqardhje për Ebu Sufjanin, i cili i bëri edhe pyetjen, tha:

“Jo vetëm që nuk dua që Profeti të jetë në vendin tim dhe unë të jem me familjen dhe fëmijët e mi, por unë nuk dëshiroj që as një gjemb ta shpojë këmbën Profetit, për të shpëtuar unë”.

Ebu Sufjani, i cili u shtang i mahnitur nga kjo skenë e pashembullt dashurie, tha:

“Me të vërtetë e mahnitshme! Në këtë botë, ende nuk kam parë dy njerëz që të duhen ashtu siç e duan sahabët Muhamedin.” (Uakidi, I, 360; IbënSa’d, II, 56)

Shumë prej studiuesve të huaj, të cilët e kanë studiuar jetën e Profetit ﷺ, me objektivitet, nuk kanë arritur ta fshehin mahnitjen e tyre. Shkrimtari perëndimor, **Thomas Carlyle**, rrëfen:

“Asnjë perandor me kurorë në kokë, nuk ka parë kaq dashuri dhe respekt sa Muhamedi ﷺ, që vishte rroba, arnat e të cilave i qepte me dorën e vet.”

I vetmi kusht që duhet të plotësohet për ta njohur në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe për të përfituar prej tij ashtu siç e meriton, është dashuria dhe respekti që tregohet ndaj tij. Asnjë dashuri tjetër në zemrën e sahabëve, nuk e kaloi dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. As dashuria për pasurinë, as ajo për fëmijët dhe familjen dhe as dashuria për jetën e vet... Të gjitha këto do të ngeleshin në këtë botë, ndërsa dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, do të bëheshin kapitali i shpirtit të tyre për arritjen e lumturisë së përjetshme.

NËSE E DONI ALLAHUN...

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë), transmeton:

“Sahabët e nderuar i thanë Profetit ﷺ:

«- O i Dërguar i Allahut! Ne e duam shumë Allahun Teala. Mirëpo, a na thua se cili është treguesi i dashurisë së vërtetë për Allahun?»

Për këtë arsye, Allahu Teala zbriti një ajet fisnik, në të cilin thuhet:

Thuaju (o Muhamed): **“Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!**

Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. (Al-i Imran, 31)

(Shih. Taberi, Xhamiu'l-Bejan, nr. 6845, 6846)

Pra, dashuria për Profetin ﷺ, do ta bëjë njeriun të arrijë edhe dashurinë e Allahut Teala, sepse dashuria për Profetin ﷺ, është dashuri për Allahun. Bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut. Ndërsa kundërshtimi i tij, është kundërshtim i Allahut.

I nderuari Alaeddin Konevi, me qëllim që nxënësit e tij të ndiqnin rrugën e Profetit ﷺ dhe ta respektonin atë, u vuri këto kushte:

1. Të bënin salavate, sa herë që përmendej emri i bekuar i Profetit ﷺ.

2. Të tregonin edukatë dhe të mos e ngrinin zërin gjatë vizitës së varrit të Profetit ﷺ.

3. Të respektonin Medine-i Muneuueren, që është edhe qyteti i Resulullahut dhe të gostitnin popullin e saj.

4. Të ruheshin nga gjërat që e ulin vlerën e fjalëve dhe veprave të Profetit ﷺ. P.sh., kur të përmendej se Profeti ﷺ, e pëlqente diçka, menjëherë në zemrat e tyre të zgjohej ndjenja e dashurisë për të njëjtën gjë.

5. Të mos vendosnin libra të tjerë apo sende të ndryshme mbi Kuranin dhe librat e haditheve.

6. Të mos e hidhnin apo të grisnin një letër, në të cilën ishte shkruar emri i Allahut ose i Profetit ﷺ. Madje, të tregonin respekt për çdo libër të fesë. Nëse ato nuk do t'i përdornin më, t'i groposnin në një vend ku nuk shkelej ose t'i digjinin.

SALAVATET MBI PROFETIN ﷺ

Njeriu që dashuron dikë, e imiton atë aq sa dashuri ndjen për të. Nuk e nxjerr atë nga zemra dhe nuk e lëshon nga gjuha. Dhe treguesi më i mirë i një lidhje të tillë shpirtërore me Profetin ﷺ, është përkujtimi i tij me salavate. Ndërsa e kundërta e kësaj, të çon në një humbje të madhe shpirtërore. Nga Ebu Hurejre ؓ, transmetohet se i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ai që nuk bën salavat për mua, kur pranë tij përmendet emri im, është i humbur dhe i nënçmuar.” (Rijadu's-Salihin, fq.20, 1408)

Ndërsa, në disa hadithe të tjerë, transmetohet se Profeti ﷺ, ka thënë:

“Koprrac është ai që, megjithëse përmendem pranë tij, nuk bie salavat për mua.” (Tirmidhi, Deauat, 100)

“Kush harron të bie salavate ndaj meje, ngatërron rrugën për në Xhenet.” (Ibën Maxhe, Ikamet, 25)

Ja pra, kaq të rëndësishme janë salavatet fisnike! Madje edhe gjatë faljes së namazit, kur ulemi për Tahiajjatin, jemi urdhëruar të bëjmë salavate dhe t'i japim selam të dashurit tonë, të Dërguarit të Allahut ﷺ. Megjithëse dhënia selam dikujt gjatë namazit është prej gjërave që e prishin namazin, Allahu Teala, e ka bërë dhënien e selamit për Profetin ﷺ, prej rukneve vaxhib të namazit.

I nderuari Imam Gazali, ka thënë:

“Gjatë teshehudit në namaz, mundohu të përfytyrosh fytyrën e bukur dhe karakterin e lartë të Resulullahut ﷺ dhe thuaj “es-salatuue's- selamualejke ja Resulallah”! Të jesh i

sigurt se selami yt do t'i shkojë të dërguarit të Allahut dhe ai do të të përgjigjet në një mënyrë edhe më të bukur". (Ihja'u-Ulumi'd-Din, I, 224)

DELIKATESA E OSMANLINJVE NË DASHURIN NDAJ PROFETIT ﷺ

Të parët tanë, Osmanllinjët, treguan një dashuri dhe bindje të thellë ndaj Kuranit dhe Sunetit, mbajtën lart flamujt e Islamit për gjashtëqind vjet, duke i treguar botës mirësitë e Islamit dhe u bënë flamurtarë të lirisë dhe drejtësisë. Mirëpo, ndjenjat e dashurisë dhe respektit që kishin ndaj Profetit tonë të dashur ﷺ, ishin më madhështore se qytetërimi që ngritën.

Kubenë e parë mbi varrin e Profetit ﷺ, të cilën dëshiron ta vizitojë nga afër çdo i përmalluar për Profetin ﷺ, e ka ndër-tuar Sulltani Memluk **Kajëtbaj**. Ndërsa nderin e restaurimit të xhamisë së Profetit ﷺ dhe ndërtimit të kubesë së gjelbër që shohim sot, e ka pasur njëri prej Sulltanëve Osmanlli, **Mahmudi i II**.

Kur u bë fjalë për restaurimin e kubesë, Mahmudi II dërgoi arkitektët dhe ustallarët më profesionistë prej Stambollit. Arkitektët dhe ustallarët u menduan thellë para se të fillonin nga puna, sepse do t'u duhej të ngjiteshin mbi kubënë ekzistuese, të hiqnin tullat dhe më pas, ta ndërtonin nga e para. Kjo detyrë duhej të realizohej me delikatesë të madhe, pa bërë asnjë veprim që do ta shqetësonte shpirtin e bekuar të Profetit ﷺ. Pasi u konsultuan gjerë e gjatë, më në fund morën një vendim:

“Gjatë punës së ndërtimit nuk duhet të flasim asnjë fjalë të kësaj bote. P.sh., Kur të kemi nevojë për tulla, të themi

“Allah!”, kur të duam ujë, të themi “Bismilah!”, kur të kërkojmë çekiçin, të themi “La ilahe il-lall-llah!” e kështu me radhë...

Ja pra, Kubbe-i Hadra / Kubeja e gjelbërt, u ndërtua me madhështi dhe respekt, në një atmosferë të tillë shpirtërore. Gjithashtu, edhe ustallarët që punuan në restaurimin e Mesxhidit Nebevi, çdo gur e vendosën duke qenë me abdest dhe duke thënë bismilah. Madje, kur duhej të ngulej një gozhdë, me qëllim që të mos bëhej zhurmë, i veshën çekiçët me shajak.

Në librin me kujtime “Tajjibetu’l-Edhkar”, që u shkrua në fund të shekullit të 18-të nga Dervishi Ahmed Peshkarizade, në lidhje me edukatën, respektin dhe delikatesën që është treguar në Ravza-i Mutahhara¹, tregohet:

“Pasi largohej xhemati i namazit të jaxisë, agallarët e ngarkuar me detyrë tek Ravza, me një fener në dorë, shëtisnin Haremin Sherif qoshe më qoshe dhe, kur vinin tek Babu’s-Selam, mbyllnin derën. Nëse vihej re dikush që ishte ende brenda në mesxhid, i bënin me shenjë që të dilte, duke thënë “Bismilah”, sepse në Haremi Sherif nuk fliteshin fjalë të kësaj bote. Nëse dikush gjendej afër varrit të Profetit ﷺ edhe atij i bëhej me shenjë, duke thënë “La ilahe il-lall-llah!”.

Tri orë para lindjes së diellit, (kur hynte koha për namazin e natës), kryemuezini thërriste njëherë jashtë derës: “La ilahe il-lall-llah!” Me të dëgjuar këtë thirrje, roja që ndodhej brenda, thoshte: “Muhamedur-Rasulullah...”, pastaj hapte derën”.

Padyshim që në gjithë këtë delikatesë dhe edukatë që është treguar nga të parët tanë, gjenden mësimet të rëndësishme. Një nga këto, është edhe braktisja e fjalëve të kota dhe

boshe të kësaj bote, sidomos prej atyre që shkojnë në Haxh dhe Umre dhe vizitojnë varrin e Profetit ﷺ. Gjuhët dhe zemrat e tyre duhet t'i lajnë me përmendjen e Allahut dhe me qetësi e respekt të bëjnë salavate për Rasulullahun ﷺ.

Një banor i devotshmëm i Medine-i Muneuueres, Zijaeddin Efendiu, i këshillonte kështu ata që vinin për të vizituar atë vend të bekuar:

“Ai që vjen në këtë vend, duhet të hyjë tek Ravza duke parë majat e këmbëve dhe në të njëjtën mënyrë duhet të kthehet në shtëpinë e tij”.

Pra, nuk duhet ta prishë gjendjen shpirtërore, duke menduar për punët e çarshisë dhe telashet e kësaj bote, por duhet të përqendrohet dhe të kujtojë se ndodhet në një vend të bekuar.

Një shembull tjetër i respektit dhe edukatës që kanë treguar të parët tanë ndaj Profetit ﷺ, është edhe ky:

Abdulhamid Hani i II, ndërtoi një hekurudhë që lidhte Stambollin me Medine-i Muneuueren. Stacionet i vendosi në vendet ku kishte bujtur Profeti ﷺ, gjatë udhëtimeve të tij. Ndërsa stacionin e trenit të Medines, e vendosi rreth 2 km larg Ravzës dhe shinat e trenit që kalonin brenda Medines, i veshi me shajak, me qëllim që të mos bënin zhurmë dhe për pasojë, të shqetësohej shpirti i bekuar i Profetit ﷺ.

Poeti Nabi, në një varg të një poezie të tij, e shpreh kështu ftesën për edukatë, respekt dhe dashuri ndaj Profetit ﷺ, që treguan Osmanlinjtë, të cilët u kujdesën jashtë mase për qytetet e shenjta:

“Ki kujdes edukatën! Ky është qyteti i të Dashurit të Allahut...”

Të parët tanë, që treguan shembuj të pashoq të respektit dhe dashurisë për të Dërguarin e Allahut në qytetet e shenjta, sollën edhe në qytetet e tyre zakone që mbanin frymën shpirtërore të Haremejnës (dy qyteteve të shenjta).

Për shkak të dashurisë ndaj Profetit ﷺ, dhe për të mbajtur besimin gjithmonë të gjallë dhe dinamik, ishte bërë zakon që prej personave të kualifikuar, të lexoheshin në xhami tre libra për xhematin. Në shenjë respekti, të tre këtyre librave, iu dha cilësia “**Sherif**”⁷. Këta libra ishin **Buhari-i Sherif**, **Shifa-i Sherif** dhe **Mesnevi-i Sherif**.

Osmanlinjtë, në themel të të cilëve gjendej respekti dhe lartësimi i Kuranit, treguan kujdes të veçantë dhe dashuri të pashoqe edhe në lidhje me “**emanetet e shenjta**”. Gjithashtu, Osmanlinjtë i quajtën ushtarët e tyre “**Mehmetçik**”, duke u dhënë mundësinë që sipas kapacitetit të vet, çdonjëri prej tyre të ndjente frymëzimin e të qenit një “**Muhamed**”.

Ndër zakonet e Osmanllinjve, zinin vend edhe festimet madhështore të Mevludeve. Aty silleshin qimja e mjekrës së bekuar të Profetit ﷺ, hurma prej Medine-i Muneuures, Zemzem prej Meke-i Mukerremes dhe në një atmosferë të mbushur plot emocione, kujtohej Profeti ﷺ dhe jeta e tij. Në një pjesë të Mevludit sherif, ku përfytyrohet lindja e Profetit ﷺ, i gjithë xhemati ngrihej në këmbë dhe këndonte salavate dhe selame për nder të Rasulullahut...

Në kohën e Osmanllinjve ishte bërë zakon që në xhamitë, që ishin ndërtuar nga sulltanët apo gratë e tyre, të gjendej një muezin i verbër. Kjo vazhdoi deri vonë në xhaminë Sulejmanije, Fatih dhe xhami të tjera si këto. Në të shumtën

7. Sherif; i nderuar, i respektuar.

e rasteve, ky fakt pandehej si një rastësi, prandaj kalonte pa u vënë re. Mirëpo, ky zakon e kishte zanafillën në “epokën e lumturisë”. Në Mesxhidin Nebevi, përveç **Bilali Habeshiut** ﷺ, kryente detyrën e muezinit edhe sahabiu i verbër, **Abdullah ibën Umm-i Mektum** ﷺ.

Pra, për të vazhduar këtë zakon të Profetit ﷺ dhe për të ngjallur sunetin e tij, të parët tanë, deri në kohët e vona kanë treguar kujdes të madh që në xhamitë e ndërtuara prej Sulltanëve apo grave të tyre, të mbajnë muezinë të verbër.

Allahu Teala na bëftë nga ata që marrin shembull prej delikatesës dhe ndjesive shpirtërore të të parëve tanë! E bëftë të vazhdueshme lidhjen shpirtërore me Profetin ﷺ! Sunetin e tij e bëftë boshtin e jetës sonë! Na faltë dhe na mëshiroftë për hatër të të Dashurit të tij!

Amin!..





"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijon (gjithçka),
e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!" (Alak, 1-2)

Zotëruesi i Kuranit

*Ajetet e Kuranit, janë vend i mrekullive, që ndriçojnë
errësirat historike dhe shpjegojnë të pashpjegueshmet;
vendi ku mund të jetohet pranvera e lumturisë dhe e
paqes së kësaj bote dhe botës tjetër.*

*Në fakt, Kurani lexohet me zemër. Detyra e syrit, është
të luaj rolin e syzeve për zemrën. Njerëz të lartë e të
thjeshtë ulen në gjunjë dhe lexojnë Kuran përpara të
njëjtës rahle, por çdokush merr prej tij sipas gjendjes
së vet shpirtërore.*



ZOTËRUESI I KURANIT

Ajetet e Kuranit kanë zbritur pjesë pjesë në formën e mesazheve hyjnore, të cilat kanë thurur dalëngadalë jetën profetike prej 23 vjetësh. Kur zbritej ndonjë ajet, të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe shokët e tij të zgjedhur, herë i kapte një lumturi e papërshkrueshme, herë trembeshin dhe herë u shtohesh devotshmëria. Në sajë të këtyre mesazheve që vinin prej Allahut Teala, ushqehesh bota shpirtërore e besimtarëve, rritej dëshira e tyre për të punuar dhe dashuria për besimin arrinte majat më të larta në zemrat e tyre.

Për të parët tanë të mirë, sahabët fisnikë, zbritja e shpalljes ishte një sofër hyjnor që zbriste nga qielli, prandaj dhe nuk ngopeshin kurrë me të. Sa herë që dëgjonin se ishte zbritur ndonjë ajet, vraponin menjëherë për tek ajo sofër hyjnor dhe me një entuziazëm të papërshkrueshëm, prej urdhrave të reja që zbrisnin mundoheshin të mësonin përgjigjen e pyetjes: “Në cilat punë është kënaqësia e Allahut?”.

Abdullah ibën Mes’ud ﷺ, tregon:

“Kur një sahabi vinte në shtëpi (në mbrëmje), grua e tij i bënte më parë këto dy pyetje:

1- Sa ajete janë zbritur sot nga Kurani?



2- Sa prej haditheve të Profetit ﷺ, mësove përmendsh?..

(Abdulhamid Keshk, Fi Rihabi't-Tefsir, I, 26)

TË PASIONUARIT PAS VAHJIT (SHPALLJES)

Sahabët e nderuar ishin aq të lidhur me vahjin, saqë hidhërimi i tyre më i madh pas ndërrimit jetë të Profetit ﷺ, ishte ndërprerja e vahjit. Kjo ndodhi është shembulli më kuptimplotë i këtij fakti:

Ummu Ejmen ﷺ, ishte dadoja e Profetit tonë ﷺ. Për shkak të ndjenjës së madhe të dashurisë që kishte për të, Profeti ﷺ, e vizitonte shpesh dhe e respektonte shumë atë. Pasi i Dërguari i Allahut ﷺ, ndërroi jetë, **Ebu Bekri** ﷺ, i thotë **Omerit** ﷺ:

“Ngrihu të shkojmë tek e afërmja e të Dërguarit të Allahut ﷺ, Ummu Ejmenja. Ta vizitojmë edhe ne, ashtu siç e vizitonte i Dërguari ﷺ.”

Kur shkuan tek ajo, Ummu Ejmen ﷺ, filloi të qante. Ata pandehën se me këtë vizitë, i kishin kujtuar Profetin ﷺ, prandaj edhe ajo filloi të qante. Por më pas, e pyetën:

“Përse po qan? A nuk di se Profeti gjendet midis të mirave pranë Allahut Teala?”

Ummu Ejmen tha:

“Unë nuk po qaj për atë. Dhe sigurisht që e di se Profeti ndodhet midis të mirave pranë Allahut. Unë po qaj për ndërprerjen e vahjit”.

Këto fjalë të mbushura plot me mall për vahjin, i prekën shumë dy sahabët e nderuar, Ebu Bekrin dhe Omerin (r.anhuma). Prandaj filluan të qanin së bashku me Ummu Ejmenen. (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 103)

Dashuria që kishin sahabët e nderuar ndaj Kuranit Kerim, ishte shumë e veçantë, sepse vlerën e Kuranit, mënyrën e leximit dhe respektin ndaj tij, e kishin mësuar drejtpërdrejt nga Profeti ﷺ. Dhe për këtë arsye, ata përfitonin në një mënyrë të veçantë prej Kuranit. Ata e lexonin shumë atë dhe nuk dëshironin t'u ikte ndonjë ditë pa e lexuar dhe pa parë faqet e tij. Ditën e fillonin me Kuran, ndërsa ata që kishin shqetësim nga sytë, këshilloheshin të shihnin Mushafin Sherif. (Shih. Hejthemi, VII, 165)

Një natë, **Omeri** ﷺ, nuk kishte mundur të lexonte Kuran. Të nesërmen, i Dërguari i Allahut ﷺ, i thotë:

“O biri i Hattabit! Allahu Teala ka zbritur një ajet në lidhje me ty” dhe më pas lexoi këtë ajet:

“Ai krijoi natën dhe ditën, që të vijnë njëra pas tjetrës, si këshillë për ata që duan ta kujtojnë ose duan ta falënderojnë.” (Furkan, 62)

“Adhurimet që të kanë ikur natën, plotësoji ditën, ndërsa ato që të kanë ikur ditën, plotësoji natën.” (Razi, XXIV, 93, në tefsirin Furkan, 62)

KURANI ËSHTË I SHENJTË, TË FISNIKËRON

NafibinAbdi'l-Haris ishte takuar me **Omerin** ﷺ, në Usfan. Omeri ﷺ, e kishte emëruar si vali në Mekë, prandaj dhe e pyeti:

- Kë ke lënë (si zëvendës) në krye të mekasve?
- **Ibën Ebzan!**- u përgjigj ai.
- Kush është Ibën Ebza?- pyeti Omeri ﷺ.
- Një nga skllëvërit që kemi liruar.- u përgjigj Nafiu.

Kur Omeri ﷺ, i tha:

- Në vendin tënd ke lënë një skllav të liruar?- Nafiu i dha një përgjigje shumë të bukur dhe mbresëlënëse:

- Ai e lexon Librin e Allahut (e jeton dhe e zbaton) dhe i njeh mirë farzet.

Pas kësaj, Omeri ﷺ, i mahnitur thotë:

I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Allahu, me këtë Kuran, disave ua rrit vlerën, ndërsa disa të tjerë i poshtëron!”*

(Muslim, Musafirin, 269)

Lumturia e besimtarit dhe e shoqërisë arrihet me futjen Kuranit dhe Sunetit që është edhe zbatuesi i tij, në çdo fushë të jetës. Kurani është një nur që i jep paqe botës së brendshme dhe të jashtme të besimtarit. Ai është i mbushur përplot me urtësi, mësim dhe këshilla. Është i vetmi udhëzues që të shpie tek Haku. Ajetet e Kuranit ndriçojnë errësirat historike dhe shpjegojnë të pashpjegueshmet. Kurani është një vend i mrekullive, ku mund të jetohet pranvera e lumturisë dhe e paqes së kësaj bote dhe botës tjetër.

Kurani është fjala e mrekullueshme e Zotit tonë. Është pasqyrimi në fjalë i shfaqjeve hyjnore të gjithësisë. Mirëpo, të ndriçohesh me nurin e tij dhe të përfitosh prej të vërtetave të tij, është privilegj vetëm për besimtarët me zemër të pastër, të cilëve Allahu u ka falur pjesë prej urtësisë.

Zemra e ndriçuar më së shumti me Kuran, ka më shumë vlerë pranë Allahut. Edhe Profeti ﷺ, në çdo çështje u jepte më përparësi zotëruesve të Kuranit. Kur ishte duke u përgatitur për fushatën e Tebukut, sanxhakun e bijve të Nexharit ia dha **Umare bin Hazmit** ﷺ. Mirëpo, kur pa **Zejd bin Thabitin** ﷺ, e mori sanxhakun prej Umares dhe ia dha atij. Umare ﷺ, pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Mos u hidhërove gjë me mua? (Bëra ndonjë gjë të papëlqyeshme?)”

Profeti ﷺ, u përgjigj duke thënë:

“Jo! Uallahi nuk jam hidhëruar! Por edhe ju merruni më shumë me Kuran! Zejdi ka mësuar më shumë Kuran se ti. Njeriut që di më shumë Kuran, i jepet më tepër përparësi se të tjerëve, edhe nëse mund të jetë një skllav me hundë të prerë!” (Uakidi, Megazi, Bejrut 1989, III, 1003.)

Osman bin Ebi'l-As ﷺ, tregon:

Shkuam tek **Profeti** ﷺ, si përfaqësues të fisit tonë. Prej të gjithë shokëve të mi, unë isha më i zellshmi në mësimin e Kuranit. Me mësimin e sures Bekare, arrita të isha më lart se të tjerët. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, më tha:

“Megjithëse je më i vogli prej të gjithëve, po të vendos si prijës të grupit. Mos e prek Kuranin, nëse nuk je i pastër!” (Hejthemi, I, 277)

Në Uhud, Ensarët pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Prej radhëve tona ka shumë shehidë. Çfarë na urdhëron të bëjmë?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëroi të hapeshin varre të thellë dhe të gjerë dhe të varroseshin tre nga tre. Kur sahabët pyetën se cilët prej shehidëve të varrosnin më parë, Profeti ﷺ, tha:

“Varrosni më parë atë që dinte më shumë Kuran!” (Nesai, Xhenaiz, 86, 87, 90, 91.)

Shembujt e respektit të madh, që tregonte i Dërguari i Allahut ﷺ, për zotëruesit e Kuranit, janë të shumtë. Ne si umeti i Muhamedit ﷺ, kemi për detyrë të respektojmë edhe Kuranin, si librin e shenjtë të Allahut, por edhe zotëruesit e

Kuranit, ata që e mbajnë Kuranin në zemrat e tyre, hafizët e vërtetë. Duhet t'u japim rëndësi dhe t'u dalim për zot, sepse ata janë shkak i mëshirës hyjnore në të dyja botët.

TË AFËRMIT E ALLAHUT: ZOTËRUESIT E KURANIT

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Padyshim që ka prej njerëzve, të cilët janë të afërt me Allahun!”

Sahabët fisnikë e pyetën:

“O i Dërguar i Allahut! Kush janë ata?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Ata janë zotëruesit e Kuranit dhe robërit e mirë të Allahut!” (Ibën Maxhe, Mukaddime, 16)

Nuk ka nder dhe lumturi më të madhe se të jesh i afërt i Krijuesit të gjithësisë, Allahut Teala. Për të merituar këtë nder dhe lumturi, duhet plotësuar kushti i të qenit prej zotëruesve të Kuranit. Pra, ta lexosh Kuranin në mënyrë të përsosur, të hysh në atmosferën e tij duke u zhytur në një meditim të thellë, të marrësh mësimet e duhura dhe të ecësh në drejtimin që tregon ai. Besimtarët që arrijnë të bëhen zotërues të Kuranit me një përsosmëri të tillë, përfitojnë prej bujarisë dhe mirësisë së veçantë të Allahut Teala.

I nderuari **Muhmud Sami Ramazanoglu** (Allahu e mëshiroftë!), na ka treguar se në qytetin e Adanës kishte ndërruar jetë një hafiz me këto cilësi që përmendëm më sipër. Pas 30 vjetësh, për shkak se në vendin ku ishte varrosur do të kalonte një rrugë, u detyruan ta zhvarrosnin për ta varrosur në një vend tjetër. Por për çudinë e të gjithëve, trupi i tij qëndronte

aty i paprishur. Madje edhe qefini me të cilin ishte mbështjellë, qëndronte i pastër si ditën e parë.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ka thënë se Allahu e ka urdhëruar tokën që të mos e tretë trupin e zotëruesve të vërtetë të Kuranit. (Shih. Dejlemi, I, 284/1112; AliMuttaki, I, 555/2488.)

Kurani Kerim sjell në zemrat dhe gjuhët e atyre që jetojnë sipas udhëzimeve hyjnore, butësi, delikatesë, bukuri dhe ëmbëlsi shpirtërore. Përveç kësaj, ai do të jetë shkak qetësie dhe lumturie në ditën e gjykimit, kur të gjithë të jenë mbledhur në mahsher dhe të fillojë peshimi i veprave.

Muhjiddin Arabiu (Allahu e mëshiroftë!), ka këshilluar kështu:

“Duhet ta lexosh shumë Kuranin dhe të mendosh për kuptimin e tij. Gjatë leximit, bëj kujdes në cilësitë me të cilat Allahu Teala ka cilësuar robërit e Tij të dashur! Shih edhe ato vepra të këqija, të cilat Kurani i qorton dhe Allahu i ka cilësuar si të humbura dhe ruaju prej tyre. Të gjitha këto, Allahu i ka zbritur dhe i ka përmendur në librin e Vet, vetëm që ti të punosh me to dhe të bësh atë që kërkohet. Për këtë arsye, kur të lexohet Kurani, bëhu njësh me Kuranin, që të kuptosh brendësinë e tij!”

Që të arrish të përfitosh shpirtërisht prej Kuranit, kërkohet që gjatë leximit, zemra të mos jetë e shkujdesur, sepse leximi i Kuranit bëhet me zemër. Detyra e syrit është të veprojë si një lloj syze për zemrën. Të pasur e të varfër ulen në gjunjë dhe lexojnë Kuran përpara të njëjtës rahleje, por çdokush merr prej Kuranit sipas gjendjes së tij shpirtërore.

Allahu Teala, në lidhje me ata që janë të shkujdesur ndaj Kuranit dhe ata që përfitojnë shpirtërisht prej Kuranit, shprehet:

“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgje-



dhur (nga ndjekësit e Muhamedit -a.s.-). **Disa prej njerëzve i bëjnë dëm vetes** (duke bërë vepra të ndaluara), **disa janë në rrugë të mesme** (duke kryer detyrimet dhe duke shmanhur të ndaluarat), **ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira** (përtej detyrimeve); **kjo është dhuntia e madhe.**” (Fatir, 32)

Pra, ka prej njerëzve që, kur lexojnë Kuran, nuk u kalon më poshtë se fyti. Ai nuk u reflekton as në zemër dhe as në vepra. Në këtë mënyrë, i bëjnë dëm vetes dhe humbasin mirësinë më të madhe. Disa të tjerë janë në rrugë të mesme. Bëjnë edhe punë të mira, por edhe neglizhojnë. Ndërsa, disa të tjerë përparojnë me hapa gjigandë në mirësi dhe në përfitimin shpirtëror të Kuranit.

Për të përfituar shpirtërisht prej Kuranit, duhet që përveç pastërtisë trupore, t'i japim rëndësi edhe pastërtisë shpirtërore. Përndryshe, sëmundjet e zemrës e pengojnë njeriun të takohet në mënyrën e duhur me Kuranin. Për këtë arsye, **Osmani** ﷺ, ka thënë:

“Nëse zemrat do të ishin të pastra prej papastërtive shpirtërore, nuk do të ngopeshin kurrë me Kuranin”.

Ndërsa **Mevlana Xhelaleddin Rumi**, ka thënë:

“Kuranin e kuptojnë vetëm ata, të cilët u kanë vënë zjarrin dhe i kanë bërë shkrumb e hi dëshirat dhe epshet e tyre dhe ata të cilët janë shkrirë përpara Kuranit duke sakrifikuar shpirtin e tyre”.

Kurani Kerim ua hap të fshehtat e veta vetëm zemrave të pastra dhe të mbështjella me nur. Për këtë arsye, duhet që zemrat tona t'i mbështjellim me devotshmëri dhe me këto ndjenja t'i afrohem Kuranit, sepse Allahu Teala shprehet:

“...ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju...” (Bekare, 282)

Nuk duhet harruar se Kurani nuk është vepër e një të vdekshmi, por është një udhëzues i rugës së drejtë, të cilin Krijuesi i gjithësisë na e ka falur, me qëllim që të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër. Prandaj, për të përfituar në mënyrën e duhur prej Kuranit, duhet që kapakun e tij ta hapim me ndjenja të larta respekti dhe ta lexojmë me vetëdijen që Allahu Teala u ka mësuar njerëzve. Pra, ta lexojmë Kuranin sikur është duke u zbritur në ato momente.

SIKUR JE DUKE FOLUR ME ALLAHUN

Kurani Kerim është rruga më e mirë për njeriun që të dëgjojë thirrjet e Rrahmanit, të ndjejë në shpirtin e tij flladet hyjnore dhe të flasë me Allahun që në këtë botë. Të lexosh Kuran duke medituar, me rregull dhe edukatë, është sikur të flasësh me Allahun. Profeti ﷺ, ka thënë:

“Nëse dikush prej jush dëshiron të flasë me Allahun, le të lexojë Kuran me qetësi shpirtërore”. (Sujuti, I, 13/360)

Për të përfituar siç duhet prej Kuranit, duhet t'i hapësh zemrën atij. Përndryshe, ashtu siç nuk përfitojnë shkëmbinjtë prej shirave të begatë të prillit, ashtu edhe zemrat e kyçura nuk mund të kenë dobi prej Kuranit. Mbase Kurani ua shton njerëzve të tillë edhe më tepër humbjen, sepse ata që nuk arrijnë të takohen me mëshirën dhe udhëzimin e Kuranit, bien në një humbje të madhe. Njëri prej mufesirëve më të famshëm të tabiinëve, Katade, ka thënë:

“Ata që lexojnë Kuranin Kerim ose përfitojnë, ose humbasin. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.” (Isra, 82.)”

Prandaj, gjatë leximit të Kuranit, nuk duhet të sillemi si të verbër e të shurdhër përpara tij. Në një ajet fisnik, në lidhje me gjendjen e të dashurve të Allahut, të cilët përfitojnë prej ndjenjave shpirtërore që u fal Kurani, urdhërohet:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe mbështeten vetëm te Zoti i tyre.” (Enfal, 2)

Detyra jonë si besimtarë është të bëjmë një jetë nën udhëzimin e Kuranit. Në të kundërtën, ndërsa presim që Profeti ynë ﷺ, të bëjë shefat për ne, mundet që ai edhe të ankohet për ne. Në një ajet fisnik, tregohet se Profeti ynë ﷺ, do të ankohet për ata që bëjnë një jetë në kundërshtim me parimet e Kuranit:

“Dhe i Dërguari do të thotë: “O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urreyer”. (Furkan, 30)

Pra, për të mos rënë në këtë qortim profetik në ditën e gjykimit, duhet që Kuranin Kerim ta lexojmë shpesh dhe sipas rregullave të texhudit. Gjithashtu, duhet të mësojmë kuptimet e tij të thella dhe të mundohemi ta zbatojmë atë me ndjenja të larta dashurie dhe respekti, siç i takon një myslimani të vërtetë, i cili pretendon se është prej umetit të Muahamedit ﷺ. Siç do të shprehej edhe vetë **Gazaliu**: *“Gjuha duhet të lexojë. Mendja me urtësinë e saj duhet të përkthejë dhe të meditojë. Ndërsa zemra, duhet të përvetësojë dhe të marrë mësim.”* (Shih. Ihja' u-Ulumi'd-Din, I, 816)

Profeti ynë ﷺ, dëshironte shumë që umeti i tij të ishte gjithmonë i lidhur me Kuranin. Madje ai jetonte me vetëdijen dhe shqetësimin se, në lidhje me këtë çështje, do të jepte llogari përpara Allahut në ditën e gjykimit. Për këtë arsye, ai merrej më shumë me ashab-i suffice, që ishin nxënësit e Kuranit.

Madje edhe në kohët kur mbretëronte zia e bukës, ai lidhte gurë në bark dhe shkonte të jepte mësim Kurani.

Abdullah ibën Mes’udi ﷺ, i cili ishte prej nxënësve të ashab-i suffes dhe u edukua pranë Profetit ﷺ, ka thënë:

“Profeti ndikoi aq shumë tek ne, sa arritëm të dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave të bukës që kalonin në fytin tonë”.

(Buhari, Menakib, 25)

Brezi i sahabëve, të cilët morën shembull Profetin ﷺ, në lidhje me mësimin e Kuranit, e mbushi Medinën me mësues Kurani.

PËRGJEGJËSIA JONË NDAJ KURANIT

Kurani Kerim është i fundit i katër librave hyjnorë që e kanë burimin tek Allahu Teala. Ai është thirrja dhe mesazhi i fundit i Allahut për mbarë njerëzimin. Prej të gjithë librave që ka shpallur, Kurani Kerim është i vetmi libër për të cilin Allahu ka premtuar se do ta ruajë deri në ditën e kijametit. Për këtë arsye, ai është i vetmi libër hyjnor, i cili ka ruajtur origjinalitetin e vet pa iu ndryshuar qoftë edhe një gërme. Mirëpo, megjithëse Allahu ka premtuar se do ta ruajë Kuranin, nuk do të thotë se ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie ndaj Kuranit. Për këtë arsye, duhet të llogarisim veten se sa familjaritet kemi me Kuranin. Sa e lexojmë atë, duke e ndjerë dhe kuptuar mesazhin e tij? A i ndjejmë edhe ne emocionet që ndjente Profeti ﷺ, me sahabët e tij, kur e lexonin atë?

A kemi arritur ta transferojmë Kuranin Kerim në çdo pjesë të jetës sonë? Sa e marrim atë si kriter në jetën tonë familjare, në marrëdhëniet me komshinjtë dhe në jetën tregtare? Sa e shohim veten tonë përgjegjës për kohën dhe shoqërinë?

A u japim edukatën e duhur fëmijëve tanë, në lidhje me

njohjen e Allahut? Sa jemi duke punuar për të përhapur Kuranin në zemrat e të tjerëve dhe për të ndihmuar në udhëzimin e tyre?

Të mos harrojmë se lumturia e të dyja botëve është e mundur me edukimin e fëmijëve tanë, të cilët janë një amanet hyjnor, me kulturën e Kuranit. Prindi më i mëshirshëm është ai që e përgatit fëmijën e tij me edukatën Kuranore, që është edhe e ardhmja e vërtetë në botën tjetër. Dhurata më e bukur, që mund t'i bëjë njeriu fëmijës së tij, është edukimi i mirë.

Prindërit, të cilët nuk i ndihmojnë fëmijët e tyre të shijojnë prej mirësive të panumërta të Kuranit, për arsye se nuk i kanë shijuar as vetë, kanë mbi supet e tyre një gjynah shumë të madh. Fëmijët, që nuk edukohen me shpirtin e Kuranit dhe Sunetit dhe lihen analfabetë në çështjet shpirtërore, në ditën e kijametit do t'i akuzojnë prindërit e tyre në lidhje me këtë çështje. **Ibën Omeri** (r.anhuma.), thotë:

“Edukoje mirë fëmijën tënd, sepse je përgjegjës dhe do të japësh llogari se çfarë ke bërë në lidhje me edukimin e tij dhe çfarë i ke mësuar”.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Edukojini fëmijët tuaj në tri çështje: në dashurinë ndaj Profetit, në dashurinë ndaj Ehl-i Bejtit dhe në leximin e Kuranit..., sepse shërbyesit e Kuranit (ai që mëson Kuran, ua mëson të tjerëve dhe shërben në këtë rrugë), do të jenë së bashku me profetët dhe të dashurit e Allahut nën hijen e Arshit, në ditën e kijametit, ku nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit”. (Munavi, Fejzu'l-Kadir, I, 226.)

Prandaj dhe një nga çështjet më të rëndësishme të besimtarëve të sinqertë, është edukimi i fëmijëve të tyre me shpirtin Kuranor.

Halifi II, Abbasit, **Ebu Xhafer Mansur**, i pyet Emevitët, që ishin burgosur gjatë trazirave politike të kohës:

“Çfarë vështirësish keni në burg?”

Ata përgjigjen, duke thënë:

“Jemi të privuar nga edukimi i fëmijëve tanë”. (Ibrahim Xhanan, Kutub-i Sitte, I, 381.)

Për këtë arsye, duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me shpirtin Kuranor, pa na ikur rasti prej dore, sepse, nesër kur të jemi në varr, do të bëhemi shumë pishman se nuk arrijmë ta bëjmë. Prandaj dhe me fëmijët tanë duhet të interesohemi në kohën e duhur. Duhet që në zemrat e tyre të pastra të mbjellim dashurinë për Allahun dhe Profetin ﷺ, për kulturën Kuranore dhe profetike. Duke u nisur nga fakti se talentet dalin në pah me motivim, për të zhvilluar bukuritë shpirtërore të fëmijëve tanë, duhet t'i motivojmë ata me dhurata dhe komplimente.

Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!), thotë:

“Sa herë që mësoja përmendsh një hadith, babai më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë, kur mësimi përmendsh i hadithit u bë dëshira ime më e madhe, edhe pse babai nuk më jepte dhurata”.

Imami **Ebu Hanife** (Allahu e mëshiroftë!), kur djali i tij **Hamadi** mësoi suren Fatiha, i dha mësuesit të tij pesëqind dirhem. Në atë kohë, me një dirhem mund të blihej një dash. Mësuesit iu duk e tepërt kjo bujari, sepse djali kishte mësuar vetëm suren Fatiha. Por Ebu Hanifja, tha:

“Mos e nënvleftëso suren që i mësove djalit tim! Nëse do të kisha me vete më shumë (para), do të t'i jepja të gjitha që të tregoja respektin e duhur ndaj Kuranit.”⁸

8. Ebu gudde, Fethu Babi'l-Inaje, fq. 19; Muhammed Nur Suejd, “Edukimi i

Ndërsa **Salahuddin Ejjubi**, kur ishte duke shëtitur në kampin ushtarak, pa një djalë që po lexonte Kuran përpara babait të tij. Atij i pëlqeu leximi i djaloshit, prandaj i dha një pjesë prej ushqimit të tij. Përveç kësaj, babait dhe djalit të tij i dhuroi një pjesë prej tokës që zotëronte.⁹

Të gjithë këta janë shembuj të bukur, prej të cilëve duhet të marrin mësim të gjithë prindërit, në lidhje me edukimin e fëmijëve të tyre. Për mësimin e Kuranit duhen shfrytëzuar shumë mirë edhe pushimet e verës. Nuk duhet të mjaftohemi me dërgimin e fëmijëve në kurset e Kuranit apo në xhami, por si prindër, duhet të interesohemi më nga afër me ecurinë e edukimit të tyre. Duhet të kontrollojmë më shpesh nivelin e kulturës së tyre Kuranore, dituritë e tyre në lidhje me besimin dhe fikhun dhe vazhdimisht t'i motivojmë me interesimin tonë.

Lum ata prindër që arrijnë shefatin e Kuranit dhe Profetit ﷺ, duke edukuar fëmijët e tyre me Kuran!..

Allahu na ruajtë nga mbajtja e ngarkesës së rëndë të zemrave të sëmura, që janë shkatërruar për shkak të privimit nga Kurani. Na bëftë të gjithëve prej robërve të lumtur, që takohen në shërimin, udhëzimin dhe mëshirën e Kuranit dhe që vrapojnë të qetë drejt takimit hyjnor...

Amin!..



fëmijëve në sunetin e Profetit tonë ﷺ", fq. 119-120

9. Bundari, Ebu'l-Feth Ali, Neuadiri's-Sultanije (Siretu Salahuddin), fq. 9; Muh - med Nur Suuejd, "Edukimi i fëmijëve në sunetin e Profetit ﷺ", fq. 120.





Gjendja e "Hiç"it

Ata që arrijnë ta kuptojnë ashtu si duhet fuqinë dhe madhësinë e Hakut, as nuk preokupohen më për ekzistencë dhe as nuk pretendojnë më për ego. Kjo, sepse ata shndërrohen në qirinj që shkrihen në sajë të ndjenjës së dobësisë dhe hiçit. Këta njerëz të mëdhenj që arrijnë majat e ndjenjës së "hiç"it duke pirë eliksirin e dobësisë përball Hakut, bëhen të dashurit e Hakut.

Po ashtu, besimtarët e devotshëm, jetojnë gjithmonë duke u përpjekur të arrijnë majën të ndjenjës së "hiç"it, duke thënë: "Të gjitha mirësitë, janë prej Teje o Zot!"

GJENDJA E “HIÇ”IT

*“Nëse ti prej vetes del,
vetëm Ai që të ka krijuar ngel!”*

Ashtu si çdo krijesë, njeriu ishte “asgjë” dhe nuk i përme-
ndej as emri. Pastaj, doli në skenën e jetës me urdhrin hyjnor
“Kun! / Bëhu!” falë mirësisë dhe bujarisë së Allahut. Pra, doli
prej mosekzistimit në botën e “ekzistencës”.

Njeriu nuk ka paguar asgjë për të “ekzistuar”. Ai ekzis-
ton thjesht për shkak të mirësisë dhe bujarisë hyjnore. Mbi
të gjitha, është krijuar në “ahsen-i takuim / formën më të
bukur” dhe është pajisur me aftësi të veçanta që e kanë bërë
atë “eshref-i mahlukat”, pra, “më fisnikun prej krijesave”.
Për këtë arsye, njeriu ka për borxh falënderime të pafundme
ndaj Krijuesit të tij.

Pika më e rëndësishme e kësaj çështjeje, është të paguarit
për mirësinë e “imanit”, sepse të pretendosh pronësi mbi diçka
për të cilën nuk ke paguar, do të thotë të merresh me punë të
padobishme. Kurse xheneti dhe shikimi i Allahut, janë mirësia
dhe bujaria e veçantë e Allahut Mëshirëplotë si shpërblimi i
besnikërisë, miqësisë dhe devotshmërisë.



Edhe vetë profetët që kanë bërë një jetë të devotshme, kanë rrëfyer dobësinë e tyre për të larë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut ashtu siç e meriton. Profeti ﷺ, ka falur namaz nate deri sa i janë ënjtur këmbët. Rrobat, mjekra e tij e bekuar dhe vendi ku binte në sexhde, janë lagur nga lotët e tij të bekuar. Kur i thanë:

“O i Dërguar i Allahut! Përse qani kaq shumë, kur Allahu jua ka falur të gjitha gabimet e shkuara dhe të ardhme?”, ai është përgjigjur:

“A të mos jem rob falënderues?..” (Shih. Ibën Hibban, II, 386)

Pra edhe vetë Profeti ﷺ, që ishte robi më i dashur i Allahut, jetonte me vetëdijen se, sado që të bënte adhurime, nuk do t’ia arrinte kurrë të lante borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut ashtu siç duhet. Zemra që mbështillte botët me mëshirë, përpëlitej përpara Allahut me ndjenjën e të qenit asgjë. Për këtë arsye, çdo gjë që bënte, e quante gjithmonë të pamjaftueshme, madje “asgjë” dhe vazhdimisht mundohej të shtonte nënshtrimin dhe përgjërimin.

Sa herë që e shihte se sa e mangët dhe e zhveshur ishte gjendja e tij e devotshmërisë përballë Madhështisë së Allahut, bënte teube dhe kërkonte falje. Në disa hadithe fisnike Profeti ﷺ, është shprehur:

“Vallahi unë i kërkoj falje Allahut më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë...” (Buhari, Deauat, 3; Tirmidhi, Tefsir, 47)

“Ndonjëherë ndodh që zemra ime të turbullohet. Por unë i kërkoj falje Allahut njëqind herë në ditë”. (Muslim, Dhikr, 41)

Sigurisht, që në të shumtën e rasteve, Profeti ﷺ, nuk kërkonte falje dhe nuk bënte teube për shkak të gjynaheve apo gabimeve, por nga një anë për të larë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut dhe nga një anë tjetër për të arritur kënaqësinë e

Tij. Pra, për shkak të dëshirës së tij të madhe për t'iu afruar sa më shumë Allahut. Kjo, sepse Profeti ﷺ, ndodhej gjithmonë në një ngritje shpirtërore të vazhdueshme dhe kërkonte falje e bënte teube për gjendjen në të cilën ndodhej më parë.

Përgjërimin e tij ndaj Zotit brenda një horizonti të tillë shpirtëror, na e transmeton edhe nëna e besimtarëve, Aisheja :

“Një natë, kur u ngrita nga shtrati, nuk e gjeta pranë meje të Dërguarin e Allahut. Menjëherë mendova se mund të kish-te shkuar tek ndonjë prej grave të tjera. Por kur kontrollova me dorë përreth vetes, dora ime ceku këmbët e tij. Në atë moment e kuptova se i Dërguari i Allahut ndodhej në sexhde. Fillova të dëgjoja dhe ndjeva se ai po qante me dënësë dhe i përgjërohej Allahut kështu:

“O Allah! Strehohem në kënaqësinë Tënde prej zemëri-mit Tënd dhe në faljen Tënde prej dënimit Tënd! O Allah! Strehohem tek Ti prej Teje. Unë nuk jam i aftë të të lavdë-roj e të të falënderoj ashtu siç e meriton! Ti je ashtu siç e ke lëvduar dhe madhëruar veten Tënde!” (Muslim, Salat, 222.; Tirmidhi, Deauat, 75/3493)

THELBI I DEVOTSHMËRISË SË PASTËR

Detyra më e rëndësishme për ne njerëzit, është të mundo-hemi të lajmë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut. Edhe kri-jimi prej asgjësë, është një mirësi për të cilën jemi të paaftë të falënderojmë... Po mirësia e të qenit njeri midis të gjitha krijesave, e të qenit besimtar midis gjithë njerëzve, e të qenit prej umetit të Muhamed Mustafait ﷺ, në mesin (sipas trans-metimeve) e 124 mijë profetëve?..



Edhe sikur të biem në sexhde, në shenjë falënderimi përballë Allahut për të gjitha këto mirësi dhe të mos e ngremë kokën gjatë gjithë jetës, përsëri është pak, përsëri është e mangët, madje një “hiç”...

Sa bukur dhe sa qartë e shpreh ky hadith këtë fakt:

“Nëse një njeri, me qëllim që të fitojë kënaqësinë e Allahut, do të mendohej të mos e ngrinte kokën prej sexhdes që nga dita në të cilën lind e deri në ditën që do të plakët e do të vdesë, në ditën e kijametit, (me mendimin se ka qenë i dobët në falënderimin e Allahut për të gjitha mirësitë që i ka falur) përsëri veprat e tij do t’i dukeshin të pakta”. (Ahmed, V. IV, s. 185)

Pra, edhe një jetë e tillë, e mbushur me adhurime, nuk do të mjaftonte për shpëtimin e përjetshëm. Mirëpo, Allahu, së bashku me punët, do të shohë edhe zemrat tona, sepse Ai kërkon prej nesh zemra të pastra. Dhe zemra e pastër është e lidhur ngushtë me shpirtin e mbushur me ndjenjat e “hiçit dhe dobësisë” përballë Allahut...

Tek Allahu fitojmë vlera vetëm:

- Kur mundohemi të bëjmë një jetë me pjekuri shpirtërore. Kur jemi të devotshëm dhe të bindur. Kur falënderojmë dhe i lutemi Allahut...

- Kur jemi të vetëdijshëm se, nëse nuk na mëshiron Allahu, asnjë prej punëve tona të sinqerta nuk do të mund të na shpëtojë...

- Kur të mos harrojmë se ashtu si lutjet tona, edhe adhurimet tona kanë nevojë për pranimin hyjnor...

Kjo pra është pjekuria shpirtërore që formon thelbin e një devotshmërie të pastër...

ÇDO GJË FILLON PAS “HIÇ”IT

Jeta që kalohet me adhurime dhe me pjekuri shpirtërore, e ngre robin në lartësitë e miqësisë me Allahun, sepse dritarja e zemrës nuk hapet, nëse nuk përparon në përlulësi, modesti dhe devotshmëri ndaj Allahut...

Për këtë arsye, nënshtrimi i “egos” me aq sa mundesh, është një nga çështjet më të rëndësishme të tasavufit. Në lidhje me këtë çështje, që prej shumë kohësh është bërë zakon që në muret e teqeve të vendosen tabela, ku me art kaligrafie shkruhen thënie që përmbajnë këshilla dhe tërheqin vëmendjen.

Në një nga këto tabela, shkruhet “hiç”, e cila nënkupton faktin se për të përfituar prej mëshirës hyjnore, është kusht që më parë të çlirohesh nga dëshirat dhe epshet e nefsit. Pra, pa arritur gjendjen e “hiç”it, duke u zhveshur prej egos, nuk mund të bëhet fjalë për përsosmëri shpirtërore.

Bota e brendshme e çdo njeriu, ndjek një udhëtim midis animeve nga gjynahu dhe devotshmërisë... Jeta sipas qejfeve të egos, në çdo ngjarje e rrit më tepër egon, ndërsa jeta sipas vlerave morale dhe shpirtërore, nxit gjendjen e hiçit dhe të bën të kuptosh se çdo mirësi është dhuratë prej Allahut Teala.

Edhe lufta brenda nesh, është luftë midis egos dhe hiçit. Nëse arrijmë t'i mundim dëshirat e nefsit dhe gjynahet, do e kthejmë “egon”, pra mendjemadhësinë, mburrjen dhe krenarinë në një “hiç”. Në rrugën e pjekurisë shpirtërore, çdo gjë fillon pasi “hiç”i të ketë fituar mbi “egon”. Edhe e fshehta e thënies: مَنْ عَرَفَ نَفْسَهُ فَقَدْ عَرَفَ رَبَّهُ “Kush e njeh nefsën e tij, njeh edhe Zotin e tij”, arrihet të kuptohet pas asaj pike. Pra, pas asaj pike i bëhet e mundur “marifetullahu / njohja e Zotit me zemër”.

Një besimtar që ka mundur ta njohë Zotin e tij me zemër, duke arritur gjendjen e hiçit, fillon t'i lexojë në shpirtin e tij të fshehtat dhe urtësitë hyjnore të kësaj bote të përkohshme. Në këtë pikë, këtij robi fatlum, i shfaqet urtësia që dëgjoi **Abdulkadir Gejlani** prej Hakut:

“Unë jam e fshehta e njeriut..”¹⁰

Të dashurit e Allahut, gjatë gjithë jetës së tyre janë përpjekur ta eliminojnë krejtësisht egon e tyre, prandaj dhe kanë thënë:

“Nëse tek dikush ngelet qoftë edhe një germë prej egos, ai nuk mund të bëhet i dashur i Allahut.”

Kjo, sepse për të gjetur rrugën e vendit të madhështisë, më parë duhet ngritur perdja e egos. Prandaj dhe të urtët kanë thënë: *“Nëse ti prej vetes del, vetëm Ai që të ka krijuar ngel!”*

I dashuri i Allahut, i nderuari **Mevlana**, për shkak se arriti ta shndërronte egon e tij në një hiç, hyri në hauzin ku gjendeshin lebrozët dhe me një pjekuri të madhe shpirtërore i ripërtëriti zemrat e tyre të lënduara.

Ndërsa i nderuari **Bahauddin Nakshibendi**, për të kapërcyer pengesën e egos, u shërbente kafshëve, i hapte rrugë çdo gjallese, duke menduar se “edhe mua, edhe atë e ka krijuar Allahu” dhe e barazonte nefsin e tij me to.

Kadiu i Bursës, i nderuari **Hydai**, për të shembur murin e ekzistencës dhe egos në shpirtin e tij, me urdhër të mësuesit të tij, u bë shitës mëlçish në pazarin e Bursës, i veshur me kaftan të qëndisur me argjend. Gjithashtu, punoi edhe si pastrues i abdes'hanës së teqes. Në këtë mënyrë, ai filloi të përparonte në botën shpirtërore, vetëm pasi eliminoi egon e tij.

Tek ata që arrijnë ta kuptojnë ashtu si duhet fuqinë dhe

10. Shih. Fususu'l-Hikem, Përkthimi me shpjegim I, 48.

madhëstlinë e Hakut, edhe shqetësimi për ekzistencë, edhe pretendimi për ego e humbasin fuqinë e tyre. Kjo, sepse në sajë të ndjenjës së dobësisë dhe hiçit, ata shndërrohen në qirinj që shkrihen. Këta talente të mëdhenj, që arrijnë majat e ndjenjës së “hiç”it, duke pirë eliksirin e dobësisë përballë Hakut, bëhen të dashurit e Hakut.

KTHEHU NË “HIÇ”, QË TË BËHESH DIELLI I DIEJVE...

Sipas një transmetimi, i nderuari **Halid Bagdadi**, megjithëse gëzonte famë në të gjithë botën islame dhe zotëronte një dituri të gjerë, pas një viti udhëtimi, me një edukatë she-mbullore, u ul në gjunjë para të nderuarit **Abdullah Dehleviut**. Duke fshirë krenarinë dhe mburrjen prej zemrës së tij dhe duke shtypur kryeneçësinë dhe dëshirat e nefsit, pranoi të kryente detyrën e pastruesit të abdes’hanës. Si rezultat i kësaj modestie, i gjendjes së “hiç”it që kishte arritur dhe edukimit që kishte marrë, meritoi lavdërimet e mësuesit të tij dhe mirë-sitë shpirtërore.

Kur erdhi koha të ndahej prej teqes së Abdullah Dehleviut, në sytë e tij shkëlqente drita e dashurisë. Midis ardhjes dhe ikjes së tij, kishte shumë ndryshim. Kur erdhi, Abdullah Dehleviu, me qëllim që t’i jepte mësimin e parë të gjendjes së “hiç”it, nuk doli për ta pritur, ndërsa, kur po ndahej, doli ta përcillte me respektin më të madh. Madje, megjithëse Halid Bagdadi u turpërua shumë, mësuesi i tij mbajti me dorë vendin ku vihet këmba për të hipur në kalë dhe e ngriti nxënësin e tij të bekuar me duart e veta. Pasi e përcolli përreth katër milje, atyre që ndodheshin pranë u thotë këto fjalë, në lidhje me nxënësin e tij:

“Halidi mori gjithçka me vete.”

Kjo do të thotë që, edhe pse njeriu mund të arrijë majat

më të larta të diturisë, është i detyruar ta zbukurojë diturinë e tij me bukuritë shpirtërore. Dhe për këtë arsye, edukata shpirtërore është shumë e domosdoshme. Në të kundërtën, njeriu zhytet në batakun e krenarisë dhe mendjemadhësisë së nefsit dhe nuk mund t'i shpëtojë shkatërrimit. Kush nuk e merr nën këmbë nefsën e tij, nuk mund të arrijë majat e përsosmërisë shpirtërore.

Për arsye se Halid Bagdadi zotëronte edhe dijet dhahiri edhe dijet batini¹¹, është thirrur me emrin **“Dielli i Diejve”**. Nxënësit e tij u shtuan shumë dhe rrethi i mësimave të shpirtërore sa vinte e zgjerohej. Madje edhe sot e kësaj dite, myslimanët anekënd botës përfitojnë prej dijeve të tij.

Letrat që ka shkruar i nderuari Halid Bagdadi drejtuar bijve dhe vëllezërve të tij shpirtërorë, na japin mësim të rëndësishme në lidhje me gjendjen e hijt. Ndërsa në një letër drejtuar vëllait të tij të gjakut, veten e tij e përshkruan me këto fjalë:

“...Betohem në Allahun Teala se, që kur më ka lindur nëna e deri më sot, nuk besoj të kem bërë ndonjë të mirë, e cila është e pranuar dhe me vlerë tek Allahu, aq sa të mos kërkohet llogari për të.”

Padyshim se ajo që e shtynte këtë lider të madh shpirtëror në këto ndjenja, ishte gjendja e “hiç”-it, që ndjente përballë Allahut.

Pra, sado punë të mira të ketë bërë një njeri, asnjëherë nuk duhet t'u besojë atyre dhe të mbështet në to, por gjithmonë duhet t'i shohë të mangëta dhe të strehohet në mëshirën e Allahut.

11. Në tasavuf ka dy lloj dijesh. Dhahiri dhe batini. Dijet dhahiri janë ato dije që fitohen me të lexuar dhe mësuar, siç janë shkenca e hadithit, tefsirit, fikhut etj. Ndërsa dijet batini janë ato dije që kanë të bëjnë me botën e shpirtit dhe fshehtësitë e tij. Këto dije Allahu ua fal profetëve dhe robërve të Tij me grada të larta devotshmërie.

Pas këtyre fjalëve, Halid Bagdadi vazhdoi duke thënë:

“Nëse gjatë kryerjes së punëve të mira nuk e sheh të falimentuar nefsën tënd, ky është niveli më i lartë i injorancës. Nëse e ndjen të falimentuar, mos e humb shpresën tek Allahu, sepse mirësia dhe bujaria e Allahut Teala për njeriun, është shumë më e dobishme se të gjitha punët e mira të njerëzve dhe xhinëve.

Allahu Teala urdhëron:

“Thuaj: “Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij, vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.” (Junus, 58)

Ibën Abbasi , në komentimin e shprehjes «ajo që grumbullojnë», thotë se kuptimi i saj është “ajo që kanë fituar.”

Kurrë mos i neglizho adhurimet duke u mbështetur në mirësinë dhe bujarinë e Allahut ashtu siç vepruan ata, me mendjet e të cilëve luan shejtani! Vazhdoje kontrollin ndaj vetes në mënyrë vigjilente! Mos u ndaj prej Tij (Allahut), goftë edhe kur je duke ecur në rrugë...”¹²

Me një fjalë, ashtu si adhurimet, të gjitha veprat tona kanë nevojë për pranimin nga ana e Allahut. Prandaj, veprat e mira nuk duhet të bëhen shkas që në zemrën e besimtarit të zënë vend cilësitë egoiste.

Por nga ana tjetër, besimtari nuk duhet të shkojë në skajin tjetër dhe të bjerë në gjendje të pashpresë. Historia e **Junusit** , është një shembull mësimdhënës në lidhje me humbjen e shpresës:

Junusi , në vend që të zbatonte urdhrin hyjnor dhe të kumtonte fenë për dyzet ditë, në ditën e tridhjeteshtatë u zemërua me popullin e tij, i cili nuk po vinte në rrugën e

12. Mektubat-i Mevlana Halid, Letra e 28.

besimit dhe i braktisi ata. Prej afatit që i kishte dhënë Allahu Teala, kishin ngelur edhe tri ditë. Por Junusi ﷺ, u largua prej popullit të tij i pashpresë. Më vonë, kur e hodhën nga anija në të cilën kishte hipur dhe po qortonte veten për gabimin që kishte bërë, papritur gëlltitet nga një peshk.

Kur ishte në barkun e peshkut, Junusi ﷺ, bëri teube, kërkoi falje prej Allahut dhe u angazhua vetëm me përmendjen e Allahut. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Po të mos ishte nga ata që i luten Allahut, me siguri do të mbetej në barkun e tij deri në Ditën e Ringjalljes.”

(Saffat, 143-144)

Në një ajet tjetër, Allahu Teala i drejtohet Profetit ﷺ, duke e këshilluar të mos i humbë shpresat:

“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi, a.s.), kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës)! Sikur të mos i vinte mëshira prej Zotit tënd, ai do të hidhej në një shkretëtirë, i fajësuar!” (Kalem, 48-49)

Pra, robi gjithmonë ka nevojë për mëshirën dhe mirësinë e Allahut. Prandaj, asnjëherë nuk duhet t’u besojë veprave të veta dhe të nxjerrë në pah egon e tij. Por nuk duhet të bëjë as të kundërtën e saj dhe t’i nënvleftësojë ato plotësisht e të bjerë në gjendje të pashpresë. Deri në frymën e fundit ai duhet të përmbushë detyrën e tij si rob i Allahut me thjeshtësi të madhe. Gjithashtu, duhet të jetojë në mes frikës dhe shpresës dhe gjithmonë të strehohet në mëshirën e Allahut.

Në një letër tjetër të **Halid Bagdadit**, e cila i drejtohet si këshillë një nxënësi të tij që e kishte ngarkuar me detyrën e mësimdhënies, zënë vend shprehje që na lënë të kuptojmë qartë gjendjen e “hiç”it në të cilën ndodhej:

“...Ju këshilloj të angazhoheni me punë të cilat do t’u

bëjnë dobi në frymën e fundit, të zbatoni sunetin e Profetit ﷺ, të mos shkoni pas bukurive të jashtme të kësaj bote mashtruese, të mos ndiqni zakonet e popullit (pra të mos zbatoni zakone të cilat janë në kundërshtim me fjalën e Allahut) dhe të mos e harroni me lutje për sukses dhe përfundim të mirë këtë rob të varfër.”¹³

Pra, ai rob i devotshëm i Allahut, i kërkonte nxënësit të tij të bënte dua për të, me qëllim që frymën e fundit ta jepte duke qenë besimtar.

ZEMRAT QË KANË ARRITUR GJENDJEN E “HIÇ”IT.

I nderuari **Musa Topbash**, të cilin e përcollëm në përjetësi pas një jete të pastër e të zbukuruar me besnikëri dhe shërbim, në sajë të modestisë së madhe që zotëronte, ishte kthyer në një shembull të gjallë të vetëdijes së gjendjes së “hiç”it. Në lidhje me këtë çështje, ai edhe pas vdekjes u bë shkak udhëzimi për zemrat e atyre që e donin, duke u lënë kujtime dhe mësim të vlefshme. Kur u hap testamenti që kishte lënë, që në paragrafin e parë zinin vend këto shprehje, të cilat tregojnë vetëdijen e tij në lidhje me gjendjen e “hiç”it që ndjente përballë Allahut:

“Çdokush që vjen në këtë botë, do të emigrojë për në botën e përjetshme, pasi t’i ketë plotësuar orët e tij dhe frymëmarrjet e numëruara. Lum për atë që e ka shpenzuar jetën e tij në rrugën e Allahut dhe ka emigruar në botën tjetër me faqe të bardhë!..

Edhe unë i mjeri, megjithëse e dija këtë fakt me aq sa më ishte dhënë mundësia, nuk arrita t’i bëhem rob Zotit

13. Mektubat-i Mevlana Halid, letra e 25.

ashtu siç e meriton Ai. Megjithëse jam i moshuar dhe i kam braktisur mirësitë e kësaj bote, nuk munda ta përmirësoj veten. Kam lexuar biografite e jetës së ndershme dhe të vetëdijshme të të mëdhenjve të islamit, por nuk munda të bëhem si ata. Pas një jete të mbushur me gabime, po shkoj pranë Allahut Teala vetëm duke shpresuar në faljen e tij, sepse Ai është Rrahman dhe Gaffar.”

Nëse një i dashur i Allahut, që ia ka kushtuar të gjithë jetën shërbimit në rrugë të Allahut mendon kështu për veten, po ne çfarë duhet të themi për gjendjen tonë? Allahu na pranoftë të gjithëve në mëshirën e Tij!

EGOJA: SHKAKU I MOSBINDJES NDAJ ALLAHUT

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës e megjithatë, ai bëhet kundërshtar i hapët?!”

(Ja-Sin, 77)

Të shkujdesurit që kanë harruar se natyra e tyre e vërtetë është “hiçi dhe mosekzistimi”, nuk mund të shpëtojnë nga vorbulla e egos, krenarisë dhe mendjemadhësisë, të cilat janë fatkeqësitë më të mëdha shpirtërore.

Për shkak të egos së tij, Iblisi guxoi të debatojë me Allahun, duke thënë për Ademin ﷺ, “unë jam më i lartë se ai” dhe në fund u shkatërrua.

Karuni, i cili u mbyt në thesare si sprovë hyjnore, e kundërshtoi Musain ﷺ, që i llogariti zekatin dhe dëshiroi t’ia marrë. Ai mbajti qëndrim të ashpër dhe me arrogancë të madhe tha: “Këto thesare i fitova me dijen time”. Por në të vërtetë ai

harroi se ato ishin mirësia dhe sprova e Allahut Teala. Prandaj dhe u varros në fund të dheut bashkë me thesaret e tij.

Ndërsa Bel'ambin Baura ia atribuoi vetes suksesin shpirtëror që arriti dhe me mendjemadhësi anoi nga dëshira e tij. Por Allahu Teala e shkatërroi, duke e çmendur si një qen që merr frymë duke nxjerrë gjuhën jashtë.

Në vitin 1912, kur anija gjigande Titanik doli në udhëtimin e saj të parë, me krenari dhe mburrje u tha: "Këtë anije nuk mund ta fundosë asnjë forcë". Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe humbi në thellësitë e oqeanit së bashku me ata që kishte brenda.

Në vitin 1986 anija kozmike "Challenger", që do të thotë "Sfiduesja", shpërtheu 73 sekonda pas lëshimit dhe i gjithë ekuipazhi i saj vdiq.

Në 18 Mars të vitit 1915, luftanija e madhe franceze "Inflexible" që do të thotë "e papërthyeshme, e papërkulshme", u dëmtua rëndë dhe ngeli jashtë luftimi në luftën legjendare të Çanakalesë. Në të njëjtën ditë, edhe luftanija "Irresistible" që do të thotë "e papërballueshme", u përplas dhe u mbyt.

Edhe luftanija e madhe e flotës së Shteteve Aleate, e quajtur "Goliat", emër i frymëzuar nga Xhaluti, i cili u vra nga profeti Daud , u fundos në ujërat e Ngushticës së Dardaneleve, më 13 Maj të 1915 nga fregata Muavenet-i Millije, e cila dukej shumë më e vogël dhe më e pafuqishme në krahasim me të.

Historia dëshmon se shembuj të tillë janë të panumërt. Ata që guxuan të sfidojnë Allahun Teala në cilësinë e Madhështisë, zullumqarët që thanë "unë" përpara Hakut, popujt e fuqishëm si Adi dhe Themudi, të cilët u mburrën duke thënë: "Kush



është më i fuqishëm se ne?” dhe ata që me mburrje e mendjemadhësi u mbështetën në mjetet të cilat i ndërtuan me aftësitë mendore që u kishte falur Allahu, gjithmonë u bënë shembujt më të këqinj të hakmarrjes hyjnore, duke u shkatërruar nën kamxhikët e dënimit.

Si përfundim, kur besimtari arrin një mirësi, gjithmonë duhet të thotë: “Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim” dhe duke ia atribuar atë mirësi pronarit të vërtetë, duhet të falënderojë i përlur. Në vend që të biem pre e nefsit tonë duke thënë: “E fitova me forcat e mia, apo e arrita me dijet dhe aftësitë e mia”, duhet synuar arritja e majës të ndjenjës së “hiç”it, duke thënë: “Të gjitha mirësitë janë prej Teje, o Zot!”.

Por, në të kundërtën, kur përballemi me ndonjë vështirësi, në vend që të ankohemi dhe të bëhemi kryeneçë, duhet të përpiqemi të kontrollojmë gjendjen tonë shpirtërore dhe të kompensojmë të metat tona, duke menduar se: “Unë jam fajtor për të gjitha! Ose, vallë cili prej gabimeve të mia u bë shkak i kësaj vështirësie që po kaloj?”.

Allahu Teala i bëftë këto ndjenja ushqimin shpirtëror të zemrës sonë. Na bëftë të gjithëve prej robërve të përsosur që kanë arritur të vërtetën e “hiç”it. Na e bëftë të mundur të jetojmë një jetë me devotshmërinë me të cilën është i kënaqur dhe na pranoftë në grupin e të urtëve, të singertëve dhe besnikëve, të cilët merituan mëshirën dhe faljen e Tij!..

Amin!..





"...Mos u dëshpëro, se në të vërtetë Allahu është me ne!..." (Teube, 40)

Të genit bashkë me Allahun

Besimtari, shpirti i të cilit në këtë botë është i lidhur me Allahun, nuk e shkon jetën kot në vrazhdësinë e egos, nuk prishet në amoralitet dhe poshtërsi, nuk vrapon pas aventurave të panevojshme, nuk zhytet në besëtytni e gjëra të kota dhe nuk i kalon kufijtë, nuk mashtrohet nga dashuri të kota dhe nuk e njollos kalendarin jetës së tij me thashetheme, por jeton duke u përpjekur të bëhet mik i Allahut të Madhëruar.

I nderuari Melvana, thotë:

"Kur je me Allahun, edhe jeta edhe vdekja është e bukur. Por kush është pa Zot dhe kush nuk e gjen Allahun, edhe uji i bëhet zjarr."

Për ata që janë pavetëdijsëm ndaj Allahut dhe përplasen nga erërat e fatit në shirësen e jetës, nuk qan as bota që lënë pas, nuk qesh as bota tjetër që i pret dhe u del përballë...

TË QENIT BASHKË ME ALLAHUN

Të jesh me Allahun, do të thotë të jetosh duke e ndjerë Atë në zemër dhe me vetëdije të lartë. Pra, të veprojmë duke e ditur, menduar dhe ndjerë se Allahu i Madhëruar është gjithmonë me ne.

Kjo vetëdije dhe ky botëkuptim, është mirësia më e madhe e Allahut ndaj robit të Tij, sepse kjo, tregon se robi është mik i Zotit të tij. Miqësia, buron prej faktit se i dashuruari sheh veçoritë e veta tek njeriu që dashuron. Pra, për të arritur miqësinë me Allahun e Madhëruar, duhet të kesh një zemër të pastër prej çdo gjëje që të largon nga Ai dhe që zotëron cilësi të bukura si mëshira dhe falja.

Qenia e zemrës bashkë me Allahun, është tregues i suksesit në sprovën e kësaj bote. Në të kundërtën, rezultati i një jete të shkujdesur ndaj Allahut, do të jetë vetëm një humbje dhe pendesë e madhe.

Sa bukur e shpreh kjo ndodhi të vërtetën e të qenit bashkë me Allahun:



PO TI ME KË ISHE?

Një vaiz¹⁴, ishte duke treguar çështjet e botës tjetër, ndërkohë që midis xhematit ndodhej edhe Shejh Shibli.

Vaizi, duke folur për pyetjet që do të bëjë Allahu i Madhëruar në ditën e gjykimit, shprehet:

“Do të pyetet, se ku e ke përdorur diturinë! Do të pyetet, se ku e fituar dhe ku e shpenzuar pasurinë! Do të pyetet, se si e ke kaluar jetën! Adhurimet si i ke pasur? A ke bërë kujdes ndaj haramit dhe hallallit?.. Pas këtyre, do të pyeten këto e ato!..”, duke numëruar edhe disa gjëra të tjera.

Shejh Shibli, i cili po dëgjonte me vëmendje, me një zë të butë, tha:

“O vaiz efendi! Harrove një nga pyetjet më të rëndësishme! Allahu i Madhëruar, shkurt do të pyesë:

«O robi Im! Unë isha me ty, më afër se damari i qafës tënde; po ti me kë ishe?!»”

Ja pra, e gjithë çështja në devotshmërinë ndaj Allahut, është të zotërosh këtë vetëdije, botëkuptim, urtësi dhe pjekuri shpirtërore!..

Me të vërtetë që, njeriu është në rrugë të drejtë për aq sa është bashkë me Zotin e tij. Dhe po aq sa qëndron indiferent dhe e harron Zotin e tij, po aq zhytet edhe në vrazhdësinë e egos dhe devijimin e shejtanit. Për të na paralajmëruar në lidhje me këtë çështje, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (Hashr, 19)

14. Predikues



Shpirti i njeriut, i cili në këtë botë gjendet për t'u sprovuar, është si një zog i mjerë, i burgosur në kafazin e trupit. Bota e tij e brendshme vuan për shkak të ndarjes së tij prej mëmë-dheut. Dhe ajo që do t'ia shuajë këtë vuajtje e do ta gëzojë, është bashkimi i tij me Allahun. Për këtë arsye, pamja e frikshme e vdekjes, zhduket në sytë e të dashuruarve me Allahun dhe, tashmë ajo konceptohet thjesht si një udhëtim i takimit me Allahun. Sahabët fisnikë, i shihnin me zili të sëmurët që gjendeshin në shtratin e vdekjes, sepse atyre u ishte afruar takimi me Allahun dhe Resulullahun ﷺ. Megjithatë, me anë të tyre, ata i dërgonin selame Profetit ﷺ.

Se si do të shkojë udhëtimi i vdekjes, pra, a do të përfundojë me shpëtimin në xhenet apo me dënimin në xhehenem, varet nga fakti se sa i lidhur ka qenë shpirti me Zotin e tij në këtë botë. Për këtë arsye, në këtë botë, njeriu duhet të jetë bashkë me Zotin e tij, me qëllim që të arrijë mirësitë që Allahu ka përgatitur për miqtë e Tij dhe për më tepër, të ketë nderin të shohë bukurinë e Tij.

Besimtari, shpirti i të cilit në këtë botë është i lidhur me Allahun, nuk e shkon jetën kot në vrazhdësinë e egos, nuk prishet në amoralitet dhe poshtërsi, nuk vrapon pas aventurave të panevojshme, nuk zhytet në besëtytni e gjëra të kota dhe nuk i kalon kufijtë dhe nuk mashtrohet nga dashuri të kota; nuk diskuton me injorantët kur ata e ngacmojnë dhe nuk e njollos kalendarin jetës së tij me thashetheme, por jeton duke u përpjekur të bëhet mik i Allahut të Madhëruar.

Po ashtu, besimtari e zbukuron jetën e tij me mirësi dhe bamirësi, e merr Kuranin dhe Sunetin si udhëzues, merret me punë që përputhen me kënaqësinë e Allahut dhe duke e njohur

pronarin e vërtetë të mirësive, di edhe si ta përdorë pasurinë dhe jetën e tij. Ai e ruan shpirtin nga gjërat dhe vendet që do të hidhnin hije mbi vlerën e fesë dhe moralit të tij. Gjithashtu, i shton adhurimet, bamirësitë dhe pjesëmarrjen në bisedat fetare. Dhe si përfundim, ai lë pas kujtime të mbushura me virtyte si një dëshmitar i Zotit mbi tokë.

ME KË KUJTOJE SE ISHA?

Sulltani Javuz Selim, ishte një sundimtar që pothuajse të gjithë kohën e sundimit të tij e kaloi nëpër beteja dhe, asnjë prej njëmijenjë vuajtjeve që kishte kaluar, nuk e kishte mërzhitur apo lodhur. Shoku i tij i afërt **Hasan Xhan**, i tregon kështu momentet e fundit të jetës së tij:

“Në shpinën e Javuzit kishte dalë një çiban që ndryshe quhet edhe lungë. Çibani u zmadhua në një kohë shumë të shkurtër dhe u shndërrua në një vrimë. Plaga u hap aq shumë, saqë prej saj mund të shiheshin mushkëritë e Javuzit. Ai vuante shumë. Ishte si një luan i plagosur. Mirëpo, kurrsesi nuk e pranonte dobësinë dhe vazhdonte t’u jepte taktika dhe direktiva ushtarëve të tij trima. Iu afrova dhe duke më folur për veten tha:

«Hasan Xhan, ç’është kjo punë?»

Ndërsa unë, për shkak se e ndjeja se ai gjendej në fund të jetës së përkohshme dhe në fillim të jetës së përhjetshme, i hidhëruar thashë:

«Padishahu im! Mesa duket ka ardhur koha të jeni bashkë me Allahun!»

Sulltani u kthye, më pa i habitur dhe tha:

«Hasan, Hasan! Më kë kujton ti se kam qenë deri tani?! A mos ke parë ndonjë të metë në lidhjen time me Allahun e Madhëruar?»...

Tashmë, i dalldisur në një botë tjetër, Sulltani më urdhëroi të këndoja suren Ja-Sin. Kur mbërrita në ajetin e “selamit”, ai ia dorëzoi shpirtin Zotit të tij.”

Ata që janë bashkë me Allahun gjatë jetës së tyre, e kanë këtë mirësi edhe në frymën e tyre të fundit. Ja pra, **të jesh bashkë me Allahun**, do të thotë të jetosh në horizontin e këtij botëkuptimi. Do të thotë, t’ia kushtosh zemrën Atij që e meriton më shumë, Krijuesit të Madhërishëm, duke eliminuar të gjitha dashuritë kalimtare dhe tundimet e egos. Kjo, sepse në zemrën e cila nuk merret me Allahun, zë vend e kota.

Një shembull tjetër:

Askush nuk e ka arritur sundimin që ka arritur profeti **Sulejman** ﷺ, në këtë botë. Mirëpo, kjo botë nuk ka mundur të zërë vend në zemrën e Sulejmanit ﷺ dhe nuk e ka penguar atë nga të qenit gjithmonë bashkë me Allahun.

Siç tregohet, në ditën e kijametit do të sillet një rob i pasur dhe Allahu i Madhëruar do ta pyesë:

“Çfarë të pengoi ty nga adhurimi ndaj Meje?” Njeriu i pasur thotë:

“O Zot! Më pengoi pasuria ime e shumtë.” Ndërsa Allahu, duke dhënë si shembull Sulejmanin ﷺ, urdhëron e thotë:

“A mos ishe më i pasur se robi im Sulejman? Po atë përse nuk e pengoi gjithë ajo pasuri?”¹⁵

15. shih. Bursevi, Ruhul-Bejan, IV, 258; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, V, 202-203.



Po ashtu, edhe jeta e profetit **Ejub** ﷺ, i cili u sprovua me gjërat më të shtrenjta të njeriut, si pasuria, jeta dhe fëmijët, është një shembull i veçantë i durimit dhe falënderimit si rezultat i vetëdijes së të qenit në çdo situatë bashkë me Allahun:

Allahu i Madhëruar, e ka sprovuar Ejubin ﷺ, me sprovat shumë të vështira. Si fillim, i mori pasurinë. Më pas, me anë të një tërmeti të fuqishëm, i mori edhe fëmijët. Më vonë i dha një sëmundje të rëndët trupit të tij. Mirëpo, Ejubi ﷺ, nuk u ankua dhe nuk u qa aspak për sëmundjen e tij, e cila zgjati me vite.

Njëherë, bashkëshortja e tij, zonja Rahime, i thotë:

“Ti je profet; dua jote pranohet. Bëj dua që të shëro-hesh!”

Ndërsa Ejubi ﷺ, tha:

“Allahu më dha tetëdhjetë vjet shëndet të mirë. Ndërsa sëmundja ime nuk i ka mbushur ende tetëdhjetë vjet. Unë po vuaj veç prej disa vitesh. Më vjen turp të kërkoj shëndet prej Allahut të Madhëruar!”

Mirëpo, kur sëmundja e tij filloi ta pengonte nga kryerja e adhurimeve me shpirt të qetë, atëherë iu lut Allahut. Sipas një transmetimi, Profeti ynë ﷺ, në lidhje me këtë fakt shprehet:

“Betohem në Allahun e Madhëruar, se Ejubi, nuk rën-koi dhe nuk u qa nga belaja. Mirëpo, sëmundja qëndroi në trupin e tij shtatë vite, shtatë muaj, shtatë ditë e shtatë net. Ai dëshiroi të falë namaz në këmbë, por nuk mundi të qëndrojë dhe u rrëzua. Kur vuri re mangësi në shërbimin e

tij në rrugë të Allahut, tha (duke iu përgjyruar Zotit): «Me të vërtetë që qenkam sëmure»”¹⁶

Si rezultat i durimit dhe dorëzimit të tij legjendar, Allahu i Madhëruar ia hoqi të gjitha hallet dhe vështirësitë që kishte dhe ia ktheu përsëri jetën e tij të mëparshme.

Në mëngjesin e natës së parë që kaloi pas shërimit të sëmundjes, Ejubi , nxori një “ah!” nga thellësia e shpirtit. Kur u pyet për shkakun e kësaj, tha:

“Çdo natë para agimit, dëgjoja një zë që thoshte: «Si je o i sëmuri ynë?». Tani erdhi përsëri kjo kohë, por nuk dëgjova të thuhej: «Si je o robi ynë i shëndetshëm?». Për këtë arsye u hidhërova.”

SËMUNDJA MË E KEQE

Siç tregohet, profeti Isa , rastisi një njeri të sëmure me njolla në lëkurë dhe tëmtha të bërë gropë nga sëmundja. Njeriu, sikur të mos e ndjente fare sëmundjen që kishte, thoshte me vete:

“O Zot! Falënderimet e pafundme të takojnë Ty, që më ke shpëtuar prej halleve të cilat ua ke dhënë shumë njerëzve të tjerë!..”

Isai , për të kuptuar nivelin e botëkuptimit të këtij njeriu dhe përsosmërinë e tij shpirtërore, i thotë:

“O njeri! Çfarë është ai hall prej të cilit Allahu të ka shpëtuar?!”

16. Shih. Kurtubi, Tefsir, XI, 323, 327.



I sëmuri u përgjigj:

“O i Dërguar i Allahut! Sëmundja dhe belaja më e keqe, është shkujdesja e zemrës ndaj Allahut. Falënderuar qoftë Allahu i Madhëruar, që unë ndjej kënaqësinë dhe frymëzimin shpirtëror të të qenit bashkë me Të. Më duket sikur nuk ndjej asnjë prej sëmundjeve të trupit tim...”

Ja se si na paralajmëron Allahu i Madhëruar nga sëmundja e keqe e shkujdesjes së zemrës ndaj Allahut, duke na kujtuar neve robërve të Tij, se Ai ndodhet çdo çast bashkë me ne:

...وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ...

“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...” (Hadid, 4)

...وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ...

“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”

(Kaf, 16)

...وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَحُولُ بَيْنَ الْمَرْءِ وَقَلْبِهِ...

“...Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij...” (Enfal, 24)

وَلِلَّهِ الْمَشْرِقُ وَالْمَغْرِبُ فَأَيْنَمَا تُولُوا فَثَمَّ وَجْهُ اللَّهِ

“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni aty është edhe Fytyra (ana) e Allahut...”

(Bekare, 115)

Në lidhje me këtë, çështje, në një hadith thuhet:

“Grada më e lartë e besimit, është vetëdija se Allahu është bashkë me ty kudo që të jesh.” (Hejthemi, I, 60)



PËRBALLË MIKUT MADHËSHTOR

Allahu i Madhëruar, është gjithmonë afër nesh, por e rëndësishme është që edhe ne të jemi afër Tij. Ndërkohë që edhe një punë e vogël e bërë me këtë vetëdije, bëhet sa një mal, punët të cilat bëhen në mënyrë të shkujdesur ndaj Allahut, janë të padobishme sado të mëdha qofshin. Namazi që fal një zemër e tillë e shkujdesur, është pajetë, lëmosha që jep s'ka dobi, lutja që bën nuk pranohet dhe pendimi i saj, ka nevojë për pendim.

Sa bukur e shpreh kjo ndodhi, këtë të vërtetë:

Mexhnuni i cili endej nëpër shkretëtirë i dashuruar pas Lejlës, padashur kalon përpara një njeriu që po falte namaz. Kur e përfundoi namazin dhe dha selam, njeriu u ngrit dhe e qorton me ashpërsi:

“A nuk e di ti që nuk kalohet para dikujt që po fal namaz?!”

Ndërsa Mexhnuni ia priti me këto fjalë:

“Unë nuk të pashë fare ty, për shkak të dashurisë ndaj Lejlës! Po ti si më pe mua ndërkohë që ndodheshe në namaz para të dashurit tënd, Allahut?!”

Domethënë, edhe zemra e dashuruar pas një njeriu kaplohet nga ndjenja të forta ndaj atij që dashuron dhe syri i tij nuk sheh kënd tjetër përveç tij. Në mënyrë të njëjtë, edhe adhurimet e të dashuruarve me Allahun, realizohen në një atmosferë të përkryer shpirtërore. Grada e cilësisë së adhurimeve, është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e afërsisë së zemrës me Allahun.

Nëna jonë **Aisheja** , thotë:



“Kur Resulullahu ﷺ, qëndronte në namaz, shpesh herë prej kraharorit të tij dëgjohej një zë sikur ziente ndonjë kazan.” (Ebu Daud, Salat, 157; Nesai, Sehv, 18)

Po ashtu, edhe Aliu ﷺ, në jetën e tij të adhurimit, hynte në një atmosferë të veçantë përqendrimi dhe përkushtimi. Gjatë një beteje, ai ishte goditur me një shigjetë në këmbë. Por për shkak të dhimbjes së madhe, nuk mundën t’ia nxirrnin shigjetën. Për këtë arsye, Aliu ﷺ, tha:

“Unë po qëndroj të fal namazin, ndërsa ju nxirreni!”

U bë ashtu siç tha ai dhe e nxorën shigjetën pa asnjë vështirësi. Aliu ﷺ dha selam dhe pyeti; “Çfarë bëtë?”. Ndërsa të pranishmit i thanë; “E nxorëm!”

Ja pra, përkushtimi dhe kënaqësia shpirtërore e atij që e ka zemrën me Allahun, është krejtësisht diçka e veçantë.

Nga ana tjetër, vetëdija e të qenit bashkë me Allahun, nuk është e veçantë vetëm për momentet e adhurimeve. Ajo, është një pjekuri shpirtërore që i jep formë të gjithë jetës së besimtarit. Ajo, është një ndjenjë shpirtërore e cila aq sa organizon adhurimet, organizon edhe jetën familjare e shoqërore, fitimet dhe shpenzimet. Me një fjalë, çdo veprimtari njerëzor...

DORA NË KËTË BOTË, ZEMRA ME ALLAHUN

Një nga robërit e dashur të Allahut, **Muhamed Parisa**, i cili ishte edukuar nga dora e **Shah Nakshibendit**, rrugës për në haxh, u kthye në qytetin e Bagdadit ku rastisi një argjendar në moshë të re, të cilit i ndriste fytyra. Kur e pa të riun që ishte duke tregtuar vazhdimisht me myshterinjtë e tij, mendoi

se ai po shpenzonte shumë kohë në punët e kësaj bote. Për këtë arsye u mërzit dhe tha me vete:

“Sa keq! Atë e paska kapluar angazhimi me këtë botë, pikërisht në moshën kur mund të kryejë adhurime në mënyrën më të bukur!” Mirëpo, kur e vëzhgoi me vëmendje, vuri re se zemra e të riut që shiste flori, ishte gjithmonë bashkë me Allahun, sepse ai e përkujtonte Atë vazhdimisht. Prandaj, duke e lavdëruar të riun tha:

“MasheAllah! Duart në këtë botë, por zemra me Allahun!..

Kur Muhamed Parisa arriti në Mekë, pa një të moshuar mjekërbardhë, i cili qante me përgjërime i kapur pas mbulesës së Qabes. Në fillim, kur e pa të moshuarin që po i përgjërohej Allahut duke qarë, tha me zili:

“Ah sikur edhe unë të mund t’i përgjërohesha Allahut kështu duke qarë.” Mirëpo, kur i dëgjoi me vëmendje lutjet e të moshuarit, kuptoi se gjitha ato të qara, ishin për realizimin e dëshirave të kësaj bote të përkohshme. Kjo, e mërziti shumë zemrën e tij të butë.

Ja pra, nëse zemra është gjithmonë bashkë me Allahun, angazhimi me punët e kësaj bote nuk të dëmton. Mirëpo, adhurimet që bëhen me një zemër, të cilën problemet e kësaj bote e kanë bërë të shkujdesur ndaj Allahut, kanë shumë probleme!..

Kapitali më i çmuar i njeriut, është koha. Ajo, as nuk mund të blihet, e as nuk mund të jepet dhe të merret borxh. Ndërsa pjesa më e rëndësishme e mirësisë së kohës, është çasti i tanishëm, i cili ndodhet midis të shkuarës dhe të ardhmes.



Kjo, sepse dosjet në lidhje me të shkuarën, janë mbyllur dhe vulosur. Tashmë, në ato dosje nuk mund të bëhet asnjë korrigjim. Ndërsa e ardhmja nuk dihet se me çfarë surprizash është e ngarkuar. Për këtë arsye, kapitalin e tij më të çmuar, besimtari duhet t'ia kushtojë po më të çmuarit, duke e kaluar kohën e tij bashkë me Allahun e Madhëruar.

Ahmed er-Rifai, ka thënë:

“Begatia e kohës së njeriut, është ajo kur ai gjendet më afër Allahut të Madhëruar.”

Ndërsa **Abdullah bin Zejdi** ka shumë këshilla dhe fjalë të mbushura me urtësi. Një ditë, ai tha:

“Lum ai që jeton edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër!”

Kur u pyet; “Si jetohet edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër?”, ai përgjigjet:

“Të mos e nxjerrësh Allahun nga zemra në këtë botë (duke u thelluar në meditimin e shfaqjeve dhe fuqisë hyjnore), të jetosh gjithmonë duke u lutur dhe në sajë të këtyre, të fitosh mëshirën e Tij në botën tjetër.”

Një ditë, një nga të dashurit e Allahut, Ibrahim bin Et'hemi, shkon tek Imam Adhami, Ebu Hanifja (Allahu e Mëshiroftë). Nxënësit përreth Ebu Hanifes, e shikojnë Ibrahim bin Et'hemin me sy përgjues. Ndërsa Ebu Hanifja, i cili e kuptoi këtë gjendje, i drejtohet Ibrahim bin Et'hemit dhe i thotë:

“Urdhëroni zotëria ynë, na nderuat me ardhjen tuaj këtu!”

Mirëpo, Ibrahim bin Et'hemi, paksa i fyer, jep selam dhe largohet prej aty.

Nxënësit, habiten me respektin dhe nderin që tregoi një jurist me famë botërore si Ebu Hanifja, ndaj një dervishi. Prandaj, pasi Ibrahim bin Et'hemi u larguar prej aty, e pyetën Ebu Hanifen:

“Nëse e krahasojmë me ju, çfarë meritash ka ky person për të qenë zotëri apo i madh? Si është e mundur që një personalitet si ju, i thotë atij «zotëria ynë?»”

Ndërsa Ebu Hanifja, u dha këtë përgjigje e cila tregon edhe modestinë e tij të jashtëzakonshme:

“Ai, është i angazhuar vazhdimisht me Allahun, ndërsa ne merremi vetëm me çështjet sipërfaqësore...”

Ndërsa i nderuari **Ebu Bekir Shibli**, kur përkufizon tasavufin, thotë:

“Tasavuf, do të thotë të jesh bashkë me Allahun në të dyja botët dhe të mos shohësh tjetër përveç Tij.”

Ja pra, pjekuria shpirtërore që kërkon të arrijë edukimi i tasavufit, është ky horizont i bashkimit me Allahun.

TRAGJEDIA E SHKUJDESJES NDAJ ALLAHUT

Një zemër e cila nuk tregon durim, falënderim dhe dorëzim ndaj vështirësive të jetës, por bëhet mosmirënjohëse, ankuese, kryeneçe dhe injorante, do të thotë se e ka humbur ndjenjën e të qenit bashkë me Allahun.

Nëse robi është bashkë me Allahun, Ai, me madhështinë dhe bujarinë e Tij, është më afër robit. Kjo, sepse siç thuhet



në një hadith fisnik¹⁷, ku transmetohet një shembull i ofruar për mendjen njerëzor në lidhje me dashurinë e Allahut ndaj robit: “kur një rob i afrohet Zotit të tij një pëllëmbë, Zoti i afrohet një krah; nëse robi shkon drejt Zotit të tij duke ecur, Zoti shkon drejt tij duke vrapuar; Ai gjendet me të (robin) kudo që ai e përmend dhe nuk e kursen mëshirën dhe ndihmën ndaj tij.”

Është fakt, se një zemër e cila nuk e harron Zotin e saj dhe është gjithmonë me Të edhe kur është e qetë materialisht e shpirtërisht, e gjen Zotin pranë edhe nëse përpallet me ndonjë vështirësi. Nëse robi duron dhe kërkon shpërblim për vështirësitë dhe problemet me të cilat sprovohet, Allahu ia lehtëson atij durimin dhe qëndresën. Por nëse dëshiron shpëtim, Allahu i mjafton atij si ndihmës dhe mëshirues.

Allahu i Madhëruar, është i lirë në veprat e Tij. Ai i sprovon robërit e Vet edhe me mirësi edhe me privim nga të mirat. Qenia e robit bashkë me Allahun edhe në sprovat më të vështira, vërteton besnikërinë e besimit të tij. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, sprovat më të mëdha ia ka dhënë robërve që do më shumë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Vërtet mendoni të hyni në Xhenet pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: “Kur do të arrijë ndihma e Allahut?!” Ja, ndihma e Allahut është afër!” (Bekare, 214)

Për këtë arsye, kur një mysliman përballet me vështirësi dhe vuajtje, të mos qahet i pashpresë duke thënë fjalë që mund

ta shpien në mohim, si: “Përse Allahu që unë e adhuroj nuk më ndodhet pranë në këto çaste të vështira?”, sepse ai nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Në këtë botë sprovash, është Allahu që e sprovon robin e Vet, e jo robi Zotin e tij!

Nisur nga kjo, një besimtar i cili përballet me vështirësitë e jetës, duhet të kujtojë fjalën e Allahut në ajetin:

لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا

“...Mos u dëshpëro, se me të vërtetë Allahu është me ne!...” (Teube, 40) dhe të jetojë në paqe shpirtërore miqësi-në dhe afrimin me Allahun e Madhëruar. Edhe profetët dhe robërit e mirë që kanë kaluar nëpër sprovat më të vështira të kësaj bote, kanë përjetuar dhe përhapur gjithmonë këtë qetësi dhe paqe.

Nuk duhet harruar se, për besimtarët e devotshëm, zemra e të cilëve është gjithmonë me Allahun, nuk ka frikë dhe hidhërim as në këtë botë dhe as në botën tjetër. Allahu i Madhëruar, në lidhje me mirësinë dhe përgëzimin e botës tjetër në frymën e tyre të fundit, shprehet:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar!» (Fussilet, 30)

Lum ato zemra që janë gjithmonë të qëndrueshme me Allahun përballë furtunave të jetës dhe të egos, duke e përmbyllur jetën e tyre me arritjen e përgëzimeve hyjnore!

Zoti ynë e bëftë vetëdijen tonë të të qenit bashkë me



Të në çdo kohë dhe vend, thesarin e lumturisë së zemrave tona! Gjithashtu, na bëftë të gjithëve prej robërve të Tij fatlumë, të cilët në këtë botë jetojnë në atmosferën e të qenit bashkë me Të, ndërsa në botën tjetër nderohen me mirësinë e shikimit të bukurisë së Tij madhështore!

Amin!..





Përmendja e Allahut -1

Një njeri që e ka shpirtin të ndjeshëm dhe syrin e zemrës të hapur, është i vetëdijshëm se e gjithë bota përbëhet prej shfaqjeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore. Për rrjedhojë, në çdo gjë ai vëren bukuritë magjepse të artit hyjnor. Çdo grimcë e gjithësisë, i tregon atij bukuritë hyjnore. Madje, shpirtrat e etur për Allahun, edhe poezitë vajtuese që rrjedhin nga zemrat vogla të zogjve, i shohin si përmendje mallëngjyese të Allahut.



Daudi ﷺ, kërkonte strehim tek Allahu, me këto fjalë:

“O Hyj! Mos më ndaj prej vendit ku përmendesh Ti! Por nëse dëshiroj të shkoj në vendin e të shkujdesurve ndaj Teje, m'i thyej këmbët pa arritur ende atje! Nëse Ti vepron kështu, për mua është një mirësi shumë e madhe.”

PËRMENDJA E ALLAHUT - 1

Një nga miqtë e Allahut, i nderuari **Uftade**, kishte dalë së bashku me nxënësit e tij për një bisedë në natyrë. Me porosinë e mësuesit të tyre, nxënësit shëtitën vendet më të bukura të pyllit dhe i sollën mësuesit të tyre nga një buqetë me lule. Mirëpo, në dorën e **Aziz Mahmud Efendiut**, kishte vetëm një lule të vyshkur me bisht të thyer. Pasi të gjithë nxënësit ia dhuruan lulet mësuesit të tyre me gëzim të madh, Aziz Mahmudi i ofroi kokulur këtë lule të vyshkur me bisht të thyer. I nderuari Uftade, mes shikimeve kureshtare të nxënësve të tjerë, pyeti:

“Biri im Mahmud! Të gjithë kanë sjellë lule tufa tufa... po ti, pse ke sjellë një lule të vyshkur me bisht të thyer?..”

Aziz Mahmudi, uli kokën me respekt dhe u përgjigj:

“Zotëri! Çfarëdo që t’ju dhuroj, është pak! Mirëpo, cilësdo lule që i zgjata dorën për ta këputur, e gjeta atë duke përmedur Zotin e saj dhe duke thënë «Allah Allah». Zemra ime nuk mund ta pranonte që të pengoja përmendjen e tyre. Dhe pa rrugëzgjidhje tjetër, unë u detyrova t’ju sillja këtë lule që nuk ka mundur ta vazhdojë më përmendjen e saj!..”



KUR PËRMENDIN MALET DHE GURËT...

Allahu i Madhëruar, ia ka prezantuar Veten e Tij të gjitha krijesave me jetë dhe pajetë, të cilat i ka krijuar dhe i ka ngarkuar ato me detyrën e përmendjes së Tij në mënyrë të pandërprerë. Për rrjedhojë, të gjitha krijesat e përmendin Allahun sipas gjuhëve dhe veçorive të tyre, në mënyrë të natyrshme dhe të vazhdueshme, jashtë dijes sonë. Pra, njohja dhe bindja ndaj Allahut, nuk është e veçantë vetëm për njeriun. Madje, krijesat e tjera, edhe pse jashtë vullnetit të tyre, në këtë çështje janë në një nivel më të lartë se njeriu.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Ne i nënshtroam malet dhe shpendët që, bashkë me Dautin, të thurnin lavde (për Allahun). Ishim Ne që i bënim këto.” (Enbija, 79)

Këto fakte me të cilat na lajmëron Zoti ynë i Madhëruar në lidhje me përmendjen që bëjnë malet dhe zogjtë, janë një paralajmërim i hapur për birin e njeriut, i cili është krijesa më fisnike, me qëllim që në çështjen e përmendjes së Allahut, të mos tregohet më i shkujdesur se krijesat e tjera të pajeta apo kafshët.

Ja edhe një shembull tjetër shumë domethënës në lidhje me këtë çështje:

Kur Profeti ﷺ, po ecte në rrugë, rastis një grup njerëzish, të cilët qëndronin mbi kafshët e tyre dhe bisedonin. Ai u tha atyre:

*“Qëndroni mirë mbi kafshët tuaja dhe mos i lodhni ato. (Kur nuk i përdorni) Lëshojini dhe lërinin të pushojnë. Mos i ktheni ato në podiume të bisedave tuaja nëpër rrugë e sokakë. **Ka shumë kafshë, të cilat janë më të mira se***

ata që u hipin atyre dhe që e përmendin Allahun më tepër se ata.” (Ahmed, III, 439)

Për shkak se besimtarët e urtë e përmendin vazhdimisht Allahun, të gjitha krijesat, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh ata i shohin si vitrina të madhështisë së hyjnore. Edhe biseda e përzemërt e Junus Emresë me lulen e verdhë, të cilës thoshte: “Unë e shoh me madhësi edhe një milingonë...”, është një shprehje e kësaj urtësie të besimtarit.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“A nuk e sheh ti se, në të vërtetë, Allahut i përulen në sexhde ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe kafshët dhe shumë nga njerëzit? Por ka shumë njerëz (mohues), që meritojnë dënimin...” (Haxhaxh, 18)

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ato...” (Isra, 44)

Në gjithësi, vetëm njerëzit dhe xhinët tregohen të shkujdesur ndaj këtij programi të përmendjes hyjnore. Kjo, sepse xhinët dhe njerëzit, për shkak se i nënshtrohen sprovave dhe zotërojnë vullnet të lirë, janë të aftë të bëjnë edhe mirë, edhe keq. Për këtë arsye, fatkeqësia e largimit nga adhurimi i Allahut dhe mosbindja ndaj Tij, përfshin vetëm këto dy grupe midis të gjitha krijesave.

Deklarimi i Allahut të Madhëruar, se të gjitha krijesat e përmendin Atë vazhdimisht, është një mesazh i qartë për të gjithë ata që e harrojnë Allahun dhe zhyten në dëshirat e kësaj bote. Ai sikur dëshiron të thotë: **“A nuk e shihni!?”**



Edhe kjo botë për hir të së cilës më harruat, në fakt më përmend Mua dhe i përulet sundimit Tim hyjnor me një dorëzim të plotë”.

Për rrjedhojë, për njeriun, i cili është krijesa më fisnike e Allahut, është një mashtrim shumë i hidhur të mos marrë pjesë në përmendjen dhe adhurimet madhështore të krijesave që mbushin gjithësinë, duke qëndruar larg kësaj përmendjeje i tromaksur e vrenjtur!..

Mirëpo, ashtu siç urdhërohet edhe në ajetin fisnik, perceptimit njerëzor -si pjesë e sprovës hyjnore- i është vendosur një perde ndaj faktit se krijesat e tjera përdorin një gjuhë të veçantë vetëm për ato në përmendjen e Allahut. Perceptimi i përmendjes/dhikrit që bëjnë krijesat e tjera; është i mundur vetëm në sajë të një jete të devotshme të mbushur me sinqeritet dhe frikë ndaj Allahut, brenda atmosferës shpirtërore të përmendjes dhe me zotërimin e një zemre të pastër e të rafinuar, të cilës Allahu i Madhëruar i ka dhënë mirësinë dhe mundësinë të shohë botën e vërtetë. Njësoj si në shembullin e të nderuarit Aziz Mahmudut, edhe disa të dashur të Allahut, të cilët kanë arritur të vërtetën dhe devotshmërinë e duhur ndaj Allahut -nëse dëshiron Allahu-, mund të arrijnë ta ngrenë disi këtë perde të shkujdesjes së përgjithshme.

Po ashtu, edhe thënia e njërit prej sahabëve më të zgjedhur, **Abdullah ibn-i Mes’udit** رضي الله عنه, i cili ishte edukuar nga vetë Profeti ﷺ, se; “*Ne arritëm deri aty sa që dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave të bukës që kalonin në fytyrën tonë!*”, është një shembull i bukur i kësaj të vërtete.¹⁸

Siç njoftohemi edhe në veprën “*Hiljetu’l-Evlja*”, në kohën kur të gjithë mbyllnin sytë dhe flinin, **Mugire bin Hakim**

18. shih. Buhari, Menakib, 25.

es-San'ani zbriste në det dhe fillonte të përmendte Allahun së bashku me peshqit. (Ebu Nuajm, Hilje, 10/141)

Po ashtu, edhe një nga të dashurit e Allahut, Shah Nakshibendi, i kishte shërbyer të sëmurëve, të vetmuarve, madje edhe kafshëve dhe shpirti i tij ishte zbutur aq shumë nga përmendja e Allahut, saqë kishte filluar të dëgjonte edhe zërat vajtues të kafshëve që rënkonin dhe kërkonin strehim tek Allahu.

Shkurtimisht, një njeri që e ka syrin e zemrës të hapur, është i vetëdijshëm se e gjithë bota përbëhet prej shfaqjeve të fuqisë dhe madhësisë hyjnore. Për rrjedhojë, në çdo gjë, ai vëren bukuritë magjepsë të artit hyjnor. Çdo grimcë e gjithësisë, i tregon atij bukuritë hyjnore. Madje, shpirtrat e etur për Allahun, edhe poezitë vajtuese që rrjedhin nga zemrat vogla të zogjve, i shohin si përmendje mallëngjyese të Allahut...

ÇELËSAT E PËRMENDJES SË ALLAHUT

Për shkak se të dashurit e Allahut merren vazhdimisht me përmendjen e Tij dhe e kanë kuptuar të vërtetën e përmendjes së Tij, e kujtojnë Allahun me çdo vepër apo fjalë të tyre. Në hadithet fisnike, thuhet:

“Ndër njerëz, ka çelësa të përmendjes së Allahut. Kur njerëzit i shohin ata, menjëherë u kujtohet Allahu.” (Hejthem, X, 78)

“Ata janë njerëz, që kur i sheh fytyrat e tyre, të kujtojnë Allahun e Madhëruar.” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 4)

Njerëz të tillë, duhen konsideruar si mirësi të Allahut dhe duhet përfituar shpirtërisht prej tyre, sepse ata janë mëshirë hyjnore për vendet ku ndodhen.

Ajo që i ka bërë të dashurit e Allahu të arrijnë një gradë të tillë, është përjetimi i përmendjes së Allahut me një gjendje të lartë shpirtërore. I nderuari Eshrefoglu Rumi, e ka ndarë përmendjen/dhikrin në tre nivele:

“E para; kur zemra është e shkujdesur ndërkohë që gjuha përmend Allahun. Kjo është përmendja që bëjnë besimtarët e thjeshtë.

-E dyta; kur përmendja bëhet edhe me gjuhë edhe me zemër. Kjo është përmendja që bëjnë besimtarët e ditur dhe të devotshëm.

-E treta; kur përmendja bëhet edhe me gjuhë, edhe me zemër edhe me të gjitha organet e trupit. Kjo, është përmendja që bëjnë besimtarët e përsosur...

Dikush që ndodhet në mes të shkretëtirës dhe i ka ikur truri nga etja, nuk mund të shpëtojë prej etjes pa e gjetur dhe pa e pirë ujin. Vetëm rënkimi i tij, duke thënë “ujë, ujë!”, nuk mund ta heqë etjen e tij... Prandaj edhe zemra e nevojtarit, në fillim duhet të digjet me dashurinë ndaj Allahut. Më pas, etja për takimin me Allahun mbizotëron mbi të dhe ai entuziazmohet. Dhe, pa arritur takimin me Allahun, zemra e tij nuk gjen paqe...”¹⁹

Nga kjo, kuptojmë se dhikri i gjuhës duhet të jetë në harmoni me dhikrin e zemrës. Përndryshe, nëse zemra bredh diku tjetër ndërkohë që gjuha përmend Allahun; nëse zemra nuk është me Allahun, por me diçka tjetër të kësaj bote, është e kotë të shpresosh ndonjë dobi prej kësaj përmendjeje.

I nderuari Mevlana thotë:

“Dhikri që bëhet veç me gojë e me gjuhë, pa e ndjerë dhe

pa u menduar (si papagall), është një iluzion pa vlerë. Ndërsa dhikri që bëhet me gjithë zemër, duke e ndjerë në shpirt, është i pavarur edhe nga shqiptimi, edhe nga fjalët... O ti që mjaftohesh me emrin e Tij, pa e gjetur Atë! Si mund të shpëtosh prej dëshirave të egos pa pirë prej kupës “Hu”²⁰?

Pra, përmendja e Allahut, nuk përbëhet vetëm nga shqiptimi i fjalës “Allah”. Dhikri, bëhet shkak i përmirësimit të qëllimeve e veprave dhe i ngritjes së nivelit shpirtëror, vetëm atëherë kur gjendet në qendrën e aftësisë së ndjenjave, që është zemra. Për këtë arsye, është thënë:

“Kreu i dhikrit, është **Teuhidi** (njëshmëria e Allahut); Mesi i tij, është **Texhridi** (pastrimi i zemrës nga qeniet e tjera përveç Allahut); Ndërsa fundi i tij, është **Tefridi** (qëndrimi vetëm për vetëm me Allahun dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij)”.

Profeti ﷺ, në lidhje me njerëzit e tefridit, ka thënë:

“Muferridët e fituan garën.” Sahabët pyetën:

“Kush janë muferridët, o Resulullah?”

“Burrat dhe gratë që e përmendin shumë Allahun!”, u përgjigj Ai. (Muslim, Dhikir, 4.)

Ndërsa Aliu ؑ, e ka cilësuar kështu gjendjen e sahabëve gjatë dhikrit:

“Kur përmendej emri i Allahut, ata lëkundeshin si pemët nga era në një ditë me furtunë. Ndërsa lotët u rridhnin mbi rrobat e tyre.” (Ebu Nuajm, Hilje, 1/76.)

Kjo, do të thotë se dhikri, nuk është çështje e një përmendjeje të thatë. Përkundrazi, një dhikir i vërtetë, është të meditosh mbi madhësitinë e Allahut, të thellosh ndjenjat

20. Hu: Përemër vector i vetës së tretë në gjuhën arabe. Në literaturën mistike, “Hu” përdoret për Allahun.

përballë shfaqjeve të fuqisë hyjnore dhe të pastrosch zemrën nga ndikimi i kësaj bote, duke qenë gjithmonë së bashku me Allahun. Vetëm një dhikër i tillë mund të bëhet mburojë kundër fatkeqësive materiale e shpirtërore. Për këtë arsye, thënia profetike: *“nuk do të bëhet kijameti derisa në tokë të thuhet ende «Allah, Allah»”*²¹, mbase duhet kuptuar se përderisa të ketë njerëz që e përmendin Allahun me gjithë shpirt, nuk do të ndodhë kijameti.

Zoti ynë, na mëson se si duhet ta përmendim Atë, duke urdhëruar:

“Përmende Zotin tënd me vete, i përulur dhe me frikë -jo me zë të lartë-, në mëngjes e mbrëmje dhe mos u bëj nga ata që janë të shkujdesur!” (A'raf, 205)

“Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkush-toju krejtësisht Atij!” (Muzzemmil, 8)

Nga kjo, kuptojmë se gjatë përmendjes së Allahut, duhet të drejtohem nga Ai me gjithë qenien tonë. Ajo që në të vërtetë kërkohet prej dhikrit, më tepër është dhikri i zemrës. Që zemra të zgjohet, të shkundet nga pluhurat e shkujdesjes, të dridhet e të drithërohet nga frika dhe të ndriçohet me dritën e Allahut, është i nevojshëm një dhikër i përsosur i cili bëhet me frymëzim të lartë shpirtëror.

Një nga të dashurit e Allahut, **Abdullah bin Hubejk**, është pyetur:

“Si i dalloni njerëzit e devotshëm?” Ndërsa ai është përgjigjur:

“Një nga zakonet e bukura të njerëzve të devotshëm, është se ata e përmendin Allahun ditë e natë. Përmendja e

Tij, bëhet me zemër dhe me gjuhë. Por përmendja që bëhet me zemër, është më e lartë...

Jepuni jetë zemrave tuaja me përmendjen e Allahut. Mbushini ato me frikën ndaj Tij. Ndriçojini ato me dashurinë ndaj Tij. Gëzohuni me dëshirën për t'u takuar me Të dhe dijeni se: Ju mund të ngriheni aq sa e dashuroni Atë. Në sajë të drejtësisë së qëllimeve, mund të nënshtroni egon tuaj. Ndërsa duke mposhtur epshin, mund të pastroni veprat tuaja..."

Nga ana tjetër, për shkak se zemrat e të dashurve të Allahut, që janë edhe çelësat e dhikrit, marrin jetë në sajë të dhikrit dhe kanë arritur dritën me të cilën mund të ndajnë të vërtetën nga e kota dhe të drejtën nga e shtrembëta, konsiderohen si një busull e saktë e të drejtës dhe të mirës. Prandaj, është e këshillueshme që t'i kërkojmë këta njerëz dhe të marrim mendimin e tyre në çështjet rreth të cilave ka kundërshti.

TUBIMET E DHIKRIT

Tubimet ku përmendet Allahu, duhen konsideruar si mirësi. Prandaj, familjarizimi me to, vazhdimi dhe pjesëmarrja në tubimet e dhikrit, do të ishte lumturi e vërtetë. Ndërsa e kundërta e kësaj, pra të marrësh pjesë në tubimet që janë larg përmendjes së Allahut, do të ishte një fatkeqësi e vërtetë. Allahu i Madhëruar, na urdhëron të qëndrojmë bashkë me besimtarët e devotshëm që e përmendin shumë Atë dhe të largohemi prej atyre që janë të shkujdesur ndaj përmendjes së Tij:

“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar



stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë, e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.” (Kehf, 28)

Po ashtu, edhe kjo lutje e Daudit ﷺ, në lidhje me këtë çështje, është shumë domethënëse:

“O Zot! Mos më ndaj prej shoqërisë së atyre të cilët të kujtojnë e të përmendin Ty! Nëse dëshiroj të shkoj në vendin e të shkujdesurve ndaj Teje, m’i thyej këmbët pa arritur ende atje! Nëse Ti vepron kështu, për mua është një mirësi shumë e madhe.” (Ihja, I, 852.)

Gjithashtu, tubimet e dhikrit ku përkujtohet Allahu, kanë një vlerë të veçantë tek Ai. Profeti ﷺ, këtë të vërtetë, e shpreh me këto fjalë:

“Kur një grup njerëzish mblidhen për ta përmendur Allahun, ata rrethohen nga engjëjt, i mbulon mëshira e Allahut, mbi ta zbret qetësia e prehja dhe Allahu i përmend ata duke i laudëruar midis atyre që ka pranë!” (Muslim, Dhikr, 38-39)

Një ditë, Resulullahu ﷺ, tha:

“Në ditën e kijametit, Allahu i Madhëruar do të ringjallë një grup njerëzisht, fytyrat e të cilëve shndrisin si dritë. Ata ulen në kolltukë të bërë prej perlave dhe të gjithë njerëzit e tjerë i shohin me zili. Këta, nuk janë as profetë e as dëshmorë.”

Një beduin ra menjëherë në gjunjë dhe tha:

“O Resulullah! Na trego kush janë ata që ta dimë!”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ata janë njerëz nga fise dhe qytete të ndryshme, që

e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe tubohen për ta përmendur Atë.” (Hejthemi, X, 77)

Përsëri një ditë tjetër, Resulullah ﷺ, për t’u treguar sahabëve vlerën e tubimeve të dhikrit, thotë:

“Kur të kaloni nga kopshtet e xhenetit, përfitoni sa më shumë prej tyre.”

“Çfarë doni të thoni me, kopshtet e xhenetit, o Resulullah?”, pyetën sahabët.

Resulullah ﷺ, u përgjigj:

“Tubimet e dhikrit.” (Tirmidhi, Deauat, 82/3510)

Një nga sahabët e nderuar, Ebu Hurejre ؓ, thotë:

“Siç i shohin banorët e tokës yjet që ndriçojnë në qiell, ashtu i shohin edhe banorët e qiellit shtëpitë ku përmendet Allahut.” (Ihja, I, 852)

PËRMENDJA E ALLAHUT; ADHURIMI MË I MADH

Të parët tanë kanë thënë; *“Memoria e njeriut, është e sëmurë me harresën!”*. Kundër sëmundjes së harresës dhe indiferencës së njeriut, pra kundër dobësisë së harresës dhe ngurtësismit të zemrës, duhet ripërtërirë vazhdimisht ekzistenca shpirtërore e Allahut dhe pozita e Tij e lartë në zemra. Po ashtu, duhet që Ai të mbahet gjithmonë në kujtesë dhe që zemra të mbahet gjithmonë e gjallë me kujtimin e Tij. Dhikri, që është edhe lidhja më e fortë që e afron robin tek Zoti i tij, në të njëjtën kohë është edhe një përforsim shpirtëror dhe shkak frymëzimi, që e eliminon turbullimin e meditimit dhe mpirjen e mendjes.

Nisur nga kjo, adhurimet që bëhen shkak i përmendjes së Allahut, si këndimi i Kuranit, namazi, agjërimi, haxhi, tesbihi²², tahmidi²³, tehlili²⁴, tekbiri²⁵ dhe istigfari²⁶, konsiderohen të gjitha dhikrit. Për rrjedhojë, komentuesi i Kuranit, **Burseviu**, shprehet:

“Në ajetin; “**...Nxitoni për ta përmendur Allahun!..**”²⁷, Allahu i Madhëruar, “namazin”, e ka përdorur në kuptimin e “dhikrit” dhe, urdhri “**Më përmendni Mua!**”, përfshin të gjitha adhurimet dhe veprat që bëhen për Allahun.” (shih. Ruhu'l-Bejan, II, 95-96)

Ndërsa i nderuari **Abdulvehhab Mutteki**, është pyetur:

“Thonë se besimtari duhet të merret gjithmonë me dhikër. Si arrihet kjo?” Ai përgjigjet:

“Kush merret me punët të mira, është gjithmonë në dhikër. Falja e namazit është dhikër, këndimi i Kuranit është dhikër, mësimi i dijeve fetare është dhikër. Pra, çdo punë e mirë, është dhikër.”

Nga ana tjetër, të gjitha adhurimet marrin vlerë, nëse Allahu përmendet me një zemër vigjilente dhe të vetëdijshme. Ndërsa adhurimet e bëra me një zemër indiferente e të pavetëdijshme, janë të privuara nga frymëzimi i dhikrit dhe do të thotë se nuk e kanë plotësuar kushtin e përkushtimit.

Pra, dhikri, është një nga kushtet e domosdoshme që

22. Tesbih: Të thuash “Subhanallah” (I madhëruar dhe larg të metave është Allahu)

23. Tahmid: “Elhamdulilah” (Falënderimi i takon Allahut)

24. Tehlil: “La ilahe il-lallah” (Përveç Allahut s’ka Zot tjetër)

25. Tekbir: “Allahu Ekber” (Allahu është më i Madhi)

26. Istigfar: “Estagfirullah” (Kërkoj falje prej Allahut)

27. Xhumu’a, 9.

duhet të gjendet brenda një adhurimi. Lidhur me këtë, Profeti ﷺ, është shprehur kështu në hadithet e tij:

“Tavafi i Bejtullahut²⁸, Sa’ji²⁹ mes Safas dhe Merves dhe gurëzimi i shejtanit, është urdhëruar për të mbajtur në këmbë dhikrin e Allahut.” (Ebu Daud, Menasik, 50/1888)

“Kush i bindet Allahut dhe i respekton siç duhet urdhrat dhe ndalesat e Tij, (konsiderohet se) e ka përmendur Atë; edhe nëse namazet (vullnetare), agjërimet dhe këndimin e Kuranit, i ka të pakta!

Por kush e kundërshton Allahun (nuk i braktis gjynahet), ai nuk e ka përmendur Atë; edhe nëse namazet (vullnetare), agjërimet dhe këndimin e Kuranit, i ka të shumta!” (Hejthemi, II, 258.)

Një sahab, shkoi tek Resulullahu ﷺ dhe e pyeti:

“Cili xhihad, e ka shpërblimin më të madh?” I Dërguari i Allahut ﷺ, përgjigjet:

“Xhihadi i atij që e përmende më së shumti Allahun!” Sahabi, pyeti përsëri:

“Cili agjërim e ka shpërblimin më të madh?” Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Agjërimi i atij që e përmend më së shumti Allahun!”

Pas kësaj, sahabi bëri të njëjtën pyetje edhe për ata që falin namaz, që japin zekat, që shkojnë në haxh dhe që japin sadaka. Ndërsa Profeti ﷺ, të gjithave iu përgjigj:

“E atij që e përmend më së shumti Allahun!”

Nisur nga kjo, Ebu Bekri رضي الله عنه, i thotë Omerit رضي الله عنه:

28. Qabja

29. Vajtje-ardhja 7 herë midis dy kodrave, Safa dhe Merve.

“O Omer! Ata që e përmendin Allahun i morën të gjitha mirësitë!” Sapo e dëgjoi këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, u drejtua nga ata dhe tha:

“Po, ashtu është!” (Ahmed, III, 438; Hejthem, X, 74.)

Njëherë tjetër, pasi Profeti ﷺ, foli për dobinë dhe shpërbli-min e dhikrit pas namazit dhe dhikrit kur bie për të fjetur, tha:

“Kur dikush prej jush ndodhet në namaz, shejtani i vjen dhe i thotë: «Kujto këtë, kujto atë!». Ai e vazhdon këtë derisa ai të mbarojë namazin dhe të largohet. Si përfundim, njeriu e braktis këtë dhikër (pas namazit). Kur njeriu hyn në shtrat, shejtani i vjen dhe përpiqet ta vërë në gjumë dhe, e vë në gjumë (pa e bërë dhikrin para gjumit).” (Tirmidhi, Deauat, 25/3410; Ebu Daud, Edeb, 99-100/5065)

Domethënë se, përkujtimi i Allahut, përmendja e Tij duke e lidhur mendje dhe zemrën pas Tij, është një nga kushtet e pranimit të adhurimit. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar. Dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjith-çka që ju bëni.” (Ankebut, 45)

Ja pra, përmendja si “dhikër” e adhurimit të namazit, që është edhe shtylla e fesë, e përforcon faktin se dhikri konside-rohet si damari kryesor i adhurimeve. Kështu që, një adhurim pa dhikër, është i mangët dhe me të meta pranë Allahut.

Ibn-i Abbasi ؓ, shprehjen; **“...përmendja e Allahut është më e madhe!..”** që përdoret në ajetin e mësipërm, e komenton në dy mënyra:

1. Përmendja që ju bën juve Allahu, është më e madhe se përmendja që i bëni ju Allahut.

2. Përmendja e Allahut, është më e lartë se çdo adhurim që bëhet pa përmendur Allahun.³⁰

Shkurtimisht, synimi i adhurimit, është të përmendësh Allahun, ta madhërosh Atë dhe ta përkujtosh Atë, duke i shprehur devotshmërinë. Mirëpo, nëse kalohet në ekstrem duke e interpretuar këtë të vërtetë në mënyrë egoiste dhe djallëzore dhe, për rrjedhojë të nënvleftësosh adhurimet, është jashtëzakonisht e rrezikshme.

Ta konsiderosh të mjaftueshme dhikrin që bëhet me përkushtim dhe të mos i japësh rëndësi adhurimeve të tjera, do të thotë largim nga rruga e drejtë dhe devijimi në një rrugë djallëzore, duke mos e kuptuar thelbin e adhurimeve. Në fakt, ashtu si dua/jalutja, edhe dhikri, si një prej veçorive thelbësore të adhurimet, gjendet në të gjitha adhurimet. Është e pamundur ta mendosh atë të ndarë nga adhurimet ose ta kryesh atë në vend të adhurimeve.

Për rrjedhojë, **i Dashuri i Allahut, Profeti ﷺ**, edhe pse ishte në majën e devotshmërisë njerëzore, përveç adhurimeve farz (të detyrueshme), falte namaz nate derisa i ënjteshin këmbët. Atëherë, edhe nëse dikush arrin grada të larta në sajë të dhikrit, ai nuk mund ta shohë kurrë veten larg përgjegjësive të adhurimeve të tjera. Përkundrazi, frymëzimi shpirtëror i dhikrit, e shton edhe më tepër vetëdijen dhe përpjekjen e besimtarit në devotshmëri.

Megjithatë, të mendosh që me kryerjen e adhurimeve, si namazi, agjërimi etj., e ke plotësuar edhe adhurimin e dhikrit,

30. shih. Ihja, I, 847.



duke mos bërë asnjë lloj dhikri përveç atyre adhurimeve, tregon injorancë të madhe. Kjo, sepse Zoti ynë, dëshiron që ne ta përmendim sa më shumë Atë. Dhe kjo, është diçka shumë e rëndësishme, me qëllim që gjendja jonë pas adhurimeve, madje në çdo frymëmarrje tonën, të ndodhemi në brendësi të frymëzimit shpirtëror të dhikrit. Kjo është edhe arsyeja që besimtarët e mirë, përpiqen që gjatë gjithë jetës së tyre t'i binden urdhrit:

“Andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur! Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 98-99)

Zoti ynë qoftë i kënaqur prej të gjitha adhurimeve që kryejmë. Po ashtu, Allahu na e bëftë të mundur ta përmendim Atë në harmonin të plotë midis trupit dhe shpirtit, duke i mbushur zemrat tona me frymëzimin shpirtëror të përmendjes së Tij!

Amin!..





Dërmendja e Allahut -2

Për robërit që arrijnë të vërtetën e dhikrit, duke shijuar ëmbëlsinë e dashurisë hyjnore, të gjitha kënaqësitë e kësaj bote e humbasin vlerën e tyre. Për rrjedhojë, Ibrahim bin Et'hemi, i cili e la mënjanë luksin e kësaj bote dhe u zhyt në detin e dashurisë hyjnore, ka thënë:

“Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë.”

Koha e jetës së kësaj bote, e cila kalohet jashtë dhikrit; pra, frymëmarrjet që konsumohen në harresë të Allahut, janë fletë të shkuara dëm nga kalendari i jetës.

PËRMENDJA E ALLAHUT – 2

Njeriu, lidhet pas asaj qenieje ndaj së cilës ndjen dashuri. Ai e bart atë çdo moment në vendin më të zgjedhur të zemrës. Mendimi, imagjinata, ndjenjat dhe përkujtimi janë gjithmonë me të. Për të nuk do të thotë ndonjë gjë nëse është larg me trup, sepse ai jeton shpirtërisht me të. Lidhur me këtë fakt, të urtët janë shprehur: *“Ai që kam afër, është në Jemen, ai që është në Jemen, është afër meje!..”*

Për shembull, dikush që ndjen dashuri të madhe ndaj fëmijës së tij, flet çdo moment lidhur me të, duke u kënaqur me këtë. Ndërsa dikush që është i pasionuar pas profesionit të vet, ndjen kënaqësi kur flet në lidhje me çështjet e profesionit të vet. Sa herë që i kujtojnë ato që duan, atyre u shtohet edhe më shumë dashuria për to.

Po kështu edhe zemra e besimtarit. Kur ajo mbushet me dashurinë e një besimi të përsosur, emri i Zotit të tij, bëhet një përmendje e vazhdueshme tek ai. Për të, dhikri është pothuajse uji i jetës. Ashtu si një peshk, i cili nuk mund të qëndrojë dot jashtë ujit, ashtu edhe besimtari nuk mund të gjejë qetësi pa dhikër. Për të, dhikri është një nevojë e domosdoshme sa edhe ushqimi, pija dhe ajri.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Shembulli i atij që e përmend Allahun dhe atij që nuk e përmend, është si i gjalli me të vdekurin.” (Buhari, Deauat, 66)

Për rrjedhojë, një besimtar që e mban jetën e zemrës të gjallë me dashurinë e besimit, shpirti i tij e përmend emrin e Zotit të tij në mënyrë shumë të natyrshme. Për të, të falsë në lidhje me madhësitë hyjnore të Allahut Teala, në lidhje me fuqinë e Tij të pakufishme dhe në lidhje me pushtetin e Tij absolut, është një kënaqësi shpirtërore e papërshtatshme. Për këtë arsye, ai e përmend Allahun në çdo moment dhe me përkujtimin e Tij, ëmbëlson shpirtërisht zemrën dhe gjuhën e tij. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“...Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra’d, 28)

Frymëzimi shpirtëror që vjen prej dhikrit, është njësoj si rrezet e dritës që vijnë prej diellit dhe mblidhen sipër një lente, e cila i djeg e i shkrumbon të gjitha dëshirat egoiste që ndodhen nën të. Sa më shumë të vazhdojë kjo gjendje, tek besimtari nuk do të ketë asgjë tjetër më të kënaqshme se përkujtimi i Allahut. Sa më shumë ta përfshijë shpirtin kjo kënaqësi, aq më shumë shtohet edhe afërsia e robit ndaj Allahut. Dhe, sa më shumë shtohet afërsia ndaj Allahut, aq më shumë shtohet edhe dëshira për të bërë dhikër.

I nderuari **Ebu Said Harrazi**, në një bisedë të tij lidhur me të dashurit e Allahut, ka thënë:

“Kur Allahu i Madhëruar vendos kurorën e miqësisë në kokën e njërit prej robërve të Tij, në fillim i hap atij derën

e dhikrit, duke i dhënë zemrës së tij shijen e dhikrit. Pasi robi e shijon këtë, Allahu i hap atij derën e afërsisë me Vetën e Tij, duke e ulur atë në pozitën e miqësisë dhe të afërmit. Pas kësaj, Allahu e ngre në podiumin e teuhidit. Dhe pas kësaj, do të fillojnë të ndodhin ato që duhet të ndodhin!”

VEPRA E ÇMUAR PREJ MBRETËRISË SË KËSAJ BOTE

Për robërit që shijojnë ëmbëlsinë e dashurisë hyjnore, duke arritur të vërtetën e dhikrit, të gjitha gjërat e kësaj bote e humbasin vlerën e tyre. Për rrjedhojë, **Ibrahim bin Et’hemi**, i cili i la mënjanë mirësitë e kësaj bote dhe u zhyt në detin e dashurisë hyjnore, thotë:

“Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë.”

Po ashtu, edhe **Daudi** عليه السلام, të cilit edhe pse i ishte falur pasuri e madhe dhe mbretërim, ai nuk anoi nga kjo botë. Ai jetonte në një paqe të veçantë dhe atmosferë afërsie me Zotin e tij. Aq, sa kur ai fillonte të bënte dhikër, edhe malet, gurët dhe kafshët e egra zhyteshin së bashku me të në pasionin e dhikrit.

Ndërsa djalit të **Daudit** عليه السلام, **Sulejmanit** عليه السلام, i ishte dhuruar një mbretërim madhështor, që nuk i ishte dhënë asnjë njeriu tjetër. Sipas një transmetimi, Sulejmani عليه السلام, po marshonte nën hijen e zogjve me ushtrinë e tij të përbërë prej njerëzve, xhinëve, kafshëve të egra dhe të buta në të djathtë dhe të majtë të tij. Gjatë marshimit, një person prej bijve të izraelit iu afrua dhe i tha:

“O biri i Daudit! Sa mbretërim madhështor të ka falur Allahu!”

Kur Sulejmani e dëgjoi këtë, ia ktheu:

“Një tesbih (fjala subhanallah), e vetme në librin e punëve të një robi besimtar, është më e vlefshme se ajo që i është dhënë birit të Daudit, sepse ajo që i është dhënë atij, është e përkohshme, ndërsa mbretërimi që të sjell tesbihi, është i pafundmë.” (Ruhu'l-Bejan, VII, 150.)

Allahu i Madhëruar, edhe **Ibrahimit** عليه السلام, i kishte falur tufa të mëdha delesh. Një ditë, **Xhibrili** عليه السلام, i erdhi në formën e njeriut dhe i thotë:

“Kush i ka këto tufa? A më shet ndonjë prej këtyre tufave?” Ibrahim i عليه السلام, i tha:

“Këto tufa janë të Zotit tim. Tani për tani ato më janë lënë mua amanet. Nëse e përmend Zotin tim një herë, të jap një të tretën; nëse e përmend tre herë, merri janë të gjitha të tuat!”

Kur Xhibrili عليه السلام, tha tre herë:

سُبُّوحٌ قُدُّوسٌ رَبُّنَا وَرَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ

“Zoti ynë, i melekëve dhe i shpirtit, është larg çdo të mete dhe i pastër prej të gjitha mangësive.”, Ibrahim i عليه السلام, tha:

“Merri! Janë të gjitha të tuat!” Mirëpo, Xhibrili عليه السلام, i thotë:

“Unë nuk jam njeri. Jam Xhibrili. Unë s’mund t’i marrë.” Ibrahim i عليه السلام, ia ktheu:

“Nëse tij je Xhibrili, unë jam Halili (Miku i Allahut). Nuk më ka hije të marr atë që e kam dhënë njëherë.”

Si përfundim, Ibrahimî عليه السلام, i shiti të gjitha tufat me dhen dhe me paratë e tyre bleu një pronë, të cilën e dhuroi si vakëf për besimtarët. Në këtë mënyrë, ai e shprehu me vepra faktin se të gjitha mirësitë e kësaj bote janë një “hiç” përballë dhikrit (përmendjes) të Allahut, duke treguar se e përfaqësonte me dinjitet edhe gradën “Halilullah/Mik i Allahut”.

Një ditë, për të shprehur vlerën e dhikrit tek Allahu, **Resulullahu** ﷺ, i pyeti sahabët:

“A t’ju tregoj për një vepër, e cila është më me vlerë tek Allahu, që do t’ua ngrejë edhe më tepër gradat tuaja, që është më fitimprurëse se sa të jepni si sadaka ar dhe argjend, që do t’ju sjellë më tepër shpërblime se sa kur e goditni armikun gjatë përballjes me të ose të vriteni prej tyre?” Ata thanë:

“Po, na trego!” **Resulullahu** ﷺ, tha:

“Është dhikri i Allahut të Madhëruar!” (Tirmidhi, Deauat, 6)

Njëherë tjetër, Profeti ynë ﷺ, kishte dërguar një togë ushtarësh në zonën e Nexhdit, të cilët u kthyen me një sasi plaçke lufte. Një person tha:

“Ne nuk kemi parë asnjë grup tjetër si ky që është kthyer kaq shpejt dhe ka fituar më shumë plaçkë lufte.” Pas kësaj, Profeti ﷺ, urdhëroi e tha:

“A t’ju tregoj një grup që fiton mirësi më shpejt dhe më tepër së këta? Ata janë njerëzit që gjenden të gatshëm në namazin e sabahut dhe më pas ulen dhe përmendin Allahun deri sa të lindë dielli.” (Tirmidhi, Deauat, 198.)

Tek Allahu, kjo botë nuk ka vlerë as krahu i një mushkonje.³¹

31. shih. Tirmidhi, Zuhd, 13.

Për rrjedhojë, ka njerëz që përkundër joshjeve mashtruese të kësaj bote, munden ta angazhojnë gjithmonë gjuhën dhe zemrën e tyre me përmendjen e Allahut. Kjo vepër e tyre, është aq e vlefshme tek Allahu, sa nuk mund të ndërrohet as me gjithë pasuritë e botës. Këtë të vërtetë, **i Dërguari i Allahut ﷺ**, e ka shprehur kështu:

“Bota dhe ato që janë brenda saj, janë të pavlera. Këtu bëjnë përjashtim vetëm përmendja e Allahut, ato që të afrojnë tek Allahu, dijetari që jep dije dhe nxënësi që studion.” (Tirmidhi, Zuhd, 14.)

Një shok i Profetit ﷺ, Theubani rahimë Allahu, tregon:

“Kur u zbrit ajeti; “...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.”³², ne gjendeshim në një udhëtim së bashku me Profetin ﷺ. Disa nga sahabët, thanë:

«Ajo që do të zbriste në lidhje me arin dhe argjendin, zbriti! (Tashmë nuk do t'i mbledhim më ato. Ato që janë jashtë nevojës tonë do t'i falim.) Ah sikur ta dinim se çfarë është më mirë të mbledhim dhe të fitojmë pak prej saj.»

Pas këtyre fjalëve, Resulullahu rahimë Allahu, tha:

«Më e mira e atyre që zotërohen, janë:

- Një gjuhë që përmend Allahun. (Duke mos e harruar në asnjë fazë të jetës.)

- Një zemër falënderuese. (Për çdo mirësi që ka dhuruar Allahu.)

- Një grua e devotshme, e cila e ndihmon besimin e burrit të saj.» (Tirmidhi, Tefsir, 9/9)

NJERËZIT QË NUK SHKËPUTEN PREJ DHIKRIT...

Asgjë nuk mund ta pengojë nga përmendja e Allahut besimtarin e devotshëm, i cili e kupton siç duhet se dhikri është më i vlefshëm se mirësitë dhe mbretërimi më i vyer i kësaj bote.

Mirësitë e kësaj bote, janë si një thikë me dy tehe. Mirëpo, ndërkohë që për zemrat e urta, të cilat dinë ta përdorin mirë atë, është një zbukurim, për ata që kaplohen prej joshjes së saj, aq sa të harrojnë Allahun dhe botën tjetër, duke u zhytur në dehjen e indiferentizmit, ajo bëhet një problem dhe disfatë e madhe. Për këtë arsye, shembulli i atyre që ia japin zemrën kësaj bote, është si anija që i thyhet timoni në mes të oqeanit, e cila nuk dihet se në cilën vorbull do të zhduket.

Dashuria e tepërt që ndjehet për mirësitë dhe dëshirat egoiste të kësaj bote, e shkatërron dashurinë mes njeriut dhe Allahut, jetën e adhurimeve e kthen në një gjeometri të thatë dhe të pashpirt dhe e helmon frymëzimin shpirtëror të zemrës. Zoti ynë i Madhëruar, na paralajmëron kështu lidhur me dhënien pas kësaj bote dhe mirësive të saj:

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (Hadid, 20)

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj



t'ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)

Mirësitë e kësaj bote, gjithmonë e joshin egon. Aq, sa ata të cilët jetojnë vetëm për të kënaqur egon e vet, duke menduar vetëm interesat dhe kënaqësitë e kësaj bote dhe duke u angazhuar vazhdimisht me të, nuk mund të mendojnë asnjëherë në lidhje me urtësinë e ekzistencës së tyre dhe qëllimin e krijimit. Pra, duke e kthyer mjetin në synim, ata e konsumojnë jetën e tyre në errësirën e një indiference të thellë.

Gjithashtu, ka edhe nga ata që edhe pse e dinë se mirësitë e kësaj bote janë vetëm mjete dhe se nuk duhen futur në zemër, ata nuk arrijnë ta kontrollojnë dot egon e tyre. Për këtë arsye, ata nuk arrijnë të shijojnë ëmbëlsinë e adhurimeve dhe nuk e kapin dot gjendjen e qetësisë dhe përkushtimit. Allahu i Madhëruar, duke folur për persona të tillë, urdhëron: **“ وَلَا أَقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ : Betohem në shpirtin vetëqortues!”** (Kijame, 2)

Nefs-i leuuame (Shpirti vetëqortues), është shpirti që e vret ndërgjegjja për shkak të neglizhencës dhe mangësive që tregojn ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut dhe që për këtë arsye, ai e qorton ashpër veten e tij. Pra, këta janë ata të cilët janë të dobët në kundërvënien ndaj dashurisë së kësaj bote dhe gjynaheve.

Ndërsa robërit e urtë, të cilët e kuptojnë siç duhet se mirësitë e kësaj bote janë vetëm një amanet hyjnor dhe shkaqe të sprovave, nuk i japin rëndësi më tepër se ç'është nevoja. Ata ia kushtojnë fronin e zemrës vetëm Allahut. Për rrjedhojë, ata janë heronjtë e vërtetë të zemrave. Allahu është i kënaqur prej tyre, dhe ata janë të kënaqur prej caktimit të Allahut. Prandaj,

ata janë plotësisht me zemra të qeta. Allahu i Madhëruar, u drejtohet atyre duke u thënë:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27-30)

I nderuari **Mevlana Xhelaledin Rumi**, në veprën e tij *“Mesnevi”*, shënon një tregim shumë mësimdhënës:

Mexhnuni, i cili ishte degdisur nëpër shkretëtirë për shkak të dashurisë ndaj Lejlës, një ditë merr vesh se Lejla ishte nisur për udhëtim. Për këtë arsye, i hipën devesë së tij dhe përpiqet të nxitojë drejt fshatit ku do të shkonte Lejla. Mirëpo, deveja e tij, e cila sapo ishte bërë nënë, e kishte hallin tek vogëlushi i saj që kishte lënë pas. Në kohën kur Mexhnuni filloi të dre-miste mbi deve, ajo kthehet në drejtim të vogëlushit të saj. Kur Mexhnuni e kupton këtë, mundohet ta kthejë devenë përsëri në drejtim të fshatit të Lejlës. Kjo, u përsëri disa herë, sepse Mexhnuni donte të takonte Lejlën, ndërsa deveja donte të vraponte drejt vogëlushit të saj.

Në fund të ditës, Mexhnuni shikon përqark për të kuptuar se ku ndodhet. Mirëpo, sheh se për shkak të këtyre lëvizjeve para-mbrapa, ata nuk kanë lëvizur asnjë metër prej vendit nga ku u nisën në mëngjes. Atëherë, Mexhnuni i thotë devesë:

“Ah moj deve! Ti je dashuruar pas vogëlushit tënd, ndërsa unë pas Lejlës sime! Për rrjedhojë, rrugët tona janë të ndryshme. Ti po pengon rrugën time, ndërsa unë rrugën tënde! Në këtë mënyrë ne s’mund të jemi bashkudhëtarë. Ti je dashuruar pas një trupi të përkohshëm, ndërsa unë pas një shpirti të përjetshëm... Prandaj duhet të ndahemi!”

Në këtë tregim, Mexhnuni përfaqëson “anën shpirtërore”,



ndërsa deveja “anën e egos”. Shpirti është i dashuruar pas Allahut, i Cili është Bukuria Absolute, ndërsa “egoja”, pas dëshirave dhe kënaqësive të kësaj bote...

Në përgjithësi, kështu është edhe gjendja e njeriut indiferent në detyrën e tij të devotshmërisë ndaj Allahut. Kjo, sepse ndërsa shpirti i njeriut rreh krahët për t’u ngritur në majat shpirtërore, egoja e tij, e tërheq atë poshtë si një gurë i rëndë i lidhur në këmbën e tij. Për rrjedhojë, një rob që dëshiron të arrijë tek Allahu, është i detyruar t’i kapërcejë fiksime egoiste dhe ta pastrojë zemrën e tij nga çdolloj gjëje që e largon atë prej Allahut.

Padyshim se, mënyra më e rëndësishme e afërsisë ndaj Zotit, janë adhurimet që kryhen me përkushtim, dashuri e pasion. Kur besimtari arrin t’i kryejë adhurimet e tij me këtë lloj vetëdijeje, e në mënyrë të veçantë dhikrin, ai arrin të fitojë edhe afërsinë me Allahun. Mirëpo, nëse dëshirat e tij egoiste ia zaptojnë zemrën dhe e bëjnë indiferentë ndaj Allahut, sado që gjuha e tij të përmend Zotin, shpirti i tij nuk mund të përparojë asnjë hap.

Për rrjedhojë, për ta kryer dhikrin në kuptimin e plotë të tij, duhet ta ndjesh Allahun shpirtërisht në zemër dhe, (në ato momente) përveç Tij të mos mendohet asgjë tjetër. Dhe për këtë, më parë duhet pastruar vetja nga gjërat e ndaluara dhe të dyshimta, më pas të zbrazen prej zemrës të gjitha dashuritë e përkohshme dhe mendimet lidhur me këtë botë. Kjo, sepse drita e dhikrit, është sipas gjendjes së atij që e bën.

Lidhur me robërit e mirë, të cilët nuk mashtrohen nga bukuria e kësaj bote të përkohshme dhe e ngjallin zemrën me dhikër, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes



dhe mbrëmje, njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara. (Këta shpresojnë) që Allahu t'i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë e t'ua shtojë dhuntinë e Tij. Allahu i jep kujt të dojë, pa llogari.” (Nur, 36-38)

Gjithashtu, Zoti ynë i Madhëruar, me qëllim që ne të ruhemi nga mashtrimi i kësaj bote dhe rreziku i humbjes së ndjesisë së besimit dhe butësisë së zemrës, na paralajmëron në këtë mënyrë:

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?..” (Hadid, 16)

Ky ajet, është zbritur për të qortuar disa sahabë të cilët filluan të dobësoheshin disi në devotshmëri pas emigrimit në Medinë, pavarësisht nga vuajtjet dhe mundimet që kishin përjetuar në Mekë. Dhe ky është një fakt shumë domethënës, sepse nëse edhe brezit të sahabëve u ka ardhur ky paralajmërim, atëherë, ne duhet të përpiqemi edhe më shumë për të arritur një vigjilencë shpirtërore më të madhe, e cila nuk do të na lejojë të ndikohemi prej ambicieve të kësaj bote dhe interesave të përkohshme të saj. Për këtë arsye, ne duhet ta përmendim vazhdimisht Zotin tonë, si në vështirësi, ashtu edhe në rehati, duke mos e nxjerrë kurrë prej mendjes tonë.

Nga ana tjetër, kur njeriu është në skamje dhe vështirësi, egoja e tij është shumë e dobët. Dhe, për rrjedhojë, ai i drejtohet Zoti i tij dhe strehohet më tepër tek Ai. Mirëpo, në kohët e rahatisë dhe begatisë, egoja e njeriut fryhet dhe fillon ta shohë veten të panevojshme, duke u treguar arrogante.



Për këtë arsye, njeriu është i prirë ta kujtojë më pak Zotin, madje edhe ta harrojë Atë. Në mënyrë të veçantë, në kohët e rehatisë dhe begatisë, ne duhet ta kujtojmë edhe më tepër Zotin tonë. Shembulli më i bukur i kësaj, është Sulejmani ﷺ, i cili nuk e bëri kurrë zemrën e tij kasafortën e mirësive të përkohshme të kësaj bote dhe për të cilin Allahu i madhëruar ka thënë; **“Sa rob i mirë!”**. Pra, edhe ne, në kohë të begatisë dhe rehatisë, duhet t’ia kushtojmë zemrën tonë Allahut, me qëllim që në kohë të vështira të na vijë në ndihmë mëshira hyjnore, duke na mbajtur për dore dhe duke i dhënë forcë e qetësi zemrës sonë.

Lidhur me njerëzit indiferentë, të cilët kur janë në këtë botë i anashkalojnë thirrjet e shumë udhëzuesve, të cilët i ftojnë për të kujtuar Allahun, Zoti ynë i Madhëruar, shprehet:

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: «O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?» (Allahu) do t’i thotë: «Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.»”

(Ta-Ha, 124-126)

Padyshim se, Allahu i madhëruar, është i pastër prej çdo dobësie siç është “harresa”. Ndërsa harrimi i dikujt nga ana e Tij, është vetëm shprehje e ndëshkimit hyjnor. Për këtë arsye, ai që nuk dëshiron që në atë ditë të ashpër të kijametit të mos harrohet nga Allahu dhe të lihet jashtë mëshirës hyjnore, nuk duhet ta harrojë Allahun as në jetën e kësaj bote. Aq sa ta përkujtojmë Zotin tonë sot në jetën e kësaj bote, aq do ta arrijmë edhe takimin me Të nesër në botën tjetër. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Prandaj, më kujtoni Mua, që edhe Unë t’ju kujtoj!..”

(Bekare, 152)

Ta shpërdorosh afatin e jetës në dehjen e indiferencës që shkaktojnë joshjet e përkohshme të kësaj bote, ndërkohë që mund të fitosh nderin e të qenit një rob që kujtohet nga Allahu, është një vetëmashttrim shumë i hidhur! Ata që e harrojnë Allahun, i Cili thotë se, “Ne jemi më afër robërve se sa damari i qafës së tyre”, janë udhëtarët më të hutuar të kësaj jete!..

Për këtë arsye, ata që zotërojnë urtësinë e një besimi të vërtetë, nuk lazdrohen me mirësitë e kësaj bote dhe, furnizimin, nuk e kthejnë kurrë në një perde ndaj Furnizuesit. Ata, edhe pse nga jashtë mund të duken sikur rendin pas furnizimit, zemrat e tyre janë gjithmonë të angazhuara me përkujtimin e Furnizuesit të tyre. Madje, ata nuk mund të qëndrojnë dot pa e përmendur Zotin e tyre, sepse një gjë e tillë, i shqetëson shumë ata. Ky shqetësim, për ta është si një paralajmërim hyjnor. Dhe, ta ndjesh këtë paralajmërim, në fakt është një mirësi më vete, për të cilën duhet falënderuar. Kjo gjë, është një tregues se ka ende një dritë shprese për të përmirësuar gjendjen dhe për të shlyer gabimin. Mungesa e kësaj ndjeshmërie, -për shkak të largimit nga dhikri-, e indiferentëve me zemra të ngurtësuara dhe të vulosura, nënkupton se ata nuk kanë asnjë mirësi prej mëshirës hyjnore. Tashmë, ata e konsumojnë jetën e tyre si një tufë hutaqësh, të cilët mjerimin e vet e pandehin lumturi.

I nderuari Mevlana, lidhur me këtë fakt, shprehet:

“Kur e braktis dhikrin dhe falënderimin e Allahut, bie në vështirësi e vuajtje dhe të vjen një mërzi e brendshme, shkaku i së cilës nuk dihet. Kjo mërzi pa shkak dhe ky

shqetësim i brendshëm, është një paralajmërim. Është një farë edukimi, që do të thotë; «Mos e lër dhikrin që ke bërë vazhdimisht dhe mos e prish marrëveshjen!»

Vazhdoje dhikrin, para se ky shqetësim i brendshëm dhe ky ngushtim të marrë formën e një zinxhiri dhe para se kjo gjë që të shtrëngon përbrenda dhe të lidh shpirtin, të të lidhë edhe këmbët!..”

NEGLIZHENCA E DHIKRIT, NUK KA ARSYETIM!

Ibn Abbasi , në komentimin e ajetit; **“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun!”**³³, shprehet:

“Allahu i Madhëruar, ka vendosur një kufi të caktuar për çdolloj adhurimi që ua ka bërë të detyruar (farz) robërve të Vet. Dhe, në lidhje me këtë çështje, Allahu i ka pranuar edhe disa lehtësime dhe arsyetime prej njerëzve. Mirëpo, dhikri bën përjashtim. (Në Kuranin Fisnik, gjenden me qindra ajete në trajta dhe kallëpe të ndryshme, në formë porosish hyjnore të cilat nxisin dhikrin.) Në fakt, Allahu i Madhëruar, nuk ka vendosur ndonjë kufi të caktuar në lidhje me dhikrin. Dhe, përveç prej atij që ka humbur mendjen, Ai nuk pranon arsyetime prej askujt tjetër që e braktis dhikrin. Pra, Allahu i Madhëruar, ka dëshiruar që njerëzit të bëjnë dhikër në mënyrë të vazhdueshme.”³⁴

Sa mësimdhënës është fakti se, kur Allahu i Madhëruar dërgoi Musain dhe Harunin (alejhimusselam), tek faraoni për

33. Ahzab, 41.

34. Taberi, xhamiu'l-Bejan an Te'uili Aji'l-Kur'an, Bejrut 1995, XXII, 22; Kurt - bi, XIV, 197.

t'i kumtuar urdhrat hyjnorë, i urdhëroi me këto fjalë; **“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së përmenduri Mua!”**³⁵ Në këtë mënyrë, duke i porositur për dhikrin edhe dy robërit e Tij që ishin profetë, në emër të tyre, Allahu ka porositur edhe të gjithë njerëzimin.

Për rrjedhojë, për shkak të rrezikut të madh të të qëndruarit qoftë edhe një çast indiferent ndaj përmendjes së Allahut, edhe Profeti ﷺ, është lutur: *“O Zot! Mos më lërë në dorë të vetes sime as sa një hapje mbyllje e syrit!..”*³⁶

Nuk duhet harruar se, koha që kalon e privuar nga dhikri në jetën e kësaj bote; pra, frymëmarrjet që konsumohen pa e përmendur Allahun, janë fletë të shkuara dëm prej kalendarit të jetës. Për këtë arsye, në hadithet fisnike, është thënë:

“Nëse njerëzit ulen në një vendtubimi dhe nuk e përmendin emrin e Allahut, kanë lënë diçka mangët dhe kanë bërë gjynah. Kush ecën në një rrugë dhe nuk e përmend Allahun, ka lëndë diçka mangët dhe ka bërë gjynah. Kush shtrihet në shtratin e tij dhe nuk e përmend Allahun aty, ka lëndë diçka mangët dhe ka bërë gjynah.” (Ahmed, II, 432)

“Nëse një popull mblidhet në një vend dhe nuk e përmendin Allahun e nuk bëjnë salavat për profetin e tyre, kjo mbledhje, për ta do të jetë shkak pendimi në botën tjetër. Nëse dëshiron, Allahu i fal, nëse dëshiron nuk i fal.” (Tirmidhi, Dua, 8/3380)

“Banorët e xhenetit, nuk do të ndjejnë mall dhe pendim për asgjë tjetër përveç momenteve që i kanë kaluar pa e përmendur Allahun në këtë botë!” (Hejthemi, X, 73-74)

35. Ta-Ha, 42.

36. Xhamiu's-Sagir, I, 58.

Shkurtimisht, frymëmarrjet që konsumohen në mënyrë indiferente larg dhikrit të Allahut, do të jenë shkaku i pendimit më të madh në botën e përjetshme. Për rrjedhojë, përfitimi prej mundësive për ta gjallëruar jetën me dhikër, me qëllim që të mos ndihet ky pendim në botë tjetër, është një urtësi e domosdoshme e besimit të një myslimani. Dhe, besimtarët e devotshëm, të cilët e jetojnë kohën e tyre me urtësinë e duhur, janë të vetëdijshëm se; “Koha e vetme që humbasin, është ajo që kalon pa e përmendur Allahun.”

Allahu na i ruajttë zemrat nga indiferenca dhe ngurtësia; na e mundësoftë të gjithëve të jetojmë në atmosferën e dashurisë së Tij dhe na bëftë pjesë të njerëzve të devotshëm, të cilët e ringjallin zemrën e tyre me dhikër. Gjithashtu, Allahu na e bëftë të mundur të mos e kalojmë qoftë edhe një çast pa e përmendur Atë; Allahu i mbushtë ditët dhe netët tona me frymëzimin shpirtëror të dhikrit!

Amin!..





Meditimi

Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore pa zë dhe pa fjalë. Leximi i këtyre poezive, është i mundur në sajë të thellësisë së ndjenjave që gjendet në zemra. Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë të gjerë zemre, veprat e artit hyjnor në gjithësi, nuk i shohin në mënyrë sipërfaqësore, por sikur shohin një oqean të thellë. Dhe, duke vërejtur oqeanet e fshehtë në një pikë, ata përparojnë në atmosferën shpirtërore.



Në këtë botë, çdo grimcë mund të flasë me një njeri që e ka zemrën të gjallë. Të gjitha krijesat shprehen me gjuhën e gjendjes së tyre. Në gjithësi, nuk ka asnjë grimcë që nuk e njeh Krijuesin e saj dhe të gjitha krijesat mbajnë vulën e Allahut të Madhëruar, i Cili i krijoi ato nga asgjëja. Detyra e njeriut, është të thellohet në meditimën e shfaqjeve të fuqisë hyjnore, me qëllim që t'i shohë këto vula hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim.



MEDITIMI

TË MOS NGATHTËSOHEN ZEMRAT!..

Disa persona, shkuan tek Hasan Basriu dhe i thanë:

“O shejh! Zemra jonë është në gjumin e indiferencës; aq, sa tashmë asnjë fjalë nuk ka ndikim. Ju lutemi! Na këshilloni, me qëllim që të zgjohemi!..”

Hasan Basriu, tha:

“Ah sikur zemrat tuja të ishin duke fjetur... sepse ai që fle, zgjohet shpejt. Mirëpo, unë kam frikë se zemrat tuaja kanë vdekur! Sepse, unë kam kohë që dua t'i zgjoj, por ato nuk kanë lëvizur fare prej vendit!”

Këta persona, u tronditën shumë nga fjalët e Hasan Basrit dhe thanë:

“O Shejh! Po na tmerroni me këtë gjykimin tuaj!”

Ndërsa Hasan Basri, tha:

“Nëse frikësoheni sot, nesër në ditën e kijametit, do të jeni të sigurt. Mjerë ai që nuk ka frikë sot prej atyre (urdhrave dhe ndalesave) që duhet të frikësohet!..”³⁷

37. Shih. Feriduddin Attar, Tezkiretu'l-Evlja, fq. 29-30, E.Yayınları, Istanbul, 1984.



“Zemra”, që është edhe qendra e ndjenjave dhe një mirësi e jashtëzakonshme që Allahu i Madhëruar na ka falur, dëshiron të jetë gjithmonë e mrekulluar në mënyrë të pangopur prej të fshehtave dhe urtësive hyjnore në këtë botë të sprovave hyjnore. Në këtë mënyrë, ajo kërkon që ne të bëjmë një jetë të devotshme në afërsinë ndaj Allahut dhe ndjenjën e miqësisë me Të. Ajo, dëshiron që ne të zotërojmë vigjilencën shpirtërore, e cila do të na bëjë të kuptojmë përkohshmërinë tonë.

Indiferenca, pra, kushtëzimet materiale dhe egoiste, shkaktojnë dobësinë e kuptimit, verbërinë e ndjenjave dhe ngathtësinë e zemrës. Në krye të mënyrave më efektive të kurimit të kësaj sëmundjeje, vjen “**meditimi**”. Kjo, sepse meditimi, është një mundësi e rëndësishme që i jepet njeriut për të kuptuar gabimet dhe gjynahet ku ka rënë në mënyrë të pavetëdijshme dhe t’i korrigjojë ato.

ÇFARË DUHET TË MEDITOJMË?..

Qëllimi i meditimit, nuk është një veprimtari e të menduarit pa synim, pavetëdije dhe sipas dëshirës së egos. Është e natyrshme që çdo njeri të zhytet në mendime të ndryshme. Mirëpo, pikat ku do të arrijnë të gjithë me anë të meditimit, ndryshojnë në bazë të gjendjes së zemrës. Kjo, sepse ashtu si çdo mirësi tjetër, edhe mirësia e meditimit është si një thikë me dy tehe. Ajo mund të bëhet shkak i të mirës ose të keqes, sipas vendit që përdoret... Për këtë arsye, ndërkohë që dikush i hap krahët drejt horizonteve shpirtërore me anë të mendimit, dikush tjetër e shkon dëm jetën në shërbim të dëshirave të egos.

Lidhur me këtë, Mevlana i nderuar, na jep një shembull shumë të bukur:

“Drejtuesit i ngjajnë një baseni; ndërsa populli i ngjan tubave që e mbushin basenin. Nëse prej tubave vjen ujë i papastër, baseni do të mbushet me ujë të pisët; nëse vjen ujë i pastër, baseni do të mbushet me ujë të pastër.”

Ashtu edhe “zemra”, e cila është qendra e meditimit dhe ndjenjës në trupin e njeriut, është si një basen. Siç shprehet edhe poeti Nexhip Fazil; tubat që e mbushin këtë basen, janë dy; nga njëri rrjedh dritë, ndërsa nga tjetri papastërti... pra, nëse prej këtyre tubave kalojnë gjithmonë dëshira egoiste, lakmi dhe indiferentizëm, bota jonë e brendshme do të kthehet në një plehërishte. Por, nëse prej këtyre tubave kalojnë burime të frymëzimit shpirtëror, zemrat shndërrohen në një oqean urtësie.

Allahu i Madhëruar, prej nesh kërkon një meditim shpirtëror. Përndryshe, aftësia e meditimit, shkatërrohet në vorbullat e dëshirave të egos, sepse zemrën e cila nuk angazhohet me të vërtetën, e pushton e kota.

Çdo gjë në gjithësi, është si një vitrinë ku sheh zemra, e cila patjetër do të ndikohet prej një vitrine. Prandaj, duhet pasur shumë kujdes se çfarë sheh zemra, vitrinat hyjnore, apo ato djallëzore. Kjo, sepse ashtu si gjurma e gishtit që luan rolin e një identiteti material, ashtu edhe ato vitrina që njeriu sheh dhe iu kushton vëmendjen, formojnë identitetin e tij shpirtëror.

Nga ana tjetër, aftësia e meditimit shpirtëror, është një cilësi që e dallon njeriun nga krijesat e tjera dhe bën më superior se ato. Sa bukur shprehet Mevlana Xhelaledin Rumi:



“O vëlla! Trupi yt është i njëjtë me atë të kafshëve për nga mishi dhe kocka (materialisht). Në të vërtetë, ti duhet të gjeshe jetë me anë të meditimit. Nëse mediteti është trëndafil, ti je një trëndafilishte. Nëse mendon si gjemb (pre je mposhtur nga dëshirat e egos), atëherë do të digjesh në zjarr si një kërcu!”

Nëse njeriu e përdor në mënyrën e duhur meditimin, ai ngrihet shpirtërisht dhe arrin një shkallë më të lartë se melekët. Por, nëse mposhtet nga egoja e vet dhe e humbet këtë cilësi, atëherë nuk ndryshon fare nga krijesat e tjera. Për rrjedhojë, hyn në cilësimin që është bërë në këtë ajet fisnik; “**...Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.**” (Furkan, 44)

I nderuari Mevlana, gjendjen e hutuar shpirtërore të indiferentëve të cilët qëndrojnë larg meditimit, e shpreh në këtë mënyrë:

“Një ka, shkon në Bagdad dhe e shëtit qytetin nga një cep në tjetrin. Mirëpo, në gjithë qytetin e Bagdadit (i cili është qendra e shumë civilizimeve, i mbushur me vepra arti madhështore dhe midis të cilit rrjedh Lumi Tigër), atij i pëlqejnë vetëm lëvoret e pjeprit dhe shalqirit... Në fakt, ajo që mund t’i pëlqej një kau apo një gomari në një udhëtim, është ose kashta e rënë në rrugë, ose bari dhe bimët e mbira buzë rrugës!”

Ta nënshtrosh mirësinë e meditimit ndaj dëshirave të egos, duke qëndruar larg meditimit shpirtëror, e bën zemrën shurdhmemecë dhe të pandjeshme ndaj të vërtetave hyjnore. Ata që vijnë vërdallë me çehre të vrenjtura në shkollën e sprovës hyjnore, duke luajtur symbyllazi në indiferentizëm, në botën tjetër do të jenë përjetësisht të verbër. Në një ajet

fisnik, urdhërohet: “Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.” (Isra, 72)

ATMOSFERA E VËRTETË E MEDITIMIT...

Ashtu si syri, i cili ka nevojë për dritën që të shikojë, ashtu edhe zemra, për të arritur një thellësi shpirtërore në meditim, ka nevojë të ndriçohet me dritën e “**Kuranit** dhe **Sunetit**”. Kjo, sepse mendja njerëzore, është programuar të çojë tek e vërteta dhe e mira vetëm me nën dritën e Kuranit dhe Sunetit. Për rrjedhojë, po të mos ishte horizonte i meditimit që hapi Kurani dhe Suneti, vetëm me mendjen tonë, nuk do të arrin as t’i kuptonim, por as t’i shprehnim shumë të vërteta. Madje, do të shkatërroheshim nëpër rrugicat qorre ku kanë rënë shumë filozofë.

Njeriu, në këtë botë vjen si një kaset bosh. Nëse kjo kaset mbushet me Kuran, njeriu shkon drejt përsosmërisë. Kurani Fisnik, në 137 vende të ndryshme, e fton besimtarin në rrugën e meditimit të urtësive dhe të vërtetave hyjnore.

Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore pa zë dhe pa fjalë. Leximi i këtyre poezive, është i mundur në sajë të thellësisë së ndjenjave që gjendet në zemra. Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë të gjerë zemre, veprat e artit hyjnor në gjithësi, nuk i shohin në mënyrë sipërfaqësore, por sikur shohin një oqean të thellë; dhe, duke vërejtur oqeanet e fshehtë në një pikë, ata përparojnë në atmosferën shpirtërore. Kështu, edhe njerëzit e zemrës, të cilët synojnë të arrijnë Allahun me zemër, e kanë bërë Kuranin dhe Sunetin, udhërrë-



fyesin e tyre të vetëm që do t'i shpie në synimin e tyre. Shumë prej ajeteve Kuranore, mbi të cilat duhet të meditohet thellë, ata i kanë kthyer në formën e dhikrit të përsëritur. Po ashtu, për të kuptuar urtësitë e holla të Kuranit, ata kanë besuar në domosdoshmërinë e purifikimit të zemrës.

LEXO LIBRIN E GJITHËSISË!

Të jetosh brenda kësaj Gjithësie, e cila ashtu si Kurani Fisnik, është një libër urtësie i mbushur me shfaqjet e fuqisë dhe madhështisë hyjnore dhe, të mos meditososh në lidhje me të, nuk i ka hije ndjenjave njerëzore. Kjo, sepse në këtë botë, çdo grimcë mund të flasë me një njeri që e ka zemrën të gjallë. Të gjitha krijesat shprehen me gjuhën e gjendjes së tyre. Në gjithësi, nuk ka asnjë grimcë që nuk e njeh Krijuesin e saj dhe të gjitha krijesat mbajnë vulën e Allahut të Madhëruar, i Cili i krijoi ato nga asgjëja. Detyra e njeriut, është të thellohet në meditimin e shfaqjeve të fuqisë hyjnore, me qëllim që t'i shohë këto vula hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim.

Edhe një njeri i verbër, i cili nuk mund ta shohë lindjen e diellit, e kupton këtë prej nxehtësisë së tij. E, kur çështja është kështu, mund të themi se është shumë e hidhur nëse një njeri që zotëron mendje dhe ndjenja, qëndron i ftohtë dhe i vrenjtur përballë mrekullive që shkruan lapsi i fuqisë hyjnore në librin e gjithësisë; dhe që nuk mund të kalojë mendërisht dhe shpirtërisht prej artit tek artisti.

Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk kanë arsye.” (Enfal, 22)

Për njeriun, i cili jeton në këtë botë të pajisur me të vërteta hyjnore, është diçka e pakuptimtë, të mos e kuptojë ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut të Madhëruar. Sa bukur e shpreh këtë fakt, kjo ndodhi:

Një prej të dashurve të Allahut, Xhunejd Bagdadi, një ditë sheh shumë njerëz që nxitojnë me emocione dhe kureshtje drejt një vendi dhe i pyet:

“Ku po shkoni kështu kaq të emocionuar e kureshtarë?”
Ata u përgjigjën:

“Ka ardhur një dijetar nga filan vend! Ai e shpjegon ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut me njëmijenjë argumente! Prandaj, po shkojmë të përfitojmë prej tij. Nëse doni ejani edhe ju!”

Pas këtyre fjalëve, Xhunejd Bagdadi, me një buzëqeshje të ftohtë, thotë:

“Për sytë që shohin, veshët që dëgjojnë dhe zemrat që ndjejnë, në gjithësi ka argumente dhe dëshmi hyjnore të panumërta. Madje për Vet Allahun ka dëshmi të shumta. O popull! Nëse pas gjithë këtyre, dikush prej jush ka ende dyshime, atëherë le të shkojë! Në zemrën tonë, nuk ka asnjë grimcë dyshimi.”

Një njeri që mund ta lexojë librin e gjithësisë, e sheh se i gjithë universi është krijuar me llogaritje precize dhe i nënshtrohet plotësisht Allahut. Në të njëjtën kohë, ai e kupton se, edhe pse njeriu është krijesa më e lartë e kësaj bote, ai sillet në mënyrë të padenjë, si i mposhtur nga egoja e vet, gjë e cila është shumë e palogjikshme dhe e pahijshme. Gjithashtu, ai e kupton detyrën e tij në këtë botë dhe domethënien e jetës dhe gjithësisë.



Shkurtimisht, aktiviteti i një meditimi që do të kënaqë Allahun, mund të gjejë jetë vetëm në themelet e një mendjeje dhe zemre të ushqyer me frymëzimin shpirtëror të Kuranit dhe Sunetit. Dhe, synimi përfundimtar i një meditimi të tillë, është:

- Të njohësh ekzistencën e Krijuesit të Gjithësisë, i Cili është një ekzistencë e domosdoshme (Vaxhibu'l-Vuxhud).

- Të kuptosh dobësinë dhe gjendjen e hiçit përballë fuqisë dhe madhësisë së Tij.

- Të arrish vetëdijen se jemi të dobët në falënderimin e mirësive të Tij të panumërta. Dhe, me një zemër të tillë, të bëjmë një jetë të ngritur mbi devotshmëri.

MEDITIMI NË JETËN E ADHURIMIT

Meditimi shpirtëror, është një mënyrë e arritjes së besimit të vërtetë. Që dija të kthehet në urtësi, është e domosdoshme që ajo të sitet në horizontin e meditimit dhe të gdhendet në zemër.

Vehb bin Munebbih, -rahmetullahi alejh-, thotë:

“Ai që mediton shumë, bëhet i ditur në mënyrë të prerë. Dhe, kush bëhet i ditur në kuptimin e vërtetë të fjalës, patjetër bën vepra të mira.” (Ihja, IV, 764.)

Adhurimet, fitojnë vlerë vetëm nëse kryhen me përkushtim të lartë. Ndërsa meditimi, siguron përkushtimin gjatë adhurimit, sepse meditimi; i jep besimtarit vetëdijen se në prezencë të kujt ndodhet gjatë adhurimit. Për këtë arsye, ndërmjet adhurimeve që bëhen në thellësinë e meditimit dhe

adhurimeve që bëhen në mënyrë të pavetëdijshme, ka një dallim të jashtëzakonshëm.

Aliu , duke theksuar nevojën e madhe të meditimit për një jetë adhurimi të pranueshme, është shprehur:

“Në adhurimin pa dije dhe në leximin e Kuranit pa meditim, dobia dhe frymëzimi është shumë i pakët.”

Profeti , ka thënë:

“*Nuk ka adhurim si meditim.*” (Ali Muttaki, Kenzu'l-Ummal, XVI, 121.) Nga kjo, kuptohet se Profeti , e ka parë meditim në nivelin e adhurimit. Pra, ashtu siç kërkohet meditim për të shpëtuar prej lakmive të egos, për të zbutur zemrën, për të forcuar besimin, për të braktisur shqetësimet e kota dhe të për të gjetur qetësinë, në të njëjtën mënyrë, meditim është edhe një kusht për pranimin e adhurimeve.

MEDITIMI I PROFETIT

Padyshim se, ndër të gjithë njerëzit, Profeti , është personaliteti i vetëm që ka arritur thellësinë e vërtetë në meditim dhe përkushtim. Një nga të dashurit e Allahut, Ahmed er-Rifai, ka thënë:

“Meditimi, është puna e parë e Profetit . Kjo, sepse adhurimi i tij para çdo farzi, ishte meditim rreth krijesave dhe mirësive të Allahut. Atëherë, edhe juve kapuni fort mbas meditimit dhe bëheni atë mjet mësimi.”

Në fakt, i dërguari i Allahut , pak kohë para se të ngarkoheshe me detyrën e profetësisë, ishte përkushtuar më tepër me meditim. Në mënyrë të veçantë, ai ishte ngujuar në shpellën Hira dhe kishte hyrë në një meditim të thellë, duke



vëzhguar Qaben dhe menduar rreth krijimit të qiejve e të tokës për të marrë mësim, si stërgjyshi i tij Ibrahim عليه السلام.

I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe në jetën e tij të mëvonshme, vazhdoi të meditonte. Ai nuk fliste pa pasur nevojë dhe gjendja e tij e heshtur zgjaste shumë. Gjithashtu, sa herë që i jepej mundësia, ai e ftonte popullin e tij të meditonte më tepër mbi krijesat e Allahut.³⁸ Në një hadith fisnik, thuhet:

*“Zoti im, më ka urdhëruar që heshtja ime të jetë meditim!..”*³⁹

Nëse njeriut i duhet të flasë, atëherë duhet të thotë fjalë më të çmuara se heshtja. Përndryshe, duhet të heshtë. Fakti që Profeti ﷺ, fliste pak e qartë dhe heshte për një kohë të gjatë, është një paralajmërim për ne, që të mos bëhemi si indiferentët, të cilët nga e folura e tepërt, nuk gjejnë kohë për të medituar.

Hasan Basri, thotë:

“Ai që flet pa urtësi, fjalët e tij janë pavend; ai që hesht pa medituar, heshtja e tij është e kotë; ai që nuk shikon për të marrë mësim, shikimi i tij është i gabuar.” (Ihja, IV, 764)

Po ashtu, Hasan Basri, në komentimin e ajetit: **“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë!..”**⁴⁰, shprehet:

“Allahu i Madhëruar, zemrat e njerëzve të tillë, i pengon nga meditimi i madhështisë hyjnore.” (Ihja, IV, 764)

Lidhur me jetën medituese të Profetit ﷺ, Aisheja رضي الله عنها, transmeton këtë kujtim:

38. shih. Dejlami, II, 56.

39. shih. Ibrahim Canan, Hadis Ansiklopedisi, XVI, 252, hadis no: 5838.

40. A’raf, 7/146.

Një natë, Resulullahu ﷺ, më tha:

“O Aishe! Nëse më lejon, dëshiroj ta kaloj natën në adhurimin e Zotit tim.”

“Vallahi, unë dua shumë të jem bashkë me ty. Mirëpo, e dua më shumë atë që të gëzon ty.” – i thashë unë.

Më pas, u ngrit, mori abdest për bukuri dhe qëndroi në namaz, ku filloi të qante. Ai qau aq shumë, sa iu lagën rrobat, mjekra e tij e bekuar dhe vendi ku bënte sexhde. Ndërkohë që ishte në atë gjendje, vjen Bilali për ta thirrur në namazin e sabahut. Kur e pa që Profeti ynë po qante, e pyeti:

“O Resulullah! Përse qani, ndërkohë që Allahu jua ka falur gabimet e shkuara dhe të ardhme?” Pas kësaj, Resulullahu ﷺ, tha:

“A të mos bëhem një rob që e falënderon shumë Allahun? Vallahi, këtë natë më janë zbritur ajete të tilla, saqë mjerë ata që i lexojnë dhe nuk meditojnë mbi to!” – dhe më pas lexoi këto ajete:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Al-i Imran, 190-191)⁴¹

Në këtë mënyrë, Profeti ﷺ, ka derdhur lot deri në mëngjes, duke medituar mbi shfaqjet e madhështisë hyjnore. Pra, edhe ne, si umeti i Muhamedit ﷺ, duhet të meditojmë

41. Ibn-i Hibban, II, 386.



më shumë mbi shfaqjet e madhështisë hyjnore, me qëllim që zemrat tona të zbuten.

TALENTI I VËRTETË

Çdo betim hyjnor në Kuranin Fisnik, është një nxitje për meditim, që do të thotë; “Shih madhështinë hyjnore, njihje atë dhe mos harro se para kësaj madhështie je veç një «hiç»!” Dhe, një devotshmëri e pranuar, kërkon që robi të pranojë dobësinë e tij përballë pakufishmërisë së fuqisë dhe madhështisë së Zotit

Në fakt, mundësitë e kuptimit që zotërojmë si njerëz në kushte e kësaj bote, janë të kufizuara. Ndërsa të vërtetat hyjnore janë të pakufishme. Mendja, është si një ana e një peshoreje. Mirëpo, e vërteta që duhet të peshohet, është aq e rëndës, sa nuk mund ta durojnë as malet. Të vërtetat që Allahu i Madhëruar i ka shpallur njeriut, janë vetëm një pjesë e të vërtetave hyjnore. Dhe, sa për qind të kësaj pjese zotërojmë ne? Por, një gjë e shumë e qartë, se nëse do të zotëronim në kuptimin e vërtetë të fjalës qoftë edhe aq sa mund të kapë mendja jonë prej të vërtetave hyjnore, ne do të kërruseshim prej njohjes së Allahu, dashurisë dhe frikës nga Ai, duke e pritur frymën tonë të fundit pa e ngritur ballin nga sexhdja.

Nëse do ta njihnim Allahun, siç shprehet edhe ky ajet; “...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët!..”⁴², atëherë do të zhvilloheshin edhe ndjenjat tona të devotshmërisë ndaj Tij.

I nderuari **Bishr-i Hafi**, shprehet:

“Nëse njerëzit do të meditonin ashtu siç duhet në lidhje

me madhështinë e Allahut, ata nuk do tregoheshin të pabindur ndaj Tij dhe nuk do të bënin gjynahe.” (Ibn-i Kethir, I, 448.)

Ndërsa një tjetër për të dashurve të Allahut, **Hatem-i Esam**, ka thënë:

“Shikimi për të marrë mësim, shton diturinë; dhikri shton dashurinë; ndërsa në sajë të meditimit ngjiten shkallët e devotshmërisë.” (Ihja, IV, 765)

Të vërtetat që na ka njoftuar Allahu i Madhëruar, i kuptojmë aq sa na lejojnë kushtet e kësaj bote. Kushedi se sa dallim ka ndërmjet kuptimit që nxjerr në pah perceptimi i ynë i kufizuar dhe asaj që Allahu na ka njoftuar me të vërtetë!? Përveç të vërtetave hyjnore që mund të zotërojmë në mendjen tonë, kushedi se sa të fshehta të mrekullueshme ekzistojnë, të cilat njeriu është i dobët t’i perceptojë!..

Profeti ﷺ, i cili është dërguar si mëshirë për botët, ka thënë:

“Nëse do t’i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak, e do të qanit shumë.” (Buhari, Kusuf, 2; Muslim, Salat, 112.)

Megjithëse Profeti ﷺ, përbënte majën e gjithë njerëzimit në çështjen e njohjes së Allahut, ai i lutej dhe i kërkonte falje Allahut në mënyrë të vazhdueshme:

“O Zot! Nuk mundëm të të njohim ashtu siç të takon Ty...” (Munavi, Fejzu’l-Kadir, II, 520.)

Gjithashtu, në disa lutje të tjera, thoshte:

“O Allah! Strehohem tek kënaqësia Jote, prej zemërimi Tënd; tek falja Jote, prej ndëshkimit Tënd; dhe tek Ty po prej Teje! Unë jam i pafuqishëm të të laudëroj dhe të të falënderoj ashtu siç të takon! Ti je ashtu siç e laudëruar dhe madhëruar Veten Tënde!” (Muslim, Salat, 222.)



Po ashtu, edhe ne duhet të meditojmë rreth gjendjes sonë të “hiçit” përballë pafundësisë së madhësisë dhe fuqisë hyjnore dhe prej thellësive të këtyre ndjenjave, duhet t’i drejtohem falënderimit, mirënjohjes, dhikrit dhe kërkimit të faljes. Nuk duhet të harrojmë se, Zoti ynë është i Lartë. Pra, është më Madhështor se sa e njohim ne Atë dhe ka një përsosmëri të tillë, që mendja njerëzore është shumë e dobët ta konceptojë. Ai, është i pastër prej çdo lloj të mete dhe gëzon të çdo lloj cilësie të përsosur. Ja pra, pikërisht në këtë horizont meditimi duhet ta adhurojmë Atë.

Shkurtimisht, meditimi shpirtëror, është një shkollë edukimi. Si besimtarë që jemi, ne duhet jemi nxënësit punëtor të kësaj shkolle dhe duhet të përpiqemi të zbatojmë me përpikëri urdhrin hyjnor: “Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!”⁴³

Zoti ynë na ruajttë prej meditimit egoist dhe prej indiferencës së mos meditimit! Na e bëftë të mundur të jetojmë në një atmosferë meditimi shpirtëror e cila do ta bashkojë zemrën, mendjen, ndjenjat dhe mendimet tona, me kënaqësinë hyjnore!

Amin!..





Të lexosh me syrin e urtësisë për të marrë mësim

Ashtu si Kuranin Fisnik, ajo që do ta lexojë edhe gjithësinë dhe fenomenet në të dhe do të zbulojë urtësitë e saj, është zemra. Ndërsa drita e besimit në zemra ndriçon me anë të meditimit. Për rrjedhojë, ne jemi të detyruar të mësojmë me zemër, me qëllim që të mund t'i shfletojmë fletët e jetës dhe të gjithësisë dhe t'i lexojmë duke medituar për të marrë mësim.

Ai që ka një ego mendjemadhe, arrogante dhe të ashpër, e ka të verbër syrin e zemrës. Për këtë arsye, nëse dëshirojmë të na forcohet shikimi për të marrë mësim dhe të na shtohet drita e urtësisë, është kusht që egon tonë ta edukojmë me mendime të dobishme dhe përpjekje fetare.

TË LEXOSH ME SYRIN E URTËSISË PËR TË MARRË MËSIM

Urdhri i parë i Allahut në Kuranin Kerim, është **“Lexo”**. Për zemrat e ndriçuara, çdo krijesë dhe çdo ndodhi në gjithësi, është një mësim urtësie që duhet lexuar dhe kuptuar. Në fakt, çështja më e rëndësishme e devotshmërisë, është që të mund të fitohet aftësia e të lexuarit sipas urdhrit hyjnor: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka).”** (Alak, 1) Kjo përbën edhe diturinë thelbësore. Pra, të fitosh aftësinë e të lexuarit të urtësive hyjnore në çdo gjë.

Ashtu si Kurani Kerim, edhe gjithësia është ligjëratë e mrekullueshme hyjnore, e cila i drejtohet njerëzimit për ta lexuar me sytë e zemrës. Çdo thërmijë e saj, është si një zarf (letër) i urtësisë dhe së vërtetës. Detyra e një besimtari të përsosur dhe të ditur, është të hapë atë zarf dhe të lexojë mesazhin hyjnor, të fshehtat dhe urtësitë që ndodhen brenda tij dhe t'i kuptojë ato ashtu siç e meritojnë.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim, ftohemi të lexojmë mesazhet e urtësive hyjnore që ndodhen brenda në zarf. Në një nga këto ajete, urdhërohet:



“Me të vërtetë, në qiej dhe në Tokë ka shenja për ata që besojnë. Edhe në krijimin tuaj dhe të kafshëve të shpërndara nëpër Tokë, ka shenja për besimtarët e bindur. Edhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, edhe në ujin që Allahu e zbret nga qielli, duke gjallëruar nëpërmjet tij tokën e shkretuar, edhe në ndërrimin e erërave, ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Xhathije, 3-5)

Në shumë ajete të ngjashme, Allahu i Madhëruar urdhëron:

- Duke na tërhequr vëmendjen tek krijesat thotë: **“A nuk i shohin devetë?”**

- Duke na tërhequr vëmendjen në faktet gjeografike dhe atmosferike thotë: **“A nuk i shohin retë, shiun, malet dhe bimët, të cilat vdesin në dimër dhe ngjallen në pranverë?”**

- Duke na tërhequr vëmendjen tek historia thotë: **“A nuk e shohin përfundimin e popujve të shkuar?”** Dhe këtë ftesë për të shikuar dhe mësuar, Allahu Teala e përsërit në mënyrë të vazhdueshme.

NË TË VËRTETË, AJO QË LEXON, ËSHTË ZEMRA

Nuk duhet të harrohet se në fakt, është zemra ajo që do të lexojë dhe do të zbulojë urtësitë e Kuranit dhe gjithësisë. Sytë e ballit, janë si syze për sytë e zemrës, sepse syri shikon dhe vëren sipas qëllimit dhe përmbajtjes së zemrës.

Mevlana i nderuar, këtë e shpjegon kështu:



“Syte dhe shikimet tona, janë në itinerarin e zemrës. Nëse do zemra, syri sheh gjarprin, pra helmin. Por nëse do zemra, syri sheh gjërat prej të cilave do të marrë mësim. Nëse do zemra, syri sheh botën dhe mirësitë e saj (ato që ia ka ënda). Por, nëse do zemra, syri kërkon vetëm të fshehtat hyjnore... Nëse do zemra, llogaritë i bën me gishtat e dorës, nëse do, me ata gishta shkruan libra dhe vepra. Kini kujdes! Dora e shkathët, e cila i bën të gjitha këto, në fakt vepron sipas dëshirës së një dore të fshehtë (zemrës) që ndodhet brenda. Ajo dorë e fshehtë (që është qendra e ndjenjave dhe mendimit), kryen punë pozitive ose negative duke e përdorur si një mjet dorën e trupit.”

Sipas kësaj, duhet që zemrën ta përgatisim shpirtërisht që të mësohet të marrë mësim prej urtësive hyjnore.

Jusuf Hamedani -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Dhikri me zemër, është si pema me ujin. Ndërsa meditimi me zemër, është si pema me frutin. Të presësh që pema të lulëzojë dhe të japë fruta pa e ujitur, është gabim i madh. Edhe sikur të duash, ajo nuk jep kurrë fruta, sepse kjo nuk është koha për të dhënë fruta, por për të ushqyer dhe ujitur pemën. Më parë duhet të ujitet, të pastrohet nga barërat e këqija, pastaj të presë ngrohtësinë e rrezeve të diellit. Kur të jenë plotësuar këto, pema do të gjallërohet dhe do të zbukurohet me gjethe të gjelbra. Pasi pema të ketë arritur në këtë stad, atëherë mund të presim edhe frutat. Kjo pra është koha që ajo të japë frutat e saj.”

(Rutbetu'l-Hajat fq. 71)

Ashtu siç syri nuk mund të shohë asgjë nëse mungon drita, pa qenë drita e besimit dhe ndikimi shpirtëror i Kuranit



e i Sunetit, edhe syri i zemrës nuk mund të shohë asnjë të vërtetë. Ndërkohë që drita e besimit në zemra ndriçon me anë të meditim. Prandaj jemi të detyruar t'i mësojmë zemrat tona të lexojnë jetën dhe gjithësinë, duke medituuar dhe duke marrë mësim. Njerëzit e urtë kanë thënë:

“Kush e sheh këtë botë pa marrë mësim, syri i zemrës së tij verbohët aq sa është edhe niveli i pakujdesisë së tij.”

(Ibn-i Kethir, I, 448)

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Thuaj: A barazohet i verbri me atë që sheh? A s'po mendoni?” (En'am, 50)

Gjendja e mos meditim, të cilën Allahu Teala e ka përmendur duke e ngjasuar me verbërinë, është mbulimi i zemrës me perde pakujdesie. Ka shumë sy që shohin, por që zemrat i kanë të ngurtësuar dhe u janë mbyllur ndaj urtësive dhe të vërtetave. Në lidhje me këta (njerëz), në një ajet tjetër urdhërohet:

“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (Haxh, 46)

Njeriut të cilit i është verbuar syri i zemrës, të bukurën e sheh të shëmtuar dhe të shëmtuarën të bukur. Gjendja e **Ebu Xhehlit**, i cili vepronte i zhytur në errësirën e shirkut dhe injorancës, është shembulli më i mirë i kësaj të vërtete. Dhe kjo përkundër faktit që ai kishte pasur mundësinë ta shihte Profetin ﷺ, kushedi sa herë kur ishte në jetë, ndërkohë që shumë të dashuruar pas Profetit nuk e panë fytyrën e tij të bekuar. Mirëpo, ai mushrik i tërbuar, ishte zhytur në interesa

të ngushta të kësaj bote dhe për shkak të errësirës verbuese që kishte në zemër, syri i tij nuk mundi ta shohë dritën e xhenetit që qëndronte para tij. Njëlloj si mënyra e shikimit të iblisit të mallkuar ndaj Ademit عليه السلام...

Mevlana i nderuar thotë:

“Shejtani, pa baltën e Ademit (përbërjen e trupit të tij prej balte), por nuk pa lartësinë e tij. Ai vuuri re vetëm baltën që i përket kësaj bote dhe u verbua ndaj shpirtërores që i përkiste botës tjetër. Ajo që nuk dinte shejtani, ishte se njeriu ishte halifja (mëkëmbësi) i Allahut në tokë.”

“O njeri, nga kjo botë vijnë dy zëra të kundërt me njëri-tjetrin. Vallë, cilin prej këtyre dy zërave është e aftë të dëgjojë zemra jote? Një nga ata zëra është gjendja e atyre që mundohen t’i afrohen Allahut (të devotshmëve), ndërsa tjetra është gjendja e të mashtruarve (atyre që janë zhytur në gjynahe). Nëse e pranon njërin prej këtyre zërave, tjetrin nuk e dëgjon fare, sepse dikush që do diçka, është i verbër dhe i shurdhër ndaj gjërave të kundërta me atë që do.”

Dikush që në jetë e kushtëzon veten dhe vendos të shohë çdo gjë nga dritarja e nefsit (egos), ngelet gjithmonë i mbyllur në guaskën e vet dhe nuk arrin të shohë kurrë thelbin dhe të vërtetën e gjërave.

Ibn-i Ataullah Iskenderi thotë:

“Pjesa e jashtme e botës, është e bukur, ndërsa e brendshmja mësimdhënëse. Nefsi sheh pjesën e jashtme (formën), ndërsa një zemër e stolisur me ndjesi shpirtërore sheh pjesën e brendshme.”



Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme se çfarë shohim dhe si e shohim. I nderuari **Ebu Ali Ruzbari** thotë:

“...Dikush që e sheh nefsin e vet, qoftë edhe njëherë të vetme duke i dhënë më shumë vlerë se ç’e meriton, (pra ai që është peng i mendjemadhësisë dhe mburrjes), nuk mund të shohë asgjë që ndodhet në gjithësi me syrin e urtësisë për të marrë mësim.”

Kjo do të thotë, se ai që ka një ego të fryrë, epsh të pacipë dhe është tepër ambicioz, e ka të verbër syrin e zemrës. Prandaj, nëse dëshirojmë që syri i zemrës sonë të forcohet dhe drita e urtësisë sonë të shtohet, është kusht që ta edukojmë nefsin tonë me durim dhe përpjekje në rrugë të Allahut.

Në një hadith fisnik udhërohet:

“Në këtë botë, jetoni si mysafirë! Xhamitë konsiderojini si shtëpi! Zemrat tuaja mësojini me butësi (ndjesi dhe delikatesë)! Meditoni shumë (në shfaqjet e madhështisë dhe fuqisë hyjnore) dhe qani shumë (me shqetësimin që u jep mos falënderimi ashtu siç duhet për mirësitë e Allahut)! Dhe dëshirat e nefsit (epshit) tuaj të mos ju ndryshojnë!..”

(Ebu Nuajm, Hilje, I, 358)

Edhe Ebu Bekri zemërbutë ؓ, e pa Profetin ﷺ, dhe u bë shoku e miku i tij më besnik. Ai e donte aq shumë Profetin ﷺ, saqë përmallohej edhe kur ishte pranë tij. Çdo moment të jetës së tij e jetoi me një dashuri dhe besnikëri të paparë për Profetin ﷺ.

Prandaj, asgjë nuk duhet parë nga dritarja problematike e epshit, ashtu siç bëri edhe shejtani. Përkundrazi, duhet përpjekur që çdo gjë të shihet me dritën shpirtërore si shembulli i Ebu Bekrit ؓ dhe besimtarëve të përsosur...

Ashtu siç thotë edhe poeti:

“Ajo që me dashuri shihet si dritë, me urrejtje bëhet zjarr.”

TABLO MËSIMDHËNËSE

Ebu Sulejman Darani thotë:

“Kur dal nga shtëpia, kudo që më shkon syri, shoh një mirësi që më ka dhënë Allahu. Prandaj dhe (duke medituuar në të) marr mësim prej saj.” (Ibn-i Kethir, I,447)

Edhe **Sufjan bin Ujejne**, në lidhje me këtë fakt, vazhdimisht përsëriste këtë thënie:

“Nëse mendon, njeriu merr mësim nga çdo gjë.” (Ihja, IV, 764)

Çdo moment i jetës, është i mbushur me ndodhi dhe shfaqje të panumërta, të cilat mund të jenë shkak për të kujtuar dhe për të marrë mësim prej fuqisë dhe madhështisë hyjnore. Në një prej shumë ajeteve fisnike, me të cilat Allahu Teala na fton të marrim mësim prej këtyre ndodhive dhe shfaqjeve, urdhërohet:

“Është Ai që ju tregon shenjat e Tij dhe ju zbret riskun prej qiellit. Por askush nuk e kujton këtë, përveç atyre që kthehen tek Ai të penduar.” (Gafir, 13)

Qëkur është krijuar bota e deri më sot, janë shtruar sofra të panumërta hyjnore dhe vazhdojnë të shtrohen çdo moment, duke mos u neglizhuar furnizimi i asnjë krijese. Nëse mendojmë për një çast; tre të katërtat e tokës janë të mbuluara



me ujë. Ndërsa një e katërta e tokës përbëhet nga shkëmbinjtë ose shkretëtira, ku bimët nuk mund të zhvillohen. Një pjesë e vogël që mbetet është tokë e përdorshme. Mirëpo, fuqia madhështore e Allahut Teala, ka bërë që toka me anë të një lloj metamorfoze (ndryshimi i stinëve), të jetë burim ushqimi për të gjitha gjallesat.

Profeti ﷺ, ka thënë:

“Allahu Azze ue Xhle, ka urdhëruar: “Dhuro dhe unë do të dhuroj ty”. Thesaret e Allahut janë të mëdha. Asgjë prej asaj me të cilën furnizon krijesat, nuk e pakëson thesarin e Tij. Ai dhuron dhe furnizon ditë e natë pa ndërprerje. Mendo pak për ato që ka dhuruar Allahu qëkur ka krijuar qiellin dhe tokën! Ato nuk kanë pakësuar asgjë nga pasuria e Tij.” (Buhari, Tefsir 11/2, Teuhid, 22.)

Sa i mahnitshëm është fakti që, kur bie borë dhe mbulon gjithçka, shumë gjallesa strehohen në gjirin e tokës dhe qëndrojnë të gjalla e të shëndetshme për një kohë të gjatë me mbrojtjen e Krijuesit të tyre. Me mëshirën e Allahut, toka bëhet si një djep i vërtetë për ta. Prandaj dhe nuk shohim kufoma të atyre gjallesave pasi shkrin bora, sepse ato dalin përsëri mbi tokë dhe vazhdojnë jetën e tyre.

Për ata që shohin me syrin e urtësisë për të marrë mësim, edhe këto fakte mjaftojnë për të kuptuar se sa i mahnitshëm është ekuilibri dhe rregulli hyjnor i gjithësisë, në të cilën jetojmë dhe veçanërisht urtësinë, diturinë dhe fuqinë e pafundme të Allahut Teala.

Përsëri, në një ajet fisnik, Allahu Teala urdhëron:

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim!

Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”

(Ankebut, 60) Me anë të këtij ajeti, Allahu thekson se ambicia dhe shqetësimi i njeriut në lidhje me çështjen e riskut (furnizimit), është e kotë.

Hafiz Shirazi, në një poezi të vetën, e ka përkufizuar njeriun me këto fjalë:

“Një pikë gjaku, mijëra shqetësime.”

Nëse shohim me qëllim për të marrë mësim, në vitrinat hyjnore përreth nesh shohim lloje të ndryshme lulesh të cilat duken si barëra të thjeshta, por që nxjerrin prej tokës ngjyra, aroma dhe gjethe të ndryshme, të cilat mahnitin sytë dhe lodhin mendjet e shumë njerëzve të shkencës.

Ndërkohë që një kafshë e kthen barin në mish dhe në qumësht, njeriu i cili është më i përsosuri i krijesave, me të gjithë teknologjinë që ka në dispozicion sot nëpër laboratorët më të përparuar të kimisë, nuk arrin të prodhojë qoftë edhe një gram mish apo qumësht nga tonelata bari.

Nëse do të na ishte lënë në dorë për një ditë programi hyjnor i trupit të njeriut, që punon me një rregull të mahnitshëm, i ndonjë organi ose edhe i një qelize të vetme, ku zhvillohen me qindra reaksione kimike, nuk do të kishim duruar qoftë edhe disa minuta. Kushedi se sa dëme mund të shkaktonim!?

Sa e mahnitshme është kur shohim se nga një anë, një elefant dhjetëra tonësh mund të komandohet nga një fëmijë dhjetëvjeçar (nëse Allahu i jep aftësinë) dhe nga ana tjetër shohim se një virus i vogël, aq sa nuk mund të shihet me sy të zhveshur mposht trupa me fuqi të madhe!..



Kjo nënkupton se njeriu asnjëherë nuk duhet të mburret dhe nuk duhet t'ia atribuojë vetes forcën që ia ka falur Allahu Teala, nuk duhet të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive dhe për këtë gjithmonë duhet të jetojë me ndjenja mirënjohjeje dhe falënderim. Gjithashtu, duhet të kuptojë se nuk është as sa një thërmijë pluhuri përpara fuqisë hyjnore dhe se duhet të kërkojë strehim tek Krijuesi i tij, sepse edhe fryma që jep e merr, është një prej mirësive të mëdha hyjnore.

Nëse bie shtypja atmosferike, ndërsa jemi në lartësi të madhe gjatë udhëtimit me një aeroplan i cili është prodhuar me teknologjinë më të lartë, përpara nesh do bien maskat e oksigjenit dhe jepet lajmërim për përdorimin e tyre. Mirëpo, askush nuk shqetësohet se “mos vallë nesër niveli i oksigjenit ngrihet nga 21 në 25, ose bie në 18 dhe të marrë një bombol oksigjeni”. Kjo, sepse të gjithë, edhe ai që beson, edhe ai që nuk beson e vazhdon jetën e tij me një besim të natyrshëm në rregullin hyjnor... Përndryshe, nëse njeriu do të mendonte për çdo lloj rreziku me të cilin mund të përballlet çdo ditë, jeta do t'i bëhej e padurueshme.

Një njeri, i cili mendon rreth këtyre fakteve dhe të tjerave si këto ashtu siç duhet, nuk vonon të kuptojë se si të gjitha gjallesat mbi tokë kanë nevojë për ndihmën dhe mbrojtjen nga një dije dhe fuqi e madhe, qoftë edhe për të mbijetuar. Ai e kupton se të gjitha këto nuk mund të realizohen kurrë vetë dhe se jeton në botën e mrekullive hyjnore. Asnjë mendje, e cila e kupton e këtë dhe ka logjikë, intuitë dhe ndërgjegje të shëndoshë, nuk guxon t'i ngrejë krye dhe të jetë mosmirënjohës ndaj Allahut Teala, që është Krijuesi i botëve dhe Rregullatori i tyre.

TË SHOHËSH ANËN MËSIMDHËNËSE TË NGJARJEVE

Ashtu si këto shfaqje në librin e gjithësisë, njeriu duhet të lexojë me syrin e urtësisë për të marrë mësim edhe nga ngjarjet me të cilat përballlet gjatë jetës. Sepse çdo ngjarje i jep me mijëra mesazhe një njeriu, i cili zotëron një zemër të ndjeshme dhe të butë.

P.sh., kur shohim një të sëmurë, duhet të mendojmë: “Edhe unë mund të isha në atë gjendje. Ky njeri i sëmurë ka nevojë për dashamirësi, mëshirë dhe interesim nga ata që e rrethojnë. Prandaj edhe unë duhet t’i afrohem dhe të përpiqem t’ia lehtësoj vështirësitë. T’i plotësojë nevojat dhe ta ngushëllojë zemrën e tij të hidhëruar, sepse Profeti ﷺ, shpesh herë pyeste: “A keni vizituar ndonjë të sëmurë sot?” ..”

Përsëri, kur shohim ndonjë aksident rrugor, duke menduar se “në atë aksident mund të isha edhe unë ose edhe të afërmit e mi”, duhet të falënderojmë për mirësitë e jetës dhe shëndetit që zotërojmë.

Kur të shohim ndonjë jetim, ai jetim duhet të na çojë deri tek Profeti ﷺ dhe të kujtojmë se edhe ai erdhi si jetim në këtë botë dhe të mendojmë për detyrat tona ndaj tyre...

Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se ashtu si çdo mirësi, edhe vështirësitë janë pjesë e sprovave. Nëse Allahu nuk na e ka bërë të mundur një gjë, këtë duhet ta shohim me syrin e zemrës dhe duke menduar se: “Edhe në atë ka një mirësi”, e të falënderojmë për çdo gjë.

P.sh., nëse Allahu nuk na e ka bërë të mundur të kemi fëmijë, duhet të mendojmë se në këtë çështje që duket si



mallkim, ka shumë mirësi të fshehura. Ka shumë prindër, të cilët, për shkak të jetës së keqe ku janë zhytur fëmijët e tyre që merren me vrasje, imoralitet, drogë dhe të tjera si këto, përjetojnë hidhërime të jashtëzakonshme të cilat të bëjnë të harrosh gëzimin e të qenit prind. Për shkak se nuk e dimë se me çfarë surprizash është e mbushur jeta, duhet të përpiqemi që në çdo lloj gjendjeje të jemi falënderues, sepse ndonjëherë, vështirësia që jep Allahu, është e fshehur në mirësi dhe ndonjëherë mirësia është e fshehur në vështirësi.

Të mos harrojmë se gjendemi në një botë sprovash të përkohshme dhe se çështja më e rëndësishme, është të arrijmë të bëhemi robër të mirë të Allahut. Prandaj, pa ngecur në pengesat e thjeshta të jetës, duhet të ruajmë qetësinë e shpirtërore.

Skena më mësimdhënëse dhe më e rëndësishme e jetës është kur shohim ndonjë xhenaze. Njëherë e pyetën të nderuarin **Hatem-i Esamin**:

“Kur dhe si mund të bëhemi prej atyre që e shohin botën me syrin e urtësisë për të marrë mësim?”

Hatem-i Esam u përgjigj:

“Kur të shihni (kuptoni) se fundi i çdo gjëje në këtë botë është shkatërrimi dhe se toka është vendi ku do të shkojnë të gjithë! Nëse dikush nuk merr mësim nga një xhenaze, e cila del nga shtëpia e tij apo e ndonjë të afërmi, atij nuk i bëjnë dobi as dija, as urtësia dhe as këshilla.”

Prandaj dhe kur të shohim ndonjë xhenaze, të mendojmë: “Sot në atë tabut mund të isha unë” dhe të llogaritim veten për gjithçka që kemi bërë në jetë. Duhet të mendojmë se në varr

do të hyjmë vetëm me qefinin si pjesë e kësaj bote, pastaj edhe qefini edhe trupi ynë do të kthehet në origjinë (në dhe) dhe se ato që do të ngelen pas janë vetëm besimi dhe veprat tona. Gjithashtu, të kemi parasysh se trajtimi që i bëhet xhenazes që shohim, një ditë patjetër do të na bëhet edhe ne.

Sa mësimdhënëse janë këto fjalë të **Hasan Basriut**:

Kur ishte në një ceremoni varrimi, pasi mbaruan të gjitha ceremonitë, Hasan Basriu pyeti dikë që kishte pranë:

“Vallë a mendon më ky njeri që ka vdekur, të kthehet përsëri në këtë botë dhe të shtojë punët e mira, dhikrin e të kërkojë falje për gjynahet?”

Njeriu i thotë:

“Po! Sigurisht që mendon.” Pas këtyre fjalëve, Hasan Basriu thotë:

“Atëherë, po ne pse nuk mendojmë si ky njeri që ka vdekur?” (Ibnu'l-Xheuzi, Hasenul'l Basri)

Prandaj, edhe ne duhet ta kuptojmë mirë se pjesa e jetës që na ka mbetur, është një afat të cilin na e ka dhënë Allahu dhe sipas kësaj duhet ta vlerësojmë mirë atë, duke e përgatitur veten për të vërtetën e pashmangshme të vdekjes.

Shkurtimisht, që nga thërmija më e vogël e deri te trupi më i madh qiellor, i gjithë kozmosi dhe çdo gjë që ndodh në të, është një poezi e mrekullueshme e mbushur me urtësi dhe mësim për zemrat që dinë të lexojnë... Shkollimi më i rëndësishëm në këtë jetë, që është edhe vendi i provimeve hyjnore, është që të gjitha këto t'i lexojë me syrin e zemrës. Siç thotë edhe **Shejh Sadi Shirazi**:



“Në shikimin e njerëzve të mençur, çdo gjethë peme është një poezi e mrekullueshme që dëfton Allahun. Ndërkohë që për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethë.”

Allahu Teala na i ruajttë zemrat nga ngathtësia nën ndikimin e harbutërisë së nefsit tonë. Na dhëntë një zemër të ndjeshme, e cila do të mund të lexojë çdo gjë, që nga thërmijat më të vogla e deri tek trupat më të mëdhenj qiellorë, sipas urdhrit “Lexo!” të të Madhërishmit. Gjithashtu, na e bëftë të mundur të përfitojmë nga fshehtësitë dhe urtësitë e gjithësisë dhe ndodhive në të...

Amin!..



لَنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ

“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj
edhe më shumë begatitë e Mia...” (Ibrahim, 7)

Falënderimi

Çdo njeri me ndërgjegje dhe logjikë, ia ka për borxh një falënderim edhe atij që i jep qoftë edhe një gotë ujë. Dhe kur i jepet rasti, ia kthen atë mirësi me të njëjtën gjë. Nisur nga kjo, mund të themi se, qëndrimi i njeriut në mënyrë të ftohtë e të vrenjtur përballë të gjitha mirësi që i ka falur Allahu i Madhëruar, nuk është aspak e logjikshme.



Të mos harrojmë se, të gjithë ne po mbushim kasetën e jetës, e cila do të hapet për t’u shikuar në ditën e gjykimit. Dhe, kur të vdesim, do të varrosemi me veprat tona. Ndërsa në ditën e llogarisë hyjnore, sytë, veshët, lëkura dhe të gjitha organet tona do të fillojnë të flasin, duke shpalosur çdo gjë që kemi bërë në jetën e kësaj bote.

FALËNDERIMI

Ibrahim bin Ethem dhe **Shakik-i Belhi**, ishin dy miq të ngushtë për hir të Allahut. në një prej bisedave të tyre, zhvillohet një dialog shumë mësimdhënës:

Shakik-i Belhi e pyet Ibrahim bin Ethem:

“Si e siguroni jetesën?”

Ibrahim bin Ethem përgjigjet:

“Kur gjejmë falënderojmë, kur nuk gjejmë durojmë!..”

Shakik-i Belhi thotë:

“Kështu bëjnë edhe qentë e Horasanit!” Pas këtyre fjalëve, Ibrahim bin Ethem pyet:

“Po ju çfarë bëni?”

Shakik-i Belhi përgjigjet:

“Kur gjejmë, falënderojmë dhe dhurojmë. Kur nuk gjejmë bëjmë durim duke falënderuar.”

Të dashurit e Allahut, duke qenë të vetëdijshëm se sado që të falënderojnë për mirësitë e panumërta të Allahut, asnjëherë nuk është e mjaftueshme, gjithmonë janë përpjekur t'i shtojnë sa më shumë falënderimet. Gjithashtu, falënderim; do të thotë që robi të jetë i devotshëm ndaj Zotit të tij që i ka falur mirësi të panumërta, si në fjalë ashtu edhe në vepra. Pra, të jetojë me pasionin e adhurimit.



FALËNDERIMI; NJË MIRËSI QË DUHET TË FALËNDEROHET

Sado që të falënderojmë për mirësitë e pafundme të Allahut të Madhëruar, përsëri ne nuk mund ta paguajmë dot borxhin e falënderimit. Një nga të dashurit e Allahut, **Mehmed Emin Efendi**, në një letër drejtuar një prej nxënësve të vet, ndër të tjerrja shprehet:

“...Në një frymë, ka dy mirësi (njëra është mundësia për të marrë frymë dhe tjetra mundësia për ta dhënë). Për këtë arsye, për çdo frymë duhen dy falënderime. Çdo orë bëhen njëmijë frymëmarrje dhe, shumëzuar për dy falënderime, në një njëzetekatër orë, duhen bërë dyzetetetë mijë falënderime. Nëse njeriu i lë të gjitha punë dhe mundohet vazhdimisht të falënderojë Allahun, duke thënë; «falemi-nderit, faleminderit...», ai përsëri nuk mund t’ia japë hakun falënderimit. Madje, ai nuk mund të plotësojë asnjë një në njëmijë prej falënderimit ndaj Allahut.”

Sipas një transmetimi, Musai عليه السلام, i drejtohet Allahut duke i thënë:

“O Zot! Falënderimi im ndaj Teje, është një mirësi më vete që më ke dhënë. Por edhe kjo kërkon falënderim të veçantë. (Atëherë si mund të të falënderoj ashtu siç e meriton?)”

Allahu i Madhëruar, i shpall Musait عليه السلام, këto fjalë:

“Kur ti e pranon se çdo mirësi është prej Meje, atëherë edhe Unë këtë pranim do ta konsideroj si falënderim.” (Ihja, IV, 163)

Përveç pranimi se të gjitha mirësitë janë prej Allahut, të tregosh edhe delikatesën e falënderimit të atyre që u bën shkak që ato mirësi të vijnë tek ne, është një kusht i rëndësishëm i

falënderimit të Allahut. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush nuk i falënderon njerëzit, nuk e ka falënderuar as Allahun.” (Ebu Daud, Edeb, 11/4811; Tirmidhi, Birr, 31)

Falënderimi, është pasqyra e njerëzimit. Falënderimi ndaj njerëzve, aq sa është një çështje edukate dhe morali, është edhe një çështje trajnimi të kalimit nga metaforikja, tek e vërteta. Kjo, sepse falënderimi i njerëzve me kusht që të mos harrohet Krijuesi, në fund të fundit përsëri është një kthim tek Allahu.

Një robi shumë falënderues, nuk i mjafton të njohë vetëm dobinë e mirësive. Falënderim, është të njohësh pronarin e vërtetë të mirësive dhe ta adhurosh Atë. Pra, mirësitë duhet ta zgjerojnë horizontin e meditimit dhe të çojnë drejt Allahut. Për rrjedhojë, edhe zemrat, edhe dashuria orientohet drejt njohjes së Allahut.

Nëse ne e harrojmë personin që na ka dërguar një dhuratë të çmuar dhe mjaftohemi vetëm me falënderimin e personit që na e sjell atë, kjo është shumë e çuditshme dhe e gabuar. Në të njëjtën mënyrë, nëse ne e harrojmë Furnizuesin e vërtetë të mirësive që kemi, duke u përqendruar vetëm tek shkaqet që i kanë sjellë ato mirësi, apo tek vet mirësia, kjo tregon një mosmirënjohje shumë të madhe. Për njeriun, nuk mund të imagjinohet turp dhe humbje më e madhe se sa të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive, pra të harrojë Allahun.

PJESËT E FALËNDERIMIT

Një falënderim i pranuar, nuk është një falënderim i shprehur vetëm me fjalë. Një falënderim i vërtetë, përbëhet nga tre



elemente të lidhur me njëri-tjetrin. Këto janë; **dija**, **gjendja** (ndjenja) dhe **vepra**.

- **Dija**; Të jesh i vetëdijshëm se të gjitha mirësitë vijnë prej Allahut.

- **Gjendja** (ndjenja); të ndjesh respekt, dashuri dhe mirënjohje ndaj pronarit të vërtetë të mirësive.

- **Vepra**; të jetosh në përputhje me këto ndjenja, duke e shprehur falënderimin me fjalë dhe me vepra. Gjithashtu, edhe mirësitë duhet t'i përdorësh në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe të ruhesh nga mos bindja ndaj Tij.

Kur i nderuari **Xhunejd Bagdadi** ishte shtatë vjeç, daja i tij, **Serijj-i Sakati**, e merr me vete në haxh. Në një prej bisedave që u zhvillua në Qabe, u fol për falënderimin. Pasi të gjithë të diturit shprehën mendimin e tyre, Serijj-i Sakati, u kthye nga Xhunejdi i vogël dhe i kërkoi që edhe ai të fliste. Xhunejdi, pasi u mendua pak, u shpreh në këtë mënyrë:

*“Falënderim, është të mos tregohesh i pabindur me atë mirësi që të ka falur Allahu dhe të mos e përdorësh atë mirësi vetëm për këtë botë.”*⁴⁴

Pra, edhe përdorimi i mirësive që ka dhuruar Allahu, në përputhje me kënaqësinë e Tij, është një nga elementet plotësuese të falënderimit. Pra, edhe falënderimi i gjuhës është i nevojshëm, por nuk është i pranueshëm. Falënderimi, duhet të provohet me vepra të mira dhe largim nga gjynahet.

Përveç kësaj, është edhe falënderimi për çdo organ të trupit që na ka falur Allahu. Dhe kjo, bëhet duke i përdorur ato në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe duke i ruajtur nga haramet dhe të dyshuarat.

Lidhur me këtë çështje, **Bishr-i Hafi**, shprehet:

“Falënderimi i atij që falënderon vetëm me organin e gjuhës, është i pakët, sepse falënderimi i syrit, është që kur të shohë diçka të mirë ta marrë, e kur të shohë një të keqe, të mbyllet. Falënderimi i veshit, është që kur të dëgjojë një të mirë, ta mësojë përmendësh, e kur ta dëgjojë një të keqe, ta harrojë atë. Falënderimi i duarve, është që me to të mos kapë asgjë që nuk është e drejta e tyre. Falënderimi i stomakut, është të ushqehet me hallall. Falënderimi i mendjes dhe i zemrës, është të jenë të mbushura me dije dhe urtësi. Ndërsa falënderimi i këmbëve, është të mos shkojnë askund tjetër përveçse në të mirë. Kush vepron kështu, bëhet me të vërtetë prej falënderuesve.”

Të mos harrojmë se, të gjithë ne po mbushim një kasetë jete, e cila do të hapet e do të shihet në ditën e gjykimit. Në ditën e llogarisë hyjnore, sytë, veshët, lëkura dhe të gjitha organet tona do të fillojnë të flasin, duke shpalosur çdo gjë që kemi bërë në jetën e kësaj bote. Këtë, e vërteton edhe Kurani Fisnik, kur shprehet:

“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.”

(Fussilet, 20)

Atëherë, duhet menduar se, sa shfaqje të fuqisë hyjnore kemi parë me sytë tanë dhe kemi falënderuar; dhe, sa pamje të shëmtuara kemi parë e jemi bërë gjynahqarë? Sa e kemi dëgjuar me veshët tanë shpalljen hyjnore, sunetin, zërin e së drejtës dhe të mirës; dhe, sa gjëra të padobishme kemi dëgjuar, duke e çuar dëm këtë mirësi? Ku e kemi shpenzuar energjinë e trupit tonë? A ia kemi kushtuar atë mirësive brenda kufijve hyjnorë, apo mos ndoshta jemi zhytur në haramë dhe punë të



këqija? Ja pra, nuk duhet harruar kurrë se, nesër, në ekranin hyjnor do të shohim skenarin e jetës sonë.

GJYSMA E FESË...

Profeti ﷺ, ka thënë:

“Besimi ndahet në dy pjesë. Gjysma është tek durimi, e gjysma tjetër tek falënderimi!” (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, fq. 127)

Durim, do të thotë të mos e prishësh ekuilibrin përballë kushteve të ndryshueshme të jetës, të jesh i qëndrueshëm ndaj fatkeqësive që të bien, pa u ankuar dhe ta detyrosh veten (egon) të kryejë detyrat e devotshmërisë dhe të ruhet nga haramet.

Ndërsa **falënderim**, do të thotë t'i drejtohesh Allahut me të gjitha shfaqjet e devotshmërisë, të cilat janë shprehje e mirënjohjes ndaj Tij, për mirësitë e panumërta që ka dhuruar.

Abudallah Ensari, rëndësinë e falënderimit në Islam, e ka shprehur me këto fjalë:

“Falënderim; është emri i njohjes së mirësisë, sepse falënderimi, të çon në njohjen e dhënësit të mirësisë. Për rrjedhojë, në Kuranin Fisnik, Islamit dhe besimit, i është dhënë emri «shukr/falënderim».”

Të njohësh Allahun si pronarin e vërtet të mirësive, do të thotë falënderim. Ndërsa e kundërta e kësaj, është mohimi. Pra, të mohosh që të gjitha mirësitë vijnë prej Allahut. Pra, e kundërta e falënderimit të mirësisë, është mohimi i saj, gjë e cila është shkak i humbjes së përjetshme.

Për rrjedhojë, në ajetet ku zhvillohet biseda midis Allahut dhe Iblisit, shihet qartë se sa i rëndësishëm është falënderimi në fenë tonë të lartë:

Kur Iblisi nuk iu bind urdhrit të Allahut dhe u dëbua nga prezenca hyjnore, kërkoi që Allahu t'i jepte afat. Dhe, atij iu dha afat deri në ditën e kijametit -si një urtësi e sprovës që do të kalojë njeriu në këtë botë-. Atëherë, Iblisi, i tha kështu Allahut të Madhëruar:

“...Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë!” (A’raf, 16)

Disa prej komentuesve të Kuranit, janë shprehur se kup-timi i shprehjes; **“në rrugën Tënde të drejtë”**, është **“rruga e falënderimit”**. Kjo, sepse siç kuptohet edhe nga ajeti vijues, në sajë të devijimit dhe tundimeve që do të bëjë, shejtani shprehet:

“...Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk do të jenë mirënjohës!” (A’raf, 17)⁴⁵

Caku përfundimtar ku shejtani dëshiron ta tërheqë nje-riun, është mosbesimi, pra mohimi. Nga kjo, kuptohet se, të jesh vazhdimisht në falënderim të Allahut, të pranosh se të gjitha mirësitë janë dhuratë e Tij dhe të njohësh dobritë e atyre mirësive që ka falur Ai, duke i përdorur në rrugën e drejtë për të kënaqur Allahun, është një shfaqje devotshmërie, e cila e trondit shumë shejtanin.

Falënderimi nuk ka ndonjë kufi të caktuar. Profetët dhe të urtët, që janë edhe të dashurit e Allahut, kanë treguar devotshmëri të pashoqe. Por, megjithatë ata gjithmonë kanë qenë të shqetësuar, se mos nuk kanë falënderuar ashtu siç i takon madhësisë së Allahut.

Për rrjedhojë, Profeti ﷺ, falte namaz nate derisa i ënjte-shin këmbët dhe për shkak të të qarës, i lageshin rrobat dhe vendi ku bënte sexhde. Kur iu tha:

45. shih. Ihja, IV, 153.

“O Resulullahu! Përse e lodhni veten kaq shumë, ndër-kohë që ju janë falur të gjitha gabimet e të shkuarës dhe të ardhmes?” Ai u përgjigj:

“A të mos bëhemi një rob që e falënderon shumë Allahun?..”⁴⁶

NA BËJ PREJ TË PAKTËVE!..

Njëherë, **Omeri** ﷺ, rastisi një besimtar, i cili lutej vazhdimisht:

“O Allah! Më bëj prej të paktëve!”

Omeri ﷺ, nuk arriti ta kuptonte se çfarë donte të thoshte ai person me këtë lutje. Prandaj e pyeti:

“Përse lutesh kështu?” Besimtari iu përgjigj:

“Allahu i Madhëruar, urdhëron: «**...Pak nga robërit e Mi, janë falënderues!**»⁴⁷ Për këtë arsye, edhe unë dëshiroj të bëhem prej asaj pakice fatlume.”

Omeri ﷺ, i cili u mahnit prej këtij mendimi të bukur, tha me keqardhje:

“Turp për mua. Të gjithë janë më të zgjuar dhe më ditur se Omeri!” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 81)

Ky është ai Omer ﷺ, në kohën e udhëheqjes së të cilit janë çliruar shumë vende, janë futur në Bejtu'l Mal⁴⁸ thesaret e Bizantit dhe Persisë dhe kur mirëqenia e popullit është ngritur si asnjëherë deri atëherë. Mirëpo, ky Omer ﷺ, ashtu siç ka qenë e detyruar edhe më parë, mjaftohej me një pagë shumë të vogël dhe mbante hytbe me rroba të arnuara. Madje, të

46. shih. Ibn-i Hibban, II, 386.

47. Sebe', 13.

48. Bejtu'l-Mal: Thesari i shtetit

afermit e tij, të cilët nuk mund ta duronin këtë gjendje të tij, me anë të vajzës ë tij Hafsës ة, i shprehën dëshirën që ai ta shtonte disi sasinë e mundësive dhe të jetonte pak më rehat. Mirëpo, ai, u përgjigj:

*“Dy miqtë (Profeti -a.s.- dhe Ebu Bekri -r.a.-) dhe unë, ngajmë me tre udhëtarë që bëjnë të njëjtën rrugë. I pari prej nesh, arriti në vendin e tij. Po ashtu edhe i dyti prej nesh shkoi nga e njëjta udhë dhe u takua me të parin. Si i treti që jam, edhe unë dëshiroj të takohem me shokët e mi. Nëse shkoj me shumë ngarkesë, nuk mund t’i arrijë ata! Apo mos nuk dëshironi që unë të jemi i treti në këtë udhë?”*⁴⁹

Po ashtu, edhe një prej sahabëve të pasur, **Abdurrahman bin Auf** ة, i cili e falënderonte shumë Allahun, një ditë kur ishte agjërueshëm, iu vunë përpara disa lloje ushqimesh, që të hapte iftarin. Mirëpo, ky sahabi i bekuar, u ngrit nga sofa me lot në sy dhe tha:

“Mus’ab bin Umejri ra shehid (dëshmor) në Uhud. Ai ishte më i mirë se unë. Mirëpo, edhe për qefin nuk kishte gjë tjetër përveç një trikoje. Por edhe me të, nëse i mbuloje kokën, i ngeleshin këmbët jashtë. E, nëse i mbuloje këmbët, i ngelej koka jashtë. Ndërsa tani, neve në është dhënë çdo gjë si pasuri e kësaj bote. Në të vërtetë, kam frikë se shpërblimi i mirësive tona, na është dhënë në këtë botë. (Vallë a mos na pakësohet shpërblimi i mirësive në botën tjetër?)” (Buhari, Xhenaiz, 27)

Siç shihet, nga frika se mos nuk e plotësonin dot detyrën falënderimit, ata edhe mirësitë që i kishin hallall i përdornin me kujdes. Po ashtu, ata e konsideronin të mjaftueshme edhe sasinë më të vogël të një mirësie, me qëllim që ta jepnin më lehtë llogarinë e saj para Allahut.

49. Shih. Ahmed, Zuhd, fq. 125. Shebenderzade Ahmed Hilmi, Tarih-i Islam, I, 376.

Ndërsa ata që janë të privuar nga këto ndjenja, në përgjithësi janë të pavëmendshëm ndaj këtyre mirësive të Allahut. Pa u menduar fare se a do të mund ta kryejnë siç duhet falënderimin, ata vazhdojnë të kërkojnë me lakmi të gjitha mirësitë e kësaj bote. Dhe për këtë arsye, robërit që janë me të vërtetë falënderues, janë shumë të pakët.

MORALI ISLAM

Çdo njeri me ndërgjegje dhe logjikë, ia ka për borxh një falënderim edhe atij që i jep qoftë edhe një gotë ujë. Dhe kur i jepet rasti, ia kthen atë mirësi me të njëjtën gjë. Nisur nga kjo, mund të themi se, qëndrimi i njeriut në mënyrë të ftohtë e të vrenjtur përballë të gjitha mirësi që i ka falur Allahu i Madhëruar, nuk është aspak e logjikshme.

Nga ana tjetër, për njeriun, kapitali i të cilit është “asgjëja”, është e pamundur t’ia kthejë Allahut me të njëjtën të mirë që Ai i ka falur. Megjithatë, Allahu i Madhëruar, në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Tij të pafundme, na shpërblen për çdo punë të mirë -sipas qëllimit dhe sinqeritetit-, nga dhjetë deri në shtatëqind fish. Kjo, është si domosdoshmëri e Cilësisë së Tij “esh-Shekur”⁵⁰. Në ajetet fisnike, urdhërohet:

وَاللَّهُ شَكُورٌ حَلِيمٌ “...Allahu është Mirënjohës dhe nuk
nxiton në dënime!” (Tegabun, 17)

فَإِنَّ اللَّهَ شَاكِرٌ عَلِيمٌ “...Padyshim Allahu është Falënderues
dhe i Gjithëdijshëm.” (Bekare, 158)

50. esh-Shekur: Mirënjohës. Pra është Ai që të falënderon për atë të mirë që veproje dhe për këtë të shpërblen shumëfish në këtë botë dhe në botën tjetrën.

Allahu i Madhëruar, i pranon veprat e mira të robërve të Tij, falënderimet, durimin, mirënjohjen, singëritetin dhe jetën që bëjnë me devotshmëri dhe, duke ua shpërblyer me shumëfish, shfaq emrin/cilësinë e Tij,” esh-Shekur”. Ja pra, tregimi i mirënjohjes dhe falënderimit për përfituar prej këtij morali, është një horizont shpirtëror i veçantë për besimtarët e përsosur.

Në ajetin Kuranor, lidhur me **Nuhun** عليه السلام, urdhërohet:

إِنَّهُ كَانَ عَبْدًا شَكُورًا “...Ai ka qenë vërtet një rob mir - njohës!” (Isra, 3)

Nuhu عليه السلام, e falënderonte gjithmonë Allahun, në çdo veprim që bënte, që prej ngrënies e pirjes, e deri tek veshja. Kur vishej, hante apo pinte, thoshte “**bismilah**”; kur mbaronte së ngrëni apo kur zhvishej, thoshte “**elhamdulilah**”. Për këtë arsye, Allahu e quajti atë, عَبْدًا شَكُورًا, pra, “rob mirënjohës e falënderues”. Dhe, për të nxitur falënderimin edhe tek njerëzit e tjerë, e bëri këtë vepër të tij, shembull për gjithë njerëzimin.⁵¹

FALËNDERIM NË ÇDO SITUATË!..

Arritja e kënaqësisë së Allahut, kërkon të kënaqësinë me caktimin e Tij dhe ta falënderosh Atë, jo vetëm në kamje, por edhe në skamje. Pra, falënderimi, është një virtutet i palëkundshëm i zemrës së besimtarit, edhe nëse ndryshojnë kushtet e jetës.

Lidhur me këtë çështje, gjendja e **Ejjubit** عليه السلام, është një shembull shumë mësimdhënës:

Gruaja e tij Rahime, një ditë i thotë Ejjubit عليه السلام:

51. shih. Ibn-i Hanbel, ez-Zuhd, fq. 50.

“Ti je profet! Sikur t’i kërkoje Allahut shërim e t’i hiqte këto vuajtje!”

Pasi dëgjoi këto fjalë, Ejjubi عليه السلام, i drejtohet të shoqes dhe i thotë:

“O Rahime! Zoti im më ka dhënë tetëdhjetë vite shëndet. Ndërsa koha e sëmundjes sime, nuk është bërë ende tetëdhjetë vite. Vetëm disa vite kam që vuaj. Prandaj, kam turp t’i kërkojë Allahut shëndet.”

Ejjubi عليه السلام, nga turpi që ndjente për shkak se nuk e kishte plotësuar falënderimin për pjesën e jetës që kishte kaluar në shëndet, ngurronte të kërkonte shërim prej Zotit. Dhe, si shpërblim i falënderimit dhe durimit të tij, Allahu i Madhëruar, i Cili është “**Shekur**”, pra, i Cili shpërblen me shumëfish më tepër, i fali Ejjubit عليه السلام, edhe më shumë shëndet, begati dhe rehati se ç’kishte më parë.

Sa bukur e shpreh edhe ky shembull, falënderimin që tregonin njerëzit e devotshëm:

Gruan e devotshme, **Rabian** -Allahu qoftë i kënaqur prej saj-, e pyetën:

“Kur kënaqet Allahu nga robi i Tij?” Ajo u përgjigj:

“Kur robi falënderon sikur është në mirësi, edhe kur gjendet në vuajtje dhe vështirësi...”

Besimtarët e devotshëm, e dinë mirë se falënderimi nuk është një adhurim që bëhet vetëm në kohë të rehatisë. Sado fatkeqësi të mëdha t’u bien, tek ata, falënderimi ndaj Allahut, është bërë pjesë e karakterit të tyre. Për këtë arsye, në vend që të ankohen prej vështirësive me të cilat përballen si domosdoshmëri e sprovave hyjnore, ata shfaqin virtytin e falënderimit ndaj Allahut, i Cili i ka ruajtur nga fatkeqësi edhe më të mëdha se ato.

MIRËSIA E VËRTETË...

Në Kuran, urdhërohet:

“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke Mu bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!”

(Bekare, 152)

“...«Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë!»”

(Ibrahim, 7)

Falënderimi, është shkak i begatimit të mirësive. Ndërsa mos falënderimi, është mohim i mirësisë, mosmirënjohje dhe shkak i humbjes së begatisë e mirësisë. Po ashtu, mos falënderimi shkakton edhe zemërimin e Allahut. Lidhur me këtë çështje, Fudajl bin Ijad –rahmetullahi alejh-, ka thënë:

“Vazhdoni të falënderoni, sepse mirësia që të ikën njëherë prej duarsh, rrallë mund të kthehet përsëri.” (Ihja, IV, 232)

Ndërsa gjendja e dashuruarve pas Allahut në çështjen e falënderimit, nuk ka të bëjë fare me shtimin apo pakësimin e mirësive. Për ta, e rëndësishme është të shtojnë afërsinë me Allahun, duke falënderuar për ato mirësi.

Lidhur me këtë fakt, Mevlana shprehet:

“Të falënderosh për mirësinë, është më e kënaqshme se vet mirësia. Ai që e dashuron falënderimin, a mund ta lërë atë dhe të anojë nga mirësia?.. Në derën e mikut tënd, të çon vetëm falënderimi. Mirësia, përveçse të zgjon, mund të të vërë edhe në gjumë. Ndërsa falënderimi të mban gjithmonë të zgjuar. Mblidhe mendjen dhe me anë të mirësisë së falënderimit, gjuaj mirësinë e vërtetë!”



PËRMBLEDHJE

Edhe sikur të gjithë njerëzit të na i falin pasuritë e tyre, në fund të fundit, këto janë përfitime që mund të përdoren vetëm brenda afatit të jetës. Vdekja do të na i marrë të gjitha dhe pasuria e kësaj bote, do të ngelet po në këtë botë. Ndërsa mirësia e besimit që na ka falur Allahu, do të na çojë në një lumturi të pafundme. Për këtë arsye, detyra jonë më e rëndësishme, është të mund ta falënderojmë dhe t'i jemi mirënjohës Allahut për mirësinë e besimit që na ka falur. Ndërsa çështja jonë më e rëndësishme, është të mund të arrijmë në prezencën hyjnore duke u përpjekur të falënderojmë vazhdimisht dhe me një zemër të pastër.

Duhet të mendojmë vazhdimisht, se kemi ardhur në jetë si njerëz, si besimtarë dhe si populli (umeti) i Muhamedit ﷺ dhe i Kuranit, vetëm si mirësi e Allahut dhe pa paguar asgjë. Të gjitha këto, janë mirësi për të cilat ne jemi të dobët të falënderojmë siç duhet. Në shumicën e mirësive materiale kemi shumë të përbashkëta me kafshët dhe dallimi nga ato është shumë i vogël. Mirësitë e vërteta të cilat na ndajnë nga kafshët dhe na ngrenë në superioritetin njerëzor, janë pikërisht këto mirësi shpirtërore. Mirëpo, sa jemi duke falënderuar për këto mirësi? Sa gëzohemi ne me një mirësi të kësaj bote! Por, sa mirënjohës dhe falënderues jemi për mirësinë e besimit dhe përkatësisë sonë si umeti i Muhamedit ﷺ, të cilat do të na çojnë drejt lumturisë së pafundme?

Mevlana, thotë:

“Kur arrin mirësitë dhe begatitë e Allahu, falënderoje Atë; edhe personin prej të cilit sheh mirësi, falënderoje dhe kujtoje! Ja pra, pikërisht për këtë arsye Allahu i Madhëruar, ka urdhëruar; «Bëni salavate për Profetin!»,

sepse Muhamedi ﷺ, është një qenie e veçantë dhe e pashoqe, të cilin e marrin shembull të gjithë besimtarët!”

O Zot! Na e bëj të mundur të falënderojmë gjithmonë për mirësinë e nderit që na ke dhënë duke na bërë umetin e të dashurit tonë Muhamedit ﷺ! Shtoji mirësitë e Tua ndaj nesh dhe falënderimin tonë ndaj Teje! Na ngri në pozitën e njerëzve që janë falënderues të vërtetë, duke i frymëzuar zemrat tona me mirësinë e falënderimit!

Amin!..





Të jetosh me pasionin e adhurimit

I nderuari Bishr-i Hafi, e llogariste veten në këtë mënyrë:
“E si mund të fle unë, kur Resulullahu ﷺ, kryente adhurime natën derisa i ënjteshin këmbët edhe pse i ishin falur gabimet e të shkuarës dhe të ardhmes!? Unë nuk e di a më është falur qoftë edhe një gjynah i imi!..”



Jeta, është një mirësi e kufizuar, e cila na është dhuruar për të fituar lumturinë e botës tjetër. Ajo as nuk përsëritet dhe as nuk kompensohet... Nuk duhet harruar se, të qenit mysliman, nuk është një ceremoni që zhvillohet në kohë të caktuara, por një jetesë e devotshme për gjatë gjithë jetës. Lum ata që e kalojnë gjithë jetën si një Ramazan i vazhdueshëm dhe e përjetojnë frymën e fundit si një mëngjes Bajrami...

TË JETOSH ME PASIONIN E ADHURIMIT

Allahu i Madhëruar, ditët e bekuara dhe, veçanërisht Ramazanin e bekuar, na i ka dhuruar si mundësi të veçanta, me qëllim që ne të rishikojmë jetën tonë në aspektin e devotshmërisë, për të plotësuar mangësitë tona dhe për të shtuar punët e mira. Dhe, nëse ne i kalojmë këto ditë të veçanta duke agjëruar, duke lexuar Kuran, e duke bërë vepra të mira; ndërsa netët i kalojmë duke falur namaz, duke medituar, duke bërë dhikër, duke u lutur dhe kërkuar falje, Ai na ka premtuar shpërblime të mëdha.

Në fakt, nxitjet hyjnore që janë bërë për këto kohë të veçanta, formojnë themelin e një jete të mbushur me adhurime të pranuar, të cilën Allahu na ka urdhëruar ta jetojmë sa të kemi jetën. Ky, është një edukim shpirtëror, i cili na e bën të mundur ta shpërndajmë përgjatë gjithë vitit, atë pasion për adhurimin dhe ëmbëlsinë e devotshmërisë të fituar në këto kohë të bekuara.

FRYTET E ADHURIMIT

Atmosfera e dendur e adhurimeve ku njeriu futet gjatë ramazanit të bekuar dhe pjekuria e veçantë e devotshmërisë, është si një farë që mbillet. Dhe, në muajt e tjerë të vitit,



do të shihet se a ka zënë apo jo kjo farë, duke çelur filiza, duke lëshuar gjethe, lule dhe fruta. Pra, vazhdimi edhe jashtë Ramazanit i atyre virtyteve të mira dhe asaj pjekurie shpirtërore që kemi fituar gjatë tij, janë tregues të pranimit të atyre adhurimeve nga ana e Allahut t Madhëruar.

Nisur nga kjo, për të kuptuar se a janë pranuar apo jo agjërimet që kemi mbajtur, teravitë që kemi falur, Kurani që kemi lexuar dhe sadakatë e zekatet që kemi dhënë, duhet të shohim me kujdes ndikimin që kanë reflektuar ato në gjendjen tonë shpirtërore pas Ramazanit.

Agjërimet dhe sadakatë, duhet të na bëjnë më të devotshëm, më të mëshirshëm, më të butë e të ndërgjegjshëm. Por, nëse këto ndjenja nuk janë zhvilluar mjaftueshëm në zemrat tona dhe shpirti ynë nuk është zbutur, do të thotë se agjërimin nuk e kemi mbajtur ashtu siç duhet, sadakanë nuk e kemi dhënë në mënyrën e duhur dhe nga adhurimet nuk e kemi marrë mësimin që duhej të merrnim.

Një **namaz** i pranuar, e pengon njeriun nga të këqijat. Nëse dëshirojmë të kuptojmë se a na janë pranuar pesë namazet farz dhe ato namaze nafile (vullnetare), që i falim si shtesë, mjafton të shohim sa larg prej gjynaheve jemi në jetën tonë të përditshme.

Ata që arrijnë ta përmendin ashtu siç duhet Allahun e Madhëruar, nuk mund t'i cenojnë tundimet e egos dhe të shejtanit. Kjo, sepse përmendja (dhikri) e Allahut, e mbron njeriun nga këta dy armi, si një kala shumë e fortë. Në Kuran, bëhet e qartë se shejtani, duke nxitur egon njerëzore, e tërheq atë (njeriun) në indiferencë dhe bëhet ortak në pasurinë dhe fëmijët e tij.⁵² Atëherë, për të kuptuar se sa jemi të mbrojtur

52. shih. Isra, 64.

prej tundimeve të egos dhe shejtanit, duhet të rishikojmë vazhdimisht sjelljet dhe veprimet tona, marrëdhëniet njerëzore, jetën tonë familjare, edukimin që u japim fëmijëve tanë, jetën tonë ekonomike etj. Pra, neve na duhet të shohim, nëse egoja apo shejtani kanë apo jo pjesë në këto çështje.

FRYMËZIMI SHPIRTËROR I MËNGJESEVE...

Gjithashtu, gjatë gjithë Ramazanit të bekuar, në sajë të syfyreëve, bëjmë edhe një lloj trajnimi për të marrë frymëzim shpirtëror në kohën para agimit. Këto kohë të vyera, të cilat janë shkak i veçantë i afrimit me Zotin, kur derdhen lot dashurie dhe frike ndaj Allahut të Madhëruar, kur pranohen faljet dhe shtohet pjekuria shpirtërore, duhen gjallëruar me namaze, dhikër, kërkim faljeje dhe dua edhe gjatë netëve pas Ramazanit.

Gjallërimi i kohëve para agimit, janë një ëmbëlsi shpirtërore me të cilën nuk kanë të ngopur në namazet e tyre, miqtë e Allahut dhe besimtarët e devotshëm, të cilët i kanë zemrat të mbushura me pasionin e adhurimeve. Një nga shembujt më të bukur të këtij fakti, është edhe gjendja e **Shejh Sejjeddinit**:

I nderuari Shej Sejjeddini, është nipi i **Imam Rabanit**. Gjatë disa netëve, ai e lexonte të gjithë Kuranin në dy rekate namaz dhe me dëshirën që kënaqësia që ndiente nga qëndrimi me Zotin, të mos mbaronte, lutej duke thënë:

“O Allah! Nuk kam të ngopur. Sa të shkurtra janë netët!..”

Po ashtu, edhe **Ali Masisi** -rahmetullahi alejh-, nga fundi i jetës, ka thënë:

“Gjëja e vetme që më ka mërzitur që prej dyzet vjetësh, është ekzistenca e mëngjesit.” Kjo, sepse edhe ai ishte një



prej fatlumëve që gdhiej i pangopur nga ëmbëlsia shpirtërore e kohëve para agimit.

Po ashtu, edhe ky shembull që pasqyron përpjekjen e adhurimit të një prej miqve të Allahut, **Bishr-i Hafi**, është shumë domethënëse:

Dikush erdhi tek Bishr-i Hafi dhe i tha:

“Pushoni pak gjatë natës!” Ndërsa ai iu përgjigj:

“E si mund të fle unë, kur Resulullahu ﷺ, kryente adhurime natën derisa i ënjteshin këmbët edhe pse i ishin falur gabimet e të shkuarës dhe të ardhmes!? Unë nuk e di a më është falur qoftë edhe një gjynah i imi!..”

Ja pra këta janë miqtë e Allahut, të cilët janë edhe trashëgimtarët e Resulullahut ﷺ. Me dëshirën për të qenë robër që falënderojnë shumë, ata kryenin adhurime me pasion të madh deri në agim, me vetëdijen për të ngjarë sa më shumë me Profetin ﷺ.

Profeti ﷺ, nuk e ka neglizhuar asnjëherë namazin e natës, qoftë edhe gjatë kohëve të vështira dhe udhëtimeve. Përkundrazi, ai e ka vazhduar atë me një kujdes shumë të veçantë. Si umeti i Muhamedit ﷺ, neve na duhet të tregojmë kujdes për namazet e natës edhe pas muajit të Ramazanit. Kjo, do të jetë shprehja më e bukur e dashurisë ndaj Resulullahut ﷺ, i cili ka thënë: *“Njeriu është bashkë me atë që do!”*

(Buhari, Edeb, 96)

Shkurtimisht, Ramazani i bekuar, e përgatit robin për moral të bukur, vepra të mira dhe një jetë plot virtyte të larta. Prova që tregon se me të vërtetë kemi përfituar prej Ramazanit, është se jeta jonë pas Ramazanit, është edhe më afër kënaqësisë hyjnore se para Ramazanit.

NË ADHURIM NUK KA DEMBELIZËM!..

Nuk duhet harruar se, të qenit mysliman, nuk është një ceremoni që zhvillohet në kohë të caktuara, por një jetesë e devotshme për gjatë gjithë jetës. Pas Ramazanit të bekuar, nuk duhet të kaplohem nga dembelizmi në lidhje me adhurimet. Virtytet e larta dhe kujtimet shpirtërore që kemi fituar në atë muaj, nuk duhen harruar, ndërsa qëllimet dhe veprat e mira e të singerta, nuk duhen braktisur. Pra, duke e ruajtur shpirtin e Ramazanit, duhet të arrijmë në Ramazanin tjetër me të njëjtin frymëzim shpirtëror. Në këtë mënyrë, të gjithë jetën duhet ta kalojmë me shpirtin e Ramazanit.

Në fakt, edhe agjërimi i pëlqyeshëm i gjashtë ditëve të muajit Sheual, menjëherë pas Bajramit të Ramazanit, nga një anë shërben për rikthimin e trupit gradualisht në gjendjen normale, nga ana tjetër është një nxitje për të vazhduar shpirtin e Ramazanit me adhurime vullnetare. Këtë funksion kanë edhe agjërimet e ditëve të hëna e të enjte dhe të ditëve trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë të muajit hënor.

Po ashtu, nuk duhet harruar se, mëshira hyjnore, shfaqet në mënyrë të vazhdueshme. E rëndësishme, është të jesh gjithmonë në kërkim të shkaqeve që do të shpien drejt asaj mëshire. Po në këtë kuptim, përkrah vazhdimin të agjëtimeve vullnetare (nafile), duhen mbajtur gjallë edhe ndjenjat e mëshirës në zemra, duke i fituar zemrën të varfërve me entuziazmin e dhurimit dhe sadakasë. Kujdesi ndaj të vetmuarve, jetimëve dhe nevojtarëve me sadaka, zekat dhe bamirësi të ndryshme, lehtësimi i vuajtjeve të sëmurëve me anë të vizitave, pjesëmarrja në xhenaze⁵³, shqetësimi me hallet e umetit Islam dhe shërbimet e sakrificat në rrugë të Allahut, janë gjithmonë vepra të mira, të cilat e tërheqin mëshirën hyjnore.

53. Xhenaze: Ceremoni varrimi.



Profeti ﷺ, i pyeste vazhdimisht shokët e tij:

“A ia keni përkëdhelur kokën ndonjë jetimi sot? A keni vizituar ndonjë të sëmurë? A keni marrë pjesë në ndonjë xhenaze?...”⁵⁴

Përkrah adhurimeve të tilla shoqërore, duhet që vazhdimisht të jemi me abdes për të ruajtur shpirtin e adhurimit. Madje, edhe nëse nuk e kemi të domosdoshme, është mirë ta rinovojmë abdesin për çdo namaz, sepse kjo konsiderohet “dritë mbi dritë” dhe bëhet shkak i kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut të Madhëruar.

Edhe Profeti ﷺ, e rinovonte gjithmonë abdesin deri në ditën kur u çlirua Meka. Ndërsa atë ditë, i fali të gjitha namazet me një abdes. Me këtë veprim, ai tregoi se ishte e lejuar t'i falësh edhe të gjithë namazet me një abdes nëse ai nuk prishet.

Gjithashtu, duke qenë gjithmonë në kërkim të kënaqësisë hyjnore, edhe namazi me xhemat, sidomos për meshkujt, është një shkak i mëshirës hyjnore. Kurdo qoftë, adhurimet që kryhen në harmoni midis zemrës dhe trupit, janë çaste afërsie me Allahun e Madhëruar. Ndërsa, dija, urtësia, dhikri dhe bisedat fetare të cilat të çojnë në njohjen e Allahut, janë çaste kur shpirti mbushet me qetësi hyjnore.

Nëse arrijmë ta vazhdojmë me durim dhe qëndrueshmëri gjatë gjithë jetës pasionin e adhurimit që kemi në Ramazan, duke e reflektuar Kuranin dhe Sunetin në çdo fazë të jetës sonë, inshAllah do të arrijmë të futemi edhe ne në kategorinë e theksuar në këtë hadith kudsî:

54. shih. Muslim, Fedailu's-Sahabe, 12.

“Robi Im nuk mund të më afrohet me ndonjë mënyrë më të mirë se sa me ato që Unë ia kam bërë farz (të detyrueshme). Robi Im vazhdon të më afrohet edhe me (vepra) nafile (vullnetare) dhe Unë e dua atë. Kur Unë e dua, bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën prek dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse kërkon diçka prej Meje, ia jap, nëse strehohet tek Unë, e mbroj...” (Buhari, Rikak, 38; Ibn-i Maxhe, Fiten, 16)

Shkurtimisht, lidhur me detyrat e devotshmërisë, nuk duhet të përpiqemi vetëm në disa kohë të caktuar, por gjatë gjithë jetës. Ne duhet të ruhermi shumë nga dobësia, përtacia, dembelizmi, neglizhenca dhe humbja e pasionit të adhurimit që kemi fituar më parë. Lidhur me këtë, **Resulullahu** ﷺ, e ka këshilluar **Abdullah bin Amr bin Asin** ؓ, me këto fjalë:

“O Abdullah! Mos u bëj si filani! Ndërkohë që ishte i vazhdueshëm në adhurimin e natës, tashmë nuk ngrihet më!” (Buhari, Tehexhxhud, 19)

Gjithashtu, adhurimi më i dashur për Profetin ﷺ, ka qenë adhurimi që bëhej vazhdimisht.⁵⁵

Pra, siç shprehet edhe Kurani: **“Mos u bëni si ajo (gruaja) që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerre fort!...”**⁵⁶

Këtë urdhër hyjnor, duhet ta zbatojmë gjatë gjithë jetës sonë të adhurimit. Lidhur me domosdoshmërinë për të pasur vazhdimisht pasionin e adhurimit, **Fahreddin er-Razi**, shprehet:

“Allahu i Madhëruar, e ka fshehur se me cilin adhurim kënaqet më shumë, me qëllim që të kryhen të gjitha adhurimet.

55. shih. Buhari, Iman, 32, Tehexhxhud 18; Muslim, Musafirin, 221.

56. Nahl, 92.

E ka fshehur se me cilin gjynah zemërohet më shumë, me qëllim që të kihet kujdes ndaj çdo gjynahu.

I ka fshehur miqtë e Vet midis njerëzve, me qëllim që të respektohen të gjithë njerëzit.

E ka fshehur lutjen e pranuar ndër lutjet e tjera, me qëllim që të bëhen të gjitha lutjet.

E ka fshehur Emrin e Tij më Madhështor midis emrave të tjerë, me qëllim që të madhërohen të gjithë.

E ka fshehur se cili është namazi i mesëm ndër të gjitha namazet, me qëllim që të gjithë namazet të falen me përkushtim.

E ka fshehur pendimin e pranuar ndër të gjitha pendimet, me qëllim që të bëhet pendim vazhdimisht.

E ka fshehur çastin e vdekjes ndër gjallesat, me qëllim që të jetohet i përgatitur për vdekjen.

E ka fshehur natën e Kadrit ndër të gjitha netët e tjera të Ramazanit, me qëllim që të kryhen adhurime në të gjitha netët.” (Razi, Tefsir-i Kebir, XXIII, 281-282)

VAZHDIMËSIA: ARGUMENTI I PRANIMIT TË ADHURIMIT

Ajo që e bën të çmuar adhurimin e besimtarit tek Allahu i Madhëruar, nuk është një detyrë e kufizuar, të cilën robi duhet ta bëjë e ta mbarojë, por një detyrë e cila shihet si borxh shpirtëror dhe kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë jetës.

Allahu i Madhëruar, lidhur me cilësitë e robërve të cilët i ka përgëzuar se do t’u dhurojë të mirat e xhenetit, urdhëron:

“Janë të vazhdueshëm në faljet e tyre!” (Mearixh, 23)

“I falin namazet rregullisht.” (Mearixh, 34)

Vazhdimësia në adhurime, është aq e rëndësishme, sa Profeti ﷺ, në një hadith fisnik, ka thënë:

“Vepra më e dashur tek Allahu, është ajo që bëhet vazhdimisht edhe nëse është e pakët.” (Muslim, Musafirin, 218. shih. Buhari, Rikak, 18)

Ndërsa nëna jonë Aishe , ka transmetuar se:

*“Vepra e të Dërguarit të Allahut, ishte si shiu që bie lehtë dhe vazhdueshëm...”*⁵⁷ Me këtë, ajo na ka bërë të ditur se i Dërguari i Allahut e fillonte një adhurim dhe e bënte vazhdimisht dhe pa e braktisur.

Adhurimi i pakët por i vazhdueshëm, edhe nëse në shikim të parë duket i thjeshtë dhe i pamjaftueshëm, nëse ai vazhdohet me durim dhe qëndrueshmëri, patjetër që në fund do të sjellë shpërblime të shumta. Duhet menduar se, ajo që i bën detet dete, janë vazhdimësia e pikave të shiut. Pikë, pikë bëhet oqeani.

Nisur nga kjo, adhurimi vetëm në ditët dhe netët e bekua-ra, duke i neglizhuar ato edhe gjatë ditëve të tjera kur është mundësia, është një humbje e madhe.

Nga ana tjetër, nëse njeriu jeton gjithë jetës me entuziazmin e adhurimit me aq sa ka mundësi, kjo tregon vendosmërinë dhe qëllimin e tij në vazhdueshmërinë e adhurimeve. Për këtë arsye, edhe Allahu i Madhëruar, do t'i japë shpërblime të përgjeshme. Madje, nëse robi nuk arrin ta kryejë një adhurim për shkaqe që nuk varen nga ai, si respekt ndaj dëshirës së adhurimit që ai ka në zemër, Allahu i Madhëruar do ta shpërblejë atë sikur e ka kryer adhurimin. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

57. Buhari, Saum, 64. Rikak 18; Muslim, Musafirin, 217.



إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ

“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.” (Tin, 6)

Lidhur me këtë ajet, mufesirët⁵⁸ kanë thënë se: “Kur trupi i njeriut nuk është më i aftë për të lëvizur, madje edhe pasi të ketë ndërruar jetë, shpërblimi i robit do të vazhdojë deri në pafundësi, sipas sinqeritetit të qëllimit të tij dhe përpjekjes që ka treguar ai në kohët kur ka qenë i shëndetshëm.”

Ndërsa në një hadith fisnik, urdhërohet:

“Nëse dikush nuk arrin t’i kryejë adhurimet vullnetare që ka pasur zakon t’i kryejë, për shkak të ndonjë sëmundjeje apo udhëtimi, atij i shkruhen sevape sikur i ka kryer ato kur ndodhej në shtëpi dhe me shëndet të plotë.” (Buhari, Xhihad, 134; Ahmed, IV, 410, 418.)

Për këtë arsye, duhet ta konsiderojmë mirësi të madhe kryerjen e veprave të mira dhe bërjen zakon të tyre, sa jemi ende në kohë dhe kemi mundësi.

Nga ana tjetër, edhe urdhrat rreth adhurimeve në Kuranin Fisnik, bartin kuptimin e vazhdimësisë. Pra, urdhrat hyjnorë shprehin se, adhurimet nuk duhen kufizuar në kohë të caktuara, por duhen kryer gjatë gjithë jetës në mënyrë të vazhdueshme.

Përveç kësaj, edhe urdhri rreth gurëzimit (dëbimit) të shejtanit, i cili i jep gjithmonë dembelizëm dhe dobësi njeriut ndaj adhurimeve, bartin kuptimin e vazhdimësisë. Për këtë arsye, në çdo rast, rob duhet të bëjë duanë/lutjen e mbrojtjes nga shejtanit, duke thënë: *أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ* /

58. Mufesir: Komentues Kur’ani.

Eudhu bil-lahi mine'sh-shejtani'rr-raxhim / Strehohem tek Allahu prej shejtanit të dëbuar nga mëshira hyjnore. Më pas, ai duhet ta gurëzojë shejtanin vazhdimisht, duke bërë gjithmonë punë të mira, duke u sjell me moral të bukur dhe duke kryer adhurime.

SHPËTIMI NGA HUMBJA

Në suren Asr, Allahu i Madhëruar betohet në **“kohën”**. Në një farë mënyre, me këtë betim, Allahu na paralajmëron të kemi kujdes se koha nuk mund të kthehet më pas, nuk mund të merret dhe jepet borxh, se është një nga mirësitë më të mëdha së cilës njeriu nuk ia njih vlerën dhe se jetët tona të përkohshme por konsumohen me shpejtësi të madhe. Dhe menjëherë pas kësaj, shprehet se shpëtimi i gjithë njerëzimit prej humbjes, është i lidhur me mbushjen e kohës me këto katër elemente të rëndësishme: **besimin, veprat e mira, këshillimin e së vërtetës dhe durimit**. Pra, na bën të ditur se, kohët që nuk gjallërohen me këto katër elemente, janë një humbje shumë e madhe.

Përveç kësaj, betimi në këtë sure, nuk është për një hark të caktuar kohor, por përfshin gjithë jetën. Ndërsa në një ajet tjetër, urdhërohet:

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”⁵⁹ Pra, është kusht që pasioni ndaj adhurimit të mos humbasë kurrë.

Ai që ecën në rrugën e devotshmërisë me pasion të vërtetë për adhurimin, nuk i shkon dëm as edhe një frymë. I nderuari **Ibrahim Havvas**, ka thënë:

“Njeriun besnik (e devotshëm), e sheh ose duke kryer

59. Hixhr, 99.



një adhurim farz, ose një adhurim nafile. Atë nuk mund ta shohësh duke bërë diçka tjetër.”

Ndërsa njerëzit e urtë, kanë thënë:

“Kjo botë, është sa një çast. Prandaj përpiqu që (edhe këtë çast të shkurtër) ta kalosh me adhurime!..”⁶⁰

Për rrjedhojë, është e domosdoshme të mos lejohet asnjë-herë që koha të kalojë larg adhurimeve dhe punëve të mira.

Ebu Hazim –rahmetullahi alejh-, ka thënë:

“Bashkë me **Ebu Hurejren** ﷺ, shkuaam tek varri i dikujt që sapo ishte varrosur. Ebu Hurejre tha:

«Dy rekate namaz, që ju i konsideroni të thjeshta dhe që falen lehtë, për mua, këtu (në varr) janë më të vlefshme dhe më të dashura se sa kjo botë për ju.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 126/34702.)

Gjithashtu, sipas transmetimeve, **Junus bin Halbes**, kur po kalonte nga varrezat e Damaskut gjatë të nxehtit të drekës në një ditë Xhumaje, dëgjoi një zë që thoshte:

“O njerëz që jetoni! Ju bëni haxhin, herë-herë umren dhe falni namaz pesë herë në ditë. Sot ju keni mundësi të bëni vepra, por nuk e njihni gjendjen e tmerrshme të botës tjetër. Ndërsa ne e kuptuam nga afër gjendjen e botës tjetër. Mirëpo, tashmë nuk kemi mundësi të bëjmë vepra!”

Junusi u kthye për t’iu përgjigjur këtij paralajmërimi dhe i dha selam të vdekurve. Por selami i tij nuk mori përgjigje. Për këtë arsye tha:

“Subhanallah! Unë jua dëgjoj zërin. A nuk mund t’i përgjigjeni selamit tim?” Nga varrezat vjen në zë, që thotë:

60. Imam Gazali, Mukashefetu’l-Kulub, fq. 166.

“E dëgjuam selamin tënd, por, t’i përgjigjesh selamit, e bën njeriun të fitojë sevape. Ndërsa neve nuk kemi mundësi të fitojmë as sevape dhe as gjynahe. Për këtë arsye, nuk mundëm t’i përgjigjemi selamit tënd.” (Ebu Nuajm, Hilje, V, 251.)

Ja pra, jeta është një mirësi e kufizuar, e cila na është dhuruar për të fituar lumturinë e botës tjetër. Ajo as nuk mund të përsëritet dhe as të kompensohet... Atëherë, ne duhet të përpiqemi, që çdo çast të jetës ta mbushim me vepra të mira pa na ikur nga duart kjo mundësi. Kjo, sepse çastet që nuk të çojnë në kënaqësinë e Allahut dhe nuk bëhen kapital i lumturisë së botës tjetër, janë veçse shkak i humbjes së ardhmërisë së përjetshme.

Duhet menduar se, jeta e kësaj bote, e cila përbëhet nga ditë të numëruara, sado që të duket e gjatë, ajo përsëri është më e shkurtër se sa ditët e numëruara të Ramazanit të bekuar. Për këtë arsye, ashtu siç e konsiderojmë Ramazanin një mundësi të përfitimeve shpirtërore dhe përpiqemi për to, jemi të detyruar që edhe jetën tonë ta konsiderojmë të tillë.

Lidhur me këtë çështje, duhet të marrim si udhëzues njerëzit e devotshëm, sepse ata, kanë një shpirt aq vigjilent në lidhje me mbushjen me adhurime të kapitalit të jetës, sa që nëse u thuhet se nesër do të vdisni, ata s’kanë ç’të shtojnë më në adhurimet e tyre. Megjithatë, me një modesti dhe përulje, ata e shohin veten gjithmonë të mangët. Madje, edhe indiferencën e shoqërisë ata ia atribuojnë vetes dhe për këtë arsye, ata vazhdimisht i kërkojnë llogari vetes.

Këto rreshta të shkëputur prej një letre të **Abdullah Dehlevit**, janë një shembull shumë domethënës i këtij fakti:

“...Erdhëm të mbledhim trëndafila në kopshtin e kësaj bote, por për fat të keq mblodhëm veç gjemba. Neve na u dha shëndet dhe rehati, por mjerisht në falënderimin e



të gjithave treguam dobësi. Neve na u falën dy mirësi të mëdha si Kurani Fisnik dhe Profeti ﷺ, por sa keq që edhe falënderimin ndaj tyre nuk e plotësuam dot. Allahu na ruajttë, por çuditë! Me ç'fytirë do të dalim nesër para Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ? Është shumë e vështirë të arrijmë mëshirën e Allahut dhe shefaatin (ndërmjetësimin) e Profetit me kaq pak merita! Ne shpresojmë vetëm në mëshirën e Allahut, e cila e ka kapluar zemërimin e Tij... Përndryshe, nuk kemi aspak fytirë të arsyetohemi dhe të kërkojmë falje!

Vdekja na ka zënë pusi, ndërsa kijameti është shumë afër. Vallë sa punë të mira e të vlefshme kemi bërë!? Njerëzit e devotshëm hyjnë në xhenet dhe arrijnë mirësitë e përjetshme dhe bukurinë e Allahut. Ndërsa ne indiferentët e shkretët, merremi me gjëra për të cilat do të japim llogari dhe nuk do të na shqiten në ditën e kijametit, e cila zgjat me mijëra vite.

Le ta mendojmë mirë gjendjen tonë sot, që nesër të mos mbetemi të humbur e shkatërruar. Allahu na e bëftë të mundur të çohemi në kohën para agimit, ashtu siç veprojnë edhe robërit e mirë të Allahut. Dhe, duke derdhur lot përmallimi, të kryejmë adhurime me devotshmëri të madhe!..”

Allahu na e bëftë të mundur që jetën tonë ta jetojmë me një pasion adhurimi të vazhdueshëm dhe me shpirtin e Ramazanit. Po ashtu, na e bëftë të mundur të fitojmë miqësinë dhe afërsinë hyjnore dhe ta japim frymën tonë të fundit në një mëngjes bajrami të përjetshëm në paqe dhe lumturi!

Amin!..



Morali Islam

I nderuari Mevlana, thotë:

"Shemsi -Allahu e mëshiroftë-, më ka mësuar një gjë dhe ajo është se: Nëse në botë ka ftohtë qoftë edhe një besimtar i vetëm, nuk ke të drejtë të ngrohesh. Dhe, unë e di që në botë ka besimtarë që kanë ftohtë, prandaj, tashmë nuk mund të ngrohem!"



Duhet ditur se: interesat dhe dëshirat e egos, janë helme që spërkatin shpirtin tonë. Secila prej tyre, është si një zinxhir që i vihet jetës sonë shpirtërore. Ndërsa morali islam, mund të arrihet vetëm pasi të jenë këputur këto zinxhirë të egos.



MORALI ISLAM

Sahabiu **Hakim bin Hizam** ﷺ, ishte një i afërm i nënës sonë **Hadixhe** ﷺ. Ai ishte bujar, i butë dhe bamirës i madh. Në kohën e injorancës, ai i pengonte baballarët që donin t'i varrosnin të gjalla bijat e tyre, duke i blerë prej tyre. Në këtë mënyrë, ai u shpëtonte jetën dhe u ofronte mbrojtje vajzave të mjera. Pasi u bë mysliman, një ditë shkoi tek Profeti ﷺ dhe e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut, në kohën e injorancës kam bërë disa mirësi, si dhënia e sadakasë, lirimi i robërve dhe kujdesi ndaj lidhjeve farefisnore... A do të kem ndonjë shpërblim për këto?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Në fakt, ti për hir të këtyre mirësive që ke bërë më parë je nderuar edhe me Islam!” (Buhari, Zekat 24)

Kjo, do të thotë se, morali i bukur, është një vlerë madhështore, i cili tek Allahu mund të bëhet shkaku i nderimit me besim. Ndërsa ne, në sajë të mëshirës dhe bujarisë së Allahut, u nderuam me mirësinë e Islamit pa paguar asnjë çmim. Prandaj, për të paguar çmimin e besimit tonë, jemi



të detyruar të përfaqësojmë moralin islam në personalitetet tona, në mënyrën më të bukur, si shprehje e falënderimit ndaj Allahut.

Morali që Allahu i Madhëruar i ka falur biri të njeriut, është cilësia më e qartë, e cila e dallon atë nga krijesat e tjera. Një njeri që i humb vlerat morale, në fakt, do të thotë se i ka dhënë lamtumirën edhe cilësive njerëzore. Ajo që e bën njeriun njeri, është zbukurimi i tij me moral. Ndërsa ajo që e bën njeriun më të ulët se kafshët dhe e poshtëron atë, është zhytja e tij në batakun e amoralitetit.

Mosmirënjohësve që kanë braktisur “ndjenjën njerëzore” si rezultat i amoralitetit, u kanë ndodhur fatkeqësi dhe dënime të shumta hyjnore. Popujt si ai i Adit, Themudit dhe i Lutit, të cilët i kishin bërë profesion amoralitetet e ndryshme, janë shembujt më konkret të këtij fakti. Disa njerëz të tillë, të cilët u përngjajnë atyre popujve të shkatërruar në të kaluarën, i shohim edhe në mesin e shoqërive në ditët tona. Allahu i Madhëruar, duke na tërhequr vëmendjen tek ata njerëz, dëshiron që ne të ruhem nga pësimi i shkatërrimit shpirtëror.

Për këtë arsye, neve na duhet të përpiqemi, të mos e lëmë besimin tonë të dobësohet, duke e forcuar moralin tonë, i cili është edhe cilësia më e rëndësishme e të qenit njeri.

Qëllimi i fesë, është edukimi i njeriut të bukur, me shpirt të butë dhe botën e brendshme të pastër. Dhe kjo, arrihet me vetëdijen e devotshmërisë ndaj Allahut. Sipas Islamit, njeri ideal është ai, i cili është pajisur me moralin e Allahut dhe të Profetit të Tij. Ndërsa rrua për të arritur tek ky ideal, kalon nga edukimi shpirtëror.

Nga ana tjetër, edukimi më i vështirë, është ai i njeriut. Kjo, sepse tek njeriu, gjendet një ego dhe një un i egër që kanë nevojë për t'u edukuar dhe që nuk gjendet tek krijesat e tjera. Padyshim se, kjo gjendje është si rezultat i faktit se njeriu i nënshtrohet një sprove hyjnore.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ka dërguar njerëzimit profetët e Tij, të cilët janë edhe edukuesit më të mëdhenj të njerëzimit. Profetët janë modelet e moralit dhe edukimit më të lartë. Për rrjedhojë, Profeti ﷺ, detyrën e tij e ka shprehur të përmbledhur me këto fjalë:

“Unë nuk jam dërguar për gjë tjetër, përveçse të plotësoj moralin e bukur.” (Imam Malik, Muuatta, Husnu'l-Hulk, 8)

Morali i Profetit ﷺ, është modeli më i lartë i moralit që Allahu kërkon nga robërit e Tij. Këtë fakt, Allahu i Madhëruar e vërteton në këtë ajet fisnik:

“Padyshim se ti je në një moral të lartë!” (Kalem, 4)

Po ashtu, Profeti ﷺ, duke na bërë të ditur se morali i tij i lartë e ka burimin tek **Kurani**, ka thënë: *“Mua më ka edukuar Zoti im dhe, edukatën time e ka bërë mjaft të bukur!”*⁶¹

Për rrjedhojë, mënyra më e bukur për të arritur të vërtetën e “moralit islam”, është njohja e mirë e moralit të Muhamedit ﷺ. Sa më mirë të njihet ai, aq më shumë qartësohet edhe e fshehta e moralit. Dhe ata që arrijnë t'i afrohen më tepër Allahut të Madhëruar, janë ata që arrijnë të ndjekin gjurmët e Profetit ﷺ, me një moral të bukur.

Kur **Aisheja** ﷺ, u pyet për moralin e Resulullahut ﷺ,

61. Sujuti, Xhamiu's-Sagir, I, 12.



ajo në mënyrë të shkurtër dhe të qartë, është shprehur se:
“Moral i tij, është Kurani.” (Muslim, Musafirin, 139)

Ndërsa **Ebu Bekri** , na ka porositur në këtë mënyrë:

*“Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik, e ka përme-
 ndur shpërblimin që do të japë së bashku me dënimin, me
 qëllim që njeriu t’i japë rëndësi adhurimit dhe moralit, e
 të ruhet prej dënimit.”*

Kështu, edhe ne, frymëzimin shpirtëror, duhet ta marrim
 prej mësimëve të urtësisë së **Kuranit Fisnik**, i cili është eks-
 pozitë e moralit hyjnor dhe prej të Dërguarit të Allahut, i cili e
 ka shpjeguar dhe praktikuar moralin e Kuranit, duke e jetuar
 personalisht.

Mevlana, ka thënë:

*“Kurani Fisnik, është vetë jeta dhe cilësitë e profetëve.
 Nëse e lexon dhe e praktikon, zëre se ke parë profetët dhe
 njerëzit e devotshëm! Por nëse e lexon Kuranin dhe nuk
 i zbaton urdhrat e tij dhe nuk jeton moralin e tij, atëherë
 çfarë dobie do të kesh edhe nëse i sheh profetët dhe njerëzit
 e devotshëm!.. Ata që e kuptojnë më mirë Kuranin Fisnik,
 janë ata që e jetojnë atë.”*

Nëse besimtari është veprues i gjykimeve të Kuranit dhe
 i plotësuar me moralin e tij, do të thotë se ai është i pajisur
 me moralin kuranor. Për të arritur këtë, duhet që Kurani
 Fisnik të lexohet duke medituar mbi kuptimin e tij dhe duke ia
 hapur zemrën në mënyrë të sinqertë. Gjithashtu, duhet jetuar
 në atmosferën e Kuranit me mendje dhe zemër, duke i bërë
 parimet e Kuranit mbizotëruese në sjellje dhe vepra.

Si rezultat i kësaj, tek besimtari shfaqen virtyte si mëshira,
 butësia, bujaria, falja dhe ndarja e të mirave me të tjerët, të
 cilat i japin atij një paqe dhe ëmbëlsi të papërshkrueshme.



VIRTYTET QË E BËJNË ROBIN TË DASHUR TEK ZOTI I TIJ

Pajisja me moralin islam, para së gjithash, është e lidhur me bashkimin shpirtëror me Allahun. Dhe mënyra e kësaj, është dashuria, sepse Profeti ﷺ, ka thënë: *“Njeriu është bashkë me atë që do.”*⁶² Në një farë kuptimi, ky bashkimi, është edhe të qenit të përbashkët në cilësi. Kjo, sepse dashuria, buron nga cilësitë e përbashkëta që kanë ai që do me atë që duhet.

Në thelb të njeriut, gjendet një e fshehtë hyjnore, që është shpirti që Allahu i ka fryrë atij⁶³. Nëse robi, këtë shpirt që i ka falur Allahu e pajis edhe me cilësi të bukura hyjnore, do të realizojë bashkimin më të bukur, i cili është shkak i dashurisë së Allahut. Për rrjedhojë, çdo vepër dhe sjellje e besimtarit që e do Allahun, bart edhe gjurmët e emrave të Tij të bukur.

Duhet theksuar se, ajo që synojmë të themi me pajisjen me moral, nuk është pajisja me cilësitë e madhështisë, kryelartësisë dhe lavdisë, të cilat Allahu nuk dëshiron t'i shohë tek robërit, por pajisja me ato cilësi të bukura morale që Ai dëshiron t'i shohë, si dhembshuria, mëshira, falja, bujaria etj.

Allahu i Madhëruar, e do robin e Tij, në të cilin sheh këto cilësi të bukura morale. Për shembull, për shkak se Allahu është tek, e do tekun, për shkak se është i bukur, e do të bukurën dhe bukurinë, për shkak se është i ditur, e do dijetarin, për shkak se është bujar, e do bujarin, për shkak se është i fuqishëm, i do besimtarët e fuqishëm shpirtërisht, të cilët i mbrojnë të dobëtit dhe të këputurit, për shkak se i mban premtimet, i do besnikët, për shkak se është i drejt dhe i sigurt,

62. Buhari, Edeb, 96.

63. Sexhde, 9.



i do të drejtët, etj. Këtë të vërtetë, mund ta përmendim për të gjitha cilësitë dhe emrat e Tij të bukur.

Mirëpo, nuk duhet harruar se, kur ia atribuojmë njerëzve çfarëdolloj cilësie të Allahut të Madhëruar, kjo bëhet në formë metaforike. Për rrjedhojë, kjo duhet menduar bashkë me cilësinë e Tij, “Muhalefetun li'l-hauadis”, që do të thotë se, Allahu nuk i ngjan asnjë krijese. Përndryshe, cilësimi i kujtdo njeriu me këto cilësi të Allahut, quhet shirk. (Pra, këtu bëhet fjalë vetëm për ato cilësi të Allahut, që Ai ua ka dhuruar edhe njerëzve në mënyrë të kufizuar, si bujaria, mëshira, butësia, falja etj.)

Këto hadithe fisnike, janë shembuj të mirë në lidhje me faktin se arritja e dashurisë së Allahut, varet nga aftësia dhe dëshira e robit për t’u pajisur me moralin islam:

“Allahu i Madhëruar është bujar e bamirës dhe e do bujarinë. Po ashtu, Ai e do edhe moralin e bukur...”

(Sujuti, Xhami, I, 60; Tirmidhi, Edeb, 41/2799)

“...Allahu është Rafik (i butë) dhe e do sjelljen me butësi. Shpërblimin që nuk ia jep ashpërsisë dhe sjelljeve të tjera, ia jep sjelljes me butësi.” (Muslim, Birr, 77)

Njëherë, Profeti ﷺ, tha:

“Nuk hyn në xhenet ai që ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie në zemër.”

Një sahab tha:

“O i Dërguar i Allahut! Njeriut i pëlqen të ketë roba dhe këpucë të bukura.”

Ndërsa Profeti ﷺ, duke u shprehur se kjo nuk është mendjemadhësi, tha:

“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Ndërsa

mendjemadhësi, është mohimi dhe refuzimi i meritës (duke ia atribuuar vetes mirësitë që të ka falur Allahu) dhe përçmimi i njerëzve.” (Muslim, Iman, 147; Ahmed, Musned, IV, 133)

Njëherë tjetër, Profeti ﷺ, pa një person i cili po merrte gusul⁶⁴ pa pjesën e poshtme të veshjes. Pas kësaj, ai doli në minber⁶⁵ dhe pasi falënderoi Allahun, tha:

“Allahu është turpshëm dhe i fshehtë. Për këtë arsye, Ai e do ndjenjën e turpit dhe mbulesën. Prandaj, kushdo që merr gusul, le të mbulohet!” (Ebu Daud, Hammam, 1/4012)

I nderuari shejh Sadi, në veprën e tij “Gylistani”, lidhur me “ndjenjën e turpit”, shprehet:

“Një prej robërve gjynahqarë, i hap duart dhe bën dua me shpresën se do t’i pranohet. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, nuk e pranon duanë e tij. Ai e përsërit duanë, por Allahu përsëri nuk ia pranon. Robi i hap duar për herë të tretë dhe fillon të bëj dua e të përgjërohet. Këtë herë, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

«O melekët e Mi! Unë e pranova duanë që robi Im e bëri me këmbëngulje dhe ia dhashë atë që dëshironte, sepse unë turpërohem nga kërkesa dhe duaja e zgjatur e robit Tim.»”

Pasi e shënon këtë, Shejh Sadi, thotë:

“Pa shiko mirësinë dhe bujarinë e Allahut! Gjynahun e bën robi, por ai që turpërohet, është Allahu!”

Po ashtu, ky moral është edhe burimi moralit të Profetit ﷺ, për të cilin është thënë se, “ai është i turpshëm si një vajzë e re që ka hyrë në moshën e mbulesës”.

64. Larja e plotë e trupit.

65. Podium me tre apo me teper shkallë, nga ku mbahen ligjëratat/hutbet e xhumasë.



Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Thuaj: “Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë.” (Teube, 105)

Ndërsa Profeti ﷺ, ka thënë:

“Shëndeti im, është në të mirën tuaj: Ju bisedoni me mua dhe unë bisedoj me ju! Edhe vdekja ime është në të mirën tuaj: Veprat tuaja më prezantohen mua. Kur shoh punët tuaja të mira, unë falënderoj Allahun për këtë. Por kur shoh punët tuaja të këqija, unë i kërkoj Allahu që t’ju falë.” (Hejthemi, IX, 24)

Si umeti i Muhamedit ﷺ, nuk duhet të harrojmë se, të gjitha veprat që bëjmë dhe nuk bëjmë, shihen gjithmonë nga Allahu, e madje, i prezantohen edhe Profetit ﷺ. Për rrjedhojë, duhet të ruhem dhe të turpërohem nga bërja e veprave që nuk do t’i bënim kurrë para syve të tyre. Ruajtja sot nga gabimet, do ta shpëtojë robin nga turpërimi nesër, në ditën e gjykimit.

BËJE ZEMRËN PASQYRË TË MORALIT..

Mevlana, në veprën e tij “Mesnevi”, tregon një ndodhi të tillë:

“**Jusufit** ﷺ, i vjen një mik i largët me zemrën e mbushur plot dashuri dhe i bëhet mysafir në shtëpi. Ata janë miq të përzemërt që prej fëmijërisë. Pasi bisedoi me të për një farë kohe, Jusufi ﷺ, që kishte një bukuri magjepsë, e pyet mikun e tij:

«Na thuaj miku im! Çfarë dhuratash na solle prej vendeve ku ke shkuar?»

Mysafiri, në fillim u hutua disi përballë kësaj pyetje. Por, më pas i shpreh kështu ndjenjat e tij:

«Pashë shumë gjëra në këtë botë të përkohshme, me qëllim që të zgjedh një dhuratë për ty. Mirëpo, asnjëra nuk më pëlqeu, sepse asnjëra nuk të kishte hije. E si mund ta çoj si dhuratë një thërrime floriri tek një lum me flori apo një pikë uji, tek një det? Cila farë mund të jetë e njëjtë me bukurinë tënde, të cilën mund ta gjejë në hambarët e Egjiptit? Dhurata që të ka hije ty, mund të jetë vetëm diçka e ngjashme me bukurinë tënde. Për këtë arsye, unë mendova të të sillja një pasqyrë të ndritshme e të pastër si drita e zemrës.

O Jusuf, që je drita e qiellit ashtu si dielli! Të kam sjellë një pasqyrë prej dritës së zemrës, me qëllim që sa herë që ta shohësh, të vësh bukurinë tënde e të mahni-tesh. Dhe, sa herë që të shohësh bukurinë e fytyrës tënde, të vësh shfaqjet e bukurisë së Allahut tek ty dhe të më kujtosh mua.»

Pasi mbaroi fjalën, mysafiri nxjerr një pasqyrë prej ari dhe ia ofron Jusufit .

Allahu i Madhëruar, është i panevojshëm për çfarëdolloj gjëje. Në gjithësi, nuk ekziston asgjë, e çmueshme apo e bukur, që të mos jetë në zotërimin e Tij të pasosur. Kjo, sepse Ai është krijuesi dhe Shkaktari i vërtetë i çdo gjëje. Për këtë arsye, dhurata më e pranueshme, që mund t'i ofrohet Atij, është një pasqyrë zemre e pastruar prej çdo papastërtie, ku reflektohet morali islam. Pra, një zemër e pastër, ku Allahu të shohë bukurinë e Tij dhe të mbetet i kënaqur. Një zemër e pastër dhe e ndritshme aq sa të bëhet pasqyrë e bukurisë së Allahut, është dhurata më e bukur që meriton t'i dërgohet



Atij. Në fakt, edhe mundësia për t'u pranuar në prezencën e Zotit tonë, është vetëm në sajë të një zemre të pastër.

Lidhur me këtë fakt, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen tek Allahu me zemër të pastër!” (Shu'ara, 88-89)

Duhet ditur se: interesat dhe dëshirat e egos, janë helme që spërkatin shpirtin tonë. Secila prej tyre, është si një zinxhir që i vihet jetës sonë shpirtërore. Ndërsa morali islam, mund të arrihet vetëm pasi të jenë këputur këto zinxhirë të egos.

Pra, rruga që të çon në dashurinë e Allahut, në afrimitetin dhe miqësinë e me Të, është në mundësinë e të qenit një pasqyrë e moralit me anë të mënyrës së të jetuarit. Një pasqyrë e tillë, që kushdo që të shoh në të, të vërejë shfaqjet e emrave të bukur të Allahut dhe jo gjendjen e sëmurë me dobësitë e egos. Në fakt, zemrat e papastra dhe të nxira me turbullira, nuk mund të marrin asgjë prej moralit islam.

Po ashtu, edhe Tasavufi, i cili është një sistem edukimi shpirtëror, shpreh pastrimin e zemrës dhe purifikimin shpirtëror. Lidhur me këtë, **Ebu Bekir Kettani**, ka thënë:

“Tasavufi, është moral. Ai që është më lart se ty në aspektin moral, është edhe më i pastër në aspektin shpirtëror.”

Ndërsa **Ebu'l-Husejn en-Nuri**, ka thënë:

“Tasavufi, nuk është as formë dhe as dije. Ai është thjesht moral i bukur. Nëse do të ishte formë, do të arrihej me përpjekje fetare, e nëse do të ishte dije, do të arrihej me të mësuar. Për këtë arsye, vetëm forma dhe dija, nuk të shpie drejt qëllimit. Tasavuf, do të thotë pajisesh me moralin ideal.”

RRUGA PËR TEK ALLAHU

Tasavufi, është një udhëtim për tek Allahu, e cila do të bëhet nën udhëheqjen e besimit, Islamit dhe mirësisë. Detyra e besimtarit në këtë udhëtim, është të meditojë mbi emrat dhe cilësitë e bukura të Allahut, duke u pajisur me moralin që kërkojnë ato.

Sa bukur e shpreh këtë, i nderuari **Bursevi**:

“Duhet ditur se, pozitrat fetare janë tre: Islami, besimi dhe mirësia...”

Edhe përmendja e emrave të Allahut, është tre llojesh: Interes për pozitën e Islamit, besimit dhe mirësisë.

Të përmendësh emrat e Allahut me interes për pozitën e Islamit, do të thotë që njeriu të dëshirojë që çdonjëri prej këtyre emrave të reflektohet në veten e tij, në trupin, qelizat, sjelljet dhe veprat e tij. Gjithashtu, do të thotë të falënderosh për të mirat dhe të durosh në fatkeqësi.

Përmendja e emrave të Allahut me interes për pozitën e besimit, do të thotë që shpirti të arrijë të perceptojë të vërtetat shpirtërore të këtyre emrave dhe të pajiset me moralin e çdonjërit prej atyre emrave, në bazë të urdhrit: “*Pajisuni me moralin e Allahut*”⁶⁶. Nëse veprohet kështu, personi që pajiset me moralin e njërit prej këtyre emrave, me pjesë prej atij emri. Pra gjërat që shfaqen prej atij emri, shfaqen në formë aftësie edhe tek ky person.

Ndërsa, përmendja e emrave të Allahut me interes për pozitën e mirësisë, do të thotë të arrish qetësinë dhe paqen e vërtetë shpirtërore, me anë të përmendjes së këtyre emrave.”

(Ruhu'l-Bejan, VI, 440-441)

66. shih. Mundhiri, Tergib, IV, 185.



Pra, ndjenja e mirësisë, është të kuptosh se Allahu është e vërteta e çdo gjëje dhe qenia absolute, dhe se përveç Allahut, të gjitha krijesat dhe ndodhitë, janë relative, kalimtare, ashtu si hijet. Po ashtu, do të thotë të fitosh vetëdijen e adhurimit sikur je duke e parë Allahun, duke e bërë këtë ndjenjë të qëndrueshme në zemër dhe pjesë të pandashme të personaliteti.

MIQËSIA ME ALLAHUN

Arritja e gradës së “miqësisë me Allahun”, si rezultat i pajisjes me moralin i cili do të sigurojë dashurinë dhe miqësinë hyjnore, është qëllimi më i lartë i besimtarëve. Miqtë e Allahut, janë njerëzit fatlumë, të cilët janë plotësuar shpirtërisht, duke përsosur sjelljet e tyre dhe duke pasur nderin të jenë prej trashëgimtarëve të profetëve. Ata janë majat më të larta të udhëzimit profetik dhe përsosmërisë morale, të cilët janë shtrirë përgjatë gjithë kohës. Po ashtu, ata janë shembujt konkretë të atyre që janë pajisur me moral të lartë.

Për shkak se miqtë e Allahut kanë arritur njohjen e Allahut me besim dhe moralin e lartë me devotshmëri, ata do të jenë të sigurt dhe të shpëtuar prej çdolloj frike dhe hidhërimi, edhe në ditët më të vështira. Kjo, sepse ata janë strehuar në miqësinë me Allahun, i Cili është fuqia absolute dhe mbrojtësi më i sigurt.

Në Kuranin fisnik, urdhërohet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).” (Junus, 62-63)

Në këto ajete fisnike, jepen të përmbledhura kushtet e arritjes së miqësisë me Allahun, të cilat janë “besimi” dhe “frika” ndaj Tij.

Besim, do të thotë të pastrohesh prej çdo besimi të kotë e të gabuar dhe të pranosh me gjithë zemër se Allahu është Zoti i vetëm që meriton të adhurohet.

Ndërsa frikë, do të thotë ta t'ia dorëzosh veten Allahun me gjithë zemër, duke shpëtuar nga çdolloj rruge e keqe e të devijuar dhe nga jeta egoiste e shtazore, e më pas, të përmi-rësosh jetën nën dritën e të vërtetave hyjnore, duke hyrë në “një disiplinë shpirtërore”.

Qëllimi kryesor i njerëzve të devotshëm, është pikërisht arritja e kësaj të vërtete. Dhe kjo, shpreh një lidhje zemre që formohet me Allahun e Madhëruar. Njeriu që e formon në mënyrë të shëndetshme këtë lidhje, bëhet robi i afërt me Zotin, duke u pajisur me moral. Tashmë, lakmitë dhe prirjet egoiste tek ai, e humbin gjallërinë e tyre. Njësoj si uji i një përroi, i cili e humb cilësinë e tij dhe humbet kur arrin në oqean. Tashmë, ata do të veprojnë në përputhje me vullnetin e Zotit të tyre. Çdo gjë, do ta shohin me syrin e mëshirës. Me të do të dëgjojnë, me të do të flasin dhe me të do të jetojnë.

Sa bukur e shpreh këtë fakt ky hadith kuds:

*“Kush armiqësohet me një prej robërve të Mi të dashur, unë do t’i shpall luftë atij. Robi Im, nuk mund të më afrohet me asnjë gjë tjetër më të dashur se punët që ia kam bërë farz/të detyrueshme. Robi Im (përveç farzeve) mundohet të më afrohet vazhdimisht me adhurime vullnetare. Më në fund, Unë e dua atë. Kur Unë e dua robin Tim, **bëhem veshi që dëgjon, syri që shikon, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecën, zemra me të cilën kupton dhe gjuha me të cilën flet.** Çfarëdo që të kërkoj prej Meje, ia jap patjetër. Nëse strehohet tek unë, e mbroj atë.”* (Shih.

Buhari, Rikak, 38; Ahmed, VI, 256; Hejthemi, II, 248)



Besimtari, i cili me fjalët dhe mendimet e tij është i lidhur me Allahun, nuk mund të mendohet kurrë që të mos jetë i pajisur me disa virtyte, si mëshira, durimi, bujaria dhe falja. Kjo, sepse mendimet, ndjenjat dhe shprehjet e tij, tashmë rrjedhin me dritën hyjnore.

Allahu i Madhëruar na e zbukuroftë moralin, duke na falur pjesë prej këtyre të vërtetave dhe na e bëftë të mundur që të shpërndajmë mëshirë, butësi, mirësi, falje dhe bukuri për të gjitha krijesat!

Amin!..





Të jetosh moralin islam -1

Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik, ka urdhëruar: “**...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..**” (Kasas, 77)
Me këtë, Allahu shprehet se bujarinë e Vet, dëshiron ta shohë edhe tek robërit e Tij.
Për këtë arsye, një besimtar, i cili dëshiron të jetojë moralin hyjnor, duhet të kërkojë kënaqësinë e Allahut me dorën, gjuhën, veprat, fjalët dhe me të gjitha mundësitë materiale e shpirtërore që posedon.

TË JETOSH MORALIN ISLAM -1

Gjithësia, është një shkollë ku mësohen të vërteta hyjnore. Ndërsa njerëzit dhe xhinët, të cilët janë dërguar në këtë botë për t'u provuar, janë si nxënësit e kësaj shkolle. Mësimi shpirtëror në këtë shkollë, do të vazhdojë deri në frymën e fundit dhe më në fund, biri i njeriut do të zërë vendin e tij në gjirin e tokës, bashkë me veprat e tij pozitive apo negative.

Me qëllim që ne ta kuptojmë siç duhet ardhjen tonë në këtë botë dhe kalimin në botën tjetër, e në bazë të kësaj të organizojmë edhe jetën tonë, Zoti ynë na jep udhëzime të shumta. Për rrjedhojë, urdhri i parë i Kuranit Fisnik, është: **“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!”** (Alak, 1) Ndërsa kuptimi më i gjerë, që synohet me këtë ajet, është:

Arritja e thellësisë së ndjenjës dhe mendimit nga ana e besimtarit, përballë shfaqjeve hyjnore, duke medituar së pari mbi Kuranin, gjithësinë, fenomenet e ndryshme dhe mbi vetë krijimin e tij. E, më pas të kuptojë se të gjitha këto janë si pasojë e shfaqjes së cilësive hyjnore të mbuluara me shkaqe të jashtme. Dhe si përfundim, ta organizojë jetën e vet nën dritën e këtyre të vërtetave. Në këtë mënyrë, duke u përpjekur ta bëjë zemrën e tij një vend-shfaqje hyjnore e veçantë e cilësive të bukura të Allahut, ai duhet të ekspozojë me sjelljet



e veta bukurinë, dëlirësinë dhe delikatesën e Islamit, si një dëshmitar i Allahut në tokë.

Zemrat duhet të kalojnë nëpër edukimin shpirtëror, pra, edukimin e devotshmërisë, duke vëzhguar gjurmët e fuqisë së Krijuesit të Lartmadhëruar, të cilat gjenden në të gjithë universin, që prej botës mikroskopike, e deri në atë makroskopike, si zbatim i urdhrit “Lexo!”, të Allahut të Madhërishëm. Ashtu si lulet që kanë vazhdimisht nevojë për ujë për të jetuar, edhe zemrat kanë nevojë për devotshmërinë për të siguruar frymëzimin shpirtëror. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“...**Kini frikë Allahun! Allahu ju mëson ju...**” (Bekare, 282)

MUSAUIR...⁶⁷

Me qëllim që besimtari të marrë pjesë prej shfaqjeve të cilësive hyjnore dhe të ngrihet shpirtërisht, është i detyruar që të gjitha krijesat në gjithësi, të cilat janë krijuar në format më të bukura si shfaqje e cilësisë hyjnore **Musauuir**, t’i shohë me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Kjo, sepse gjithësia është një ekspozitë fenomenesh që rrjedhin prej burimit të fuqisë hyjnore. Po ashtu, edhe njeriu vetë, është një shfaqje e përsosur e cilësive hyjnore.

Zemrat që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë me nurin/dritën e Allahut, arrijnë të perceptojnë shfaqjet hyjnore në çdo gjë. Që prej grimcës, e deri tek trupi më i madh kozmik, çdo gjë që ekziston në këtë botë, janë vepra të përsosura të artit hyjnor dhe çdo vend, është si një muze ku ekspozohen veprat e fuqisë hyjnore.

67. Allahu i Madhëruar, është Krijuesi dhe Ai që u jep formën më të përshtatshme krijesave.

Vepra, është pasqyra e vepruesit dhe arti, pasqyra e artistit. Një rob që nuk e ka të verbër syrin e zemrës, kudo që të hedhë shikimin, në cilëndo grimcë të gjithësisë të meditojë, ai vëren artin e Zotit dhe zhytet në lumturinë dhe kënaqësinë e mahnitjes së pafundme që ka ndaj Artistit absolut. Çdo pamje që sheh, e shpie atë tek Krijuesi, si me mendje, ashtu edhe me zemër.

Me të vërtetë që, për atë njeri, i cili e ngre dijen e tij në nivelin e njohjes së Allahut, çdo grimcë në gjithësi, është një argument i ekzistencës, i njëshmërisë dhe i fuqisë së pafundme të Allahut. Po e njëjta grimcë, për ata që nuk e kanë ngritur dijen e tyre në këtë nivel, është një perde, e cila i pengon ata të gjejnë Allahun. Pra, nëse të gjitha krijesat në gjithësi shihen me vetëdijen e besimit, ato janë argumente që të çojnë tek Allahu. Por, nëse mendja është e verbër, atëherë, ato bëhen pengesë në afrimin me Allahun. Kjo është edhe arsyeja që kur disa prej dijetarëve të shkencave natyrore studiojnë krijesat e ndryshme, arrijnë ta kuptojnë fuqinë dhe madhështinë e Allahut, ndërsa disa të tjerë e burgosin mendjen e tyre brenda materies dhe bëhen mjeranë të mentaliteti materialist. Krijesat që studiohen janë gjithmonë të njëjtat. Mirëpo, dallimi në mënyrën e të menduarit në lidhje me to, mund ta çojë njeriun në rezultate të kundërta, njësoj si e bardha me të zezën.

Nga kjo, kuptojmë se, një besimtar i përsosur, është një njeri i cili në botëkuptimin e tij lidhur me gjithësinë, arrin ta ngrejë dijen dhe kuptimin e tij që të bëhet e aftë të perceptojë të fshehtat dhe urtësitë hyjnore. Kjo, i ngjan atij që arrin të bëjë një diamant nga një copë xhami e thyer. Arritja e këtij niveli, varet nga zhvillimi dhe hapja e mendjes së njeriut, me singëritet, devotshmëri dhe adhurime të ngarkuara me dashuri.



Kjo është edhe arsyeja, që ata të cilët tregohen të verbër dhe të shurdhër shpirtërisht përballë ligjëratave të heshtura të bukurive të pafundme që mbushin gjithë tokën, maleve, deteve, erërave etj., duke qëndruar larg kuptimit të shfaqjeve të cilësisë fisnike “**Musauuir**”, të Allahut të madhëruar, janë udhëtarët më të pakujdesshëm dhe më të hutuar të kësaj jete!..

BARI...⁶⁸

Pa i parë me syrin e zemrës edhe shfaqjet e cilësisë hyjnore “**Bari/Krijuesi**”, nuk mund të flitet për një mësim shpirtëror në kuptimin e plotë të fjalës. Allahu i Madhëruar, ka vendosur në mënyrën më të përshtatshme dhe në një harmoni të përsosur, të gjitha organet dhe gjymtyrët e krijesave jofrymore, bimore, shtazore dhe njerëzore. Që njeri ta kuptojë më mirë fuqinë hyjnore të Zotit, ai duhet të shohë me syrin e zemrës madhështinë dhe rregullin hyjnor në harmonin dhe ekuilibrin ekologjik të universit.

Çdo krijesë, duhet ta bëjë zemrën e besimtarit të mendojë në këtë mënyrë. Për shembull, nëse njeriu sheh qoftë edhe gjurmët e gishtave të tij, duke vërejtur madhështinë e krijimit dhe fuqisë së imagjinatës së Allahut, ai mund të përfitojë shumë prej këtyre shfaqjeve hyjnore. Vetëm nëse kuptimi është në një nivel të tillë, universi mund të kthehet në një libër që ligjëron të fshehta dhe urtësi.

Të dish se shfaqje e cilës cilësi hyjnore është çdo fenomen në univers, do të thotë se dija është ngritur në nivelin e njohjes së Allahut, nivel ky, që është edhe maja e dijeve njerëzore. Ndërsa kuptimi i synimit të vullnetit hyjnor në këto

68. Allahu ka krijuar gjithçka nga asgjëja dhe të gjitha organet, gjymtyrët e pjesët e tjera të krijesave, i ka vendosur në mënyrën më të përshtatshme.

shfaqje, është një gjendje e veçantë, për njerëzit e zgjedhur të Allahut.

Besimtarët e përsosur, e përqendrojnë zemrën e tyre në kuptimin e emrave dhe cilësive hyjnore dhe jetojnë me vetëdijen se ndërtimi i karakterit dhe personalitetit të tyre me frymëzimin e atij burimi hyjnor, do t'i shpie në dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrni Atë (lutjuni Atij) me to!..” (A'raf, 180)

Komentuesi i Kuranit, Burseviu, në komentin e këtij ajeti, shprehet:

“Lutuni Allahut, duke u pajisur me moralin e cilësive dhe emrave të Allahut. Pajisja me moralin e atyre cilësive, është e mundur në sajë të veprave dhe qëllimeve të mira...”

Për shembull, pajisja me moralin e cilësisë “er-Rrezak”⁶⁹, arrihet duke u shpërndarë të varfërve prej furnizimit që ka dhënë Allahu, duke mos e fshehur dhe kursyer (pra duke u ruajtur prej koprracisë dhe shpërdorimit). Po kështu, janë edhe cilësitë e tjera.”⁷⁰

ER-RREZZAK...

Allahu i Madhëruar, ashtu siç i ka krijuar, ka marrë përsipër edhe furnizimin apo rrizkun e të gjitha krijesave. Asnjë krijesë nuk vdes pa e marrë furnizimin që i është caktuar. Për këtë arsye, të shqetësohesh për çështjen e furnizimit/

69. Furnizues, shpërndarës i rrizkut.

70. Bursevi, RuHu'l-Bejan, v. VI, fq. 446, Erkam Yayınları, Stamboll.

rrizkut, është në kundërshtim me vetëdijen e besimit. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes...” (Hud, 6)

Allahu i Madhëruar, i furnizon krijesat e Tij, në mënyrë të vazhdueshme me sofrat e pafundme hyjnore. Mbi të gjitha, Zoti ynë, i Cili është Rrezzak, shtron sofrat e veçanta për çdolloj krijesë në tokë. Për shembull, në përgjithësi, ato që mund të hajë një dele, nuk mund t’i hanë njerëzit, ndërsa ato që mund të hajë njeriu, nuk mund t’i hanë delet. Pra, edhe mirësitë e rrizkut, jepen sipas një ndarje dhe rregulli hyjnor shumë të përpiktë.

Po ashtu, edhe ne, në çdo kafshatë që hamë, duhet të kujtojmë këto mirësi hyjnore dhe të fillojmë ngrënien me emrin e Allahut (bismil-lah), e të mbarojmë me falënderim ndaj Tij (elhamdulillah), duke bartur gjithmonë ndjenjat e falënderimit dhe mirënjohjes. Madje, duke ushqyer të uriturit dhe duke u dhënë ujë të eturve, duhet të përpiqemi të bëhemi shkak i mirë për rrizkun e krijesave të tjera.

Falënderimi ndaj mirësive, bëhet në dy mënyra:

E para, është falënderimi me fjalë, duke qenë i vetëdijshëm se të gjitha mirësitë, janë dhuratë e Allahut të Madhëruar. Ndërsa e dyta, është t’u dhurosh edhe nevojtarëve prej atyre mirësive. Dhe ky, është një falënderim me vepra, i cili duhet bërë patjetër.

Sa bukur e përmbledh kjo ndodhi këtë horizont besimi:

I nderuari **Shakik-i Belhi**, vendos të merret me tregti, për të siguruar jetesën. Dhe për këtë, duhej të shkonte në vende

të largëta. Para se të largohej, shkon tek miku i tij Ibrahim bin Ed'hemi, për të cilin kishte shumë respekt dhe dashuri, me qëllim që t'i kërkojë hallallëk. Më pas del për udhë. Mirëpo, Shakiku, i cili mendohej se nuk do të shihej më për një kohë të gjatë, u kthye pas disa ditësh. Kur Ibrahim bin Ed'hemi e pa Shakikun në xhami, i habitur e pyet:

“Përse u ktheve kaq shpejt?” Shakiku u përgjigj:

“Gjatë udhëtimit, pashë diçka të çuditshme. Prandaj u ktheva.”

Ibrahim bin Ed'hemi, e pyet përsëri:

“Pa hë, na thuaj çfarë pe?” Shakiku, fillon të tregojë:

“Gjatë udhëtimit, u ula në një qoshe për të pushuar. Aty pash një zog të verbër e të çalë. «Vallë, si jeton ky zog këtu i vetmuar? Çfarë ha, e çfarë pi?» - thashë me vete. Ndërkohë, ia behu një zog tjetër, i cili mbante ushqim në gojë. Kjo u përsërit disa herë. Pas kësaj, thashë: «Allahu ia sjell rrizkun këtij zogu edhe këtu, në këtë vend të shkretë. Padyshim që edhe mua do të më furnizojë, sepse Ai ka fuqi për këtë.» Më pas, u ktheva.”

Pasi e dëgjoi, Ibrahim bin Ed'hemi, thotë:

“Po habitem me ty o Shakik! Përse e vure veten në vendin e zogut të verbër e të çalë, i cili jetonte me ndihmën e dikujt tjetër, dhe nuk mendove të bëheshe si zogu që punonte edhe për vete, edhe për të tjerët?!”

Pas këtyre fjalëve, Shakik-i Belhi, e kupton të vërtetën, çohet menjëherë dhe pasi ia puth dorën Ibrahim bin Ed'hemit, kthehet në udhën e tregtisë.⁷¹

71. Jusuf Kardaui, Problemi i varfërisë dhe Islami.

MALIKU'L-MULK...

Zoti ynë, është Maliku'l-Mulk: Pronari i vërtetë dhe sunduesi i gjithçkaje. Ai e menaxhon pronën e Vet, ashtu siç dëshiron. Dikujt i jep më shumë, e dikujt i jep më pak, sipas dëshirës së Vet. Mirëpo, të gjithë i bën përgjegjës për aq mirësi sa u ka dhënë.

Dashuria për këtë botë dhe lakmia për të fituar pasuri, është një nga çështje që i çon më së tepërmi zemrat në indiferentizëm. Këtë dobësi të njeriut, Allahu i Madhëruar, e shpreh në këtë mënyrë:

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: «Zoti im më ka nderuar». Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: «Zoti im më ka poshtëruar.»” (Fexhr, 15-16)

Ndërsa miqtë e Allahut, të cilët e kanë kuptuar mirë se, pasuria dhe malli mund të sjellin edhe lumturi, edhe fatkeqësi dhe, se edhe pasuria, edhe varfëria janë sprova hyjnore, kanë jetuar me urtësi, për të dalë të fituar shpirtërisht, nga të dyja këto gjendje. Kur Allahu i Madhëruar, ua shton mirësitë, ata dinë ta përdorin atë në rrugë të Allahut, pa e shpërdoruar dhe pa bërë koprraci me të, duke u ruajtur nga ngazëllimi. Ndërsa kur Allahu, ua pakëson mirësitë, ata mendojnë se edhe kjo gjendje, është në të mirë të tyre. Kjo, sepse ata janë të vetëdijshëm se pasuria e kësaj bote, është problem dhe fatkeqësi për shumë njerëz. Prandaj, ata falënderojnë për gjendjen e tyre dhe përjetojnë ëmbëlsinë e durimit me zemër të qetë.

Po ashtu, edhe besimtari, me këtë vetëdije, duhet të tre-gohet i kënaqur dhe i dorëzuar përball ndarjes hyjnore të mirësive. Ai duhet të ruhet nga shkelja e kufijve hyjnorë për

shkak të lakmisë së egos dhe nga zilia ndaj pasurisë dhe pronës që i është caktuar të tjerëve. Ai nuk duhet ta harrojë kurrë se, pronari i vërtetë i pasurisë, është Allahu i Madhëruar dhe se pasuria që i është caktuar atij, është vetëm një amanet që i është dhënë për një përdorim të përkohshëm.

Në fakt, një besimtar me zemrën e mbushur me dashuri për Allahun, është më se i vetëdijshëm se, në të vërtetë, është pronari i asgjëje. Kjo, për shkak se dashuria, e cila kërkon sakrificë, nuk mund të pajtohet me një lakmi apo pretendim egoist për të zotëruar diçka. Ai që dashuron, heq dorë prej çdo gjëje për hir të dashurisë së tij. Për rrjedhojë, nëse besimtari përparon në udhën e Allahut që shkon nga besimi në mirësi, edhe kriteret e konsiderimit të kësaj bote nga ana e tij, fitojnë nivel të njëjtë në mënyrë paralele: Për shembull, në shariat⁷², i cili është thelbi i urdhrave dhe ndalesave hyjnore, që i janë propozuar gjithë njerëzimit, **“pasuria jote, është e jotja, pasuria ime, është e imja”**.

Ndërsa në botëkuptimin e njerëzve që kanë përparuar në rrugën shpirtërore, futet në lojë elementi i sakrificës, që i bën ata të thonë: **“pasuria jote, është e jotja, por edhe pasuria ime është e imja”**.

Përtej këtyre, në botëkuptimin e robërve të zgjedhur të Allahut, të cilët kanë arritur të kuptojnë të vërtetën hyjnore, **“as pasuria jote nuk është e jotja, as pasuria ime nuk është e imja”**.

Sa kuptimplote janë këto fjalë të **Ibrahim bin Ed’hemit**, drejtuar dikujt që i kërkoi ta këshillonte:

“Nëse do të kryesh gjynahe, të paktën mos ha prej mirësi-ve të Allahut! A të ka hije të hash edhe prej mirësive të Allahut,

72. Ligji i Allahut.



e të jesh edhe kundërshtar i urdhrave të Tij?! A të ka hije të jetosh në pronën e tij dhe të mos e zbatosh fjalën e Tij?!”

Robi që është në rrugën e Allahut, duhet ta rishikojë gjithmonë gjendjen e vet në dritën e këtyre të vërtetave. Në mënyrë të veçantë, nuk duhet të harrojë se, në pasurinë dhe pronën që i është caktuar nga Allahu, kanë të drejtën e tyre edhe nevojtarët. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat, 19)

Gjithashtu, duke kuptuar mesazhin hyjnor: **“...do t’i njohësh ata nga pamja...”**⁷³, besimtari duhet të tregojë urtësinë e njohjes së vështirësisë së vëllait të vet nevojtar, pa pasur nevojë që ai t’ia thotë e t’i kërkojë diçka.

MU’MIN⁷⁴...

Një nga cilësitë e Allahut, është edhe **“Mu’min”**. Allahu i Madhëruar, dëshiron që edhe robërit të cilët e kanë besuar, ta reflektojnë këtë cilësi në jetë.

“Mu’min”, nënkupton Atë që ndriçon dritën e besimit në zemra, që i mbron dhe i siguron ata që strehohen dhe i besojnë Atij, që fal qetësi, që vërteton drejtësinë dhe besnikërinë e Vetes dhe të profetëve të Tij dhe që nuk heq dorë nga premtimi i Tij. Allahu i Madhëruar, ashtu si edhe me emrat e tjerë të bukur, dëshiron që të pajisemi edhe me moralin e emrit të Tij “Mu’min”. Për këtë arsye, Ai u drejtohet robërve të Vet, duke u thënë “mu’minë”. Në këtë mënyrë, Ai na nxit

73. Bekare, 273.

74. Mu’min: Një nga emrat dhe cilësitë e Allahut, që nënkupton se Ai është që zgjon dritën e besimit në zemrat e njerëzve, që jep siguri dhe mbrojtje për ata që strehohen tek Ai dhe që e mban premtimet e dhëna.

të përfaqësojmë fenë me një personalitet dhe karakter që e meriton këtë cilësi. Dhe, treguesi më i rëndësishëm i vendosjes së cilësisë mu'min në zemër, është vetëdija e robit se gjendet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. E, për rrjedhojë, të përfaqësojë fenë në mënyrën më të bukur, me çdo vepër apo gjendje të tij. Në këtë mënyrë, ai duhet të përçojë besim në zemrat e të tjerëve, të shpërndajë mëshirë dhe të mbrojë veten dhe rrethin e tij nga çdolloj e keqe, duke nxitur respekt dhe siguri.

Kur Profeti ﷺ, u pyet se, “kush është myslimani më i mirë”, ai u përgjigj:

“Ai që prej gjuhës dhe dorës së tij, janë të sigurt myslimanët e tjerë.” (Buhari, Iman, 4, 5, Rikak, 26)

Ndërsa në lidhje me ata që veprojnë të kundërtën e kësaj dhe bëhen njerëz që nuk e mbajnë fjalën dhe që nuk mund t'u besohet, Profeti ﷺ, ka bërë këto dy paralajmërime të ashpra:

“Nuk ka për të hyrë në xhenet ai, që fqinji i tij nuk është i sigurt prej të këqijave të tij.” (Muslim, Iman, 73)

“Kush nuk është i besueshëm, nuk ka as besim.” (Ahmed, III, 135)

Nëse një besimtar nuk reflekton siguri përreth vetes, ky është tregues i dobësisë së besimit, madje edhe i humbjes së ndjeshmërisë së besimit të tij. Kjo, do të thotë se, tashmë, tek ai ka mbetur vetëm emri i besimtarit. Ndërsa brendësia e adhurimeve të tij, është zbrazur dhe ka mbetur vetëm një formë jo e sinqertë.

Sa bukur e shpreh **Omeri** , faktin se edhe adhurimet fitojnë vlerë në bazë të moralit:

“Mos shikoni namazin që fal apo agjërimin që mban



dikush! Por shihni se a thotë të drejtën kur flet, a e respekton amanetin kur i besohet diçka dhe a bën kujdes për hallallin dhe haramin kur merret me punët e kësaj bote?”⁷⁵

Pra, edhe ne duhet të përpiqemi të pajisemi me bukurinë e cilësisë së Zotit tonë të Madhëruar, “Mu’min”, me qëllim që të bëhemi “besimtarë” të mirë, me të cilët Ai është i kënaqur.

ES-SABUR...

Zoti ynë është shumë i durueshëm. Ai nuk nxitohet të dënojë robërit e Tij gjynahqarë. Përkundrazi, duke i orientuar me durim drejt pendimit, u jep atyre mundësi të panumërta dhe kohë për t’u përmirësuar.

Në të njëjtën mënyrë, edhe besimtari, duhet të dijë të tregojë durim ndaj vuajtjeve që i bien në rrugën e Allahut dhe të zbukurohet me këtë cilësi të Tij. Ai nuk duhet të marrë vendime kur është i nxehur dhe nuk duhet të ankohet e të qahet. Madje, edhe në kohët më të vështira të fatkeqësive, ai duhet të ruajë qetësinë e zemrës, duke menduar për mirësinë dhe shpërblimin në fund të durimit.

Kush dëshiron kënaqësinë e Allahut, më parë, duhet të tregohet i kënaqur me caktimin e Tij. Kush jeton i kënaqur me caktimin e Allahut, ai njeri gjendet gjithmonë nën shfaqjet e mëshirës hyjnore. Madje, edhe nëse ndodhet nën vuajtjen e sëmundjeve të rënda... Kjo, sepse Allahu është gjithmonë ndihmësi dhe mbrojtësi i tij dhe më në fund do ta shpërblejë atë.

Në lidhje me këtë çështje, Ejubi عليه السلام, është shembulli më i bukur. Ai i pranoi me një durim dhe dorëzim të jashtëzakon-

75. Bejhaki, Sunenu'l-Kubra, Daru'l-Fikr, VI, 288; Shubabu'l-Iman, IV, 230, 326.

shëm të gjitha sëmundjet që i ranë, duke treguar kënaqësi ndaj caktimit të Allahut. Ndërsa Allahu i Madhëruar, e ka lavdëruar atë duke thënë: “نِعْمَ الْعَبْدُ / **sa rob i mirë**”.

Shkurtimisht, në çdo çështje duhet durim. Në adhurim, në vepra, në kamje, në skamje etj... sepse çdo gjë në këtë jetë, është pjesë e sprovës hyjnore. Për këtë arsye, duhet të mos lodhemi kurrë së jetuari në përputhje me urdhrat e Kuranit e Sunetit dhe duke shërbyer në rrugën e Allahut. Por përkundrazi, duhet të tregojmë durim në çdo pjesë të jetës.

I nderuari **Hatem Esami**, ka thënë:

“Përvoja më e rëndësishme dhe kulmore e moralit të bukur, është durimi ndaj vuajtjeve dhe vështirësive. Të ankohesh prej sjelljes së keqe të dikujt, është tregues i moralit tënd të keq. Kjo, sepse moral i bukur, do të thotë të durosh ndaj vuajtjeve.” (Ihja, III, 161)

Një besimtar që e di se kjo botë është e përkohshme dhe se durimi ndaj vuajtjeve në të do të ketë shpërblim të përjetshëm, nuk e vendos në zemër barrën e fatkeqësive me të cilat përballlet, nuk e prish ekuilibrin përballë kushteve të ndryshueshme të jetës dhe nuk e kthen kurrë orientimin e zemrës në drejtim tjetër jashtë Allahut.

KERIM...

Zoti ynë, është jashtëzakonisht bujar, bamirës dhe dhurues i madh. Të jesh bujar tek Allahu, pra të gëzosh nder dhe respekt tek Ai, varet nga bujaria që tregohet në jetën e kësaj bote.

Besimtarë që janë pajisur me cilësinë “Kerim”, dhurojnë dhe bëjnë bamirësi në mënyrë të fshehtë e të hapur, natën dhe



ditën, duke i bërë zemrat e tyre si burim mirësie. Ardhja vërdallë e **Omerit** ﷺ, nëpër errësirën e natës me thes në krahë për të ndihmuar të varfrit dhe bartja e ushqimeve në supe nga **Zejn-elabedini** në mes të natës, për të njëjtën arsye, janë vetëm dy prej shembujve të bukur nga të dashurit e Allahut.

Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik ka urdhëruar: “... **Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..**”⁷⁶. Nga kjo, kuptohet qartë se Allahu i Madhëruar, dëshiron që ta shohë cilësinë e bujarisë edhe tek robërit e Vet. Për këtë arsye, një besimtar që dëshiron të jetojë moralin islam, duhet t’u japë edhe nevojtarëve prej mirësive që i ka dhënë Allahu. Ai duhet të kërkojë kënaqësinë e Allahut me dorën, gjuhën, gjendjen dhe fjalën e tij. Shkurtimisht, me çdolloj mundësi materiale e shpirtërore që zotëron. Lidhur me ata që përpiqen të veprojnë në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“...**Vërtet, mëshira e Allahut është afër punë-mirëve.**”

(A'raf, 56)

ER-RAHMAN, ER-RAHIM...

Pajisja me cilësitë e Allahut, **Rahman** dhe **Rahim**, arrihet me anë të reflektimit të mëshirës. Mëshira, është fruti më i zgjedhur i besimit dhe rezultati i tij i parë. Mëshira kërkon të jesh i dhembshur dhe strehim për të mjerët. Dy prej emrave të bukur hyjnorë me të cilët përballemi që në fillim të Kuranit, janë **Rahman** dhe **Rahim**.

Ndërsa një besimtar që është përndritur me cilësitë e Allahut, “er-Rahman dhe er-Rahim” duke filluar që prej njeriut, nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj rënkimeve të heshtura të asnjë krijese dhe nuk e kursen asnjë ndihmë që ka mundësi

ta bëjë. I nderuari **Mevlana**, në sajë të këtij morali me të cilin ishte pajisur, ka thënë:

“Shemsi -Allahu e mëshiroftë- më ka mësuar një gjë: «Nëse në botë ka qoftë edhe një besimtar që ndjen të ftohtë, nuk ke të drejtë të ngrohesh.» Unë e di se në këtë botë ka besimtarë që ndjejnë të ftohtë. Prandaj, tashmë nuk mund të ngrohem as unë!..”

Pra, Shemsi, i ka mësuar Mevlanës ndjesinë e një ndër-gjegjeje që drithërohet nga fakti se robërit e Allahut mund të ndjejnë të ftohtë. Në fakt, ngrohja e trupit bëhet me anë të rrobave. Por, ngrohja ndërgjegjes, varet nga afrimi i zemrës me Allahun në sajë të sjelljeve që shfaqin mëshirë. Ky shembull, është si një shabllon që duhet përdorur në lidhje me çdo lloj nevoje të krijesave të Allahut.

Për këtë arsye, përballë fatkeqësisë dhe mjerimit, para trupit duhet të drithërohen zemrat. Në këtë mënyrë, drithërimat e ndërgjegjeve të orientuara kah Allahu, i ngrohin zemrat dhe i zhysin në paqe. Padyshim se, kjo gjendje, është shfaqje e horizontit të mëshirës gjithëpërfshirëse që besimtarët duhet të zotërojnë ndaj krijesave për hir të Krijuesit.

Profeti ﷺ, u ka thënë sahabëve se, “për të hyrë në xhenet, duhet të jenë të mëshirshëm. Mirëpo, kjo mëshirë, nuk duhet të jetë vetëm ndaj njëri-tjetrit, por duhet të përfshijë të gjitha krijesat.”⁷⁷

Po ashtu, si shembull i shfaqjes së mëshirës që përfshin të gjitha krijesat, Profeti ﷺ, ka përmendur edhe rastin e gruas gjynahqare, e cila arriti faljen hyjnore për shkak se i shoi etjen një qeni që po ngordhte për ujë dhe të kundërtën e kësaj, rastin e gruas, e cila përfundoi në xhehenem për shkak të mungesës

77. shih Hakim, IV, 185/7310.

së mëshirës ndaj një maceje, të cilën e la të ngordhte nga uria duke mos e vrarë mendjen për ta ushqyer, apo për ta lënë të lirë të ushqehet vetë.⁷⁸

Për këtë arsye, nuk duhet bërë ndarje e vogël apo e madhe ndërmjet gjynaheve dhe punëve të mira dhe, asnjëra nuk duhet parë si e parëndësishme. Kjo, sepse edhe mëshira, edhe zemërimi i Allahut, ndonjëherë shfaqen tek gjërat e mëdha, ndonjëherë tek ato të mesmet, e ndonjëherë tek gjërat e vogla. Ndërsa robi, ka për detyrë të sillet me urtësinë e besimit në çdo situatë.

Nga na tjetër, mëshira e Zotit tonë, mbizotëron ndaj zemërimit të Tij. Pra, Ai i fal robërit e Tij gjynahqarë, të cilët e kanë merituar dënimin, në sajë të një pendimi të sinqertë. Po ashtu, për mirësitë më të vogla të robërve, Ai u dhuron shpërblime të shumëfishta, ashtu siç i ka hije Madhështisë së Tij. Ndërsa besimtari, duhet të sillet gjithmonë me këtë ndjenjë mëshire, duke u përpjekur të ketë një shpirt gjallërues e gjelbërues, dhe jo rrënues.

Një shembull të këtij morali, na e tregon edhe Ebu Hurejre

ﷺ:

“Gjatë një beteje, i kërkuam të Dërguarit të Allahtu, të lutje për shkatërrimin e mohuesve të fesë. Ndërsa ai, tha: *«Unë nuk jam dërguar si mallkues, por si mëshirë.»*” (Muslim, Birr, 87)

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar, të Dërguarin e Tij, na e prezanton duke thënë se: **“ai është Rauf/shumë i butë dhe Rahim/i mëshirshëm ndaj besimtarëve”**⁷⁹ Pra, cilësitë e larta “Rauf” dhe “Rahim”, që janë prej emrave hyjnorë, ishin edhe cilësitë më të spikatura të Profetit ﷺ.

78. shih. Buhari, Enbija, 54; Muslim, Selam, 151, 154, Birr, 13.

79. shih. Et-Teube, 128.

Si besimtarë që jemi, edhe ne duhet t'i bëjmë zemrat vend mëshire, duke u përpjekur të vërtetojmë në çdo rast se jemi robërit e Rahmanit/Mëshiruesit dhe populli i Profetit të mëshirës.

Allahu i Madhëruar, na bëftë të gjithëve prej robërve që meditojnë siç duhet mbi të gjitha emrat dhe cilësitë e Tij hyjnore dhe që jetojnë me moral të bukur në përputhje me ato emra dhe cilësi, me qëllim që të arrijnë në atmosferën e dashurisë dhe miqësisë hyjnore!

Amin...





Të jetosh moralin islam -2

Vallë, ata persona të cilët sot nuk shprehin vullnetin që të falin robërit e Zotit dhe kanë një shpirt interesaxhi, egoist dhe të pandjeshëm, me çfarë fytyre mund t'i kërkojnë falje Allahut nesër në ditën gjykimit? Sëmundja e mosfaljes së të tjerëve buron nga indiferenca njeriut, sepse zotëruesi i vërtetë i faljes, është Zoti. Besimtarët mund të falin të tjerët në varësi të dashurisë që ata ushqejnë në zemrat e tyre ndaj Allahut. Robërit e dashur të Allahut, që jetonin me këto parime morale, nuk ua reflektonin gjynahqarëve urrejtjen që ata ndjenin ndaj mëkatit në vete. Ata i konsideronin gjynahqarët si zogj të plagosur dhe përpiqeshin t'i shëronin brenda sarajeve të tyre të shpirtit.



Nga ana tjetër, duhet menduar edhe se Zoti, për hir të atributit të Tij, Settar, ka mbuluar sa e sa gjynahe tonat dhe i ka lënë ato si pika të zeza në zemrat tona. Kjo është shprehje e madhështisë, mëshirës dhe faljes së Tij të pafundme. Në qoftë se gjynahet do të dukeshin si pika të zeza në ballë dhe jo në zemër, nuk ka dyshim se askush nuk do të kishte fytyrë të vështronte dikë tjetër.

TË JETOSH MORALIN ISLAM -2

Një pjesën e parë të kësaj teme, kemi theksuar aftësitë dhe mundësitë e një besimtari të vërtetë, për t'u pajisur cilësitë e Allahut të Madhëruar dhe kemi shpjeguar disa prej atyre cilësive. Në këtë pjesë, do të vazhdojmë me shpjegimin e disa cilësive të tjera të Allahut të Madhëruar.

UEDUD...

Atributi i Zotit “Vedud” do të thotë, “Ai që do dhe duhet më shumë se gjithçka”. Zoti e ka krijuar gjithësinë për shkak të dashurisë. Në qoftë se në gjithësi nuk do të shfaqej ky atribut hyjnor, atëherë krijesat nuk do ta donin njëra-tjetrën dhe asnjë nënë nuk do të kujdesej për fëmijën e saj. Si shenjë e mëshirës së Tij të pafund, Zoti ka bërë që të gjitha krijesat të mbërthehen me njëra-tjetrën me lidhjen e dashurisë. Ashtu sikurse thuhet edhe në një hadith të Profetit ﷺ, “Allahu e ka zbritur një të njëqindën e mëshirës së Tij në këtë botë. Nga kjo shfaqje e mëshirës në botë, nëna ndjen dhembshuri që të ushqejë fëmijën e saj me qumësht.” (shih. Buhari, Edeb, 19; Muslim, Tevbe, 17.)



Kështu që Zoti është burimi absolut i frymës së mëshirës që ekziston tek të gjitha krijesat. Nga ky këndvështrim, në gjithësi do të ballafaqohemi me shprehje të panumërta të gjurmëve të dashurisë hyjnore. Nuk ka dyshim se është shfaqje e atributit “Vedud” të Krijuesit edhe përkujdesja me të cilën gjarpërinjtë që u kallin datën krijesave të tjera, rrisin të vegjlit e tyre, si dhe akrepat që mbajnë mbi shpinë të vegjëlit e tyre apo edhe çdo lloj tjetër kafshe e egër që përballë të vegjëlvë të tij shndërrohet në një vatër sigurie dhe dashurie.

Po kështu, si rezultat i begatisë së dashurisë hyjnore, Zoti i do robërit e tij të devotshëm dhe bën që edhe njerëzit e tjerë t’i duan ata. Jeta dhe veprat e tyre vazhdojnë të jetojnë në kujtesën dhe zemrat e brezave të ardhshëm nëpërmjet ngjarjeve mësimdhënëse të jetës së tyre apo këshillave të tyre plot urtësi.

Njeriu tek i cili manifestohet dashuria hyjnore, përfshin brenda rrethit të tij të dashurisë në zemër para së gjithash Allahun dhe më pas çdo krijesë tjetër në varësi të afërsisë që ka me Zotin ajo krijesë. Besimtari nuk do të arrijë kurrë besimin e përsosur, për sa kohë që dashuria e tij për Zotin të mos e kalojë çdo lloj tjetër dashurie që ai mund të ushqejë për krijesat e kësaj bote. Kështu edhe në Kuran thuhet:

“...Dashuria e besimtarëve për Allahun, është përpara dhe përmbi çdo lloj tjetër dashurie...” (Bekare, 165)

Për këtë arsye, njeriu duhet të kontrollojë si duhet dashurinë humane legjitime që ai ushqen për fëmijët e tij, prindërit, vëllain, motrën dhe miqtë e tij. Në të kundërt, ndjenja e dashurisë shndërrohet nga një begati në një “fitne” dhe bën që zemrat e njerëzve të shuhen.

Prindërit, bashkëshortët, fëmijët dhe të gjitha të mirat e kësaj jete janë begatitë e mëdha që Zoti u ka mundësuar robërve të Tij. Vetëm se, dashuria që ushqehet për secilin prej tyre duhet të bëhet për hir dhe në rrugën e Zotit, sepse ata që i kthejnë zemrat e tyre në sklevër të mirësive kalimtare të kësaj jete, kanë për t'u privuar nga dashuria hyjnore, që është burimi i të gjitha mirësive.

Dashuria dhe pasioni që është kaplimi i të gjithë ekzistencës si shenjë e rritjes së dashurisë ndaj saj, ndahet në **reale** dhe **alegorike**. Pasioni real konsiston në dashurinë ndaj Zotit dhe është kapitali më i madh në rrugën e takimit me Të, ndërsa pasioni alegorik është dashuria dhe varësia ndaj krijesave. Dashuria alegorike e përjetuar brenda kriterëve të pëlqimit hyjnor, është një shkallë drejt dashurisë reale dhe një lloj ushtrimi që rrit aftësinë e zemrës për të dashuruar. Rrëfimi i dashurisë mes Lejlasë dhe Mexhnunit është një shembull i kësaj kryevepre.

Në qoftë se zemra e Mexhnunit do të varej vetëm nga Lejla, ajo (Lejla) do të shndërrohej në një idhull për të, por Lejla luajti një rol kalimtar për Mexhnunin, zemra e të cilit arriti shkallën e afërsisë ndaj dashurisë hyjnore, duke e harruar më pas Lejlën. Mexhnuni me të vërtetë që u nis udhës në kërkim të Lejlës, por më pas, zemra e tij u dashurua pas Zotit dhe u vu në kërkim të Tij. Kështu, ajo (zemra) u lirua nga të gjitha lidhjet që kishte me çdo gjë kalimtare dhe relative të kësaj bote. Mexhnuni nuk shihte dhe nuk mendonte asgjë përveç Zotit. Të gjitha shijet dhe pasionet e kësaj bote kishin perënduar në sytë e tij përpara shijes shpirtërore të dashurisë hyjnore.

Kështu, njeriu i dalldisur pas dashurisë hyjnore shpëton nga skllavëria ndaj qendrave të tërheqjes së kësaj jete kalimtare dhe nuk ka më zili për asgjë që posedojnë njerëzit. Në këtë

mënyrë, ai arrin në perfeksionim dhe në cakun e dëshiruar. Kjo është dashuria hyjnore dhe pasioni i pastër.

Shkurtimisht, të gjitha llojet e dashurisë janë legjitime dhe të vlefshme në varësi të shkallës së pranimi nga ana e Zotit të krijesës për të cilën ushqehet ajo dashuri. Mjafton që dashuritë relative të mos përfundojnë me dështim, duke qenë stacioni i fundit i zemrës. Rreziku i vërtetë, është afërsia që tregohet ndaj asaj që nuk meriton të dashurohet. Të gjithë njerëzit fitojnë një nivel të caktuar në varësi të vlerës që ka ajo që dashurojnë në këtë jetë. Zhvillimi shpirtëror i njeriut nuk varet vetëm nga dashuria, por edhe nga e kundërta e saj, nga armiqësia që duhet shfaqur në kushte të caktuara. Njeriu ka për të gjetur prehjen në rast se do dhe urren ato që meritojnë të duhen dhe të urrehen, ndërsa në rast të kundërt, ai ka për t'u kthyer në një krijesë të nënçmuar.

Në këtë kontekst, mesazhi që jep ajeti i Kuranit, i shpallur në lidhje me xhaxhain e Profetit ﷺ, për të cilin thuhet: **“Iu thafshin të dy duart Ebu Lehebit! Kanë për t’iu tharë!”**⁸⁰, tregon se perfeksionimi i besimit do të arrihet edhe duke urreyer atë që e meriton.

Në një ajet tjetër të Kuranit, sqarohet me këto fjalë domosdoshmëria e fokusimit të prirjes së dashurisë, që është natyrale, tek burimi i saj dhe merituesi më i madh i saj që është Zoti, si dhe kujdesi që kjo ndjenjë të mos çohet dëm, duke u përqendruar në gjërat kalimtare të kësaj jete:

“Thuaj: «Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndjeni veten rehat, janë më të dashura për

80. Mesed, 1.

ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.» (Teube, 24)

Lum ata besimtarë, për të cilët dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, është më e rëndësishme se çdo lloj tjetër dashurie dhe nuk i mashtrojnë lulet joshëse të kopshteve të egra.

AFUV...

Një tjetër atribut i Zotit është edhe “**Afuv**”, që do të thotë se Zoti është Falës i Madh. Besimtarët e përsosur, bazuar në parimin: “*Ai që nuk di të falë të tjerët, nuk do të falet.*”, tregohen falës ndaj robërve të Zotit, në mënyrë që ata të meritojnë faljen hyjnore. Shndërrimi në shprehi e faljes së padrejtësive që të bëhen duke i konsideruar ato “të paqena”, duke mos ndjerë as mërzinë dhe as pikëllimin më të vogël në zemër, është vepër e perfeksionimit shpirtëror dhe trimëria më e madhe morale.

Hallaxhi Mansur pati thënë këto fjalë, kur të tjerët po e mbysnin me gurë:

- O Zot! Përpara se të më falësh mua gjynahet, fali këta njerëz për çfarë janë duke bërë!

Kur e kishin pyetur më parë se çfarë është morali, ai u qe përgjigjur:

- *Moral do të thotë të hedhësh pas krahësh shtypjen dhe padrejtësitë për hir të Zotit.*

Njëri nga të dashurit e Allahut, **Sami efendiu**, sapo ishte diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë. Një tjetër i dashur i



Allahut, që kishte parë tek ai edukatën e thellë dhe karakterin e tij të dëlirë, e pati këshilluar me këto fjalë:

- Biri im! Arsimimi që ke mbaruar është shumë me vend, por mos harro të përfundosh arsimin tënd të vërtetë! Eja të të regjistrojmë në shkollën e tasavvufit, ku do të mësosh shkencat e shpirtit dhe enigmat e botës tjetër.

Pastaj pati shtuar:

- Biri im ! Unë nuk e di se si dhe çfarë do të mësojnë në atë shkollë, por di të them me siguri se, mësimi i parë që ke për të mësuar është **mos lëndo** askënd, ndërsa mësimi i fundit që ke për të marrë do të jetë **mos u lëndo nga askush**.

Ndonëse është shumë e vështirë që të arrish të mos lëndosh ndokënd në këtë jetë, prapëseprapë kjo është në dorë të njeriut të formuar shpirtërisht. Kurse, të mos lëndohesh nga të tjerët, është gati-gati e pamundur. Në mënyrë që të mos lëndohesh, duhet t'i groposësh brenda në kraharor padrejtësitë që i bëhen personalitetit tënd. Ky është marifeti i madh, por marifeti më i madh është të bësh zemrën që të heshtë. Gjuhën mund ta heshtësh, nëse ke vullnet për këtë gjë, por zemrën nuk mund ta kontrollosh dot me anë të vullnetit tënd, pasi zemra përherë do të flasë dhe do të cytë nga brenda. Të administrosh zemrën, kërkon një perfeksionim të madh moral dhe vendosmëri. Prandaj, të mos lëndohesh nga të tjerët, do të thotë të harrosh padrejtësitë që mund të të kenë bërë vëllezërit e tu të fesë dhe të shkrish ftohjen që mund të jetë formuar për shkak të atyre padrejtësive dhe e gjitha kjo arrihet falë aftësisë që ka besimtari për ta bërë zemrën e tij të heshtë përpara devotshmërisë së tij të lartë. Për këtë arsye, në qoftë se **të mos lëndosh** është fillimi i rrugës së përsëritshme, **të mos lëndohesh** është konsideruar fundi i kësaj rruge.

Virtyti i shfaqur nga profeti Jusuf , në këtë pikë është shumë mësimdhënës: Vëllezërit e tij, që e kishin hedhur Jusufin brenda në pus, pas shumë ngjarjeve që ndodhën më vonë, më në fund e pranuan virtytshmërinë e tij të lartë dhe i thanë: **“Ti je Jusufi, Allahu të ka bërë ty më superior sesa ne.”** Nga ana e tij, Jusufi i kishte fashitur plagët e thella që i kishin shkaktuar ata dhe u mjaftua duke u thënë atyre: **“Sot nuk kam për t’ju qortuar dhe për t’ju hakërryer.”** Më pas, për t’i ngushëlluar zemrat e tyre të pikëlluara u pati kujtuar se: **“Allahu është Mëshiruesi më i Madh.”**

Besimtarët e pjekur, para së gjithash bëjnë një vetëllogaritje, nëse e meritojnë apo jo atë ngjarje apo ndodhi që i bën të lëndohen. Kështu, ata fitojnë mundësinë që të përfitojnë shpirtërisht nga vuajtjet që kanë pësuar.

Një person, i cili një herë e një kohë kishte qenë rrugaç, por më pas ishte shndërruar në një njeri të devotshëm, një ditë teksa po punonte në dyqanin e tij, ishte rrahur dhe plagosur paq pa këmbyer asnjë fjalë, nga një person i panjohur që kishte hyrë në dyqanin e tij gjithë nervozizëm. Përpara kësaj situate, i devotshmi, që njëherë e një kohë kishte qenë vetë rrugaç, nuk i kishte kthyer dorë dhe nuk i ishte hakërryer agresorit të tij. Njeriu i nervozuar ishte larguar, por ishte kthyer pas një ore sërish, por këtë herë për t’i kërkuar falje se e kishte sulmuar padrejtësisht duke e ngatërruar me një person tjetër. I devotshmi i qe përgjigjur :

- Jo, jo, ti nuk ke bërë asnjë gabim! Unë e kam merituar këtë të rrahur, sepse edhe unë njëherë e një kohë kam rrahur sa e sa persona më të dobët se vetja ime, pa pasur arsye të vërtetë. Prandaj unë e kam merituar të rrahurën tënde. Haku që kam për të marr prej teje në jetën tjetër ka për të vlejtur si kompensim për njerëzit e tjerë që i kam rrahur pa të drejtë.



Çdo situatë duhet parë edhe nga një aspekt tjetër. Çdo fatkeqësi nuk ngjan sepse e meritojmë atë. Ndonjëherë një individ mund të pësojë një fatkeqësi, në mënyrë që ai të vërë mbi kokë aureolën e nëpërkëmbjes, në mënyrë që të fitojë nivele shpirtërore nëpërmjet durimit dhe në fund fare, të shpërblehet në jetën tjetër për durimin e treguar me vendimin e Zotit. Në qoftë se fatkeqësitë do të binin vetëm mbi personat që i meritojnë ato, të gjithë njerëzit do të bëheshin të mirë me pahir dhe profetët nuk duhet të kishin përjetuar asnjë lloj fatkeqësie. E vërteta është se profetët kanë qenë personat që kanë vuajtur më shumë se të tjerët fatkeqësitë më të mëdha në këtë jetë. Për më tepër, ata kanë vuajtur, megjithëse kanë gëzuar cilësinë e pafajësisë.

Duhet menduar: Vallë, ata persona të cilët sot nuk shprehin vullnetin që të falin robërit e Zotit dhe kanë një shpirt interesaxhi, egoist dhe të pandjeshëm, me çfarë fytyre mund t'i kërkojnë falje Allahut nesër në ditën gjykimit? Sëmundja e mosfaljes së të tjerëve buron nga indiferenca njeriut, sepse zotëruesi i vërtetë i faljes, është Zoti. Besimtarët mund të falin të tjerët në varësi të dashurisë që ata ushqejnë në zemrat e tyre ndaj Allahut. Për këtë arsye, mosshfaqja e virtytit të faljes për arsye personale dhe ushqimi i smirës dhe hakmarrjes nuk i shkon aspak për shtat besimtarëve. Besimtarit i takon të ushqejë mëshirë ndaj njerëzve me të meta, në vend që të ushqejë hakmarrje për ta. Të ndjesh keqardhje për gjynahqarin për shkak të gjynaheve që ai kryen, është shprehje e perfeksionimit të besimit. Besimtarët e vërtetë, ndaj besimtarit që kryen një gabim, madje edhe kur ai gabim i dëmton ata personalisht, shfaqin atë qëndrim që shfaq edhe mjeku ndaj pacientit të tij. Asnjë doktor nuk hidhërohet me pacientin e tij që është sëmurë, edhe nëse ajo sëmundje ka ardhur si pasojë e gabimit



të tij, por e konsideron veten të detyruar dhe përgjegjës për shërimin e sëmundjes së tij. Miqtë e Allahut që jetonin me këto parime morale, nuk ua reflektonin gjynahqarëve urrejtjen që ata ndjenin ndaj mëkatit në vete. Ata i konsideronin gjynahqarët si zogj të plagosur dhe përpiqeshin t'i shëronin brenda sarajeve të tyre të shpirtit.

Kur e patën pyetur **Sehli Tusterin** se çfarë ishte morali, ai u qe përgjigjur :

“Niveli më i ulët i moralit është të përballosh shtypjen që të bëhet pa ushqyer në zemër dëshirën për hakmarrje, të mëshirosh personin që të bën ty padrejtësi dhe të të dhimbset në atë shkallë, sa të kërkosh prej Zotit që ta falë atë.” (Ihja, III, 163)

Sa bukur e ka shprehur ky hadith i transmetuar nga **Enes ibn Maliku** رضي الله عنه, faktin se ai mysliman që arrin këtë nivel shpirtëror, ka për të qenë udhëtar drejt xhenetit:

Po qëndronim së bashku me të Dërguarin e Allahut ﷺ, i cili tha:

“Tani do të vijë në mesin tonë një njeri që do të jetë në xhenet në jetën tjetër.”

Ne pritëm dhe pamë se erdhi një sahab nga ensarët, të cilit po i rridhte nga mjekra uji i abdesit dhe po i mbante këpucët në dorën e majtë. Ditën e nesërme, Profeti ﷺ, përsëriti të njëjtat fjalë. Pritëm dhe erdhi sërish i njëjti person. Kjo u përsërit edhe ditën e tretë. Pasi i Dërguari i Allahut u ngrit e shkoi, **Abdullah ibn Amr** رضي الله عنه, e ndoqi atë person, dhe kur e mbërriti e pyeti:

- Jam zënë me babanë tim dhe u betova se nuk do të shkoj ta takoj për tri ditë. A pranon të më mbash si mysafir në shtëpinë tënde gjatë këtyre tri ditëve.

Personi pranoi. Pastaj, Abdullah ibn Amr , rrëfen:

- Kam jetuar tri net në shtëpinë e tij. Ai nuk falte shumë namaz gjatë natës. Vetëm se aty afër agimit zgjohej dhe bënte dhikër. Në fakt, nuk e kam dëgjuar të thoshte fjalë tjetër përveçse fjalë të mira. Pas tri netësh, në sytë e mi, ai person nuk ishte më i ndryshëm nga unë nga aspekti i adhurimeve. E pyeta:

- O rob i Zotit! E vërteta është se nuk jam grindur me babanë tim. Arsyeja përse kërkoja të banoja këto tri net në shtëpinë tënde ka të bëjë me faktin se i Dërguari i Allahut, për tri ditë me radhë tha se personi që do të vinte i pari në xhami ka për të hyrë në xhenet në botën tjetër dhe, çdo herë personi i parë që vinte në xhami ishte ti. Desha të qëndroja pranë teje që të mësoja se çfarë veprash bën ti dhe të kryeja edhe unë të njëjtat gjëra që të meritoja të hyja në xhenet. Por, pas tri netësh, nuk kam parë se ti bën ndonjë punë të ndryshme nga ato që bën çdo mysliman i mirë. Vallë, për çfarë arsyeje e ke mbërritur shkallën e lartë të cilën e ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut për ty?

Ai u përgjigj:

- Unë nuk kryej asnjë veprim tjetër, përveç atyre që ti ke parë me sytë e tu.

Teksa po bëhesha gati të largohesha, ai më bëri zë dhe më tha:

- Unë nuk bëj asgjë më shumë se sa bën një mysliman i rregullt në jetën e tij, por nuk i mbaj as mërinë më të vogël ndonjë myslimani dhe nuk ia kam zili asnjë personi begatitë dhe mirësitë që i ka dhuruar Allahu.

- Ja pra, - i thashë unë, - për këtë arsye ti ke arritur gradën për të cilën të ka përgëzuar Allahu. (Ahmed, III, 166.)



Edhe ngjarja e mëposhtme e shpreh shumë bukur madhësitë e moralit të faljes së të tjerëve:

E pyetën **Ahnef ibn Kajsin**:

- Prej kujt e mësuat moralin e hijshëm?
- Prej Kajs ibn Asimit. - u përgjigj ai.
- Çfarë morali kishte ai? - e pyetën.

- Ky njeri, një ditë po rrinte në shtëpinë e tij, kur një moment hyn brenda njëra nga shërbyesit e tij me një shish hekuri të mbushur me qebape. Papritur, padashur, shishi i bie nga dora mbi kokën e foshnjës së vogël, që për pasojë edhe vdes. Shërbyesja u tmerrua për atë që ndodhi dhe nuk e donte më veten. Ai person, në vend që të nervozohet dhe të fillonte t'i hakërrehej shërbyeses së tij për atë që bëri, i tha: “Mos u mërzit! Çdo gjë është caktimi i Zotit! Ti nuk je fajtorë, sepse nuk e ke bërë qëllimisht këtë gjë! Unë vendosa të ta fal lirinë për shkak të tronditjes shpirtërore që pësove.” (Ihya, III, 164)

Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se besimtari i cili ka për qëllim të fitojë faljen e Allahut duke ua falur të tjerëve gabimet dhe fajet që i kanë bërë, ka për të marrë pjesë nga morali që buron nga cilësia e Zotit “**et-Teuuab**”, duke ua pranuar lutjet për falje që i drejtojnë ata të cilët i kanë bërë keq dhe padrejtësi.

HALIM...

Një nga atributet e tjera hyjnore është “**Halim**”. Zoti është i Butë, sillet shumë butë me robërit e Tij dhe tregon durim dhe vetëpërmbajtje shumë të madhe ndaj fajeve dhe gabimeve të robërve të Tij, në vend që të zemërohet dhe t'i dënojë ata. Zoti ynë është i kënaqur, në qoftë se robërit e

Tij shfaqin të njëjtën edukatë në marrëdhëniet e tyre me të tjerët. I Dërguari i Allahut i pati thënë kështu **Eshexhit** nga Bijtë e Abdulkajsit:

“Ti ke dy shprehi që Allahu i do shumë: Je njeri i butë dhe i matur.” (Muslim, Iman, 25, 26)

E kundërta e butësisë, është vrazhdësia, një shprehi e keqe që i bën të tjerët të fyhen, ua kall datën më të dobtëve dhe i mbush me urrejtje më të fortët, të cilët edhe do të distancohen. Për këtë arsye, butësia ka qenë njëra nga cilësitë e profetëve. Disa rabinë hebrenj që e dinin këtë gjë nga librat e tyre, shkuan dhe deshën ta sprovonin Profetin ﷺ, në lidhje me këtë çështje. Por, kur panë detin e butësisë që kishte ai në shpirt, vendosën të bëheshin myslimanë.

Allahu urdhëron dhe thotë:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata...” (Al ‘Imran, 159)

I Dërguari i Allahut ka qenë njeriu më i butë në botë. Kjo bënte që ai të zgjidhte përherë më të kollajshmen në marrëdhëniet që krijonte me njerëzit dhe të mos linte vend për vështirësi, nervozizëm dhe mëri. Atë nuk e nxehte asgjë, me përjashtim të shkeljes së të drejtës dhe i falte përherë gabimet që të tjerët bënin kundër personit të tij. Sado me vrazhdësi të sillej personi që kishte përballë, ai nuk e prishte qëndrimin e tij **të sjellshëm** dhe ia kthente me të mirë atij që sillej me të me të keq.

Llukmani i Urtë ka thënë:

“Biri im! Tri gjëra mësohen në tri situata: Butësia gjatë zemërimit, trimëria gjatë betejës dhe vëllazëria gjatë nevojës.”

Pra, njeriu ka nevojë më shumë se në çdo rast të tregohet i butë në situata kur njeriu normal nxehet dhe nevrikoset dhe në vend të mendjes komandon ndjenja. Të dish t'i vësh fre egos në këto situata, kërkon perfeksionim shpirtëror. Profeti ka thënë:

“Trim nuk është ai që mund kundërshtarin e tij në betejë, por ai që mund zemërimin e tij në momentin që nevrikoset.” (Buhari, Edeb, 76; Muslim, Birr, 107, 108)

Profeti ﷺ, sillej përherë me butësi dhe mirëkuptim me ata beduinë që kishin pranuar fenë islame, por ende nuk kishin gjetur mundësinë të mësonin edukatën e fesë. Ngjarja në vijim është një shembull tipik i kësaj:

Një beduin erdhi dhe urinoi në një cep të xhamisë së Profetit ﷺ. Sahabët u ngritën që ta qortonin ashpër. Profeti ﷺ, u tha atyre:

“Lëreni dhe mos u merrni me të. Pastrojeni vendin që ka bërë pis, duke derdhur një kovë ujë aty. Ju jeni dërguar të lehtësoni, jo të vështirësoni.” (Buhari, Vudu 58, Edeb 80.)

Njëri nga të mëdhenjtë e tabiinëve, imam **Shabi**, një gjynahqari që e kishte fyer me fjalë të rënda i qe përgjigjur me këto fjalë të rralla butësie, në vend që të nxehet dhe nevrikosej me të:

“Në qoftë se këto që thua janë të vërteta, Allahu më faltë! Në qoftë se ti je gënjeshtar, Allahu të faltë!”

Shkurtimisht, butësia dhe mirëkuptimi janë rezultat i virtyteve të mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë, thelbi i natyrës së Profetit ﷺ, dhe i urdhrit hyjnor të Zotit. I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Ai që është i butë nga natyra, i ka falur Zoti shumë mirësi. Ai që nuk është i butë nga natyra, është privuar nga shumë mirësi.” (Tirmidhi, Birr, 67/2013)

Ashtu si gjithë virtytet e tjera, edhe butësia dhe mirëkuptimi kanë një masë. Të ulësh kokën përpara padrejtësisë në emër të butësisë, apo të tregosh mirëkuptim përballë moskryerjes së urdhrave të Zotit, nuk është aspak e lejuar. Kjo lloj sjelljeje, që në gjuhën e popullit quhet “butësi prej gomari”, është një qëndrim plotësisht i gabuar, sepse në këtë mënyrë, nxitet edhe dëshira dhe guximi i keqbërësve për të bërë punë të mbrapshta.

ES-SETTAR...

Një tjetër atribut i Allahut, është edhe “**es-Settar**”. Zoti njeh të gjitha veprimet e njerëzve, qofshin ato të kryera publikisht apo në mënyrë të fshehtë. Dhe, me mëshirën e Tij ka falur sa e sa gjynahe dhe faje të tyre. Kjo është një mundësi që u jepet atyre për t’u përmirësuar, sepse personi i cili ekspozohet publikisht me gjynahet dhe fajet e bëra, do ta ketë të vështirë të pranojë të përmirësohet.

Myslimani duhet të distancohet fuqimisht nga hulumtimi i gabimeve dhe fajeve të vëllezërve të tij myslimanë. Vetë Zoti e ka ndaluar këtë sjellje të shëmtuar, duke urdhëruar dhe thënë: “**...Mos i hulumtoni gabimet dhe fajet e të tjerëve!**” (Huxhurat, 12)

Rrëfimi i gjynaheve që kanë bërë të tjerët, sikur të ishte ndonjë marifet i madh, nënkupton përhapjen e të keqes. Veçanërisht në kohët e sotme, manifestimi i një lloj mashtrimi plot dinakëri, a thua se kjo është aftësi e madhe, është një gjynah shumë i madh, madje edhe më i rëndë sesa gjynahet e vepruara. Kjo do të thotë se përhapja me anë të fjalëve të sjelljeve të pahijshme në mesin e shoqërisë, bën që mendjet e njerëzve të merren me këto lloj veprimesh dhe kjo është shumë

e rrezikshme, sepse rrit edhe më shumë rrezikun e kryerjes së tyre nga të tjerët. Allahu i ka paralajmëruar me një dënim të dhimbshëm ata që përpiqen të përhapin në mesin e njerëzve sjelljet e mbrapshta dhe gjynahqare. Personi që kryen një vepër të ndaluar, pendohet për atë që ka bërë dhe për këtë arsye e fsheh atë, shpresohet se nuk do të turpërohet në Ditën e Kiametit për shkak të atributit “Settar” të Allahut.

Nga ana tjetër, duhet menduar edhe se Zoti, për hir të atributit të Tij, Settar, ka mbuluar sa e sa gjynahe tonat dhe i ka lënë ato si pika të zeza në zemrat tona. Kjo është shprehje e madhështisë, mëshirës dhe faljes së Tij të pafundme. Në qoftë se gjynahet do të dukeshin si pika të zeza në ballë dhe jo në zemër, nuk ka dyshim se askush nuk do të kishte fytyrë të vështronte dikë tjetër.

Nuk duhet harruar se zemrat janë vend-soditje hyjnore. Sado të meta dhe gabime të ketë bërë një person, nuk duhet qëmtuar që të mësohen dhe të nxirren në shesh ato, sepse kështu do të shkaktohet thyerja e zemrës së tij dhe kjo bën që të meritojë dënimin e Zotit. Të rrëfesh ato situata që ulin nderin dhe dinjitetin e njerëzve, duke dashur që në këtë mënyrë të tregohesh se sa i mirë je në sytë e të tjerëve, është një qëndrim shumë i ulët dhe bën që sa e sa vepra të mira të kryera, të shkojnë dëm në peshoren hyjnore.

Në qoftë se dëshirojmë që Zoti të na i mbulojë gabimet dhe të metat tona në mejdanin e mahsherit, atëherë duhet që edhe ne t’ua mbulojmë gjynahet dhe gabimet e robërve të Tij në këtë jetë dhe të përpiqemi të mos i fyejmë apo t’i vëmë në pozitë të keqe duke ua bërë publike. Ja edhe një rast që tregon se ç’kryevepër është kjo ndjeshmëri shpirtërore:

Hatemi Asam po bashkëbisedonte me një grua të dobët, të thyer shpirtërisht dhe me shumë halle. Teksa gruaja po ia



rrëfente me shumë emocion situatën e rëndë në të cilën gje-
ndeje, pa dashje nuk e mbajti dot veten dhe lëshoi një zhurmë
të lehtë. Në këtë situatë gruaja u shkri si një qiri dhe nuk e
deshi më veten. Shehu e ruajti qetësinë, nuk i la gruas të
kuptonte se kishte kuptuar gjë dhe duke i treguar me gisht
nga veshët i tha asaj:

“O motër! Ngrije më shumë zërin, se nuk dëgjoj mirë.
Mua kanë filluar të më lënë veshët.”

Gruaja kujtoi se ajo që kishte ngjarë nuk ishte kuptuar dhe
mori frymë thellë, a thua se kishte lindur për herë të dytë.

Kjo **mirësjellje** e paparë në edukatën e asnjë populli
tjetër, bëri që sheh Hatemin sot e tutje ta quanin Asam, që
do të thotë Shurdhi. Madje Hatemi nisi të sillej si shurdh edhe
me njerëzit e tjerë që bashkëbisedonte, në mënyrë që gruaja
të mos e merrte vesh se ai e kishte dëgjuar. Vetëm pasi mori
vesh se ajo grua kishte vdekur, ai nisi t’u thoshte bashkëbi-
seduesve të tij:

- Unë dëgjoj mirë nga veshët, kështu që mund të flisni
me mua me zë normal.

Përfolja e të metave dhe gabimeve të njerëzve të tjerë,
fetarisht është konsideruar përgojim ose gijbet dhe si një nga
mëkatet e mëdha. Për më shumë, përgojim do të thotë për-
folja e një veprimi apo situatë që ka ndodhur me të vërtetë,
ndërsa përgojimi i një veprimi apo situatë që nuk ka ndodhur
me të vërtetë konsiderohet “shpifje”.

Shkurtimisht, marrja hise nga morali hyjnor dhe përthithja
e saj thellë në shpirt, hap rrugën për virtyte madhështore.
Atributet e Zotit arrijnë të shfaqen vetëm tek besimtarët që
e kanë purifikuar egon dhe e kanë pastruar tërësisht zemrën
e tyre. Prandaj besimtari mund të shndërrohet në pasqyrën

ku pasqyrohet morali islam në masën që ai arrin të pastrojë botën e tij të brendshme nga të gjitha negativitetet dhe nga çdo sjellje dhe veprim që e mbajnë larg Allahut.

Përcjellja e madhe e attributeve të Zotit, që i treguam më sipër, duke i shndërruar ato në një pjesë të pandarë të personalitetit dhe karakterit, është viza e besimtarit për të hyrë brenda atmosferës së miqësisë me Zotin.

Zoti na bëftë nga robërit fatlumë, që arrijnë të marrin fermanin e lumturisë së përjetshme, duke marrë hise nga morali hyjnor!

Amin!..





Ta bësh shpirtin fole mëshire

I gjithë mudi, mendimi, shqetësimi, halli dhe përpjekja e besimtarëve të përsosur, është paqja dhe lumturia e të gjitha krijesave. Si rezultat i edukimit hyjnor dhe profetik, ata kanë shpëtuar prej egoizmit, pra kanë ikur nga stacioni i "unit" dhe janë bërë altruistë duke hyrë në stacionin e "bashkësisë". Ata që janë shqetësuar me shqetësimin e të tjerëve dhe janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve, kanë arritur pjekurinë e një shpirti të butë dhe të ndjeshëm. Ata e kanë kuptuar shumë mirë se shpëtimi i tyre kalon nga përpjekja për shpëtimin e të tjerëve.



Zemrat e besimtarëve të përsosur janë mbrujtur me një edukatë aq të lartë shpirtërore, saqë nuk mund t'i bëjnë keq as edhe një milingone. Ata bëhen ujëvarë mëshire për të gjitha krijesat dhe shpërndajnë butësi dhe mëshire prej zemrave të tyre. Në sajë të butësisë dhe mëshirës së tyre të gjerë, ata i gjallërojnë dhe i gjelbërojnë bahçet e zemrave, si shirat e begatë të prillit.

TA BËSH SHPIRTIN FOLE MËSHIRE

Njeriu që është larg urtësive dhe të vërtetave të Islamit, valëvitet midis shpirtërores dhe materiales, si pasojë e ndryshimit të vazhdueshëm të kushteve në sprovat e jetës së kësaj bote. Ai i ngjan një anijeje me timon të thyer, e cila ndodhet në një oqean të errët me furtunë dhe vorbulla. Prej se e ka humbur orientimin shpirtëror, për të cilin ka nevojë shpirti i tij, ndodhet në një gjendje ku nuk e di se në cilën vorbull të nefsit do të shkatërrohet.

Njeriu, i cili lëviz nëpër korridoret tepër të ngatërruara të jetës, e ka të pamundur që vetëm me mendjen e tij të dobët të gjejë rrugën e duhur, që të mos humbë ndjenjën e devotshmërisë dhe nderit, që të mos shkatërrojë lumturinë e përjetshme dhe që të kuptojë mirësinë dhe butësinë e Islamit. Në rrugëtimin drejt përjetësisë, ai ka nevojë të madhe për udhëzimin dhe nënshttrimin ndaj ligjeve hyjnore.

Që të mund të jetojnë, gjallesat janë të detyruara të ushqehen. Po kështu edhe njeriu që të qëndrojë gjithmonë në rrugën e drejtë, duhet që jeta e tij të jetë në ekuilibër mes materiales dhe shpirtërores. Ai duhet të ushqejë mendjen dhe zemrën e tij me nurin e Kuranit dhe Sunetit, pra me një fjalë, t'i nënshtrohet edukimit hyjnor.



DASHURI DHE BINDJE

Në një hadith fisnik thuhet:

“Njeriu është bashkë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96)

Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, kërkon bindje dhe lidhje shpirtërore, sepse dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave dhe intensiteti i dashurisë varet nga gjendja e kësaj lidhjeje. Kjo lidhje zemrash bëhet e mundur me thellimin e ndjenjave, duke përfutur nga morali profetik dhe duke i parë krijesat me syrin e mëshirës, ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.

Shpirtrat mund të marrin ushqim dhe begati shpirtërore prej të Dërguarit të Allahut ﷺ, aq sa janë të lidhur me të dhe aq sa i ngjajnë atij në moral. Dashuria për të varet nga bindja ndaj tij dhe nga sakrifica e përpjekja që tregohet për t'i ngjarë atij. Ndërsa dashuria ndaj Allahut kërkon besim dhe bindje ndaj të Dashurit të Tij fisnik ﷺ. Në një ajet urdhërohet:

“Thuaju (o Muhamed): «Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!...» (Al'Imran, 31)

“Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut...” (Bekare, 207)

Në fakt, njeriu duhet t'i bëjë të panjohurat, të njohura, duhet t'i ndriçojë shtigjet e errëta, si edhe të vetëdijesohet për të papriturat e botëve, që janë jashtë fushës së perceptimit të tij, si varri dhe jeta e përtejme. Gjithashtu, duhet t'i bindet me nënshtrim të plotë dhe dashuri të madhe Allahut Teala, i Cili do t'i falë paqe shpirtit të tij. Vetëm në këtë mënyrë rob i do të arrijë pjekurinë shpirtërore, me të cilën Allahu do të jetë i kënaqur.

Në këtë pikë, rruga më e saktë për t'u ndjekur, është rruga e gjurmëve të ndritura të Profetit ﷺ, që Allahu Teala ia dhuroi të gjithë njerëzimit, si modelin e Njeriut të Përsosur.

PJEKURIA SHPIRTËRORE

Bota shpirtërore e atyre, që me besnikëri ia kanë kushtuar jetën rrugës së drejtë, shndërrohet në një det të gjerë mëshire, sepse Allahu, që është Rrahman dhe Rrahim, e ka dërguar Resulullahun ﷺ, si mëshirë për të gjithë njerëzit dhe e ka bërë atë shembull për njerëzimin, me cilësinë e kësaj mëshire.

Prandaj, ata që përfitojnë ashtu siç duhet prej moralit shpirtëror të Resulullahut ﷺ, arrijnë **ta bëjnë shpirtin e tyre vend mëshire**, i cili përqafton të gjitha krijesat. Ata tashmë janë liruar nga robëria e fiksimeve të nefsit dhe llogarive të interesave të tyre personale. Shpirtrat e tyre, duke dashur Allahun dhe Profetin ﷺ, kanë shijuar dashurinë e vërtetë. Për këtë arsye, çdo kënaqësi dhe shije e përkohshme e ka humbur ndikimin dhe rëndësinë në sytë e tyre. Tashmë, i gjithë mudi, mendimi, shqetësimi, halli dhe përpjekja i tyre është për paqen dhe lumturinë e të gjitha krijesave.

Si rezultat i edukimit hyjnor dhe profetik, ata kanë shpëtuar prej egoizmit, pra kanë ikur nga stacioni i “unit”, janë bërë altruistë duke hyrë në stacionin e “bashkësisë”. Ata që janë shqetësuar me shqetësimin e të tjerëve dhe janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve, kanë arritur pjekurinë e një shpirti të butë dhe të ndjeshëm. Ata e kanë kuptuar shumë mirë se shpëtimi i tyre kalon nga përpjekja për shpëtimin e të tjerëve.

Sa bukur e shpreh ky tregim pjekurinë shpirtërore që kërkohet për takimin me Allahun:

Bejazid Bistami (Allahu e mëshiroftë), tregon:

“Në kohën tonë kishte me mijëra veli. Mirëpo, detyra e prijësit (në rrugën e drejtë) për atë shekull, i ishte besuar një hekurpunuesi me emrin **Ebu Hafs**. Për të mësuar më shumë rreth kësaj urtësie, shkova te dyqani i tij. Kur e pashë, vura re se ai ishte shumë i shqetësuar dhe i hidhëruar. E pyeta për arsyen e kësaj dhe ai mu përgjigj me këto fjalë:

“Vallë, a ka dert më të madh se derti im, dhe njeri më me shumë derte se unë? Vallë, si do të jetë gjendja e umetit të Muhamedit ﷺ, në Ditën e Kiametit?”

Më pas filloi të qante dhe më bëri edhe mua të qaja. U bëra kureshtar dhe e pyeta:

“Përse të shqetëson kaq shumë fakti se njerëzit do të dënohen?”

Ebu Hafi u përgjigj:

“Natyra ime është mbujtur me mëshirë dhe dhembshuri. Nëse i gjithë dënimi që do t’u jepej njerëzve të shkujdesur do të binte mbi mua dhe ata do të faleshin, unë do të isha tepër i kënaqur prej kësaj dhe derti im do të merrte fund...”

Prej kësaj, kuptova se Ebu Hafi nuk ishte nga ata që thoshin “unë, unë”, por duke qenë në rrugën e Profetit ﷺ, ishte nga ata që thoshin “umeti, umeti”.

Siç shihet, gjendja e trashëgimtarëve të Profetit të mëshirës ﷺ, të cilët kanë përfituar prej moralit të tij shpirtëror, reflekton ndjenjat e larta të një shpirti që është bërë fole mëshire.

I nderuari **Ebu’l-Hasan Harakani** ka thënë: “Nëse në gishtin e njërit prej vëllezërve të mi të fesë, që ndodhen

midis Turkistanit dhe Shamit, ngulet ndonjë gjemb, është njësoj sikur ai gjemb të më ngulej në gishtin tim... Hidhërimi i zemrës së tyre, është derti im.”

I nderuari **Serijji Sakati**, tridhjetë vjet të jetës së tij, i kaloi duke bërë teube dhe duke kërkuar falje prej Allahut, sepse, për një shkujdesje të çastit nuk mendoi për fatkeqësinë që u kishte ndodhur vëllezërve të tij të fesë, por u gëzua që shpëtoi vetë. Këta dhe shembuj të tjerë prej të dashurve të Allahut, tregojnë qartë për ndjenjat e thella, që kishin këta njerëz në shpirtat e tyre.

VIRTYT MBI VIRTYT

I nderuari **Rabi** ishte një prej të dashurve të Allahut, i cili tregohej i butë, bujar dhe i mëshirshëm me të tjerët, duke sakrifikuar edhe veten e tij. Në kohën kur u paralizua, një i varfër i erdhi te dera dhe i kërkoi diçka. Rabi tha:

“Jepini një ëmbëlsirë!” Sepse edhe vetë i pëlqente shumë ëmbëlsirat. Kështu e kuptonte ai ajetin: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”** (Al’Imran, 92)

Njëherë, kur iu shtuan shumë dhimbjet, dëshiroi të hante mish pule. Mirëpo, duke e mbajtur veten për dyzet ditë me radhë, nuk hëngri mish pule. Një ditë i tha së shoqes:

“Kam dyzet ditë që dëshiroj të ha mish pule, por po e mbaj veten duke shpresuar se mund të heq dorë edhe nga kjo dëshirë.”

E shoqja ia ktheu:

“Fesubhanallah! Shiko se prej çfarë po e mban veten! Allahu ta ka bërë hallall atë ushqim!”



Pas kësaj, e shoqja shkoi në pazar dhe bleu një pulë, të cilën e preu dhe e poqi për bukuri. Pastaj gatoi bukë dhe përgatiti një sofër me ushqime të ndryshme. Të gjitha këto i mori dhe ia çoi përpara të nderuarit Rabi. Por në atë moment, një i varfër u afrua tek dera dhe tha:

-Më jepni ndonjë gjë për hir të Allahut, që Allahu t'u japë begati!

Rabi hoqi dorë nga pula dhe i tha së shoqes:

-Merre këtë pulë dhe jepja atij!

E shoqja iu përgjigj:

-Fesubhanallah!

Rabi këmbënguli:

-Bëj atë që po të them.

Këtë herë, e shoqja reagoi:

-Të paktën bëj diçka që do të jetë më e mirë për të.

-E çfarë të bëj?

-I japim paratë e pulës, ndërsa ti ha pulën që ke dëshiruar aq shumë!

I nderuari Rabi i tha:

-Një propozim shumë i bukur! Më sill aq para sa bën kjo pulë!

Kur e shoqja ia solli paratë, ai tha:

-Tani vendosi paratë pranë pulës dhe jepja atij nevojtarit!

E shoqja, mori paratë dhe pulën e ia çoi nevojtarit. (Bursevi,

Ruhu'l-Bejan)

Padyshim që kjo gjendje është edhe niveli më i lartë i



bujarisë, pra virtyti “ISAR”⁸¹. Kjo është sakrifica e dhënies së pasurisë një vëllai të fesë, vetëm për hir të Allahut. Sa bukur shprehet Allahu Teala në lidhje me këtë virtyt të lartë:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: ‘Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.’ Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim”. (Insan, 8-11)

HORIZONTI I MËSHIRËS

Ja pra, morali islam ka arritur të ndërtojë një shpirt me pjekuri të përsosur, i cili kur është nevoja, heq dorë nga nevoja e vet dhe qetësohet duke kënaqur shpirtin e një vëllai të fesë. Ata që arrijnë këtë pjekuri shpirtërore, i kanë kuptuar në mënyrën më të bukur fjalët e Profetit ﷺ, i cili ka thënë:

“Kush nuk shqetësohet për hallet e besimtarëve, nuk është prej tyre.” (Hakim, Mustedrek, IV, 352)

“Kush shtrihet i ngopur, ndërkohë që komshiu i tij është i uritur, nuk është prej nesh.” (Hakim, II, 15/2166a)

Pra, ata e kanë kuptuar shumë mirë se janë përgjegjës për çdo gjë, të cilën duart e tyre mund ta arrijnë. Gjithashtu, ata kanë kuptuar se uria nuk është vetëm ajo e stomakut, por edhe ajo e shpirtit njerëzor, e cila bëhet shkas për sëmundje edhe më të rrezikshme.

Personaliteti i pashoq dhe shembullor, Profeti **Muhamed Mustafai** ﷺ, një ditë u tha shokëve:

81. Isar: Të dhënit bujarisht të asaj për të cilën ti vetë ke nevojë.



“Betohem në Allahun, në dorën e plotfuqishme të të Cilit ndodhet shpirti im, se nëse nuk mëshironi njëri-tjetrin, nuk do të hyni në xhenet.”

Sahabët e nderuar thanë:

-O Resulallah! Ne të gjithë jemi të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Mëshira (për të cilën po flas), nuk është vetëm ajo që duhet të keni ndaj njëri-tjetrit, siç e kuptoni ju, por mëshira e cila përfshin të gjitha krijesat, po të gjitha krijesat!..”

(Hakim, IV, 185/7310)

Pra, mëshira dhe dhembshuria e Profetit ﷺ, kishte cilësinë që përfshinte të gjitha krijesat, sepse shpirti i tij i bekuar, i shihte krijesat ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.

Kjo është arsyeja që ai edhe armikun e tij e shihte me sy mëshire. Në luftën e Bedrit, kur dy ushtritë u vendosën përballë njëra-tjetrës, Resulallahu ﷺ, u dërgoi idhujtarëve përfaqësuesit e tij, që të merreshin vesh pa luftë. Në atë çast, disa idhujtarë, në mesin e të cilëve gjendej edhe Hakim bin Hizami, erdhën të pinin ujë tek pusi i myslimanëve. Myslimanët deshën t'i pengonin, por i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Lërini të pinë!”

Ata erdhën, pinë ujë dhe më vonë, përveç Hakimit, të gjithë idhujtarët e tjerë nxorën shpatat kundër ushtrisë islame dhe të gjithë përfunduan të vrarë. Ndërsa Hakimi, më vonë do të nderohej me udhëzimin në rrugë të drejtë. (Ibën Hisham, II, 261)

Në vitet kur idhujtarët e Mekës, të cilët i torturuan myslimanët vite me radhë, i kapi zia e bukës dhe ngelën të uritur, Profeti ﷺ, dërgoi ushqime për ta. Në këtë mënyrë, ai u tregoi atyre, të cilët njëherë e një kohë kishin vendosur embargo

ndaj myslimanëve duke i lënë të vdisnin urie, botëkuptimin e moralit të lartë që zotëron Islami.

Gjithashtu, Profeti ﷺ, sa herë që i jepej rasti, i këshillonte njerëzit të tregonin mëshirë ndaj krijesave për hatër të Krijuesit, dhembshuri, delikatesë dhe veçanërisht për të pasur kujdes që të mos thyenin askujt zemrën. Në sajë të këtyre këshillave, zbuteshin zemrat, delikatesa dhe butësia arrinin majat më të larta dhe ndërtohej një pjekuri shpirtërore, e cila do të përfaqësonte bukuritë e Islamit.

Resulallahu ﷺ, ka dhënë shumë këshilla edhe në lidhje me mirëmbajtjen dhe pastrimin e kafshëve. Veçanërisht, ka kërkuar që delet dhe dhitë të pastroheshin mirë nga papastërtitë dhe dheu. (Hejthemi, IV, 66-67)

Ai na ka urdhëruar, që edhe kur vrasim ndonjë gjarpër ose ndonjë kafshë të rrezikshme, ta bëjmë me një të rënë dhe pa e torturuar.

Një prej sahabëve, **Ebu Derda** رضي الله عنه, kishte parë disa njerëz që i ngarkonin shumë devetë e tyre, aq sa ato nuk mund të ngriheshin në këmbë prej ngarkesës së rëndë. Ebu Derda رضي الله عنه, pasi ia hoqi ngarkesën e tepërt, e ngriti njërën nga devetë në këmbë dhe, duke iu drejtuar të zotit të kafshës, tha:

“Nëse Allahu Teala do t’ju falë për këtë keqtrajtim që u bëni kafshëve, do të tregohet shumë falës ndaj jush. E kam dëgjuar Resulallahun ﷺ, të thotë:

“Allahu Teala ju urdhëron të silleni mirë me kafshët, sepse ato nuk mund të flasin! Nëse kaloni në ndonjë tokë pjellore, lejojini kafshët të kullosin! Nëse kaloni në ndonjë tokë të shkretë, ecni shpejt...” (Ibën Haxher, Metalibu'l-Alije, II, 226/1978)

Njëherë, Resulallahu ﷺ, pa një njeri i cili po milte delen e tij dhe i tha:

“O filan! Kur ta mjelësh kafshën, lër qumësht edhe për të voglin e saj!” (Hejthemi, VIII, 196)

Seuade bin Rebi ﷺ, na transmeton këtë shembull të mëshirës dhe delikatesës së pashoqe:

“Shkova tek Profeti ﷺ, dhe kërkova diçka prej tij. Ai urdhëroi që të më jepeshin disa deve. Pastaj më këshilloi me këto fjalë:

«Kur të shkosh në shtëpi, thuaji familjes t’i mirëmbajë kafshët dhe t’u japë ushqim të bollshëm! Urdhëroje atë që t’ua lëmojë thundrat dhe, kur t’i mjelë, të mos i dëmtojë e t’u shkaktojë plagë!» (Ahmed, III, 484; Hejthemi, V, 168, 259, VIII, 196)

Njëherë tjetër, kur Profeti ﷺ, ishte duke udhëtuar për në Mekë bashkë me sahabët, panë një gazelë që po flinte në rrugë. Profeti ﷺ, që ishte dërguar mëshirë për botët, urdhëroi njërin prej sahabëve të qëndronte pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që kafsha të mos trembej. (Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.)

Kur po shkonin për të çliruar Mekën me një ushtri prej dhjetë mijë vetash, në rrugë vuri re një qen, i cili ishte shtrirë dhe po u jepte gji këlyshëve të vet. Profeti ﷺ, caktoi Xhuajl bin Surakan ﷺ rojë pranë qenit dhe këlyshëve të tij dhe e porositi atë të kujdesej për të. (Uakidi, II, 804)

Njëherë, Profeti ﷺ, pa një fole milingonash së cilës i ishte vënë zjarri. Ai u pezmatua nga një gjë të tillë. Foleja e djegur e milingonave ia kishte hidhëruar aq shumë zemrën e tij të ndjeshme, prandaj dhe me hidhërim të madh tha:

“Kush e ka djegur këtë fole? Dënimin me zjarr, i takon ta japë vetëm Zoti i zjarrit.” (shih. Ebu Daud, Xhihad 112/2675)

Njëherë tjetër, Profeti ﷺ, pa një beduin, i cili kishte marrë një shkop dhe u binte degëve të një peme, duke u përpjekur

të shkundte gjethet e saj për kafshët e tij. Pastaj u tha atyre që kishte pranë:

“Ma sillni këtu atë beduin, por silluni butë dhe mos e trembni!”

Kur beduini i erdhi pranë, Profeti ﷺ, me delikatesë të madhe i tha:

“O beduin! Gjethet shkundi me kujdes e butësi dhe jo duke gjuajtur e thyer degët!” (Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe, Bejrut 1417, VI, 378)

Profeti ﷺ, zemra e të cilit nuk duronte dot as thyerjen pa arsye të një dege të njomë, sa herë që i jepej rasti, e ftonte umetin e tij të sillej me delikatesë, butësi dhe mëshirë ndaj çdo gjëje. Në një hadith, Profeti ﷺ, në lidhje me mirëmbajtjen e bimëve, thotë:

“Nuk ka asnjë bimë, e cila ka mbirë në tokë dhe të mos ketë një melek që e ruan me krahët e tij. Kjo vazhdon deri sa të vijë koha e korrjes së asaj bime. Atë që e shkel dhe prish atë bimë, ai melek do ta mallkojë.” (Ali Muttaki, Kenz, III, 905/9122)

MOS I BËJ KEQ AS MILINGONËS!..

Në sajë të begatisë së moralit profetik, që ishte shembulli më i mirë i zemrave të besimtarëve, u edukuan njerëz me ndjenja të thella, të cilët nuk këpusnin as edhe një lule, e nuk u bënin keq as milingonave...

Kjo ngjarje që vijon më poshtë, është një nga shembujt më të përsosur të mëshirës:

Sulltan Sulejmani, me një bejte, kërkoi fetva prej Shejhu'l Islamit **Ebu Suud Efendiut**, që të vriste milingonat që kishin tharë pemët e dardhave të kopshtit të sarajit:



*“Nëse milingonat dëmtojnë të mbjellat,
A lejohet t’i uras, çfarë thotë feja?”*

Kërkesës për fetva të sulltanit, Ebu Suud Efendiu i përgjigjet me një bejte tjetër:

*“Nesër, kur para Allahut të dalë,
Prej Sulejmanit, milingona hakun do ta marrë!”*

Zemrat e besimtarëve të përsosur janë mbrujtur me një edukatë aq të lartë shpirtërore, saqë nuk mund t’i bëjnë keq as edhe një milingone. Në sajë të butësisë dhe mëshirës së tyre të gjerë, ata i gjallërojnë dhe i gjelbërojnë bahçet e zemrave.

PËR HIR TË KRIJUESIT!..

Njëri nga të dashurit e Allahut, **Ahmed er-Rufai**, ishte shumë i mëshirshëm ndaj kafshëve. Një qen ishte sëmurë me zgjebe dhe kushdo që e shihte neveritej prej tij. Ai dëbohej nga çdo derë në të cilën shkonte, derisa arriti te dera e Ahmed er-Rufaiut. Ishte i rraskapitur dhe i mbushur me plagë. Kur e pa gjendjen e kafshës, e mori qenin dhe e çoi në një vend jashtë qytetit. I bëri një vend me hije dhe filloi ta kuronte. E pastroi mirë e mirë, ia leu plagët me melhem dhe pastaj e ushqeui.

Pas dyzet ditësh kurim, shëndeti i qenit u përmirësua dhe nuk i ngeli asnjë shenjë prej sëmundjes së zgjebes. Pastaj e lau mirë e mirë dhe e çoi në qytet. Kur arriti në qytet, ata që e panë, e pyetën:

-Zotëri! U kujdesët jashtë mase për këtë qen. A mund ta dimë urtësinë dhe arsyen?

Ahmed er-Rufai u përgjigj me këto fjalë:

-U frikësova se mos Ditën e Kijametit Zoti im, do të më pyesë: “Si s’ të erdhi keq për atë qen? Përse nuk u mundove

ta shëroje? Përse nuk mendove se edhe ti mund të sëmuresh një ditë në atë mënyrë?”

O njerëz! Mbushini zemrat tuaja me mëshirë ndaj krijesave të Allahut Teala! Kini frikë se mos Allahu ju sprovon me të njëjtat fatkeqësi si të tyre!”

Ja pra, të dashurit e Allahut, nuk cenonin askënd, nuk i hynin askujt në hak dhe nuk e zgjasnin dorën në atë që s’u takonte. Mirësitë që ata zotëronin i shihnin si amanete të Allahut dhe me një ndjenjë të thellë përgjegjësie, kanë vepruar me përpikëri dhe delikatesë të veçantë.

Nuk duhet harruar se Allahu Teala, në çdo moment i fton besimtarët për në Daru’s-Selam, pra në Xhenet. Prandaj çdo besimtar:

- Duhet të jetë gjithmonë me Allahun dhe në çdo moment të kërkojë kënaqësinë e Tij.
- Duhet ta dojë dhe t’i bindet të Profetit të Allahut ﷺ.
- Nuk duhet të harrojë përgjegjësinë e vëllazërisë fetare.
- Duhet që çdo krijesë ta shohë me syrin e mëshirës.

Allahu Teala bëftë që këto ndjenja të mos mungojnë kurrë në shpirtin tonë! I bëftë zemrat tona fole ku çdo krijesë gjen paqen dhe qetësinë!

Amin!..





Mëshirë ndaj krijesave për hir të Xrijuesit

Zemrat e ndjeshme të besimtarëve të përsosur, të cilët thellohen në vuajtjen e të mjerëve, vlojnë si mahsher. Ky ulim zemre, i sjell ata deri në pragun e derës që hapet drejt mëshirës së Allahut. Kushedi se çfarë misteresh të jashtëzakonshme dëgjohen dhe çfarë pamjesh të urtësive të mrekullueshme shihen aty?!



Në gjithësi, nuk ekziston asnjë qenie e krijuar kot dhe asnjë grimcë pa urtësinë e saj. Të gjitha krijesat, janë nga një vepër e mrekullueshme e dijes, fuqisë dhe artit të Allahut të Madhëruar. Të gjitha ato bartin vullën e madhështisë hyjnore. Për këtë arsye, të dashuruarit pas Allahut, thellohen gjithmonë në urtësi dhe, të gjitha këto vitrina hyjnore, i shohin me dashuri dhe me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Ata shijojnë të mahnitur çdo gjë që dëgjojnë.

MËSHIRË NDAJ KRIJESAVE PËR HIR TË KRIJUESIT

I nderuari **Shejh Sadi Shirazi**, thellësinë dhe delikatesën e zemrës që duhet të zotërojë një besimtar, e shpjegon me këtë tregim shumë domethënës:

“Një vit, në Sham⁸² ndodhi një zi aq e madhe, sa edhe të dashuruarit e harruan dashurinë. Nuk ra qoftë edhe një pikë ujë. Të mbjellat nuk lagën dot as buzët. Çdo burim u tha. Nuk ngeli asnjë pikë ujë përveç lotëve të të varfërve.

Në një gjendje të tillë, një ditë më erdhi një mik. Ai kish mbetur kockë e lëkurë, megjithëse ishte njeri i pasur, i fuqi-shëm, i famshëm, fisnik dhe trupmadh. Kur e pash në atë gjendje, u shushata. Më pas e pyeta:

«O miku im i mirë! Çfarë ka ndodhur, ç’fatkeqësi të ka rënë? Më thuaj shkakun e kësaj gjendjeje të dobët, të këputur e të mjerë!..»

Miku im u mërzit nga fjalët e mia dhe i habitur tha:

«Miku im! Nëse nuk e di shkakun e gjendjes sime, atëherë

82. Sham: Sot kryeqyteti i Sirisë, Damask.



ç'është ky indiferentizëm? Por, nëse e di, pse pyet? A nuk e sheh, fatkeqësia ka arritur kulmin! As nga qielli nuk zbret shi në tokë, e as nga toka nuk ngrihet në qiell rënkimi i atyre që vuajnë!»

I thashë:

«E di! Por pse ka ndikuar kaq shumë kjo fatkeqësi tek ty? Ti ke çdo gjë. Pse shqetësohesh për vuajtjet e të tjerëve?!»

Ndërsa ai mik i mirë, më pa në një mënyrë shumë domethënëse, si shikimi i një dijetari ndaj një të padituri dhe tha:

«A ka hidhërim në zemrën e një njeriu i cili gjendet në breg dhe është duke parë se miqtë e tij po mbyten në det? Fytyra ime, është zverdhur prej mjerimit të popullit. Gjendja e të vetmuarve dhe skamnorëve më ka bërë kështu si jam. Njeriu me ndërgjegje, ashtu sikur nuk dëshiron të shohë plagë në trupin e tij, nuk dëshiron të shohë as tek krijesat e tjera të Allahut. Shyqyr Zotit, unë nuk kam plagë, mirëpo vuajtja e të tjerëve ma bën ndërgjegjen të dridhet. A mund të jetë në qejf njeriu që ulet pranë një të sëmuri, edhe nëse vet është i shëndetshëm?

Sa herë që shoh gjendjen e pashpresë të të varfërve, çdo kafshatë që ha, më ngelet në fyt. Sikur gëlltit ndonjë helm. Si mund të argëtohet njeriu që sheh mjerimin e llojit të vet? Kur qan ndonjëri prej tyre, lagen edhe sytë e mi.»

Ashtu siç është theksuar edhe në këtë tregim, zemrat delikate dhe të ndjeshme të besimtarëve të përsosur, të cilat thellohen në vuajtjet e të mjerëve, vlojnë si mahsher. Ky vlim zemre, i sjell ata deri në pragun e derës që hapet drejt mëshirës së Allahut. Kushedi se çfarë misteresh të jashtëzakonshme dëgjohen dhe çfarë pamjesh të urtësive të mrekullueshme shihen aty?!

VETËM SEPSE E KA KRIJUAR ALLAHU...

Besim, do të thotë të arrish të vërtetën e dashurisë. Ndërsa dashuri, do të thotë t'ia dedikosh atë burimit absolut të tij dhe Atij që e meriton, pra Allahut të Madhëruar. Mirëpo, ai që dashuron, ndjen dashuri edhe ndaj të dashurve të atij që do. Për rrjedhojë, dashuria për Allahun, bën të domosdoshme edhe dashurinë për Profetin ﷺ, për familjen dhe shokët e tij, miqtë e Allahut dhe çdo krijesë tjetër sipas vlerës që kanë ato tek Allahu.

Poeti i nderuar, **Junus Emre**, është shprehur: *"I duam krijesat për hir të Krijuesit..."*. Ndërkohë që e thoshte këtë, ai bisedonte për zemërsisht me lulen e verdhë dhe, i dehur prej mrekullive mahnitëse, sodiste vulën e fuqisë hyjnore tek krijesat...

Po ashtu edhe i nderuari **Shah Nakshibendi**, ishte duke shijuar një kënaqësi të veçantë shpirtërore kur dëgjonte lutjet dhe përgjërimet drejtuar Allahut të kafshëve për të cilat kujdesej gjatë viteve të para të hyrjes në rrugën shpirtërore.

Ndërsa të nderuarit **Hydai**, nuk i bëri zemra të këpuste asnjë lule, sepse sapo zgjaste dorën, dëgjonte se ato gjallesa përmendnin Allahun në gjuhën e tyre...

Për të dashurit e Allahut, në gjithësi, nuk ekziston asnjë genie e krijuar kot dhe asnjë grimcë pa urtësinë e saj. Të gjitha krijesat, janë nga një vepër e mrekullueshme e dijes, fuqisë dhe artit të Allahut të Madhëruar. Të gjitha ato bartin vulën e madhështisë hyjnore. Për këtë arsye, të dashëruarit pas Allahut, thellohen gjithmonë në urtësi dhe, të gjitha këto vitrina hyjnore, i shohin me dashuri dhe me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Ata shijojnë të mahnitur çdo gjë që dëgjojnë.

SHIKIM MËSHIRUES

Muhjiddin ibn-i Arabi, thotë:

“Sillu me dhembshuri dhe mëshirë ndaj robërve të Allahut. Shpërndaje mëshirën dhe dhembshurinë tek të gjitha gjallesat e krijesat dhe kujdes, mos thuaj: “Ky është bar, pajetë e padobi.” Përkundrazi, përtej të kuptuarit tënd, ato kanë shumë dobi dhe mirësi. Lëre të qetë krijesën dhe mëshiroje atë me mëshirën e Krijuesit!”

Fruti i parë i një besimi të pjekur, është mëshira. Ndërsa mëshira, kërkon që t'i dhurojmë më nevojtarëve prej asaj që posedojmë. Nëse njeriu piqet në besim, me kalimin e kohës bëhet një vend-mëshire që përfshin të gjitha krijesat.

Ai që e do Allahun, do edhe krijesat e Tij. Ai që është mik i Allahut, bëhet edhe mik i krijesave të Tij. Ndërsa shikimi i të gjitha krijesave me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Allahut, është fitorja që sjell pajisja me moralin islam.

Profeti ﷺ, i cili është dërguar si mëshirë për botët, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar, e ka ndarë mëshirën e Tij në njëqind pjesë. Nëntëdhjetenëntë prej tyre i ka mbajtur për Vete dhe një pjesë e ka zbritur në tokë. Në sajë të kësaj pjese krijesat mëshirojnë njëra-tjetrën. Madje, për shkak të kësaj pjese të mëshirës, edhe pela e ngre këmbën e saj për të mos e lënduar mëzin kur i jep gji.” (Buhari, Edeb, 19; Muslim, Teube, 17)

Për rrjedhojë, zemra e një njeriu që pajiset me moralin islam, e do krijesën për hir të Krijuesit, e konsideron veten në shërbim të krijesave deri aty ku i arrin zemra, vrapon në ndihmë të nevojtarëve dhe shpërndan gjithmonë dhembshuri e mëshirë.

Nëse në zemrën e besimtari shtohet dashuria e besimit, më në fund ai arrin në atë gjendje, sa t'i përfshijë në këtë dashuri të gjitha krijesat -në përputhje me vlerën që kanë ato tek Allahu-. Në këtë mënyrë, besimtari arrin dashurinë e vërtetë dhe bëhet i mik i Allahut.

Po kështu, edhe miqtë e Allahut sillen me krijesat në bazë të vlerës që kanë ato tek Ai. Për shembull, njeriun, i cili është edhe krijesa më fisnike e Allahut, e shikojnë me vetëdijen se ai është “halifja/mëkëmbësi i Allahut në tokë”. Gjithashtu, ata i afrohen me vetëdijen se atij i është fryrë një e fshehtë hyjnore⁸³.

Për këtë arsye, në fenë tonë, është urdhëruar respekt për të vdekurit, po aq sa edhe për të gjallët. Kur Profeti ﷺ, rastisi në kufomën e një njeriu, kërkoi menjëherë që ai të varrosej, pa pyetur se është apo jo mysliman. Po ashtu, në fenë tonë, për shkak të këtij respekti që tregohet ndaj njeriut, është e ndaluar edhe që i vdekuri të lahet me ujë shumë të ftohtë apo shumë të nxehtë, të lëndohet, të shkelet mbi varrin e tij apo të bëhen veprime të pahijshme në të.

Në ditët tona, me qëllim që në xhenaze (ceremoninë e varrimit), të marrin pjesë edhe të afërmit dhe miqtë e largët, i vdekur mbahet për ditë të tëra në dhomat frigoriferike të morgut. Por, duhet ditur se kjo është vetëm një torturë për të vdekurin. Për rrjedhojë, Profeti ﷺ, ka këshilluar që të nxi-tohet në punët e përgatitjes dhe varrosjes së të vdekurit, pa e vonuar xhenazën.⁸⁴

Nga ana tjetër, besimtarët e përsosur që arrijnë t'i shohin krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit, duke respektuar për-

83. shih. Hixhr, 29.

84. shih. Ebu Daud, Xhenaiz, 34; Buhari, Xhenaiz, 51.

sosmërinë e thelbit të njeriut, nuk ia kthejnë shpinën askujt, qoftë ai edhe gjynahqari më i madh. Ata dëshirojnë udhëzimin dhe drejtimin e tij nga pendimi, duke u përpjekur të bëhen shpëtues të jetës së tyre të përjetshme. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë, ky shembull shumë domethënës:

Gjatë një bisede të Mevlanës, vjen një i dehur. Nxënësit e Mevlanës mundohen të nxjerrin jashtë duke e lënduar. Mirëpo, Mevlana i nderuar, duke menduar se i dehuri ishte një njeri që ka ardhur vetëm për të kërkuar të vërtetën, i drejtohet atyre që po mundoheshin ta nxirrnin, duke i qortuar me këto fjalë:

“Ai ka pirë verën, por më duket se jeni dehur ju!”

T’i shohësh krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit, kërkon që urrejtja ndaj gjynahut, të mos reflektohet tek gjynahqari dhe në vend të zemërimit, ndaj tij duhet treguar dhembshuri. Atyre që janë të privuar nga mirësia e besimit dhe atyre që janë kapluar nga dobësitë e egos së tyre, u duhet afruar me gjuhën e mëshirës dhe jo gjuhën e ftohtë e të helmatisur të gjarprit, duke fituar në radhë të parë zemrat e tyre.

Detyra e besimtarit, nuk është t’i zemërohet gjynahqarëve dhe t’i lërë në hall të tyre, apo t’u bërtasë e t’i ofendojë, por t’i kapë përdore dhe t’i ndihmojë të kthehen në një jetë të pastër.

I nderuari **Mevlana**, ka thënë: “*Eja, eja, çfarëdo qofsh eja!..*” Qëllimi i kësaj ftese mjaft tolerante, është prezantimi i njeriut me thelbin e vet, pastrimi i tij nga ndyrësitë e gjynahut nën frymëzimin e dhembshurisë dhe mëshirës, duke e bërë atë të shijojë ëmbëlsinë e besimit. Bota e zemrës së besimtarëve të përsosur, është si një qendër rehabilitimi shpirtëror, ku kurohen sëmundjet shpirtërore me metodën e mëshirës.



Dijetari i hadithit dhe fikhut prej brezit të tabiinëve⁸⁵, **Mutarriif bin Abdullahu**, ka thënë:

“Ai që nuk ndjen përbrenda mëshirë ndaj gjynahqarëve, të paktën le të lutet duke kërkuar falje për ta. Të kërkoksh falje prej Allahut për banorët e tokës, është prej moralit të melekëve.”

Ata që bëhen miq me Allahun, bëhen miq edhe me vëllezërit e tyre të fesë, duke ushqyer një dashuri të thellë për ta. Madje, herë pas here, kjo dashuri zgjerohet aq shumë, sa ata përpiqen të shpëtojnë të gjithë njerëzit. Për rrjedhojë, kur **Ebu Abdullah Basri**, u pyet: “Si njihen robërit e dashur të Allahut midis popullit? Cilat janë shenjat e tyre?”, ai u përgjigj:

“I dashuri i Allahut, njihet nga gjuha e ëmbël dhe moral i bukur. Ata e pranojnë ndjesën e atyre që kërkojnë ndjesë dhe -qoftë e mirë apo e keqe- ata e shohin me dhembshuri dhe mëshirë çdo krijesë.”

Me të vërtetë që, zemra e një besimtari të përsosur, lumturohet me shpëtimin e përjetshëm të një njeriu dhe hidhërohet nëse ai gjendet në një shkatërrim shpirtëror. Kjo, sepse zemra e tij, është një oqean mëshire, që ndjen vuajtje prej humbjes së një njeriu, qoftë ai edhe armiku i tij. Për këtë arsye, ai dëshiron që askush të mos dëmtohet. Përkundrazi, ai dëshiron që të gjithë njerëzit të arrijnë shpëtimin dhe lumturinë.

Profeti i mëshirës, **Muhamedi** ﷺ, kur po gurëzohej në Taif nga banorët e saj, nuk iu lut Allahut për shkatërrimin e tyre, por për udhëzimin dhe shpëtimin e përjetshëm të tyre.

Habibi en-Nexhar, për të cilin tregohet edhe në Kuran,

85. Tabiin: Brezi i dytë i myslimanëve. Ndjekësit e sahabëve, shokëve të Profetit ﷺ.

në suren Jasin, kur po jepte frymën e fundit, me ndjenjën e mëshirës për ata që po e gurëzonin, tha:

“...Ah, sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!” (Jasin, 26-27)

Ky ajet, shpreh horizontin e dhembshurisë dhe mëshirës në zemrën e besimtarit, i cili dëshiron edhe shpëtimin e atyre njerëzve që e martirizuan.

MORALI ISLAM

Miqtë e Allahut, të cilët janë pajisur me moralin që buron nga cilësitë e Allahut, “Rahman” dhe “Rahim”, nuk i përgjigjen me të njëjtën sjellje dhe nuk i dënojnë robërit e Allahut për veprat e këqija që u bëjnë. Përkundrazi, ata zgjedhin faljen, sepse kjo, është shfaqja më e bukur e dashurisë dhe mëshirës që tregohet ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Pra, me shpresën se mund të arrijnë faljen e Allahut, në vend që t’i përgjigjen në të njëjtën mënyrë fajtorit, ata e shuajnë egon e vet dhe i lënë ata në dorën e faljes hyjnore. Kjo, është si rezultat i shpresës për meritimin e faljes së Allahut, duke i falur robërit e Tij. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë, kjo ndodhi:

Një person, tregoi një sjellje të paedukatë ndaj të nderuarit **Bahauddin Nakshibendi**, i cili nuk iu zemërua, por i buzëqeshi. Pas kësaj, personit që u soll në mënyrë të paedukatë, i ra një fatkeqësi e madhe dhe u sëmur. Në këtë kohë, ai pendohet për gjynahun që kishte bërë dhe i kërkon falje Allahut. Kur i nderuari Nakshibendi kaloi para shtëpisë së tij, hyri tek ai, e pyeti për gjendjen dhe i thotë:

“Allahu i Madhëruar, është shërues. Mos ki frikë se do të shërohesh inshAllah!”

Pas këtyre fjalëve, personi thotë me keqardhje të madhe:

“Zotëri! Kam vepruar në mënyrë të paedukatë ndaj jush dhe ju kam lënduar shumë. Prandaj më falni!”

Bahauddin Nakshibendi, tha:

“Zemra mu lëndua atëherë, por tani pasqyra e zemrës sime është shumë e pastër. Dije mirë, se shpata e udhëzuesve në rrugë të Allahut, është një shpatë e zhveshur, e nxjerrë nga këllëfi i saj. Udhëzuesi është shumë i mëshirshëm dhe nuk godet askënd me shpatë. Mirëpo, njerëzit që kërkojnë belanë, vijnë e përplasen vetë tek ajo shpatë.”

Kur krijesat shihen me syrin e mëshirës së Krijuesit, lehtësohet edhe durimi ndaj vështirësive dhe problemet që të sjellin njerëzit, bëhesh më falës, më mëshirues dhe më tolerant. Në fakt, edhe morali islam këtë kërkon. Ashtu si Zoti ynë i Madhëruar, i Cili me mëshirën e Tij të pafundme duron edhe ndaj njerëzve që e kundërshtojnë më shumë, u fal atyre mirësi dhe furnizime të panumërta, duke u dhënë shumë mundësi për të kërkuar falje dhe duke dëshiruar që ata të përmirësohen dhe të hyjnë në xhenet, ashtu edhe miqtë e Allahut që frymëzohen prej kësaj mëshire hyjnore, i falin njerëzit dhe përpiqen me sinqeritet të plotë që ata të gjejnë rrugën e drejtë dhe të fitojnë kënaqësinë e Allahut. Gjithashtu, ata nuk bëhen kurrë egoistë, por janë altruistë dhe dhurojnë shumë, duke shfaqur karakterin e një myslimani që mendon gjithmonë për të mirën e të tjerëve.

Po ashtu, një besimtar i përsosur, kur sheh një rob të vuajtur e nevojtar, i drejtohet vetes duke menduar: “Unë mund të isha në vendin e tyre, ndërsa ata në vendin tim”. Në këtë mënyrë, hallin e tyre, e konsideron si hallin e vet. Kjo, sepse



të tregohesh i pandjeshëm ndaj njerëzve të tjerë duke u sjellë me moskokëçarje ndaj halleve të tyre, nuk mund të jetë kurrë morali i një besimtari.

Në veprën e tij “*Bostani*”, Shejh **Sadi**, tregon një histori shumë domethënëse:

Një natë, u dogj gjysma e Bagdadit. Pas kësaj, një person tha: “Shyqyr që ky zjarr nuk e preku dyqanin tonë!..” Mirëpo, një njeri i urtë, i tha:

“O njeri egoist! A mendon vetëm për veten ti? Kur digjet një qytet i tërë dhe shpëton shtëpia jote, a do të ishe i kënaqur prej kësaj? Kur dikush sheh që njerëzit lidhin gurë në bark prej urisë, ai nuk mund ta mbushë stomakun e tij, vetëm nëse është zemërgur! Një njeri me ndërgjegje që sheh një të varfër të kërrusur prej urisë, nuk mund ta përtypë kafshatën që fut në gojën e tij?.. Kur udhëtarët e mëshirshëm arrijnë në vendin bujtinës, nuk mund të flejë derisa të vijnë edhe udhëtarët e tjerë që kanë mbetur pas. Kur gomari i dikujt, i ngarkuar me ferra ngelet në baltë, hidhërohet edhe zemra e sulltanëve të vërtetë.”

Ja pra, kjo është edhe gjendja e sulltanëve të zemrave. Zemrat e tyre të ndjeshme, nuk hidhërohen vetëm për vuajtjen e njeriut, që është më fisniku i krijesave, por edhe për vuajtjen e çdo krijese tjetër.

Njëherë, Profeti ynë ﷺ, rastisi një person që po e tërhiqte delen për veshi duke e çuar për ta therur. Zemra e tij nuk mundi ta pranojë këtë, prandaj ndërhyri menjëherë, duke i thënë:

“*Lëshoje veshin e kafshës dhe mbaje nga ana e qafës!*”

(Ibn-i Maxhe, Zebaih, 3)

Po ashtu, njëherë tjetër, Profeti ﷺ, rastisi një grup njerëzish në rrugë, të cilët bisedonin me njëri-tjetrin, duke qëndruar ulur mbi kafshë. Ai u tha:

“Hipni mirë mbi kafshët tuaja pa i lodhur ato dhe rehatojini sa më mirë. Mos i bëni ato podiume të bisedave tuaja në rrugë e në sokakë. Ka shumë kafshë që u hipet, të cilat janë më të dobishme se ata që i hipin në kurriz. Ato e përmendin Allahun e Madhëruar më shumë se ata.”

(Ahmed, III, 439)

Këto fjalë profetike, janë porosi të mrekullueshme në lidhje me mënyrën e shikimit të krijesave. Përveç kësaj, në një kohë kur njerëzit janë larguar nga ndjesitë shpirtërore, ku jetojnë nën sundimin e materializmit dhe ia kanë kaluar edhe hienave për egërsi, ata pretendojnë për të drejtat e kafshëve, duke u munduar t'i marrin ato në mbrojtje. Mirëpo, në lidhje me këtë çështje, Islami është shembulli më i mirë i shpërndarjes së drejtësisë, dhembshurisë dhe mëshirës.

Omer bin Abdulazizi kishte një mushkë, të cilën ia besonte një punëtori për të punuar në treg dhe me paratë e saj siguronte nevojat e veta. Një ditë, punëtori që punonte me mushkën, solli më tepër para se çdo herë tjetër. Kur e pyeti punëtorin se pse kishte sjellë më tepër para se herët e tjera, ai u përgjigj:

“Tregu ishte i mbushur plot me njerëz dhe kishte me tepër begati.” Mirëpo, Omer bin Abdulazizi nuk u kënaq me këtë përgjigje dhe i tha punëtorit:

“Jo, s’është ashtu! Ti e ke përdorur më shumë kafshën dhe e ke lodhur. Prandaj, do ta lësh mushkën të pushojë tre ditë.”

Në zemrën e Omerit ﷺ, kishte zënë vend vetëdija se çdo krijesë është një amanet hyjnor dhe se çdo myslimani është përgjegjës për çdo gjë me aq sa ka mundësi. Këtë, ai e ka shprehur duke thënë: “Nëse një dele bie dhe mbytet në ujin buzë lumit Tigër, Allahu do t’i kërkojë llogari Omerit.”

Po ashtu, edhe i nderuari Sufjan Sevri, ishte shumë i mëshirshëm ndaj krijesave. Një ditë, pa një zog në treg, të cilin e kishin mbyllur në një kafaz, ku këndonte vazhdimisht. Ai e bleu atë dhe e la të lirë. Më pas, ky zog vinte çdo natë në shtëpinë e Sufjanit dhe e sodiste atë ndërkohë që ishte duke falur namaz. Ndonjëherë i qëndronte tek supi. Madje, ai erdhi edhe kur Sufjani ndërroi jetë. Mirëpo, kur nuk e gjeti, shkoi tek varri i tij, ku dha shpirt edhe vetë. Atë moment, u dëgjua një zë si pëshpërimë: “Për shkak të mëshirës që kishte ndaj krijesës së Allahut të Madhëruar, edhe Allahu e mëshiro shumë Sufjanin.”⁸⁶

Ndonjëherë, edhe një mirësi që duket e vogël dhe e parë-ndësishme, mund të bëhet shkak i mëshirës së Allahut dhe mirësive të Tij të panumërta. Për këtë arsye, nuk duhet anashkaluar asnjë mirësi e vogël që pandehet si e parëndësishme. Kjo, sepse në botën tjetër, njeriu ka nevojë për çdo mirësi, e vogël apo e madhe qoftë.

Njëherë, një nga sahabët e nderuar, **Ebu Derda** ﷺ, ishte duke mbjellë pemë në Sham (Damask). Pranë i erdhi një person dhe i tha i habitur:

“Megjithëse je miku i Profetit ﷺ, ti merresh me mbjelljen e pemëve!?”

Mirëpo, Ebu Derda ﷺ, personit që e kishte përçmuar punën që po bënte, i tha:

86. Evliyyalar Ansiklopedisi, c. 11, sf. 65.

“Prit pak, mos gjyko kaq lehtë në lidhje me mua! Unë e kam dëgjuar Resulullahun ﷺ, të thotë:

«Nëse dikush mbjell një pemë dhe prej frutave të saj hanë njerëzit apo çdolloj krijese e Allahut, për personin që ka mbjellë atë pemë do të ketë shpërblim.» (Ahmed, VI, 444)

Natyrisht që, edhe e kundërta e kësaj, pra të dëmtosh bimët dhe gjallesat e tjera, është një sjellje që shkakton gjynah.

Në shoqëritë Islame, parimi i mëshirës ndaj krijesave për hir të Krijuesit, është institucionalizuar me anë të ngritjes së vakëfeve. Qëllimi i tyre, është ardhja një ndihmë në mënyrë bujare, të gjitha gjallesave nevojtare, duke fituar kënaqësinë e Allahut me mëshirën dhe dhembshurinë ndaj tyre.

Të parët tanë -me aq sa është mundur të evidentohet-, kanë ngritur njëzetegjashtëmijë e më tepër vakëfe, në sajë të të cilave i kanë shërbyer njerëzve, kafshëve, e maje edhe bimëve, duke i konsideruar të gjitha krijesat si amanet hyjnor. Kjo, është një detyrë shumë e rëndësishme, që sot duhet t'i dalim për zot.

Sipas moralit islam, të gjitha krijesat i janë vënë në shërbim njeriut dhe për rrjedhojë, ato janë amanete hyjnore në dorë të tij. Në ditën e kijametit, ato do të ringjallen dhe do të marrin të drejtat e tyre prej njerëzve që u kanë bërë padrejtësi. Nisur nga kjo, nuk duhet harruar se, zogjtë apo peshqit e kafshët e tjera që mbahen në kafaze për bukuritë e ngjyrave e të zërit të tyre, veçanërisht në ditët tona, nesër në ditën e kijametit do t'i dalin para njeriut, i cili do të japë llogari për to. Gjithashtu, edhe ndeshjet me kafshë apo shpendë që bëhen në shumë vende të botës, janë gjynahe për të cilat do të jepet llogari në botën tjetër.

Shkurtimisht, Allahu i Madhëruar, e ka nderuar birin e Ademit ndër të gjitha krijesat e tjera, e ka fisnikëruar atë dhe çdo gjë e ka vendosur në shërbim të tij. Nisur nga kjo, gjithçka i është lënë amanet atij. Ai, është përgjegjës -sipas mundësisë-, për çdo krijesë në dete, tokë apo në ajër. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Për këtë arsye, të sillesh mirë me çdo krijesë të gjallë apo jo, të përdorësh me mirësjellje, kujdes dhe respekt, pa e shpërdoruar sipas dëshirave të egos sonë çdo gjë që është lënë në menaxhimin tonë për një periudhë të përkohshme, është një tregues i dashurisë dhe mirënjohjes ndaj Allahu të Madhëruar, i Cili na i ka dhuruar ato.

Çdo hollësi që binte në sy prej gjendjes dhe veprave të mësuesit tonë **Musa Efendisë**, si veshja, ngrënja e pirja, e deri tek mbajtja e gotës, ishte një shprehje e ndjeshmërisë dhe konsiderimit të gjithçkaje si amanet i Zotit. Po ashtu, përveç rëndësisë që tregonte ndaj njerëzve nevojtarë, ai përpiqet që me bujarinë dhe mëshirën e tij, të kujdesej edhe për macet, qentë, madje edhe për pulëbardhat që vinin rrotull apo strehoheshin në kopshtin e tij.

Një besimtar i mëshirshëm, për ta mbushur librin e punëve të tij me mirësi, duhet ta përdori kapitalin e jetës së tij në mënyrën më të dobishme, duke u përpjekur të vlerësojë çdo mundësi mirësie që i del përballë. Siç është shprehur edhe **Ebu Bekri** رضي الله عنه:

“Kjo botë, është tregu i besimtarit: Netët dhe ditë janë kapitali i tij, punët e mira janë malli i tregtisë, xheneti është fitimi, ndërsa xhehenemi është humbja e tij.”

Pra, para njeriu ka dy rrugë: Xheneti për të mirët dhe xhehenemi për të këqijtë. Në këtë botë, treguesi më i qartë i të këqijve të botës tjetër, është mungesa e mëshirës. Në një hadith fisnik, thuhet: “*Mëshira, merret vetëm prej zemrës së të keqit.*” (Tirmidhi, Birr, 16/1923)

Allahu i Madhëruar i bëftë zemrat tona burim të begatë të mëshirës dhe dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit! Po ashtu, na bëftë të gjithë robër të mirë, prej dorës, gjuhës, veprës dhe fjalës së të cilëve kanë dobi të gjitha krijesat! Allahu na mëshiroftë të gjithëve me mëshirën e Tij të pafundme!

Amin!..





اللهم احشردا صرة الحارنا

Horizonti i begatisë në qëndrimin me njerëzit e mirë

I nderuari Imam Gazaliu, ka thënë:

"Biri im! Nëse ka diçka për të cilën duhet të bësh kujdes të jashtë-zakonshëm, është çështja se me kë shoqërohesh. Dije mirë se, një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjë të mirë një mollë të prishur midis tyre. Mirëpo, kjo mollë e prishur, mund t'i prishë edhe të tjerat. Për këtë arsye, qëndro gjithmonë me njerëzit e mirë!"



Njerëzit e mirë reflektojnë paqe dhe qetësi në zemra, ndërsa gjynahqarët reflektojnë shqetësim dhe ngushtësi. Një fllad ere, që fryn mbi një kopsht të zbukuruar me lule të bukura dhe aromë të mirë, si trëndafilat dhe karafilat, kudo që shkon, shpie edhe aromën e tyre që kënaq zemrat e njerëzve. Ndërsa një erë që fryn mbi kalbësira me erë të keqe, do t'i përhapë ato aroma të këqija kudo përreth. Në këtë mënyrë, ajo ua zë frymën dhe ua ngushton kraharonin njerëzve. Për rrjedhojë, edhe miqësia me njerëzit e këqij dhe gjynahqarë, bëhet kanceri i jetës shpirtërore.



HORIZONTI I BEGATISË NË QËNDRIMIN ME NJERËZIT E MIRË

Për besimtarin, është fati i madh të shoqërohet me njerëzit e mirë dhe të dashurit e Allahut. Të njohësh të dashurit e Allahut dhe njerëzit e shpirtit, të jesh pranë apo rreth tyre dhe të përfitosh prej frymëzimit shpirtëror të gjendjes dhe veprave të tyre, është një mirësi e madhe Allahut të Madhëruar, e cila duhet falënderuar në mënyrë të veçantë.

NDIKIMI SHPIRTËROR

Kur dikush shëtit në një kopsht me trëndafila, aroma e trëndafilave do të ngjitet edhe tek ai. Po kështu, edhe në zemrat e atyre që ndodhen në shoqërinë e njerëzve të mirë, do të reflektohet frymëzimi shpirtëror i atyre njerëzve të mirë. Kjo, sepse gjendja shpirtërore, është ngjitëse dhe përhapet. E, në mënyrë të veçantë, kjo gjë vërehet në gjendjen shpirtërore të njeriut. Për rrjedhojë, zemrat janë në një marrëdhënie të vazhdueshme ndikimi.

Nga kjo pikëpamje, shoqërimi me besimtarët e mirë dhe të sinqertë, në edukimin e egos, ka një ndikim si valët e radios, që nuk mund të shihen, por kanë rezultat absolut.



Dijetari **Xhafer bin Sulejmani** -rahmetullahi alejh-, frymëzimin shpirtëror që i ka dhënë shoqërimi me njerëzit e mirë, e shpreh në këtë mënyrë:

“Kur ndjeja ngurtësim të zemrës, ngrihesha dhe shkoja menjëherë tek **Muhamed bin Uasi**⁸⁷. Merrja pjesë në tubimet e tij dhe e shihja në fytyrë. Në këtë mënyrë, kalonte ngurtësia e zemrës sime, më lindte dëshira për adhurime, më largohej dembelizmi dhe me këtë entuziazëm kryeja adhurime për një javë të tërë.”

Për këtë arsye, besimtari duhet t'i japë shumë rëndësi qëndrimit me dijetarët, të urtët, të mirët dhe të singertët, duke qenë i vetëdijshëm se kjo është një nga ushqimet e veçanta të ekzistencës shpirtërore. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!” (Teube, 119)

Nëse shihet me kujdes, në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar, ka thënë “qëndroni me të singertët që të ruani devotshmërinë”. Kjo, sepse hapi i parë të t'u bërë i drejtë dhe i singertë, është të shoqërohesh me të singertët.

Shumë prej sahabëve, të cilët janë edhe yjet e qiellit të Islamit, në kohën para Islamit, kanë bërë një jetë gjysmë të egër, në kundërshtim me natyrën njerëzore. Mirëpo, pasi u nderuan me Islam, qëndrimi në atmosferën e gjerë të dashurisë ndaj Resulullahut ﷺ, morali profetik reflektoi edhe tek ata dhe i shndërroi në njerëzit më të virtutshëm të botës.

Dashuria, singëriteti, përpjekja dhe sakrifica që shfaqën ata në shoqërimin me Profetin ﷺ, është një legjendë e papër-

87. Një prej të mëdhenjëve të tabiinëve.

sëritshme. Kjo, sepse për të qenë së bashku me Resulullahun ﷺ, ata nuk u kursyen të paguajnë çfarëdolloj çmimi, si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë lufte.

Për rrjedhojë, në betejën e Uhudit, disa prej muhaxhirëve dhe ensarëve, e rrethuan Resulullahun ﷺ, të cilin e donin më tepër se shpirti i tyre dhe duke u betuar se do të binin dëshmor para tij, thanë:

“Fytyra ime, do të jetë mburojë para fytyrës tënde dhe trupi im do të flijohet për trupin tënd! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë me ty! Nuk do të ndahemi kurrë prej teje o Resulullah!”

(Ibn-i Sa'd, II, 46; Uakidi, I, 240)

Ndërsa në betejën Zatu'r-Rika, sahabët hipnin gjashtë vetë me radhë në një deve dhe nga ecja në këmbë, u shpoheshin shputat dhe u binin thonjtë. Këmbët e gjakosura e plot plagë, i lidhnin me copa bezesh dhe shkonin pas Resulullahun ﷺ.

(shih. Buhari, Megazi, 31)

Po ashtu, edhe gratë sahabe, i qortonin ashpër bijtë e tyre të cilët vonoheshin të shkonin tek Resulullahu apo kishin një kohë të gjatë që nuk takoheshin me të dhe në lidhje me këtë çështje nuk lejonin të neglizhohej asgjë.

Shkurtimisht, me qëllim që zemra të ruhet prej dashurive të kësaj bote dhe të jetë vazhdimisht e nxitur në punë të mira, është e detyrueshme të shoqërohesh me njerëz dijetarë, të urtë, të mirë e të sinqertë, për të përfituar shpirtërisht prej tyre. Kjo, e ndihmon njeriun të rigjenerohet shpirtërisht dhe të fitojë energji të reja. Të shohësh besimtarët e mirë e punëtor e të frymëzohesh prej tyre dhe të zgjohesh nga gjumi i indiferentizmit duke marrë mësim prej njerëzve të virtytshëm, është me të vërtetë një nevojë e madhe. Kjo është edhe arsyeja



që në tasavuf, i cili është një metodë e edukimit shpirtëror, është domosdoshme të marrës pjesë nëpër biseda fetare për të plotësuar minimumin e kriterit të qëndrimit me njerëzit e mirë e të sinqertë.

MOS U SHOQËRO ME NJERËZIT E KËQIJ!

Të parët tanë, ka thënë: “Eliminimi i së keqes, është më i mirë se fitimi i së mirës”. Pra, të largosh të keqen, është shumë më e rëndësishme se sa të fitosh një mirësi. Për rrjedhojë, të ruhesh nga e keqja e njerëzve të këqij e gjynahqarë, është një domosdoshmëri që vjen para përfitimit shpirtëror në qëndrimin me njerëzit e mirë e të sinqertë. Në një prej këshillave të tij, Imam Gazaliu, ka thënë:

“Biri im! Nëse ka diçka për të cilën duhet të bësh kujdes të jashtëzakonshëm, është çështja se me kë shoqërohesh. Dije mirë se, një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjë të mirë një mollë të prishur midis tyre. Mirëpo, kjo mollë e prishur, mund t’i prishë edhe të tjerat. Për këtë arsye, qëndro gjithmonë me njerëzit e mirë!”

Sa bukur e ka shprehur Profeti ﷺ, rëndësinë e qëndrimit me të sinqertët dhe ruajtjes nga përzjerja me gjynahqarët:

“Shembulli i shokut të mirë dhe atij të keq është si ai që bart aromë të mirë me atë që punon si farkëtar. Mbartësi i aromës së mirë ose do të dhurojë një aromë të mirë, ose do t’ia blesh, ose atij do t’i vijë aromë e mirë. Ndërsa farkëtari, ose do të djegë rrobat, ose do të ngjisë erën e keqe.” (Buhari, Buju, 38)

Siç shihet, prirjet shpirtërore të njeriut -pak apo shumë-patjetër ndikojnë tek ata që ndodhen pranë tij. Mbi të gjitha, ndikimi nuk varet aspak nga fakti se gjendja është pozitive apo

negative. Sido që të jetë, ndikimi ndodh patjetër. Mjafton që kjo shoqëri të ketë lidhje “dashurie” dhe “miqësie”.

Njerëzit e mirë reflektojnë paqe dhe qetësi në zemra, ndërsa gjynahqarët reflektojnë shqetësim dhe ngushtësi. Një fllad ere, që fryn mbi një kopsht të zbukuruar me lule të bukura dhe aromë të mirë, si trëndafilat dhe karafilat, kudo që shkon, shpie edhe aromën e tyre që kënaq zemrat e njerëzve. Ndërsa një erë që fryn mbi kalbësira me erë të keqe, do t'i përhapë ato aroma të këqija kudo përreth. Në këtë mënyrë, ajo ua zë frymën dhe ua ngushton krahërorin njerëzve. Për rrjedhojë, edhe miqësia me njerëzit e këqij dhe gjynahqarë, bëhet kanceri i jetës shpirtërore.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, në lidhje me ruajtjen prej gjynahqarëve që përhapin gjithmonë ndikim të keq rreth vetes, urdhëron:

“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër! E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri me keqbërësit!” (En’am, 68)

KUR KRITEREVE U SHTOHEN DETAJET...

Ashtu siç ndodh në çdo çështje, kur rritet kujdesi në çështjen e shoqërimit me të sinqertët dhe largimit prej gjynahqarëve, shtohen edhe detajet e kriterëve dhe shfaqen shumë gjëra që jo të gjithë mund t’i vënë re. Një shembull i kësaj, është edhe kjo ndodhi mbresëlënëse:

Baba Sejfiu, ishte një prej admiruesve të **Sami Efendisë**. Ai ishte i devotshëm dhe kishte urtësi shpirtërore. Ai banonte



në Topkapë⁸⁸. Një ditë, ai shkoi në Erenkoj për të vizituar Sami Efendinë. Mirëpo, sapo hyri në shtëpinë e tij, i ra të fikët. Personi që po e priste për ta shoqëruar tek Sami Efendia, i shqetësuar jashtëmase, pasi e solli në vete duke i hedhur ujë, i tha:

“Po thërrasim menjëherë një doktor!” Mirëpo, Baba Sejfiu, ashtu i këputur si ishte, ndërhyri e tha:

“Jo mor bir! Mos e thërrisni doktorin. Gjendja ime s’ka të bëjë me asnjë sëmundje fizike. Njerëzit gjynahqarë që rastisa rrugës prej Topkapës e deri në Erenkoj, ma shqetësuan shpirtin. Kur hyra në këtë derë të pastër dhe ndjeva frymëzimin shpirtëror në këtë ambient, zemra ime s’duroi dot më. Edhe pak dhe do të vijë në vete prej begatisë së kësaj atmosfere shpirtërore dhe kujdesit të njeriut të zemrave, Sami efendisë.”

Ndikimi i gjendjeve shpirtërore, ndihet shumë edhe gjatë qëndrimit të pavullnetshëm me persona të ndryshëm. Për rrjedhojë, ky lloj ndikimi është i paimagjinueshëm kur një besimtar i mirë qëndron me dëshirë dhe vullnet të plotë me njerëz të këqij e gjynahqarë. Mangësia e kujdesit që tregohet lidhur me këtë çështje, mund ta çojë njeriun në një humbje të përjetshme. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Njeriu, është bashkë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96)

Pra, njeriu do të ringjallet në ditën e kijametit me ata persona që do dhe shoqërohet më tepër.

Shejh Sadi Shirazi, lidhur me faktin se si mund ta ndryshojë jetën e një njeriu ndikimi shpirtëror, na jep këtë shembull:

88. Një lagje e Stambollit

“Qeni i As’hab-i Kehfit, fitoi nder të madh për shkak se qëndroi me njerëzit e mirë e të singertë. Fama e tij u shënua edhe në Kuranin Fisnik. Ndërsa gruaja e profetit Lut عليه السلام, ra në mohim për shkak se shoqërohej me gjynahqarët.”

Lidhur me këtë çështje, Ubejdullah Ahrar, i ka paralajmëruar kështu ata që e donin atë:

“Të qëndrosh me indiferentët dhe moskokëçarësit, e mërzi zemrën dhe e shpërqendron shpirtin.”

Një ditë, Bejazid Bistami, ndjeu një shqetësim, prej të cilit nuk po shpëtonte dot. Personave që ndodheshin në tubim u tha:

“Pa shikoni njëherë, a ka ndonjë të huaj midis nesh?”

Të pranishmit kontrolluan por nuk gjetën njeri. Mirëpo, Bejazid Bistami këmbënguli dhe tha:

“Kërkoni mirë. Shikoni edhe në vendit e bastunëve!”

Ata kontrolluan përsëri dhe gjetën bastunin e një personi indiferent ndaj fesë, të cilin nxorën menjëherë jashtë. Pas kësaj, Bejazid Bistamit iu qetësua përsëri zemra.

Kjo situatë, është treguesi më i qartë i faktit se edhe sendet ndikojnë në gjendjen shpirtërore. Duhet menduar se, nëse zemra dhe shpirti ngushtohen edhe prej sendeve të njerëzve gjynahqarë e të këqij, është e domosdoshme të ruhesh edhe prej përzierjes me ta!

Shkurtimisht, ashtu siç shfaqen ndikime negative prej njerëzve indiferentë, të cilat e ngushtojnë zemrën, ashtu shfaqen edhe ndikimi pozitive prej njerëzve të mirë, të cilat e qetësojnë zemrën. Me të vërtetë që, në sajë të begatisë që sjell lidhja shpirtërore me të singertët, mund të arrihen shumë përfiti-



me shpirtërore. Mirëpo, qëllimi i shoqërimit me të sinqertët, është bashkimi i zemrave. Në fakt, bashkimi i zemrave mund të mos realizohet në çdo rast. Edhe pse bashkimi fizik mund realizohet, nga kjo nuk mund të arrihet asnjë përfitim nëse nuk realizohet bashkimi shpirtëror. Për këtë shkak, synimi i shoqërimit me njerëzit e mirë e të sinqertë, është bashkimi në aspektin shpirtëror. Pra, që përballë jetës dhe ndodhive të ndryshme, të mund të shfaqësh sjelljen e njerëzve të mirë e të sinqertë. Nëse realizohet një bashkim i tillë, atëherë arrihet dobi edhe prej bashkimit fizik. Gjithashtu, nëse ekziston një bashkim shpirtëror, nuk ka qeder prej ndarjeve fizike.

Nga ana tjetër, ekzistojnë disa metoda të bukura për arritjen e frymëzimit shpirtëror që shpresohet të fitohet prej shoqërimit me njerëzit e sinqertë. Një prej këtyre, është edhe begatia që pritët prej shoqërimit me ta.

ENTUZIAZMI I BEGATISË

Begatia, është një rezultat i natyrshëm i dashurisë së besimit që ndjehet ndaj Allahut të Madhëruar dhe i respektit që ndjehet ndaj të gjitha krijesave që janë të afërta me Të. Dashuria që ndjehet për një qenie, reflektohet tek gjithçka që është shkak i asaj dashurie apo që ka lidhje me të. Ai që dashuron, do çdo gjë që ka personi që dashuron.

Në jetën e Profetit ﷺ, kanë ndodhur shumë raste kur sahabët kanë kërkuar begati tek Profeti ﷺ dhe sendet e tij. Këto raste janë përmendur edhe në librat e haditheve dhe të Sijerit⁸⁹. Madje, sahabët e nderuar dhe pasardhësit e tyre, kanë kërkuar begati edhe tek mburoja, bastuni, shpata, unaza,

89. Sijer: Historia e jetës së Profetit ﷺ.

qimet e flokut dhe mjekrës, këpucët, enët e ushqimit dhe ujit, veshjet e tij, etj. Të gjitha këto, janë mbledhur në një kapitull të veçantë në librin me hadithe të Buhariut.⁹⁰

Enes bin Maliku رضي الله عنه, tregon se si garonin sahabët me njëri-tjetrin në kërkimin e begatisë prej flokëve të Profetit ﷺ:

“Njëherë e pashë Resulullahun ﷺ, të qethej tek berberi. Ndërsa sahabët ishin mbledhur si flutura rreth tij dhe përpiqeshin që asnjë fije e flokut të tij të mos binte në tokë por në dorën e ndonjërit prej tyre.” (Muslim, Fedail, 75)

Një nga shembujt më të bukur të kërkimit të begatisë me anë të ndonjë sendi që i përkiste Profetit ﷺ, është edhe Halid bin Uelidi رضي الله عنه, i cili kishte fshehur disa fije të flokëve të Profetit ﷺ në çallmën e tij.

Sipas transmetimit, kur Profeti ﷺ, preu flokët në haxhin e lamturmirës, Halid bin Uelidi رضي الله عنه, iu lut profetit ﷺ, duke i thënë:

“O Resulallah! Ma jep mua pjesën e ballukeve! Mos ia jep askujt tjetër para meje! T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im!”

Profeti ﷺ, e pranoi kërkesën e tij dhe pasi u lut që ai të korrte gjithmonë fitore ia dha disa fije nga balluket e veta. Kur flokët iu dhanë atij, ai fërkoi sytë me to dhe i vendosi në pjesën e parme të çallmës. Në sajë të duasë së Profetit ﷺ, ai korri fitore në çdo betejë. Madje, sipas një transmetimi, Halid bin Uelidi رضي الله عنه, ka thënë: “Në cilëndo anë që e kam drejtuar atë (flokun), ai vend është çliruar.” (Uakidi, III, 1108; Ibn-i Esir, Usdu'l-Gabe, II, 111)

Gjithashtu, Profeti ﷺ, ia ka dërguar Vejsel Karanit mantelin e vet dhe ka thënë:

90. Shih. Buhari, Fardu'l-Humus, 5.

“Le ta veshë këtë dhe të lutet për umetin tim!” (Muslim, Fedailu’-Sahabe, 223-225)

Ndërsa e bija e Ebu Bekrit ؓ, Esma ؓ, nxorri një xhybe dhe tha:

“Kjo ka qenë xhybja e Resulullahut ؐ. Këtë e ka mbajtur Aishja deri sa ndërroi jetë. Pasi ajo ndërroi jetë, xhyben e mora unë. Profeti e ka veshur këtë. Ndërsa ne e lajmë dhe ujin e saj e përdorim si shërim për të sëmurët.” (Muslim, Libas, 10)

Të gjitha gjendjet shpirtërore, të mira apo të këqija qofshin, ndikojnë edhe tek sendet edhe tek vendet. Për këtë arsye, besimtari mundësisht duhet të qëndrojë larg prej vendeve ku bëhen gjynahe apo vendeve ku është shfaqur ndëshkimi hyjnor. Përkundër kësaj, ai duhet të mundohet të përfitojë prej vendeve ku kryhen punë të mira dhe vendet ku është shfaqur mirësia hyjnore. Kjo ndodhi, e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:

Profeti ؐ, së bashku me sahabët e tij vendosën të pushonin në një zonë ku njëherë e një kohë kishte jetuar populli i Themudit. Sahabët morën ujë prej puseve të atij vendi për të kryer nevojat e veta. Po ashtu, me këtë ujë gatuan edhe brumë për bukë. Mirëpo, Profeti ؐ, i urdhëroi ata t’i derdhnin enët me ujë dhe t’ua jepnin deveve brumin e gatuar. Më pas, u tha të merrnin ujë nga pusi ku kishte pirë deveja e Profetit Salih ؑ. (shih. Buhari, Enbija, 17; Muslim, Zuhd, 40)

Gjithashtu, Profeti ؐ, ka thënë:

“Uhudi është një mal, që na do dhe e duam. Nëse ju bie rruga andej, hani prej frutave të pemëve të tij, edhe nëse janë me gjemba.” (Buhari, Xhihad, 71, 74, Et’ime 28)

Në këtë hadith, Profeti ﷺ, ka këshilluar të përfitohet prej begative të pemëve që ndodhen përreth malit të Uhudit. Gjithashtu, në vendet ku gjenden njerëzit e mirë dhe bëhen vepra të mira, zbret mëshira hyjnore. Në atë vend mbledhen melekët dhe personat që ndodhen aty i kaplon paqja dhe qetësia. Në vende të tilla, duhet përfituar prej begatisë shpirtërore që gjendet aty, duke iu drejtuar Allahut me lutje dhe kërkim faljeje.

Sahabët fisnikë, kanë përfituar nga begatia e Profetit ﷺ dhe çdo gjëje që i përkiste atij. Të pinin nga ena ku kishte pirë ai, të preknin atë që kishte prekur dora e tij e bekuar, t'i merrnin erë djersës së tij me aromë trëndafili apo të mbanin si kujtim fijen e flokut dhe të mjekrës së tij, ua freskonte dashurinë dhe besën që i kishin dhënë, ua hiqte sadopak mallin për të dhe u jepte zemrave të tyre një kënaqësi të veçantë.

Sipas të gjitha këtyre transmetimeve, kuptohet se përfitimi prej begatisë së Profetit dhe sendeve që i përkisnin atij, ishte diçka e njohur ndër sahabët dhe e lejuar. Veprimi në këtë mënyrë i shumë sahabëve, aprovimi i kësaj nga ana e Profetit, madje ndonjëherë edhe nxitja apo këshilla e tij për këtë, janë tregues të qartë të këtij fakti.

Edhe brezi pas sahabëve ka vazhduar ta mbajë gjallë këtë metodë të kërimit të begatisë. Disa shembuj të ndjenjës së dashurisë që tregonte një nga autoritetet e larta të hadithit, Ahmed bin Hanbeli, na e tregon djali i tij Abdullahu:

“Babai im merrte një prej fijeve të flokut të Resulullahut ﷺ dhe e puthte. Unë e kam parë babai tim ta vendosë fijen e flokut të Resulullahut në sytë e tij. Ai e fuste në ujë fijen e flokut të Resulullahut dhe e pinte atë ujë. Me këtë ujë kërkonte shërim prej Allahut.



Një ditë, babai mori tasin e ujit të Resulullahut ﷺ, e lau brenda një kove dhe pastaj piu ujë prej saj.

Gjithashtu, ai pinte ujë Zemzemi për qëllim shërimi. Pastaj fërkonte duart dhe fytyrën me të.” (Dhehebi, Sijeru A'lami'n-Nubela, Beirut 1986-1988, XI, 212)

DASHURIA ËSHTË KUSHT!..

Sekreti i përfitimit prej begatisë së gjërave që kanë lidhje me Resulullahun ﷺ, është dashuria e vërtetë që ndihet për të. Ndërsa treguesi më i madh i dashurisë, është të jetosh në rrugën e drejtë me sakrificë dhe bindje ndaj tij. Nëse ekziston një dashuri e tillë, mund të përfitohet edhe prej begatisë së tij. Përndryshe, sendet që kanë lidhje me Resulullahun ﷺ, ngelen vetëm gjëra të rëndomta. Njësoj si këmisha e Profetit Jusuf ﷺ, erën e së cilës e ndjeu babai i tij, Jakubi ﷺ, që prej zonës së Kenanit dhe nuk e ndjeu vëllai i tij që po e bartte atë amanet të shenjtë.

Mevlana, këtë ndodhi e shpjegon në këtë mënyrë:

“Jakubi ﷺ, kishte një dobësi të madhe ndaj Jusufit ﷺ. Për këtë arsye, ai e ndjeu erën e këmishës së Jusufit ﷺ, që prej një vendi të largët. Ndërsa vëllai që po e bartte këmishën, ishte i privuar nga kjo ndjesi. Kjo, sepse këmisha e Jusufit ﷺ, ishte një amanet në dorën e të vëllait, i cili kishte vetëm detyrën për t'ia çuar atë babait të tij, Jakubit ﷺ. Pra, ajo këmishë ishte vetëm si një robëreshë e zgjedhur në dorën e tregtarit të skllëvërve dhe jo për vet tregtarin...”

Shkurtimisht, kushti i përfitimit prej begatisë, është dashuria e vërtetë. Përndryshe, ata që janë të pavetëdijshtëm ndaj një thellësie të tillë shpirtërore, privohen edhe prej begatisë së mirësive me të mëdha.

MOS E KTHE MJETIN NË QËLLIM!..

Duhet të theksojmë se, dobia e sendit që kërkohet të përfitohet prej begatisë së tij, është në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Allahut, që Ai ua fal njerëzve për shkak të dashurisë së besimit dhe respektit ndaj Resulullahut ﷺ. Ai që fal mëshirë dhe begati, nuk është vet sendi, por Allahu i Madhëruar. Nëse Allahu nuk ia jep begatinë atij sendi, ai nuk vlen asgjë. Për këtë arsye, në këtë çështje duhet bërë kujdes prej teprimeve, duke treguar maturi. Pra, është e domosdoshme që sendeve të mos u jepen fuqi hyjnore, duke pretenduar mirësi e begati prej tyre, e mbi të gjitha duke mos qenë as në rrugë të drejtë.

Mirëpo, është plotësisht e gabuar ta mohosh këtë lloj begatie, duke u arsyetuar me ata që e teprojnë në këtë çështje. Madje, është injorancë të thuhet se kjo praktikë nuk ka ekzistuar në kohën e profetit dhe të sahabëve, duke e quajtur atë “bid’at” apo “shirk”. E rëndësishme, është të mbash rrugën e mesme. Shkaktari absolut i çdo gjëje, është Allahu i Madhëruar. Ndërsa sendet prej të cilave pritet begati, janë thjesht mjete të mëshirës, faljes dhe mirësisë së Allahut. Ashtu si mjeti ku hipet për të udhëtuar, nuk është qëllimi i udhëtimit, ashtu edhe sendet apo njerëzit prej të cilëve pritet begati, nuk janë qëllimi por vetëm mjeti apo shkaku me të cilën kërkohet begatia dhe mëshira e Allahut.



Allahu i Madhëruar, na e mundësoftë që në këtë botë të jemi bashkë me njerëzit e mirë e të sinqertë si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Po ashtu, na e mundësoftë të ringjallemi bashkë me ta edhe në ditën e kijametit. Allahu na bëftë prej robërve të mençur e të urtë, të cilët vlerësojnë siç duhet çdo mundësi që të afron me Të.

Amin!..





Mënyrat e asfrimit me Allahun

Rrugët që të çojnë tek Allahu, janë të shumta. E rëndësishme, është që ne të jemi të vetëdijshëm për mundësitë që vijnë prej Allahut, të cilat do të na afrojnë po me Allahun dhe të përfitojmë siç duhet prej tyre. Nëse zemra e robit kërkon të drejtën dhe të vërtetën, Allahu do t'ia bëjë të mundur t'i shohë mundësitë që do ta afrojnë me Të.



Përveç profetëve dhe atyre që kanë paralajmëruar profetët, askush nuk e ka të garantuar se do ta japi frymën e fundit me besim. Për këtë arsye, besimtari duhet ta kalojë jetën me këtë shqetësim, duke u përpjekur të jetojë çdo frymëmarrje nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit. Ai nuk duhet ta lëshojë kurrë nga zemra dhe gjuha e tij, përgjërimin: "... (o Zot!) bëj që të vdes si mysliman dhe më bashko me punëmirët (në botën tjetër)!" (Jusuf, 101.)

MËNYRAT E AFRIMIT ME ALLAHUN

Ai që dashuron, përdor çdo mënyrë a rrugë për të arritur njeriun që dashuron. Ai mundohet të përfitojë prej çdo mundësie për arritur dashurinë dhe kënaqësinë e njeriut më të dashur dhe nuk dëshiron të humbë asnjë mundësi për të arritur këtë qëllim.

Po kështu, edhe një i dashuruar me Allahun, që e ka zemrën të mbushur me dashurinë e besimit, përpiket të përdorë çdo mënyrë për të arritur kënaqësinë dhe afërsinë me Allahun. Këtë, e urdhëron edhe Allahu në Kuranin Fisnik:

“O besimtarë! Kini frikë Allahun dhe kërkonit mënyra që t’i afroheni Atij!..” (Maide, 35)

Padyshim se, mënyrat më të mira për të arritur këtë, janë ato që e shpien njeriun në qëllimin e krijimit të vet dhe në kënaqësinë e Allahut. Në krye të këtyre vijnë Kurani Fisnik, adhurimet, veprat e mira, përmendja e Allahut me emrat e Tij të bukur, salavatet ndaj Profetit ﷺ, vizita e vendeve të shenjta, adhurimi në kohët e këshilluara nga Kurani dhe Suneti, etj.



MËNYRAT E ARRITJES TEK ALLAHU

Mënyrat që e shpien robin tek Allahu, janë të shumta. Zoti ynë i Madhëruar, na dhuron shumë mundësi që na çojnë drejt mirësive dhe mëshirës së Tij. Këto mundësi, e shpien njeriun tek e drejta dhe e vërteta, duke e ftuar atë në xhenetin e Allahut të Madhëruar. Për shembull:

- **Omeri** ﷺ, u nderua me Islam, në sajë të ajeteve fisnike që ai dëgjoi në shtëpinë e motrës së tij, Fatmës.

- **Bishr-i Hafi** shpëtoi prej jetës së tij të mëparshme ku jetonte veç për kënaqësinë e egos dhe arriti udhëzimin në rrugën e drejtë, në sajë të një cope letre që gjeti në rrugë, mbi të cilën shkruhej fjala “Allah”. Më pas, ai e mori atë copë letër si një xhevahir të rrallë, e pastroi dhe e vendosi në një vend të veçantë në shenjë respekti.

- **Kadiu Mahmud**, arriti të vërtetën, në sajë të çështjes gjyqësore të mbushur plot me të fshehta shpirtërore të një çifti. Ai e ndoqi me sinqeritet këtë çështje, e cila e çoi në derën e të nderuarit **Uftade**, ku zbuloi rrugën **Hydaji**, e cila shkonte në kulmin e njohjes së Allahut.

- **Mevlana**, e arriti gradën e lartë shpirtërore, në sajë të dritares së botës së dashurisë që i hapi një dervish me emrin **Shems**.

Shembuj si këta, mund t'i shtojmë edhe më tepër, sepse rrugët që të çojnë tek Allahu, janë të shumta. E rëndësishme, është që ne të jemi të vetëdijshëm për mundësitë që vijnë prej Allahut, të cilat do të na afrojnë po me Allahun dhe të përfitojmë siç duhet prej tyre. Nëse zemra e robit kërkon të drejtën dhe të vërtetën, Allahu do t'ia bëjë të mundur t'i shohë mundësitë që do ta afrojnë me Të.

Ebu'l-Hasan Harakani, thotë:

“Çfarëdo të jetë ajo gjë që bëhet shkak që robi të gjejë Allahun e Madhëruar, më e bukura prej tyre, është Kurani Fisnik. Pra, Allahun e Madhëruar, duhet ta kërkon në rrugën e Kuranit.” (Hadaiku'l-Uerdije, fq. 458)

Në fakt, Kurani është një litar i fortë, njëra anë se të cilit ndodhet në dorën e Allahut, ndërsa ana tjetër është lëshuar drejt nesh. Për këtë arsye, është e domosdoshme të kapesh fortë pas këtij litari, me qëllim që të arrish afërsinë me Allahun dhe mirësitë e Tij të pafundme.

Në traditën Islame, lutjet, fillohen me falënderim ndaj Allahut dhe salavate për Profetin ﷺ dhe po në këtë mënyrë përfundohen. Salavatet janë një dua për Profetin tonë ﷺ, drejtuar Allahut të Madhëruar, i Cili nuk e refuzon, por e pranon këtë dua. Kjo është edhe arsyeja që duatë tona i zbkurojmë me këto elemente në fillim dhe në fund. Pra, duke i vendosur duatë tona midis këtyre duave, shpresojmë që Allahu t'i pranojë ato.

Një nga mënyrat që mund ta bëjë të pranueshme duanë tonë, është edhe lutja me emrat e bukur të Allahut. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrni Atë (lutjuni Atij) me to!..” (A'raf, 180)

Përveç kësaj, kur Profeti ﷺ, i lutej Allahut të Madhëruar për shi, ai falte “namazin istiska”. Pra, me anë të namazit vullnetar, Profeti ﷺ, kërkonte që Allahut t'ia pranonte duanë. Lidhur me këtë, Allahu i madhëruar, urdhëron:

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!..” (Bekare, 153)



Gjithashtu, edhe veprat e mira, janë mënyra për të arritur mirësitë e Allahut dhe për të shpëtuar prej vështirësive. Si shembull për këtë çështje, mund të tregojmë hadithin që Profeti ﷺ, tregon për tre shokë nga popujt e shkuar, të cilët kishin dalë për të udhëtuar:

“Tre shokët, i zuri shiu gjatë udhëtimit dhe futen në një shpellë për të kaluar natën. Ndërkohë, nga mali bie një shkëmb që e zë hyrjen e shpellës. Dhe ata thonë:

- Nuk kemi zgjidhje tjetër veçse t'i lutemi Allahut me anë të punëve tona të mira. Përveç Allahut, askush s'na shpëton dot prej këtu!

Njëri prej tyre bën për pretekst bindjen ndaj prindërve. Shkëmbi lëviz pak nga vendi, por dalja nuk hapet.

I dyti bën për pretekst frikën ndaj Allahut, nderin dhe virtytin e vet. Shkëmbi lëviz edhe pak nga vendi, por dalja përsëri nuk hapet sa duhet.

Pastaj, i treti i lutet Allahut duke bërë pretekst respektin që kishte treguar ai gjer atëherë ndaj të drejtave të të tjerëve. Atëherë, shkëmbi rrëshqet plotësisht nga hyrja e shpellës, dalja hapet krejt dhe shokët dalin jashtë!” (Shih. Buhari, Edeb, 5, Enbija, 53; Dhikr, 100)

Përveç këtyre, është i mundur edhe kërkimi i mirësive prej Allahut, duke bërë si pretekst një person të mirë që është ende gjallë. Pra, duke i kërkuar atij të bëj dua për ty. Shembull për këtë, është edhe hadithi që transmeton Osman bin Hunejf ؓ:

“Një i verbër, erdhi tek Resulullahu ﷺ dhe i tha:

«O Resulullah! Lutuni Allahut për mua, që të ma heqë sëmundjen e syve! Verbëria e syve të mi, ma vështirëson jetën!» I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Nëse do, bëj durim, sepse kjo është më e mirë për ty.» Mirëpo i verbëri tha:

«O Resulullah! Nuk kam njeri që të më mbajë përdore. Prandaj, kjo gjendje ma vështirëson shumë jetën. Të lutem, lutu Allahut që të më hapen sytë!» Atëherë, Profeti ﷺ, tha:

«Sill enën e ujit dhe merr abdes! Pastaj fal dy rekat namaz dhe më pas bëj këtë lutje:

“O Allah! Kërkoj dhe të drejtohem Ty për hir të të Dërguarit Tënd të mëshirës, Muhamedit... O Muhamed! Po i drejtohem Zotit tim që të më japë atë që kam nevojë për hir tënd!.. O Allah! Bëje atë ndërmjetës për mua!..”

Vallahi, ne ende nuk ishim ndarë (nga Profeti), sepse biseda jonë zgjati disi. Kur pas pak, njeriu i verbër erdhi përsëri tek Resulullahu ﷺ, i shëruar plotësisht, sikur të mos kishte pasur asgjë më parë.”⁹¹

PËR HATRIN E ZEMRAVE TË THYERA

Po ashtu, në një hadith tjetër, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Midis jush, ka shumë persona me flokë të shprishur, rroba të vjetra, me pamje të çuditshme dhe që nuk u jep rëndësi askush. Por, nëse këta do të betoheshin në Allahun, Ai nuk do t’ua refuzonte betimin e tyre... Bera bin Malik, është njëri prej tyre.” (Tirmidhi, Menakib, 54/3854)

Bera ﷺ, i cili ishte vëllai i Enes bin Malik ﷺ, nuk zotëronte asgjë prej kësaj bote. Ai jetonte me pak ushqim, aq sa

91. Shih. Tirmidhi, Deauat, 118/3578; Ibn-i Maxhe, Ikame, 189; Nesai, Kubra, VI, 169; Ahmed, IV, 138; Hakim, I, 707-708; Bejhaki, Delail, V, 464; Hejthemi, II, 279.

për të mos vdekur urie. Mirëpo, varfërinë e tij, e përballonte me durim dhe mbështetje të fortë tek Allahu. Bera ﷺ, mori pjesë në një prej betejave në kohën e Omerit ﷺ. Në këtë betejë, myslimanët ishin të paktë në numër dhe kishin mbetur ngushtë. Komandanti i ushtrisë, i kërkoi me këmbëngulje Beras ﷺ, që ai të betohej në Allahun për fitoren e myslimanëve. Për këtë arsye, Bera ﷺ, tha:

“O Zoti im! Beto hem në Ty që të na japësh fitore kundër tyre dhe që të më takosh me Resulullahun!..”

Dhe me të vërtetë, të nesërmen u bë e mundur fitorja dhe Bera ﷺ, ra dëshmorë në atë betejë, ashtu siç e kishte dëshiruar. (Hakim, III, 331/5274.)

Ndërsa në një hadith tjetër, Profeti ﷺ, thotë:

“Më thirrni të dobëtit, sepse vetëm në sajë të tyre (duave të tyre), ju furnizoheni dhe ndihmoheni!” (Ebu Daud, Xhihad, 70)

Në të njëjtën mënyrë, edhe robërit e sinqertë të Allahut, janë shkak i mëshirës dhe begatisë së Tij. Ata i ftojnë njerëzit në bindjen ndaj Allahut dhe bëjnë dua për shpëtimin e ume-tit. Nëse Allahu dëshiron, për hir të këtyre robërve të Tij të dashur, i largon rreziqet e mundshme dhe fal mëshirën dhe ndihmën e Tij.

Komentuesi i Kuranit, Burseviu, në komentimin e ajetit **“O besimtarë! Kini frikë Allahun dhe kërkonin mënyra që t’i afroheni Atij!..”** (Maide, 35.), thotë:

“Ky ajet, urdhëron në mënyrë të qartë kërkimin e mënyrave dhe shkaqeve për t’u afruar me Allahun. Kjo është e domosdoshme për afrimin me Allahun. Këto mënyra dhe shkaqe, mund të jenë dijetarët dhe mësuesit e përsosur të fesë.” (Bursevi, Ruhu’l-Bejan, v. IV, fq. 543)

Një dijetar i mirë që i jep mësim nxënësit të tij, është një shkak për edukimin e nxënësit. Po ashtu, edhe mësuesit e përsosur të fesë, bëjnë të njëjtën detyrë si dijetarët në shkencat e përgjithshme, por në fushën shpirtërore.

Orientimi i robërve në rrugën e Allahut nga dijetarët dhe njerëzit e mirë, nuk është një veprimtari si ajo e murgjive apo e priftërinjve. Ata janë vetëm udhëzues së rrugës ku duhet ecur dhe nuk kryejnë funksionin e murgjive apo priftërinjve në krishterim, të cilët konsiderohen si ndërmjetës midis Allahut dhe robit. Islami e refuzon në mënyrë të prerë këtë botëkuptim. Pra, midis Allahut dhe robit, nuk mund të imagjinohet asnjë person i tretë. Robi duhet t'i drejtohet Allahut personalisht dhe në çdo moment. Besimtari adhuron vetëm Allahun dhe vetëm prej Tij kërkon ndihmë. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“(Zoti ynë!) **Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.**” (Fatiha, 5)

Nga ana tjetër, nevoja më e madhe e njeriut, është të kalojë me sukses prej sprovës së kësaj bote dhe të takohet me Allahun. Kjo pra është edhe detyra e dijetarëve dhe robërve të sinqertë të Allahut, të cilët i kapin njerëzit përdore dhe u tregojnë rrugën e drejtë. Këta njerëz, kanë marrëdhënie të mira si me Allahun, ashtu edhe me njerëzit e thjeshtë. Për rrjedhojë, ata luajnë rolin e një ure që i shpie njerëzit tek Allahu.

Një profesor i persishtes, Jaman Dede, i cili më parë ishte i krishterë, gjeti udhëzimin në rrugën e drejtë, në sajë të veprës “*Mesnevi*”, të Mevlana Xhelaleddin Rumiut. Kur e pyetën se përse e përmendte aq shumë “*Mesnevi*” un e Mevlanës, ai u përgjigj:

“Biri im! Mevlana më kapi përdore dhe duke më orientuar në derën e Profetit ﷺ, u bë shkak i udhëzimit tim. Prandaj, është pak edhe kaq sa e përmend atë njeri që u bë shkak për shpëtimin tim nga zjarri!”

Allahu i madhëruar, e ka lejuar që njerëzit të kërkojnë ndihmë nga njëri-tjetri. Madje, Ai ka urdhëruar që kur njëri kërkon ndihmë, tjetri duhet t’i përgjigjet.

Sahabët e nderuar, kërkonin ndihmë prej Resulullahut ﷺ. Po ashtu, ata kërkonin shefaatin e tij, i qanin hallet e tyre, si varfërinë, sëmundjet, borxhet etj. Pra, sa herë që kishin probleme dhe vështirësi vraponin tek ai. Gjithashtu, sipas shumë transmetimeve, në kohët e thatësirës, njerëzit vraponin tek Resulullahu ﷺ dhe kërkonin prej atij që t’i lutej Allahut të madhëruar për shi.

Sahabët e nderuar, e dinin shumë mirë se Profeti ﷺ, ishte vetëm një mjet apo një shkak për arritjen e mirësive. Realizuesi absolut i çdo gjëje, është vetëm Allahu i Madhëruar. Mirëpo, për shkak se ata shpresonin se lutjet e Profetit ﷺ, do të ishin më të pranueshme tek Allahu, ata përfitonin prej begatisë së Resulullahut ﷺ, për arritjen e afrimit me Allahun dhe të mirave të Tij. Padyshim se, ata e dinin më mirë se ne kuptimin e “shirkut” dhe “teuhidit”. Për më tepër, veprimi i tyre ka qenë plotësisht i lejuar prej Allahut dhe i aprovuar prej Profetit ﷺ dhe ata kurrë nuk e kanë konsideruar Profetin ﷺ, si Zot apo ndërmjetës midis tyre dhe Allahut, si në rastin e murgjve apo priftërinjve.

Nëse personi që kërkon një mënyrë për t’iu afruar Allahut apo për të arritur një mirësi, e sheh atë mënyrë si diçka që mund të bëjë dobi apo dëm njësoj si Allahu, atëherë kjo quhet

shirk. Nëse dikush i kërkon një personi të bëj dua për të, ta dijë se ai mund të bëhet shkak i një mirësie vetëm me lejen e Allahut dhe, në të njëjtën mënyrë, edhe një të keqe mund ta largojë vetëm në sajë të Allahut.

Kur Allahu i Madhëruar dëshiron të bëhet diçka, Atij i mjafton vetëm të thotë “Bëhu!” dhe ajo çështje ka mbaruar. Megjithatë, Allahu ka dëshiruar që disa gjëra apo ndodhi, të kryhen nga dikush që Ai e ka zgjedhur. Njëjtë si katër melekët e mëdhenj, prej të cilëve Xhibrili عليه السلام, është ngarkuar me sjelljen e shpalljeve hyjnore tek profetët, Mikaili عليه السلام, është ngarkuar me drejtimin e çështjeve të natyrës, Azraili عليه السلام, është ngarkuar me marrjen e shpirtave dhe Israfil عليه السلام, është ngarkuar me fryrjen e surit kur të vijë koha e kijametit.

Natyrisht që Allahu i Madhëruar mund t’i realizojë këto gjëra edhe pa i ngarkuar melekët me këto. Mirëpo, Ai, me vullnetin e Tij hyjnor, u ka dhënë atyre këto përgjegjësi. Pra, fuqinë që kanë, ua ka dhënë Allahu. Në të njëjtën mënyrë, edhe disa robër të zgjedhur të Allahut mund të kenë disa veçori që Allahu i Madhëruar ua ka dhënë ndryshe nga të tjerët.

Për shembull, shërimi është prej Allahut. Mirëpo, Ai e ka vendosur atë tek doktori dhe ilaçi. Për rrjedhojë, ne duhet ta kërkojmë shërimin prej Allahut me anë të ilaçit dhe doktorit. Pra, nuk është shirk, nëse njeriu shkon në spital apo në farmaci për të kërkuar ilaçin e shërimit. Çdo besimtar e di se, Ai që jep shërim, është Allahu, ndërsa doktori dhe ilaçi janë thjesht mjete dhe mënyra për të arritur shërimin.

Mirëpo, disa njerëz kërkojnë direkt prej njerëzve që konsiderohen të mirë, në mungesë të tyre apo gjatë vizitës së varrit të tyre, duke iu drejtuar atyre me fjalë të tilla si: “O filan më

jep shërim! O filan kam nevojë për këtë apo për atë!”, veprim ky, që është shumë i gabuar dhe përbën shirk ndaj Allahut. Megjithëse disa mundohet t’i interpretojnë këto shprehje, këto janë fjalë që rrjedhin prej injorancës dhe e dëmtojnë rëndë thelbin e akides/besimit monoteist, i cili është shumë i ndjeshëm. Prandaj, është jashtëzakonisht e domosdoshme që të ruheni nga këto fjalë apo mendime, sepse besimi monoteist nuk pranon në asnjë mënyrë shirkun ndaj Allahut. T’i shoqërosh Allahut dikë tjetër në adhurim apo në qëllimin e veprave të mira, konsiderohet shirk i hapur ose i fshehtë dhe është e ndaluar në mënyrë të prerë. Prandaj, këto veprime që të çojnë direkt në shirk të hapur, janë gjithashtu të ndaluara dhe të urryera.

Shkurtimisht, nuk duhet harruar kurrë se, përveç profetëve dhe atyre që kanë paralajmëruar profetët, askush nuk e ka të garantuar se do ta japi frymën e fundit me besim. Për këtë arsye, besimtari duhet ta kalojë jetën me këtë shqetësim, duke u përpjekur të jetojë çdo frymëmarrje nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit. Ai nuk duhet ta lëshojë kurrë nga zemra dhe gjuha e tij, përgjërimin:

تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ

“...(o Zot!) bëj që të vdes si mysliman dhe më bashko me punëmirët (në botën tjetër)!” (Jusuf, 101)

Disa prej shkaqeve dhe mënyrave të shumta që Allahu i Madhëruar ka krijuar për të na dhënë mirësitë e Tij, janë edhe ditët e Ramazanit dhe Bajrameve, ku falja dhe mëshira hyjnore arrijnë kulmin. Përfitimi prej këtyre shkaqeve me sinqeritet dhe dashamirësi, duke mos i humbur këto mundësi të mëdha, është domosdoshmëri e natyrshme e urtësisë së

besimit. Të hubësh këto mirësi, është një tregues mosmirënjohje ndaj Allahut të Madhëruar, i Cili na i ka falur ato. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, ka thënë:

“...Mu shfaq Xhibrili عليه السلام dhe më tha: «Qoftë larg mëshirës ai që e arrin Ramazanin dhe nuk i falen gjynahet!» Ndërsa unë thashë: «Amin!»...” (shih. Hakim, IV, 170/7256; Tirmidhi, Deauat, 100/3545)

Nisur nga kjo, ne duhet të përfitojmë në mënyrë të plotë prej ditëve dhe netëve të begata, të cilat janë shkaqe të mëshirës dhe faljes hyjnore, me qëllim që të mos jemi prej indiferentëve që pësojnë humbjen e përjetshme.

O Zot! Pranoi të gjitha adhurimet, veprat tona të mira, shërbimet dhe përpjekjet tona me të gjitha mangësitë e tyre! Bëji të gjitha këto, shkaqe të faljes dhe mëshirës Tënde për ne! Na fal për hir të të dashurit Tënd, Muhamed Mustafasë! Na bëj të jetojmë në këtë botë dhe të ngjallemi në botën tjetër së bashku me robërit e Tu të mirë!

Amin!..





"Çdo gjë që është në Tokë, është e përkohshme!" (Rahman, 26)

Dërgatitja për botën tjetër dhe vizita e varreve

Një jetë e pandriçuar me meditim rreth vdekjes, nuk ndryshon aspak nga një natë e errët fatkeqësie. Dielli i lumturisë së përhershme, lind në horizontet e atyre që dinë të jetojnë duke iu përkushtuar me zemër udhëzimit të fjalëve dhe shpalljeve hyjnore dhe vdesin me ndërgjegje të pastër.



Nesër do të bëhemi pjesë e tokës mbi të cilën sot shkelim e kalojmë. Por, për të mos u dënuar nesër nën tokë, duhet të mos mashtrohemi sot mbi tokë prej madhështive të përkohshme që e joshin egon tonë. Në këtë botë, nuk duhet të shëtitim si vendas dhe nuk duhet të harrojmë se jemi udhëtarë drejt vdekjes, që mund t'u vijë ftesa në çdo moment. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë edhe se kemi një takim të pashmangshëm me Azrailin, në një vend dhe një kohë të panjohur për ne.

PËRGATITJA PËR BOTËN TJETËR DHE VIZITA E VARREVE

Kjo botë, e cila është krijuar si një vend sprove për njerëzit dhe xhinët, është një ekspozitë e mbushur me urtësi hyjnore dhe shfaqje madhështore e mësimdhënëse. Bashkë me njeriun e fundit, do t'i vijë fundi edhe kësaj ekspozite. Pra, gjithësia dhe gjithçka që ka në të është e përkohshme. Çdo që e krijuar është e dënuar të shkojë drejt mosekzistencës dhe çdo gjallesë që ka lindur të shkojë drejt vdekjes. Madje, edhe njerëzit më kryeneçë dhe mohues, një ditë janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij fermani gjithëpërfshirës të Allahut të Madhëruar.

Mirëpo, njeriu, të cilin Allahu i pafillim dhe i pafund e krijoi dhe e pajisi me aftësi të veçanta, nuk e do kurrë përkohshmërinë dhe gjithmonë kërkon pafundësinë duke ikur prej vdekjes. Ky kërkim, është një prej cilësive më thelbësore që është vendosur në thellësitë e krijimit të tij. Për këtë arsye, **“misteri i vdekjes”**, është çështja më e rëndësishme që dëshiron të zgjidh njeriu, i cili ndodhet i burgosur në kafazin e përkohshmërisë për gjatë gjithë jetës së kësaj bote.

Për arsye se njeriu është krijuar i tillë që jepet pas së drejtës dhe të vërtetës, në thelb, ai nuk e pranon të panjohurën.



Ai gjithmonë vrapon pas së njohurës, sepse të panjohurat dhe të paqartat, i shkaktojnë atij një vuajtje të thellë.

Prandaj, paqartësia e fundit të tij dhe të panjohurat lidhur me jetën pas vdekjes, e kanë pushtuar mendjen dhe zemrën e njeriut që prej shumë kohësh. Kjo e panjohur, e cila është bërë kutullaç në mendjen e njeriut si një gjarpër helmues dhe që sa herë që lëviz e shqetëson dhe e drithëron atë shpirtërisht, është përpjekur të mbulohet me lloj-lloj konceptesh të ndryshme nga ana e njerëzve.

Megjithatë, vdekja e cila i rrethon të gjithë si një vorbull e egër dhe e zjarhtë, është fatkeqësia më e ashpër që do t'i bjerë në kokë njeriut. E, kur puna është kështu, njohja e saj, është një nga nevojat parësore për njerëzimin.

Nëse ndjenjat, mendimet dhe përpjekjet nuk thellohen mbi misterin e vdekjes, nuk mund të arrihen të fshehtat e të nesërmes në botën tjetër. Të ikësh prej vdekjes me frikë dhe drithërim, është lodhje e padobishme. Ndërsa të përpiqesh ta harrosh atë duke e anashkuar, është budallallëku më i madh. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): ja, kjo është ajo së cilës përpiqesh t'i ikje.” (Kaf, 19)

Ashtu siç nuk ka një strehë ku të fshihesh prej vdekjes, ashtu edhe nuk është dëgjuar as ndonjë lajm se ata që kanë ikur prej saj, kanë shpëtuar.

Ndodhia e vdekjes, është shqetësimi i të gjithë njerëzve, qofshin besimtar apo jobesimtar. Edhe pse njerëzit ndahen në lidhje me kuptimet që i japin vdekjes, pyetjet si: “Vallë si do të jetë halli im pas vdekjes?”, janë një shqetësim që mbështillet në zemra dhe një çështje e përbashkët e të gjithë njerëzimit.

Jeta është një e vërtetë madhështore, që nuk mund të mbetet brenda një distance të shkurtër midis djepit dhe varrit. E, ndërkohë që kjo është e vërteta, nëse përgjigja e pyetjes “Çfarë është jeta?”, që shfaqet në mendjen njerëzore, është vetëm lagështira e ftohtë e tokës dhe heshtja e ngurtë e gurëve të varrit, atëherë çfarë hidhërimi më të madh mund të ketë se sa një jetë kaq e errët?! Shpallja hyjnore, është e vetmja gjë që mund ta shpëtojë nga një e panjohur kaq e madhe botën shpirtërore të një njeriu që mendon për fundin e vet përballë tablosë së ardhjes në këtë botë dhe shkuarjes në botën tjetër. Të mund ta zgjidhësh këtë nyjë në lidhje me të ardhmen, e cila është e pamundur të kuptohet nga mendja njerëzore, varet vetëm nga lidhja e zemrës me shpalljen hyjnore dhe udhëzimin e profetëve. E vetmja derë shpëtimi ku mund të orientohet njeriu, është të jetojë në këtë botë të përkohshme në rrugën e Kuranit dhe Sunetit dhe të përgatitet për jetën e përjetshme.

Të gjithë jemi nxënësit e shkollës së gjithësisë, që është edhe vendi i provës hyjnore. Edukimi në lidhje me devotshmërinë ndaj Allahut, do të përfundojë me vulën e exhelit/çastit të vdekjes dhe do të varrosemi në gjirin e tokës së bashku me punët tona. pra, jeta e kësaj bote, është në afat kohor që na është dhënë për të fituar kënaqësinë hyjnore dhe ardhmërinë e përjetshme.

Ata që ia kanë kthyer shpinën të vërtetave hyjnore gjatë gjithë historisë, nuk kanë mundur të shpëtojnë prej rënies në devijime të ndryshme duke besuar në besëtytni të panumërta në lidhje me vdekjen dhe përtej saj. Kjo, sepse vdekja dhe përtej saj, janë çështje që e tejkalojnë mendjen njerëzore dhe është e pamundur të peshohet me peshoren e mendjeve të cekëta.



Shumë njerëz indiferentë ndaj fesë, janë përpjekur ta peshojnë konceptin e botës tjetër me mendjet e tyre. Por, kur atyre u është bërë e ditur e vërteta me anë të shpalljeve hyjnore, në vend që ta pranonin atë të vërtetë, -për shkak se nuk u pëlqente- ndonjëherë janë tallur dhe ndonjëherë janë zhytur në debate e kundërshtime të thella. Një shembull të këtyre, na e tregon edhe Allahu i Madhëruar në lidhje me idhujtarët e Mekës:

“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime.” (Nebe’, 1-3)

Shprehja “Lajmi i madh”, që ceket në ajet, komentohet kështu nga mufesiri Hamdi Efendi:

“Ky lajm, është dërgimi i Profetit ﷺ dhe në mënyrë të veçantë, lajmi për kijametin, që ai e kumtoi me Kuranin dhe profetësinë e tij... Ata që nuk besonin, e pyetnin njëri-tjetrin në lidhje me dërgimin e Muhamedit ﷺ, si profet, duke thënë: «Ç’është ky lajm?! A është ai një i dërguar nga Allahu për të thirrur në besimin e një Allahu të vetëm dhe të botës tjetër? Po ky lajmi i kijametit ç’ishte? Do të ringjallen të vdekurit dhe të gjithë do të japin llogari për veprat e tyre!?» Dikush thoshte: «Ashtu është!», dikush tjetër, «E si mund të ndodhë diçka e tillë?», e dikush tjetër thoshte: «Të jetë kështu vallë!», duke nguruar të besojë.” (Hak Dini Kuran Dili, VIII, 488-489)

Ndërkohë që ky lajm në lidhje me të ardhmen që solli Profeti ﷺ, duhej pritur me falënderim dhe mirënjohje, për fat të keq, ai u prit me fyerje dhe moskokëçarje. Ky, është një rezultat i natyrshëm që pritej prej njerëzve të mposhtur prej egos së tyre, të cilët nuk mund ta pranojnë një përfundim të tillë. Në Kuranin Fisnik, urdhërohet kështu lidhur me qëndri-

met idhnake dhe përgënjeshttrimet e idhujtarëve përballë të vërtetës së botës tjetër me të cilën u lajmëruan:

“...Betohem në Kuranin e lavdishëm! Po! Ata çuditen që nga gjiri i tyre u ka ardhur një paralajmërues, kështu që mohuesit thonë: «Kjo gjë është e çuditshme. Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur (do të ringjallemi sërish)? Ai kthim është i largët!»” (Kaf, 1-3)

Mirëpo, lidhur me faktin se ringjallja pas vdekjes, është diçka shumë e lehtë për Allahun, shprehet kështu në disa ajete të tjerë të Kuranit:

“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?! Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: «Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?» Thuaj: «Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë!»” (Ja Sin, 77-79)

“A mendon njeriu se nuk do të mund t’i mbledhim eshtrat e tij?! Po, si jo! Ne jemi të Zotë t’ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij.” (Kijame, 3-4)

“Ai e zë fill krijimin dhe Ai e përsërit atë, e për Atë kjo është edhe më e lehtë!...” (Rum, 27)

Mekasit dhe në mënyrë të veçantë ata që e mbanin veten prej fisnikëve, por që ishin robër të mendjemadhësisë dhe krenarisë, si Ebu Xhehli dhe përkrahësit e tij, nuk arrin ta duronin dot detyrën e profetësisë që i ishte ngarkuar Profetit tonë ﷺ. Për këtë arsye, ata e pritën me habi të madhe edhe lajmin që u solli ai për botën tjetër. Në suren Nebe’, e cila fillon duke cekur këto qëndrime negative të fisit Kurejsh, lidhur me lajmin që ndriçon të panjohurat pasvdekjes së njeriut, përdor

shprehjen **“lajmi i madh”**. Dhe, urtësia e kësaj, është mjaft e qartë: Të gjithë njerëzit përjetojnë një vuajtje të përbashkët përball vdekjes. Humbja e të gjitha rrugëve të gjarpëruar të jetës në horizontin e vdekjes, i lëndon thellësisht zemrat. Për të gjallët, nuk ka asnjë ndodhi më të madhe se vdekja. Për rrjedhojë, edhe ajo që e ndriçon ndodhinë pas saj, konsiderohet një lajm i madh. Mendjet që e kuptojnë këtë realitet, nuk merren shumë mirësitë e përkohshme që vijnë e shkojnë dhe, prej ëndrrave të një ardhmërie të rrejshme, orientohen drejt një ardhmërie të vërtetë e të përjetshme. E cili njeri me mendje të shëndoshë e anashkalon këtë lajm kaq të madh në lidhje me të ardhmen!?

Një jetë e pandriçuar me meditimin rreth vdekjes, nuk ndryshon aspak nga një natë e errët fatkeqësie. Dielli i lumturisë së përjetshme, lind në horizontet e atyre që dinë të jetojnë duke iu përkushtuar me zemër udhëzimit të fjalëve dhe shpalljeve hyjnore dhe vdesin me ndërgjegje të pastër. Për këtë arsye, kujtimi i vdekjes dhe përgatitja në lidhje me të, në fenë Islame është konsideruar diçka shumë e mençur. Në një hadith fisnik, thuhet:

“I mençur, është ai që e mbizotëron egon dhe duke e llogaritur atë, përgatitet për pasvdekjen...” (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459)

SIKUR JETON NË GJIRIN E VDEKJES...

Njerëzit indiferentë, lodhen kot duke ikur prej vdekjes dhe mashtrojnë veten duke e konsideruar vdekjen larg vetes. Ndërsa sahabët fisnikë që u edukuan nga dora e Profetit ﷺ dhe ata që ndoqën gjurmët e tyre, e kishin bërë parim të jetës përgatitjen për vdekjen dhe e përkujtonin shpesh atë, duke e

konsideruar veten sikur jetonin në gjirin e saj. Një nga sahabët fisnikë, **Ebu Hurejre** رضي الله عنه, e shihte vdekjen aq afër vetes, sa që kur shihte një xhenaze, i fliste të vdekurit: “*Shko, edhe neve do vijmë pas teje.*” (shih. Ihja, IV, 865.)

Ndërsa **Aliu** عليه السلام, i vizitonte shpesh varret. Një ditë, e pyetën:

“Çfarë ka ndodhur me ty? Pothuajse je bërë fqinj me varrezat.” Ndërsa ai u përgjigj:

“*Ata janë fqinj më të mirë se ju, sepse nuk flasin për mirësitë e kësaj bote, por më kujtojnë vazhdimisht botën tjetër.*” (Ihja, IV, 866.)

Me të vërtetë që, peshën e frikshme të vdekjes, nuk mund ta bartin dot supet e dobëta të fjalëve. Çdo gur varri që është mbështjellë në heshtjen e vdekjes, është një këshillues i zjarrtë që flet me gjuhën e vet. Për rrjedhojë, të dëgjosh dhe të ndjesh rënkimet e heshtura që ngrihen prej gurëve të varreve, është një fatmirësi e madhe për çdo besimtar.

Osmani رضي الله عنه, sa herë që kalonte pranë një gur varri, qante derisa i lagej mjekra. Një ditë e pyetën:

“Ti nuk qan kur përmendet xheneti dhe xhehenemi. Përse qan pranë gurit të varrit?” Ndërsa ai, përgjigjet:

“Unë qaj sepse Resulullahu صلى الله عليه وسلم, ka thënë: «*Varri, është bujtina e parë e udhës së botës tjetër. Nëse njeriu shpëton aty, pas saj është më e lehtë. Por nëse nuk shpëton aty, pas saj është më e vështirë.*»” (Ihja, IV, 867)

Mejmun bin Mihran, tregon:

Bashkë me **Omer bin Abdulazizin**, shkuam drejt një varreze. Sapo e pa varrezën, u hidhërua. Më pas, mu drejtua duke më thënë:

“O Mejmun! Këto janë varret e të parëve të mi. Duken sikur nuk janë përzierë fare me këtë botë. Pa shiko si kanë mbetur poshtë varrit! Varret u janë vjetërsuar, ndërsa trupat ua ka ngrënë toka.” Më pas, me sy të përbotur, duke parë një varr tha:

“Vallahi, nuk mund të mendojë ndonjë njeri më fatlum se ai që ka hyrë në këtë varr dhe ka shpëtuar prej dënimit.”

(Ihja, IV, 868)

VIZITA E VARREVE

Në fillim të profetësisë së tij, Profeti ﷺ, i ndaloi vizitat e varreve për shkak të rrezikut të rikthimit në idhujtari. Kjo, sepse në periudhën e injorancës, njerëzit mendonin se shpirt-rat e të parëve të tyre fitonin shenjtëri dhe, duke pretenduar për numrin e madh të të vdekurve, ata mburreshin me superioritetin e fiseve të tyre. Për këtë arsye, ata shkonin e vizitonin edhe varret. Për rrjedhojë, me qëllim që të zhdukej kjo vepër e injorancës, Profeti ﷺ, në fillim i ndaloi vizitat e varreve.

Mirëpo, kur Islami u fuqizua dhe besimi në një Zot zuri vend në zemra, tashmë nuk kishte më rrezik për adhurimin e varreve, për shenjtërimin dhe kërkimin e ndihmës prej tyre. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, e lejoi vizitën e varreve. Madje, ai e këshillonte këtë edhe me këto fjalë:

“Unë ua kisha ndaluar vizitën e varreve. Por tashmë vizitojini ato, sepse vizita e varreve ju kujton botën tjetër.”

(Tirmidhi, Xhenaiz, 60; Muslim, Xhenaiz, 106)

Gjithashtu, ai i vizitonte shpesh varret e dëshmorëve të Uhudit dhe varrezën Xhenetu'l-Baki, duke u bërë shembull personalisht në lidhje me këtë çështje. Madje, Profeti ﷺ, i

mësonte sahabët e tij, që kur të shkonin në varreza, të thoshin kështu:

“Eselamu alejkum o banorët besimtarë dhe mysliman të këtij vendi! Në dashtë Allahu, edhe ne do t’ju bashkangjitemi së shpejti. Lutem që Allahu të na falë edhe neve, edhe juve.”

(Muslim, Xhenaiz, 104)

Kur një besimtar shkon në varreza, në fillim duhet t’u japë selam banorëve të varrezave. Pastaj duhet të bëjë dua për ta dhe të mendojë që një ditë, edhe ai vet do të bëhet si ata. Një nga të dashurit e Allahut, **Hatem-i Esam**, ka thënë:

“Një njeri që shkon në varreza dhe nuk lutet për banorët e varreve duke medituuar edhe për fundin e vet, zëre se ka tradhtuar edhe veten, edhe ata.” (Ihja, IV, 868)

Në një hadith fisnik, thuhet:

“I vdekuri në varr, është si personi që është duke u mbytur në det dhe kërkon ndihmë i tmerruar. Ai pret dua prej babait, nënës, vëllait dhe prej shokëve të tij të singertë e besnikë. Nëse do të vinte një dua, për të do të ishte gjëja më e çmueshme dhe më e dashur në botë. Padyshim se Allahu i Madhëruar, në sajë të begatisë së duave të të gjallëve, i shpërblen banorët e varreve sa madhësia e maleve. Ndërsa dhurata më e bukur që mund t’i dërgojnë të gjallët të vdekurve, është kërkimi i faljes për ta dhe sadakaja në emrin e tyre.” (Dejlemi, Firdeus bi-Me’suri’l-Hitab, IV, 103/6323)

Në historinë Islame, është bërë traditë që gjatë vizitës së varreve të lexohet edhe Kurani Fisnik. Lidhur me këtë çështje, përmenden disa hadithe:⁹²

92. Lidhur me çështjen e leximit të Kur’anit të vdekurve, duhet të dimë se dijetarët janë ndarë në dy grupe kryesore. Një grup nuk e lejon leximin e Kur’anit të

“...Jasini, është zemra e Kuranit. Nëse dikush e lexon atë duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe botën tjetër, atij do t'i falen gjynahet. Suren Jasin lexojani edhe të vdekurve tuaj.” (Ahmed, V, 26.)

Ndërsa në një hadith tjetër, thuhet:

“Kur të vdes ndonjë prej jush, varroseni pa e vonuar shumë. Dhe, kur ta varrosni, dikush prej jush le t'i lexojë tek koka suren Fatiha, ndërsa tek këmbët pjesën e fundit të sures Bekare (amenerresulu).” (Taberani, Kebir, XII, 340; Dejlami, I, 284; Hejthemi, III, 44)

Nëse vizita e varreve realizohet në bazë të edukatës dhe rregullave Islame, nga kjo do të arrihen shumë mirësi. Si rezultat i meditimit të vdekjes, thyhet lakmia e egos, njeriu do t'i drejtohet më tepër devotshmërisë, do t'i zbutet zemra dhe do të ruhet prej indiferencës ndaj fesë. Varrezat, janë si një pasqyrë që tregojnë ardhmërinë e çdo njeriu. Nëse njeriu sheh shpesh tek kjo pasqyrë për të marrë mësim, do të qëndrojë larg nga humbja e jetës pas dëshirave të kota. Për rrjedhojë, vizita e varreve, është mënyra më e bukur e përgatitjes për vdekjen dhe botën tjetër.

Në bazë të besimit të ehl-i sunetit, njeriu i vdekur, dëgjon, ndjen dhe është i vetëdijshëm. Ai përfiton dhe gëzohet prej

vdekurve, ndërsa grupi tjetër e lejon me disa kushte. Të dyja grupet kanë argumentet e tyre serioze. Megjithatë, ajo që është e pranuar nga një pjesë e mirë e dijetarëve, është se Kur'ani mund të lexohet në formë duaje apo lehtësimi për të vdekurin. Gjithashtu, duhet ditur se, Kur'ani, është libër hyjnor i zbritur për të gjallët dhe jo për të vdekurit. Prandaj, çdo teprim në lidhje me këtë çështje, mund të çojë edhe në devijim. Për shkak se kjo është një temë që merr shumë kohë për t'u trajtuar në këtë libër, është e këshillueshme që para se të merret vendimi në lidhje me leximin e Kur'anit të vdekurve, të lexohen literaturat përkatëse, ose të pyeten njerëzit e ditur. (p.s.)



mirësive që bëhen në emër të tij. Ndërsa prej të këqijave hidhërohet. Pra, njeriu vdes me trup, e jo me shpirt.

Në shumë hadithe, tregohet se pasi Profeti ﷺ, ka ndërruar jetë, ai i dëgjon bisedat e njerëzve, u përgjigjet selamit të tyre, i tregohen punët e myslimanëve dhe se për gjynahet e tyre kërkon falje, ndërsa për veprat e mira falënderon Allahun. Madje, në një hadith, tregohet se kjo gjë, nuk ndodh vetëm me Profetin ﷺ:

“Veprat tuaja u tregohen të vdekurve prej të afërmeve dhe farefisit tuaj. Nëse veprat tuaja janë të mira, ata gëzojnë. Por, nëse nuk janë të mira, ata luten duke thënë: «O Allah! Mos ua merr shpirtin pa i udhëzuar edhe ata ashtu siç na udhëzove neve!»” (Ahmed, III, 164; Taberani, Kebir, IV, 129/3887)

Ndërsa në disa hadithe, tregohet se njerëzit e mirë, edhe pas vdekjes bëhen shkak i mëshirës së Allahut për njerëzit përreth tyre:

“Nëse ndonjë prej sahabëve të mi vdes në ndonjë zonë, Ditën e Kijametit ai do të ringjallet si prijës dhe dritë për popullin e asaj zone.” (Tirmidhi, Menakib, 58/3865)

“Varrosni të vdekurit tuaj pranë njerëzve të mirë.” (Dejlemi, Musned, I, 102)

Mirëpo, duhet theksuar se, gjatë vizitës së varreve, e sidomos të varreve të njerëzve të mëdhenj, duhet qëndruar larg prej disa sjelljeve të gabuara dhe bid’ateve të ndryshme që janë përhapur. Në varre nuk ndizen qirinj, nuk i drejtohet të vdekurit me lutje, duke pritur diçka prej tij, nuk vendosen ushqime, nuk hidhen para, nuk bëhet tavaf, etj.

Nuk duhet harruar kurrë se, sado i rëndësishëm të jetë personi që prehet në varr, nuk duhet kërkuar asgjë prej tij. I

vetmi prej të cilit duhet kërkuar, është Allahu i Madhëruar. Pa dëshiruar Ai, asnjë rob nuk mund të sjellë dobi dhe nuk mund ta largojë të keqen. Për këtë arsye, t'i drejtohesh të vdekurit me lutje, duke pritur prej tij, të çon në shirk ndaj Allahut. Ndërsa ata që veprojnë kështu për shkak të paditurisë, duhen paralajmëruar dhe mësuar, gjë që është detyrë për çdo besimtar.

Nga ana tjetër, nuk duhet vepruar në mënyrë radikale, si disa që duke dashur të kundërshtojnë veprimet e gabuara, e konsiderojnë “shirk” çdolloj vizite të varreve, duke përfshirë edhe ato që bëhen në përputhje me rregullat Islame.

Ashtu si në çdo çështje, edhe në çështjen e vizitës së varreve, Islami merr për bazë të mesmen. Dhe shembulli më i mirë për këtë, janë fjalët dhe veprat e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij fisnikë.

Allahu i Madhëruar na bëftë të gjithëve prej robërve të urtë, të mençur e të devotshëm, të cilët e shohin çdo ditë si ditën e tyre të fundit, që e kuptojnë të fshehtën e vdekjes pa u ardhur vdekja, që e shohin këtë botë nga dritarja e botës tjetër dhe që mësohen me ligjëratat e heshtura por drithëruese të varrezave!

Amin!..



PËRMBAJTA

PARAFJALA	5
NDJEKJA E PROFETIT ﷺ, ME DASHURI DHE BINDJE	19
Me syrin e zemrës së Ebu Bekrit ﷺ.....	20
Një dashuri më e shenjtë se jeta.....	22
Nëse e doni Allahun.....	26
Salavatet mbi Profetin ﷺ.....	28
Delikatesa e Osmanlinjve në dashurin ndaj Profetit ﷺ.....	29
ZOTËRUESI I KURANIT	37
Të pasionuarit pas vahjit (shpalljes).....	38
Kurani është i shenjtë, të fisnikëron.....	39
Të afërmit e Allahut: Zotëruesit e Kuranit.....	42
Sikur je duke folur me Allahun.....	45
Përgjegjësia jonë ndaj Kuranit.....	47
GJENDJA E “HIÇ”IT	53
Thelbi i devotshmërisë së pastër.....	55
Çdo gjë fillon pas “hiç”it.....	57
Kthehu në “hiç”, që të bëhesh dielli i diejve... ..	59
Zemrat që kanë arritur gjendjen e “hiç”it.....	63
Egoja: Shkaku i mosbindje ndaj Allahut.....	64
TË QENIT BASHKË ME ALLAHUN	69
Po ti me kë ishe?.....	70
Me kë kujtoje se isha?.....	72



Sëmundja më e keqe.....	75
Përballë mikut madhështor.....	77
Dora në këtë botë, zemra me Allahun.....	78
Tragjedia e shkujdesjes ndaj Allahut.....	81
PËRMENDJA E ALLAHUT – 1	87
Kur përmendin malet dhe gurët.....	88
Çelësat e përmendjes së Allahut.....	91
Tubimet e dhikrit.....	95
Përmendja e Allahut; Adhurimi më i madh.....	97
PËRMENDJA E ALLAHUT – 2	105
Vepra e çmuar prej mbretërisë së kësaj bote.....	107
Njerëzit që nuk shkëputen prej dhikrit.....	111
Neglizhenca e dhikrit, nuk ka arsyetim!.....	118
MEDITIMI	123
Të mos ngathtësohen zemrat!..	123
Çfarë duhet të meditojmë?..	124
Atmosfera e vërtetë e meditimit..	127
Lexo librin e gjithësisë!	128
Meditimi në jetën e adhurimit	130
Meditimi i Profetit ﷺ	131
Talenti i vërtetë	134
TË LEXOSH ME SYRIN E URTËSISË	
PËR TË MARRË MËSIM	139
Në të vërtetë, ajo që lexon, është zemra.....	140
Tablo mësimdhënëse.....	145
Të shohësh anën mësimdhënëse të ngjarjeve.....	149
FALËNDERIMI	155
Falënderimi; një mirësi që duhet të falënderohet.....	156
Pjesët e falënderimit.....	157
Gjysma e fesë.....	160
Na bëj prej të paktëve!.....	162
Morali islam.....	164
Falënderim në çdo situatë!.....	165

Mirësia e vërtetë.....	167
Përmbledhje.....	169
TË JETOSH ME PASIONIN E ADHURIMIT.....	173
Frytet e adhurimit.....	173
Frymëzimi shpirtëror i mëngjeseve.....	175
Në adhurim nuk ka dembelizëm!.....	177
Vazhdimësia: Argumenti i pranimit të adhurimit.....	180
Shpëtimi nga humbja.....	183
MORALI ISLAM.....	189
Virtutet që e bëjnë robin të dashur tek Zoti i tij.....	193
Bëje zemrën pasqyrë të moralit hyjnor.....	196
Rruga për tek Allahu.....	199
Miqësia me Allahun.....	200
TË JETOSH MORALIN ISLAM -1.....	205
Musauuir.....	206
Bari.....	208
Er-Rrezzak.....	209
Maliku'l-Mulk.....	212
Mu'min.....	214
Es-Sabur.....	216
Kerim.....	217
Er-Rahman, Er-Rahim.....	218
TË JETOSH MORALIN HYJNOR -2.....	225
Uedud.....	225
Afuv.....	229
Halim.....	235
Es-Settar.....	238
TA BËSH SHPIRTIN FOLE MËSHIRE.....	245
Dashuri dhe bindje.....	246
Pjekuria shpirtërore.....	247
Virtutet mbi virtutet.....	249
Horizonti i mëshirës.....	251
Mos i bëj keq as milingonës!.....	255

Për hir të Krijuesit!.....	256
MËSHIRË NDAJ KRIJESAVE PËR HIR TË KRIJUESIT	261
Vetëm sepse e ka krijuar Allahu.....	263
Shikim mëshirues.....	264
Morali islam.....	268
HORIZONTI I BEGATISË	
NË QËNDRIMIN ME NJERËZIT E MIRË.....	279
Ndikimi shpirtëror.....	279
Mos u shoqëro me njerëzit e këqij!.....	282
Kur kritereve u shtohen detajet... ..	283
Entuziazmi i begatisë.....	286
Dashuria është kusht!.....	290
Mos e kthe mjetin në qëllim!.....	291
MËNYRAT E AFRIMIT ME ALLAHUN.....	295
Mënyrat e arritjes tek Allahu.....	296
Për hatrin e zemrave të thyera.....	299
PËRGATITJA PËR BOTËN TJETËR DHE VIZITA E VARREVE.....	309
Sikur jeton në gjirin e vdekjes.....	314
Vizita e varreve.....	316

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri

Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

/ Osman Nuri Topbash; përkth. Ilir Hoxha;

red. ZijaVukaj. – Shkodër: Progresi, 2016

[V.]2, 326f.; 15 x 21 cm.

Tit. origj.: Ornek ahlakindan: hak dostlarinin

ISBN 978-9928-207-13-5

1.Feja islame 2.Morali 3.Etika islame

28 -42